Jugosllavia u shemb në Trepçë

h

Anna Di Lellio

Botuar së pari në italisht, në vitin 2024 nga Prospero Editore si

La Jugoslavia crollò in miniera. Kosovo 1989: Lo sciopero di Trepça e la lotta per l'autonomia.

Përkthimi: Majlinda Bregasi

Parathënia: Korab Krasniqi

Lektorimi: Aulonë Kadriu

Copyright: ©Anna Di Lellio

Përkthimi në shqip Copyright: ©Majlinda Bregasi

ISBN: 978-9951-776-08-0

Botues: Kosovo Oral History Initiative dhe forumZFD

(Forum Ziviler Friedensdienst e.V. | Forum Civil Peace Service)

Prishtinë

2025

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

622(=18:497.1)(091)

82-94

Di Lellio, Anna

Jugoslavia u shemb në Trepçë / Anna Di Lellio ; përkthimi Majlinda Bregasi. - Prishtinë : Iniciativa për Histori Gojore, 2025. - 224 f. ; 21 cm.

1. Bregasi, Majlinda

Brezit të ri, që ta kujtojnë me

krenari historinë e tyre

Përmbajtja

Parathënie

Shënim

Një ngjarje transformuese

EPOKA E ARTË

"TREPÇA PUNON, BEOGRADI NDËRTON!”

“REVOLUCIONI I JOGURTIT”

MARSHI

GREVA

VIZITA E ŠUVARIT

SOLIDARITET DHE REAKSION

KUNDËRREVOLUCIONARËT

LUFTA VAZHDON

HISTORIA DHE KUJTESA

Lista e rrëfimtearËVE/eve

Parathënie

Rezistenca politike e klasës punëtore:

Grevat e minatorëve të Trepçës 1989

Në vitin 2020, forumZFD Programi në Kosovë dhe Iniciativa për Histori Gojore konceptuan projektin me titullin punues "Një mijë metra në nëntokë", i cili synonte të dokumentonte dhe të arkivonte përvojat e minatorëve të Trepçës dhe të akterëve të tjerë të përfshirë në grevat të vitit 1989 — ngjarje kjo e cilësuar nga shumëkush si pikënisja e shpërbërjes së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Pas angazhimit me punën në desk dhe literaturën, si dhe pas analizimit të materialeve arkivore të siguruara nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës, Arkivi i Kosovës dhe Arkivi i Radiotelevizionit të Kosovës, RTK, (dikur Radiotelevizioni i Prishtinës), nisëm bashkëpunimin me Sindikatën e Pavarur të Minatorëve të Trepçës.

Gani Osmani, minator aktiv dhe pjesëmarrës në grevën e vitit 1989, si dhe ushtrues detyre në sindikatë, na priti me shumë dashamirësi në zyrën e tij dhe shprehu gatishmërinë për na mbështetur gjatë procesit kërkimor, nëpërmjet ndihmës me rrjetëzim dhe përkrahjes logjistike. Për më shumë, ai u bë njëri nga minatorët e parë që intervistuam. Biseda me Ganiun ishte jo vetëm informative, por edhe frymëzuese. Ajo u pasua me plot 24 intervista të tjera tejet të rëndësishme. Intervistat u organizuan ashtu që të përvijonin përvojat jetësore të minatorëve dhe ofruan një mirëkuptim të thelluar dhe shumëdimensional mbi jetën, politikën, kulturën, ekonominë dhe traditat mbizotëruese në Kosovën e kohës.

Me qëllim që intervistat të ishin të hapura, të balancuara, dhe të shërbenin si burime autentike historike, ato u realizuan në formatin e historisë gojore, u regjistruan si material audio-vizual dhe u transkriptuan besnikërisht e pa ndërhyrje redaktoriale.

Përdorimi i historisë gojore për hulumtimin e përvojave të minatorëve dhe dokumentimin e grevës së Trepçës të vitit 1989 solli përparësi të veçanta që shkojnë përtej kufizimeve të burimeve arkivore tradicionale. Kjo mundësoi që zërat e minatorëve protagonistë të grevës së vitit 1989 të shpër-faqen në masë dhe të kontribuojnë në ndërtimin e një mozaiku përvojash të ndërthurura, që shpalosin një përmasë njerëzore, shpesh të munguar në narrativat zyrtare.

Intervistat nxorën shumë aspekte komplekse të grevës – motivimin, sfidat, mobilizimin, dhunën, idealet, reziliencën, qëndresën dhe sakrificën – dhe hodhën dritë edhe mbi pasojat politike dhe ndikimin afatgjatë të veprimeve politike të minatorëve. Nga këto intervista u ndërtua arkivi i gjallë i kujtesës

kolektive për minatorët, që shërbeu si burim i besueshëm historik dhe kontribuoi në nxjerrjen në pah të zërave që shpesh mbeten në margjina të historisë së shkruar.

Po ashtu, hulumtimi informoi realizimin e ekspozitës “Hapësira e përpjekjes politike: Miniera e Trepçës 1989”, kuruar nga Erëmirë Krasniqi, që u instalua në hapësirat e Muzeut Kombëtar të Kosovës. E hapur nga 1 deri më 28 shkurt 2022, ekspozita mirëpriti një numër të madh vizitorësh, përfshirë minatorë, studentë, grupe shkollore, vendimmarrës e turistë, dhe shërbeu si platformë reflektimi mbi ngjarjet historike të grevës.

Hulumtimi dhe ekspozita u mbështetën me fondet e siguruara nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). Qëllimi i tyre ishte jo vetëm të ruanin dëshmitë e drejtpërdrejta të minatorëve që ndodheshin në qendër të ngjarjeve të asaj kohe, por edhe të mundësonin artikulimin e pozicioneve të tyre në një kon-tekst më të gjerë, në prag të ndryshimeve të mëdha politike e shoqërore në rajon e në nivel global.

Në vitet që pasuan, autorja e këtij libri, Anna Di Lellio, u angazhua me arkivin e gjallë të Iniciativës për Histori Gojore dhe katërçipërisht shqyrtoi hulumtimin mbi grevat e minatorëve. Përmes një analize të thelluar, ajo kontribuoi në teorizimin dhe strukturimin e historive gojore, duke i integruar ato në një kuadër më të gjerë historik dhe politik. Në vitin 2024, libri u botua fillimisht në gjuhën italiane me titullin "La Jugoslavia crollò in miniera – Kosovo 1989: Lo sciopero di Trepça e la lotta per l’indipendenza". Një vit më vonë, në 2025, libri u përkthye mjeshtërisht në gjuhën shqipe nga Majlinda Bregasi dhe u redaktua me shumë përkushtim nga Aulonë Kadriu.

Në kontekstin pedagogjik dhe të politikave të kujtesës, diskursi historik mbi ngjarjet e vitit 1989 në Stantërg ka një rëndësi të veçantë, sidomos duke pasur parasysh kapital-izimin dhe monopolizimin e egër të së kaluarës traumatike të Kosovës. Kjo e kaluar shpesh paraqitet në mënyrë të njëanshme, herë përmes një narrative glorifikuese e herë përmes viktimizimit, në varësi të dinamikave politike dhe të interesave ditorë. Kjo qasje shpesh anashkalon përvojat civile të rezistencës, meqë lë në hije dimensionet më të gjera të angazhimit shoqëror dhe politik të kohës.

Siç thekson vetë autorja, dekada e fundit e mijëvjeçarit të kaluar shënoi shpërbërjen e Federatës Jugosllave, që e ktheu atë nga një shtet socialist unitar në disa republika të pavarura, të përfshira në konflikte etnike dhe politike. Në fund të viteve 1980, ngritja e nacionalizmit dhe kriza ekonomike destabilizuan Jugosllavinë. Njëra nga figurat më polarizuese të kësaj kohe ishte ajo e Slobodan Miloševićit, i cili u bë udhëheqës i Serbisë në vitin 1989. Milošević forcoi kontrollin mbi institucionet federale dhe ndryshoi kushtetutën serbe, duke ua hequr autonominë Kosovës dhe Vojvodinës. Këto veprime nxitën reagime të ashpra në Kosovë dhe rritën tensionet mes republikave federative.

Me 17 nëntor 1988, punëtorët dhe minatorët e kombinatit “Trepça” marshuan drejt Prishtinës për të kundërshtuar ndryshimet kushtetuese që synonin ta supri-monin autonominë e Kosovës. Si rezultat i këmbënguljes së minatorëve dhe si përgjigje ndaj përndjekjes sistematike që iu bë pjesëmarrësve në marsh, më 20 shkurt 1989 nisi greva e minatorëve të Trepçës, njëri nga aktet më të fuqishme të rezistencës së klasës punëtore në

Kosovë kundër shtypjes dhe pabarazisë ndaj shqiptarëve të Kosovës në Jugosllavi. Sipas Shkëlzen Maliqit, shqiptarët përjetuan një moment të thellë katarze dhe një shpërthim të pakënaqësisë së shtypur për shumë vite.

Më 20 shkurt, ditë e hënë, 1,350 minatorë nisën grevën në zgafellën e minierës së Stantërgut, në horizontet 7, 8 e 9, të ndodhura 600 deri në 800 metra nën tokë. Kërkesat e tyre ishin kryekëput politike: mbrojtja e autonomisë së Kosovës, dorëheqja e udhëheqësve të imponuar nga Beogradi, ndalja e politikave diskriminuese ndaj shqiptarëve dhe ndërkom-bëtarizimi i çështjes së Kosovës.

Greva trondit sistemin politik jugosllav dhe u pasua nga një valë represioni, që përfshiu arrestime, largime masive nga puna dhe përkeqësim të mëtejmë të situatës politike në Kosovë.

Qëndresa e klasës punëtore të Trepçës solli ndryshime që forcuan ndjesinë e përbashkësisë dhe përpjekjen për autonomi e barazi. Ajo ngriti ndjeshmërinë shoqërore për padrejtësitë dhe ndikoi drejtpërdrejt në industrinë minerare, meqë shkaktoi dëme të ndjeshme në ekonominë jugosllave, çka nxiti reagime të shumta. Minatorët forcuan identitetin kolektiv dhe u bënë simbol i rezistencës, duke nxitur lëvizje si pajtimi i gjaqeve dhe organizimi sindikal me parimin “familja ndihmon familjen”.

Libri "Jugosllavia u shemb në Trepçë" nga Anna di Lellio ofron një artikulim të hollësishëm të ngjarjeve të lartpërmendura. I mbështetur në rrëfimet jetësore të minatorëve dhe të akterëve të tjerë të përfshirë, si dhe me anë të një analize të thelluar historike e politike, libri hedh dritë mbi kompleksitetin e grevës dhe ndikimin e saj të gjerë. Nëpërmjet intervistave dhe dokumenteve të zgjed-hura, shohim se si rezistenca, solidariteti i punëtorëve dhe aspiratat politike u ndërthurën në një moment që trondit themelet e Jugosllavisë së atëhershme.

Greva e minatorëve të Trepçës nuk ishte vetëm një përplasje me pushtetin dhe politikat diskriminuese, por edhe “hapësirë e përpjekjes politike” dhe e shprehjes së dinjitetit njerëzor, një akt i guximshëm që sfidoi shtypjen dhe ua ndryshoi rrjedhën ngjarjeve.

Ky libër është më shumë sesa një rikujtim i asaj që ndodhi; është një reflektim mbi mënyrën se si rezistenca e punëtorëve dhe lëvizjet shoqërore formësojnë të ardhmen. Në këto faqe, lexuesi jo vetëm mund të gjejë dokumentimin e ngjarjeve të kohës, por ftohet edhe të kuptojë më thellë rolin e punëtorëve në historinë politike të vendit, të rajonit e më gjerë. Zhvillimet, që përmblidhen në të, shpalosin një histori që kërkon të tregohet dhe një të vërtetë që nuk duhet harruar.

Korab Krasniqi

forumZFD, programi në Kosovë

Shënim

Në shkurt të vitit 2000, e vizitova për herë të parë minierën e Stantërgut, që ndodhet në veri të Kosovës dhe në jug të qytetit të Mitrovicës. Po realizoja një dokumentar rreth periudhës së pasluftës — dokumentar që s'e pa kurrë dritën. Për të hyrë në minierë, qoftë edhe vetëm për t'i vizituar zyrat në sipërfaqe, duhej një leje e posaçme nga qeveria e atëhershme e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Miniera ishte braktisur gjatë luftës së viteve 1998-1999, por në 10 vitet e fundit kishte funksionuar me një ritëm shumë të ngadaltë, që kur presidenti dhe udhëheqësi i plotfuqishëm i Serbisë, Slobodan Milošević, kishte pushuar nga puna të gjithë punëtorët shqiptarë, pas grevës së madhe të shkurtit të vitit 1989.

Një ekspert ekonomik i Agjencisë Evropiane për Rin-dërtim, së cilës i ishte ngarkuar udhëheqja e sektorit ekonomik, më shpjegoi se kishte shumë pak mundësi për të nisur sërish prodhimin; do të duheshin investime të mëdha dhe konkurrenca me ndërmarrjet tjera të nxjerrjes së min-eraleve nga vendet tjera ishte tepër e fortë për t'i justifikuar investimet. Vërtet, problemi kryesor i Stantërgut ishte se Serbia nuk kishte më sovranitet mbi Kosovën, por vazhdonte, si sot, të këmbëngulë në të drejtat e saj mbi pronat e Jugosllavisë të shpërbërë, për të cilat pretendonte të jetë trashëgimtare; ndër të tjera, Milošević e kishte përkeqësuar çështjen e pronësisë duke u shitur pjesë të ndërmarrjes kompanive franceze dhe greke.[1] Stantërgu rifilloi punën 10 vjet pas vizitës sime, por çështja e pronësisë së minierës vazhdon të jetë e kontestuar edhe sot në Kosovën e pavarur dhe niveli i prodhimtarisë së saj është veç një hije e asaj që ishte në të kaluarën.

Teksa lexoja intervistat me protagonistët e grevës së shkurtit 1989, të cilat u realizuan midis viteve 2020-2022 nga Oral History Initiative Kosovo (Iniciativa për Histori Gojore e Kosovës) në bashkëpunim me organizatën gjermane ForumZFD, m'u kujtuan pamjet e zhveshtoreve së minierës, të cilat atëherë më kishin lënë shumë përshtypje. M'u kujtuan zinxhirët, që lëshoheshin të varur nga tavani dhe shërbenin për t'i vendosur rrobat e punës. M'u kujtua edhe ndjesia sikur ndodhesha në një univers paralel. Intervistat më ndihmuan t'i mbushja me zë ato hapësira fantazmë dhe ta tregoja historinë e grevës që mbylli minierën dhe tronditi gjithë Kosovën dhe përtej.

Intervistat janë arkivuar në faqen e Oral History Kosovo (https://oralhistorykosovo.org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/). Janë filmuar, transkriptuar dhe janë të qasshme për publikun në gjuhët shqipe, angleze dhe serbe. Përmbledhja përfshin intervista me minatorë, kuadro dhe drejtues të kompleksit minerar "Trepça", të cilit i përket Stantërgu, si dhe me dy juristë,

tre udhëheqës krahinorë të Lidhjes Komuniste dhe personalitete tjera të kohës. Në këtë libër kam përfshirë edhe gjashtë intervista me minatorë të Trepçës, të nxjerra nga përmbledhja me 10 vëllime, botuar nën përkujdesjen e Arsim Canollit: "Kujtesa e Trepçës. Rrëfime të 100 punëtorëve të Trepçës" (7Arte: Botime të Veçanta, 2023). Këto vëllime janë të botuara vetëm në gjuhën shqipe.

Pavarësisht përpjekjeve të shumta për të rënë në kontakt me minatorë ose përfaqësues tjerë serbë për t'i intervistuar për këtë libër, kjo nuk ndodhi. Pavarësisht nëse banojnë në Serbi apo në pjesën veriore të Mitrovicës, serbët e refuzojnë bashkëpunimin me institucionet në Kosovën e pavarur. Kushdo që do të ishte i gatshëm të bashkëpunonte, do përballej me kërcënimet nga grupet ekstremiste nacionaliste dhe me trysni nga lart, nga Serbia dhe nga presidenti aktual, Aleksandar Vučić, ish-ministër i informacionit gjatë kohës së Slobodan Milošević. Për ta plotësuar mungesën e këndvështrimeve të ndryshme, më ndihmoi historiografia e re e shkëlqyeshme e lëvizjes punëtore gjatë periudhës së trazuar të fundviteve të '80-a në Jugosllavi. Kam konsultuar gjithashtu burime të ndryshme dytësore dhe sigurisht kam përfituar shumë nga kërkimi im 20-vjeçar rreth politikës, kulturës dhe historisë së shqiptarëve në Kosovë.

Në rastet kur flasin rrëfimtarët/et, jam përpjekur të ruaj ngjyrën e bisedave të intervistave. E kam konsideruar të panevojshme që ta konfirmoj përmbajtjen e intervistave të zgjedhura për këtë libër, meqë të gjitha intervistat janë publike.

[1] *Trepca: Making Sense of the Labyrinth*, ICG Balkans Report N. 82, Washington- Prishtinë/ Priština, 26 nëntor 1999.

Një ngjarje transformuese

Më 27 shkurt 1989, një nga grevistët e parë që doli nga hyrja kryesore e minierës së Stantërgut, në veriun e Kosovës, ishte një minator në gjendje gjysmë të vetëdijshme, i bartur me barelë.[2] E përcillnin në këmbë katër veta, që mbanin në duar portretin gjigant të marshallit Tito, udhëheqësit të Jugosllavisë socialiste që nga çlirimi, në vjeshtën e vitit 1944, deri në vdekjen e tij, në vitin 1980. Pas tyre, ngadalë doli një kolonë e gjatë me burra të rraskapitur, që kishin kaluar shtatë ditë në baltë deri në gju, në rreth 600 metra nën sipërfaqen e tokës, në horizontin e nëntë të minierës.

Për rreth një javë, 1,300 minatorë shqiptarë kishin ndaluar prodhimin për të protestuar kundër ndryshimit të Kushtetutës së vitit 1974, që do të

kufizonte dukshëm autonominë e Kosovës, krahinë e Republikës jugosllave të Serbisë. Grevistët kërkonin dorëheqjen e menjëhershme të drejtuesve krahinorë, të cilët ishin imponuar nga Lidhja e Komunistëve të Serbisë për të zëvendësuar ata që kishin qenë në detyrë e të cilët konsideroheshin sapodak "të bes-ueshëm" sepse e kishin kundërshtuar ndërrimin e Kush-tetutës. Punëtorë të ndërmarrjeve tjera, studentë dhe intelektualë iu bashkuan grevës në një manifestim të jashtëzakonshëm të solidaritetit popullor. Komuniteti lokal serb, jo vetëm që u distancua, por shprehu publikisht kundërshtinë ndaj grevës së "irredentistëve" shqiptarë.

Minatorët dolën në hyrjen e errët të minierës vetëm pasi u siguruan se dorëheqjet e kërkuara ishin nënshkruar, por kjo s'ishte e vërtetë — autoritetet i kishin mashtruar. Asnjë dorëheqje nuk ishte dhënë, apo më saktë, edhe nëse kishte ndonjë, ishte refuzuar. Në vend të kësaj, ndryshimet e Kushtetutës së vitit 1974 ishin miratuar më 22 shkurt dhe Republika e Serbisë po rikonfirmonte kontrollin e saj mbi krahinat e Vojvodinës dhe Kosovës. Sipër, mbi tokë, minatorët nuk po i priste triumfi, por një fushatë arrestimesh, që përfshiu ish-kreun e Lidhjes së Kosovës dhe drejtuesit e Këshillave të Punëtorëve të ndërmarrjes dhe të minierës, me një dënim masiv për të gjithë grevistët.

Në dy vitet para grevës, besimi i munguar tradicionalisht mes serbëve dhe shqiptarëve, i përkeqësuar në dekadën e kaluar, ishte shndërruar në armiqësi. Pas grevës, u bë luftë e hapur. Brenda pak ditëve, mijëra policë dhe ushtarë të ardhur nga të gjitha republikat jugosllave zbarkuan në Kosovë për t'iu kundërpërgjigjur asaj që Beogradi e kishte quajtur një "kundërrevolucion" nacionalist. Pas protestave, të cilat u shtypën me dhunë nga ndërhyrja e policisë, ku pati edhe të vrarë, Serbia e aneksoi sërish Kosovën.

Drejtori teknik i Stantërgut dhe protagonisti i mobilizimit masiv të minatorëve, Ibush Jonuzi, nuk ka asnjë dyshim se greva ishte e suksesshme: "Se më kanë pyt shumë, 'A osht' arritë?' Efekti osht' arritë. Efekti i grevës osht' arritë, dhanë dorëheqje, s'dhanë dorëheqje, efekti osht' arritë sepse osht' shku synimi në vend. Edhe pamë, jemi dëshmitarë të asaj kohe edhe pse prej atij momenti gjithçka ka ndrrue në vazhdimësi te Kosova. Se ju ka dhonë goditje ma të fortë greva e minatorëve, ju ka dhonë ish-Jugosllavisë. Fillun minatorët mas leximit të atyre dorëheqjeve me dalë, që ka qenë e tmerrshme me pa. Edhe ka qenë e rrezikshme me metë pa të pame… megjithatë, pasoja ka lonë, gjurma shëndetësore ka lonë te të gjithë, po mbi të gjitha edhe nji herë po thom, osht' arritë efekti." (*Ibush Jonuzi*).

Ibush Jonuzi nuk është i vetmi që e cilësoi grevën si një ngjarje transformuese dhe kjo s'kishte të bënte vetëm me faktin se ajo ishte greva më e madhe dhe më e gjatë në historinë e industrisë minerare. Greva e transformoi Kosovën. Aziz Abrashi dhe Burhan Kavaja, drejtorët përkatës të kompleksit minerar "Trepça" dhe të "Stantërgut", shkruan në vitin 1996 se "minatorët e 'Trepçës' u vendosën në ballë të rezistencës aktive të shqiptarëve të Kosovës e më gjerë — të të gjitha trojeve etnike shqiptare në ish-Jugosllavi", që protesta e tyre hyri në histori si "lëvizjet e gjera patriotike për çlirimin kombëtar nga pushtuesit dhe armiqtë e ndryshëm" dhe që ato lëvizje u zhvilluan si vazhdimësi dhe prej më herët, e sidomos kohës së Lidhjes së Prizrenit dhe Rilindjes Kombëtare shqiptare nën Perandorinë Osmane.[3] Por edhe figura të tjera intelektuale dhe politike të kohës i konsideruan minatorët në grevë si përfaqësuesit e parë popullorë të një kombi shqiptar, që aspironte

pavarësinë e Kosovës nga Jugosllavia, për të cilën do të flas më vonë.

Këtu më vjen në mendje një mobilizim tjetër i mirënjohur i punëtorëve – marshimi i punonjësve të fabrikës së automjeteve "Industrija Motora Rakovica" drejt Beogradit, disa muaj para grevës në Trepçë, në tetor të vitit 1988, të cilën gazetari Jagoš Djuretić e ka përshkruar kështu: "Arritën si punonjës dhe u larguan si serbë." Në të gjitha interpretimet e ngjarjeve të Trepçës dhe Rakovicës duket sikur janë shfaqur identitete kombëtare të shtypura për një kohë të gjatë – secili me kërkesat e veta – për të shkatërruar, jo vetëm solidaritetin e klasës punëtore, por edhe karakterin mbinacional të Jugosllavisë socialiste. Që këtu lind edhe shpjegimi i shpërbërjes së Jugosllavisë që bazohet në teorinë e nacional-izmave kundërshtare, një teori gjerësisht e pranuar, së cilës i dhanë edhe më shumë peshë kërkesat e mëvonshme për pavarësi të sllovenëve dhe kroatëve.

Nëse i analizojmë ngjarjet e dekadës, që nga viti 1989, me të vërtetë kemi përpara një skenar të bindës të shpërbërjes së Jugosllavisë. Viti 1989 nisi me grevën e Trepçës; 1999 ishte viti i shkëputjes së Kosovës prej asaj që kishte mbetur prej Jugosllavisë, pra Serbia dhe Mali i Zi, pas ndërhyrjes ushtarake të NATO. Në dhjetor të vitit 1989, për të sfiduar represionin e regjimit, në Kosovë u shfaq me ndrojtje një panoramë e re politike pluraliste, e cila menjëherë u homogjenizua nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), një parti-lëvizje që përfshinte pothuajse të gjithë shoqërinë shqiptare.

Nga viti 1990 e tutje, hapësirat politike për pjesëmarrje demokratike dhe protestë u mbyllën përfundimisht. Regjimi i Slobodan Milošević, udhëheqësi komunist i Serbisë, shkarkoi masivisht shqiptarët nga vendet e tyre të punës, fillimisht nga forcat e rendit, pastaj nga ndërmarrjet publike, përfshirë Trepçën, si dhe nga shërbimet si spitalet dhe shkollat, duke i zëvendësuar me punonjës serbë. Shteti, institucionet dhe ekonomia formale u bënë ekskluzivisht serbe, ndërsa shqiptarët u organizuan në një shoqëri të ndihmave të ndërsjella, të mbështetur gjerësisht nga diaspora. Kosova u nda në dy botë paralele, por të pabarabarta; arrestimet arbitrare të shqiptarëve u shtuan, ashtu si edhe dhuna policore.[4]

E gjithë kjo ndodhte në kohën kur regjimet komuniste të bllokut sovjetik po binin një nga një si domino nga një valë mobilizimesh demokratike. Ndërkohë, në Serbi, mijëra demonstrues, që dilnin nëpër rrugë, ishin mobilizuar në mbrojtje të të drejtave të tyre kundër agresionit të armiqve të brendshëm "kundërrevolucionarë." Tribuni i tyre ishte Slobodan Milošević. Nën presionin nga poshtë për një "Serbi të Madhe", dhe nga lart, të elitave politike dhe ushtarake federale, për një "Jugosllavi të Madhe", socializmi jugosllav u shndërrua në një sistem autoritar nacionalist dhe populist. [5] Brenda një kohe të shkurtër, Jugosllavia shkoi drejt shpërbërjes.

Në verën e vitit 1991, pasi shpallën pavarësinë, Beogradi filloi luftën me Slloveninë dhe Kroacinë dhe, një vit pas, i erdhi radha Bosnjës e Hercegovinës, ku ngjashëm me Kosovën, një rajon me shumicë myslimane, jehona e "përplasjes së qytetërimeve", e nxitur nga nacionalizmi serb, përshkallëzoi dhunën.

Lufta trokiti në Kosovë në vitin 1998, pas rreth një dekade rezistence civile nga shqiptarët, me fillimin e aktiviteteve të grupit të armatosur, Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Përgjigjja e Miloševićit ndaj guerilës ishte një

kundër-ofensivë e përgjakshme, që nuk bëri dallimin ndërmjet të të armatosurve dhe civilëve, të cilët i kishte në shënjestër, duke shkaktuar zhvendosjen dhe masakrimin e mijëra njerëzve.[6] Në mars të vitit 1999, ngjashëm me gjenocidin në Srebrenicë, vetëm katër vjet më parë, NATO ndërhyri me një fushatë bombardimesh që përfundoi me tërheqjen e forcave serbe nga Kosova, duke hapur rrugën për pavarësinë në vitin 2008.[7]

Rrëfimet e këtilla, si të gjitha *emplotment,* janë vetvetiu të diskutueshme. Greva e Trepçës ndodh në një moment kritik të shpërbërjes së Jugosllavisë dhe përbën një pikë kthese, por jo për shkak se identiteti i saj kombëtar çoi pashmangshëm në rrënimin e multi-nacionalizmit jugosllav. Po ta besonim këtë teori, nuk do të kuptonim që ngjarjet nuk ndodhin në mënyrë të thjeshtë, por ndërtohen si ngjarje, ato janë krijime të çastit të historisë, që kanë një të kaluar dhe një të ardhme plot kuptim.[8] Vlerësimet për grevën e Trepçës, të paraqitura më lart, e ilustrojnë këtë proces sepse, për ta shndërruar një ndodhi në një ngjarje, domethënë për ta lidhur atë me ngjarje të tjera, mbështetemi te repertori i çështjeve politike dhe kulturore të njohura kolektivisht,[9] në këtë rast, çështja kombëtare shqiptare, ose mospërfshirja e një pjese të popullsisë shqiptare në Shqipëri dhe aneksimi i saj nga shteti i sllavëve të jugut.

Por kështu përhumbet plotësisht subjektiviteti i lëvizjes punëtore, që duke parafrazuar historianin Goran Musić, në fund të viteve të '80-a luajti një rol vendimtar në vetëdijësimin e Jugosllavisë për çështjet e diskutueshme politike dhe u hapi rrugë formave të tjera të mobilizimit edhe në vendet tjera, jo vetëm në Kosovë.[10] Musić e nisi këtë prirje me grevën e madhe të dhjetorit në vitin 1987, në fabrikën e makinerisë së rëndë në Litostroj, Slloveni. Edhe ajo grevë, e filluar si protestë për mospërshtatjen e pagave me inflacionin, u bë politike dhe u karakterizua nga një pjesëmarrje e fortë e punonjësve, nën udhëheqjen e kuadrove. Ndryshe nga Trepça, grevistët sllovenë protestuan kundër menaxhmentit të fabrikës dhe sindikatës, madje votuan për themelimin e një partie të re socialdemokrate, që do bashkonte intelektualët me klasën punëtore si një alternativë ndaj komunistëve. Greva dështoi, por sinjalizoi qartë orientimin për pavarësi të udhëheqësisë liberale sllovene në aleancë me lëvizjet në bazë, të pakënaqura me menaxhimin politik dhe ekonomik jugosllav. Ashtu si në Slloveni, edhe në Serbi dhe Kosovë, u zgjerua lëvizja për një proteksionizëm, republikan ose krahinor, varësisht nga konteksti, që u ndërthur me aspiratat për pavarësi kombëtare.

Kur flitet për nacionalizmin në kontekstin e shpërbërjes të Jugosllavisë, zakonisht përgjithësohen prirje shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. Për këtë arsye, zgjodha të shkruaj një histori gojore të grevës së Trepçës, sepse historia gojore, për dallim nga qasjet tjera, mundëson të shqyrtohen jo vetëm ngjarjet, por edhe kujtimet, synimet dhe ndjenjat e individëve dhe grupeve, pra, elementet e subjektivitetit. Përmes saj, shohim se si, në Trepçë, minatorët, teknikët, inxhinierët dhe menaxhmenti formuan një unitet të jashtëzakonshëm, jo vetëm sepse ishin shqiptarë, por sepse kishin ndërtuar një identitet të fortë grupor përmes brezave që dolën nga varfëria dhe margjinalizimi i thellë falë kësaj ndërmarrjeje — një identitet ky i fuqizuar nga krenaria e të qenit pjesë e xhevahirit të ekonomisë së vendit. Në historinë e Trepçës gjatë viteve të '80-a, ky solidaritet u manifestua në hapësirat e lirisë së krijuar prej vetëmenaxhimit relativisht të pavarur të ndërmarrjes, që ishte krenaria e strukturës socialiste jugosllave, si dhe në përpjekjet për të hartuar politika tregu që përplaseshin me politikën e dominuar nga Lidhja Komuniste.

Fakti që identiteti kombëtar ishte i rëndësishëm për grevistët ishte i patjetërsueshëm, por prapëseprapë mbetej vetëm njëri prej elementeve në repertorin e ideve që ndikuan në mobilizimin për protestë. Së fundmi, historiani Pieter Troch erdhi në përfundim të ngjashëm pas një hulumtimi kryesisht kritik bazuar në buletinin e Trepçës.[11] Tek e fundit, orientimet nacionaliste kishin karakterizuar tashmë trazirat politike dhe sociale në Jugosllavi që në vitet 1971-72, në debatin mbi karakterin e vetëmenaxhimit dhe unitarizmin jugosllav krahas tensioneve ekzistuese mes republikave; shtypja e "çështjes kroate", një shenjë paralajmëruese e lëvizjes për pavarësi e viteve të '90-a, do të ishte vetëm prova më e qartë.[12] Historia e grevës së Trepçës tregon se si punëtorët u bënë klasë hegjemone e një lëvizjeje për pavarësinë e Kosovës nga Serbia. Kjo është një histori më e pasur dhe më pak teleologjike se ajo e përplasjes së kahershme mes nacionalizmave ballkanikë. Kjo histori zbulon se, në rastin e shpërbërjes së Jugosllavisë, ishte e pamundur të modernizohej dhe demokratizohej vendi në kulmin e krizës ekonomike, duke ruajtur njëkohësisht strukturën politike komuniste. Kjo histori ndoshta tregon edhe një rrugë alternative ndaj asaj të ndjekur nga Milošević, e cila përfundoi në luftë si një epilog i krizës jugosllave, luftë që ndoshta nuk ishte e pashmangshme.[13] Është një histori që ia vlen të tregohet.

TREPÇA ËSHTË TREPÇË

Ibush Jonuzi: "Trepça, atë thonjën: 'Trepça osht' Trepçë'. Aty me punue ka qenë krenari. Pse? Në ish-Jugosllavi inxhinieri që ka punue në 'Trepçë', çdokund i ke pasë dyert e hapura me punue pa konkurue, veç kërkesë. 'Po, du me u punësue në qet minierë,' ti je shkue. Shumë kuadra, shumë, jo shqiptarë, kuptohet, veç të nacionaliteteve muslimanë, sërbë, dhe malazezë, i kanë zgjedh vendet ku kanë dashtë në ish-Jugosllavi ku kanë qenë kuadra të Trepçës. Sepse Trepça ka qenë shkollë, jo vetëm minierë, po shkollë ka qenë."

Kompleksi mineraro-metalurgjik i Trepçës është një ikonë në Kosovë dhe është ashtu me të drejtë, marrë parasysh që ka qenë një burim i rëndësishëm i punësimit dhe mobilitetit social në një ekonomi të varfër, kryesisht të bazuar në bujqësi. Mbase është edhe vetë historia e tyre e gjatë, që i bën legjendare minierat, të cilat u shfrytëzuan vazhdimisht që nga koha e romakëve dhe pastaj e saksonëve në mesjetë.

Në raportin e Pietro Maserecco (Mazrek), i dërguar i Papës, që daton nga vitet 1623-1624, lexohet se sasia e bollshme e arit, argjendit dhe metaleve të tjera tërhoqi drejt minierave të Novobërdës dhe Trepçës një emigracion katolik shqiptar që nga Shkodra në Shqipëri deri në Tivar në Mal të Zi.[14] Më vonë, minierat u shfrytëzuan nga osmanët dhe, në fund, edhe nga anglezët dhe gjermanët. Pas Luftës së Dytë Botërore, kompleksi i Trepçës, i cili kishte filluar vetëm me minierat e Stantërgut dhe Novobërdës, arriti të krijonte filiale jo vetëm në Kosovë, por edhe në Serbi, Vojvodinë dhe Mal të Zi.

Trepça ishte krenaria e Jugosllavisë socialiste, një nga shtyllat e ndërtimit të imazhit të saj në skenën ndërkombëtare. Por të dhënat tregojnë një histori pak më ndryshe ose, thënë më mirë, histori të ndryshme. Pas luftës së viteve 1998-1999, kur Bashkimit Evropian iu caktua detyra e rindërtimit, Michael Palairet, një ekspert i ekonomisë jugosllave kreu një hulumtim gjithëpërfshirës rreth Trepçës dhe arriti në përfundimin se kompania operonte "rregullisht" me humbje.[15] Fitimi i deklaruar i vitit 1983 ishte vetëm në dukje i tillë, ngaqë ai do të duhej të vlerësohej nën dritën e inflacionit. Në fakt, një vit më pas, bilanci në Trepçë u regjistrua me humbje. E njëjta gjë ndodhi edhe në kompani tjera të mëdha jugosllave, ku Palairet zbuloi se investimet e mëdha të viteve të '70-a dhe '80-a u shpërdoruan në projekte të keqmenduara dhe të paefektshme, që mbeten të papërfunduara edhe para se të mbaronin paratë, apo madje të vjetëruara ende para se të fillonin të funksiononin.

Me pak fjalë, "Trepça", si kompleksi i çelikut "MKS" në Smederevo, kompleksi automobilistik "Zastava" në Kragujevac dhe "Ramiz Sadiku" në Pejë,[16] ishte një shembull tipik i sistemit të madh të ndërmarjeve jugosllave, i karakterizuar nga investime të kushtueshme, rritje të prodhimit nëpërmjet hapjes së fabrikave të reja, rendimentit dhe fitimeve të ulëta, të mbuluara nga subvencionet shtetërore.[17] Gjatë gjithë periudhës jugosllave, vetëm Trepça mori 5 miliardë dollarë nga shteti në formë grantesh.[18] Me fjalë tjera, ishte viktimë e vendimeve që nuk prodhuan asnjë bazë të fortë eksporti, as kursime në valutë, por në vend të kësaj, në vitet e '80-a, çuan në falimentimin e sistemit industrial dhe delegjitimimin e udhëheqësisë komuniste, që përkufizohej si pararojë e klasës punëtore, por që u tregua e paaftë për t'i garantuar asaj qoftë edhe pagat e duhura.

Por nëse leximi i të dhënave zhgënjyese të Trepçës nga vëzhguesit dhe studiuesit ndërkombëtarë çon në një kritikë të ekonomisë politike socialiste, interpretimet e subjekteve analoge serbe dhe shqiptare dallojnë: të parët sugjerojnë "mentalitetin lokal" dhe "menaxhimin e keq" si shkaqe të dështimit të kompanisë, ndërsa këta të fundit drejtojnë gishtin kah praktikat e grabitjes së sistemit qendror.[19] Edhe këtyre çështjeve do t'u kthehem më vonë.

Mitrovica: qytet minierash dhe kufijsh

Legjenda e Trepçës në kohët moderne fillon shumë kohë para Jugosllavisë. Ajo fillon me shfrytëzimin e pasurisë së saj minerale nga britanikët në periudhën midis dy luftërave, kur Mitrovica u rrit krahas dhe së bashku me minierën e vet. Mitrovica ishte një garnizon i njohur osman, pikë në rrugën për në Bosnjë dhe pikë kufitare me Perandorinë Austro-Hungareze. Traktati i Kongresit të Berlinit, në nenin 25, e përfshiu atë në mënyrë eksplicite në Sanxhakun e Novi Pazarit, që kontrollohej bashkarisht nga austriakët dhe osmanët nga viti 1878, por nuk u bë një territor i qetë. Në të vërtetë, pikërisht me atë traktat, Ballkani filloi të ndahej sipas përkatësive etnike dhe fetare, duke u hapur rrugën ndërhyrjeve të fuqive të mëdha në zonat "evropiane" të Perandorisë Osmane në mbrojtje të krishterimit.[20] Si pasojë, konflikti, jo vetëm që nuk u ndal, por u shtua. Për shembull, konsulli rus, Grigoriy Shcherbina, i dërguar nga Cari për të hapur një zyrë në Mitrovicë, u vra sapo shkeli në këtë vend.

Ashtu si shumë vende që ndodhen në udhëkryqin e fuqive të ndryshme të

armiqësuara, edhe Mitrovica ka një histori mbreslënëse, të përshkuar me pushtime të huaja dhe kryengritje vendase. Ajo ishte gjithashtu një çerdhe e kaçakëve, versioni shqiptar i "banditëve socialë",[21] si gjatë periudhës osmane, ashtu edhe pas aneksimit të dhunshëm nga Serbia gjatë Luftërave Ballkanike. Një nga kaçakët më të njohur të Kosovës ishte Isa Boletini. Mendohet që ishte ai që vrau konsullin rus. Ai ishte një figurë komplekse, që fillimisht luftoi përkrah gjonturqëve, të cilët u ngritën për të reformuar Perandorinë, e më pas kundër tyre, duke u rreshtuar me osmanët dhe austriakët dhe, në fund, duke u vendosur kundër mbretërisë serbe. Isa Boletini tregoi qëndrueshmëri në mbrojtjen e komunitetit të tij në Kosovë, që kishte mbetur i ndarë nga shteti amë, kur Shqipëria e kishte shpallur pavarësinë në vitin 1912.

Dua t'i referohem këtu bisedës së famshme të Boletinit me mikun e tij, diplomatin dhe shkrimtarin anglez, Audrey Herbert, në Mitrovicë, në vitin 1912, gjatë një kryengritjeje kundër osmanëve. Kur Herbert e pyeti Boletinin nëse shqiptarët donin autonominë, Boletini iu përgjigj: "Jo, nuk e duan, duan vetëm që askush të mos ndërhyjë në punët e tyre."[22] Apo faktin se kur luftonte kundër osmanëve, pas vitit 1908, ai bëri aleancë edhe me mbretërinë serbe që po krijohej, gjë që tregon shumë për qëndrimin e luhatshëm taktik të Boletinit dhe për karakterin e adaptueshëm të kësaj zone kufitare. Një statujë e Boletinit qëndron në pjesën jugore të qytetit që nga viti 2018 për të shënuar karakterin shqiptar të qytetit, sepse, edhe sot, Mitrovica është një qytet kufitar. Përtej lumit Ibër, i cili funksionon si një lloj Muri i Berlinit, pjesa veriore është ende, *de facto*, Serbi.

Në Mbretërinë e Jugosllavisë, Mitrovica ishte qendër e rëndësishme tregtare e rajonit, por fati i saj i luhatshëm mori kthesë të mbarë pas vitit 1931, kur qyteti u lidh me linjën hekurudhore që shkonte në Serbi, në të njëjtin vit kur edhe kompania angleze Trepça Mining Ltd., nisi të operonte. Në vitin 1926, Chester Beatty, i ashtuquajturi "mbret i bakrit", ishte kontaktuar në Londër nga përfaqësues të Nikola Pašić, kryeministër i Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve. Nëpërmjet negociatave, Beatty dhe kompania e tij, Selection Trust Ltd., blenë një aksion për të drejtat minerare në malet e Kopaonikut dhe regjistruan Trepça Mining Ltd. në Londër si një kompani aksionare me rreth 7,500 aksionerë.[23] Po atë vit, përfaqësues të kompanisë, të dërguar në Kosovë, zbuluan mbetjet e një miniere saksone pranë qytetit të dikurshëm mesjetar, Stantërgut, duke e shndërruar atë në rezervën më të pasur të plumbit dhe zinkut në Evropë përbrenda vetëm një dekade. Pikërisht në atë zonë, Selection Trust bleu 70 hektarë tokë për të ndërtuar një koloni ku do të banonin administratorët dhe inxhinierët, të cilët ishin kryesisht anglezë dhe rusë.[24]

Shkrimtarja angleze, Rebecca West, botoi një profil të paharrueshëm të Mitrovicës dhe të industrisë së saj të re dhe të rëndësishme, në librin e vitit 1941, "The Black Lamb and the Grey Falcon. A Journey through Yugoslavia" [në shqip: Delja e zezë dhe skifteri i përhimtë. Një rrugëtim nëpër Jugosllavi], që konsiderohet si vepra e saj më e madhe.[25] West mbërriti në një qytet me rreth 16,000 banorë. Dy të tretat ishin sllavë, përfshirë këtu edhe një popullsi refugjatësh myslimanë nga Bosnja e Hercegovina dhe Serbia, si dhe muhaxherët e dëbuar nga territoret e Perandorisë Osmane, që iu dhanë Mbretërisë së Serbisë nga Kongresi i Berlinit. Pjesa tjetër ishte një pakicë shqiptare, kryesisht fshatarë.[26] Megjithatë, popullsia dominuese e Mitrovicës mbetej ajo osmane, aq sa shkrimtarja nuk e përmend fare kishën ortodokse të Shën Savës, ndërtimi i së cilës nisi në vitin 1896, me leje të Perandorisë, dhe mbaroi në vitin 1921. Në vend të kësaj, ajo përshkruan nga njëra anë qytezën

“Kossovska Mitrovica,”[autorja përdor dy s-ja për të nënkuptuar që zanorja paraardhëse është e shkurtër] me kazermat e saj në kodër, minaretë, shtëpitë përgjatë bregut të lumit Ibër, si dhe disa shtëpi të bukura turke. Nga ana tjetër, poshtë në luginë, përgjatë rrjedhës së lumit, ajo përshkruan një peizazh të pazakontë industrial me shina hekurudhore, një kodër të ulët me "ngjyrën e vdekjes" ku mblidheshin mbeturinat e minierës dhe me ndërtesa të zbehta, të valëzuara, të ngritura mbi shtylla, me galeri të gjata tre-katëshe në njërën anë dhe në tjetrën, “vepra fantastike të inxhinierisë” të ngjashme me “një qafë hekuri të përkulur për të pirë ose për të ngritur vaskat e vogla mbi këmbë të shkurtra si ato të lejlekëve”. Mbi këtë peizazh industrial, shtrihej një fushë e gjelbër dhe kopshte të hijshme të shtëpive që West i krahason me zonën historike në periferinë e Londrës, “Golders Green”. Më sipër akoma, një vilë që, për shoferin serb Dragutin, është një vend “*fino fino*,” në italisht, por për një etnocentrike si West mund të evokonte vetëm parajsën angleze të “Chislehurst”, një tjetër periferi bukolike e Londrës. Aty jeton “Zoti Mac,” menaxheri skocez i Trepçës.

Stari Trg / Stantërg

West vizitoi minierën e Stantërgut, bashkë me bashkëshortin, dy anglezë dhe me Zotin Mac, por pa Constantinin, mikun intelektual serb, që udhëtonte me të dhe e konsideronte industrinë shumë vulgare në krahasim me kulturën dhe shpirtëroren e popullit serb. West habitet kur takon punonjës me kapelë në stilin e Likës, një qyteti kroat, ndaj Zoti Mac i shpjegon se në minierë ka punëtorë të të gjitha llojeve: kroatë katolikë nga Kroacia dhe nga Dalmacia; serbë ortodoksë vendas dhe serbë ortodoksë, të ardhur nga Serbia, që dallonin nga të parët; shqiptarë vendas, disa prej të cilëve ishin myslimanë, disa katolikë dhe të tjerët ortodoksë; ndonjë rus i bardhë, që punonte në zyrë dhe në fabrikë; dhe në fund: skocezë, anglezë dhe amerikanë. Tani, të gjithë shkonin mirë e bukur me njërin-tjetrin, edhe pse në fillim nuk ishte kështu. Zoti Mac nuk e fsheh aspak simpatinë e tij për shqiptarët në krahasim me të tjerët. I pëlqejnë shumë, thotë, përveç zakonit të gjakmarrjes.

Duke e lënë mënjanë skepticizmin e vet socialist, West shënon se si menaxhimi skocez i minierës duket të ketë krijuar për punonjësit kushte jetese shumë më të mira se ç’ishin në të kaluarën. Përndryshe, ku do të kishin gjetur shtëpi me gropa septike? Po shkollat? Po mensën për punonjësit beqarë? Po fushat e tenisit, ku minatorët mund të luanin ose së paku të ndiqnin ndeshjet e inxhinierëve? I vetmi kapazan i Mitrovicës është shumë i lumtur nga ky hov i papritur ekonomik, që ia mbush xhepat.

Megjithatë, ata që përfituan më së shumti nga ajo epokë nuk ishin banorët vendas. Shitja e të drejtave ekskluzive të Stantërgut tek anglezët e Selection Trust Ltd., të Londrës u nënshkrua në vitin 1926 nga Radomir Pašić, i biri i ministrit Nikola Pašić, i cili u vendos në krye të kësaj pasurie të çmuar të territorit si rrjedhojë e reformës agrare. Ligjet dhe dekretet prej vitit 1919 deri në vitin 1933 e patën vetëm emrin e “reformës agrare." Në fakt, ajo “reformë” shpronësoi tokat e mijëra shqiptarëve, mundësoi kapjen e një pjese të madhe të territorit të Kosovës nga funksionarët e korruptuar shtetërorë dhe dërgoi mijëra kolonë serbë në Kosovë me premtimin e tokës me çmim të lirë,

të cilët pastaj mbetën me borxhe deri në fyt, rrethuar nga një shoqëri shqiptare, që i kishin halë në sy.[27] Shitja me çmim të shtrenjtë e pasurive natyrore vendase që serbët i kishin blerë me çmim shumë të lirë ishte pjesë e politikës së vjedhjeve, të fshehur pas petkut ideologjik të mitit të marrjes së Kosovës. Kur Luftërat Ballkanike u ndërlidhën me Luftën e Parë Botërore, Kosova iu shkëput osmanëve dhe u aneksua nga Serbia.

Deri në vitin 1940, minierat e Trepçës prodhuan 5.7 milionë tonë mineralesh, ndër të cilat 625,000 tonë ishin plumb, 685,000 ton zink dhe 444,000 ton të një koncentrati të përzier prej plumbi, zinku, bakëri dhe piriteve.[28] Pjesa më e madhe e këtyre produkteve eksportohej në Gjermani. Anglezët inkasonin përfitimet në kurriz të minatorëve, të cilët shpeshherë protestuan kundër kushteve të vështira të punës, fillimisht në vitin 1936, pastaj në korrik 1939.[29] Trepça Mining Ltd., për pak ia doli të përfundonte ndërtimet e impianteve të fonderisë dhe rafinerisë së plumbit në veri të Mitrovicës, në Zveçan, në prag të pushtimit nga të Gjermani naziste në vitin 1941. Pas pushtimit gjerman, i humbi të gjitha.

Fillimi i shpejtë i luftës solli një menaxhment të ri. Me ndarjen e Kosovës mes Italisë fashiste dhe Gjermanisë naziste, kjo e fundit mori pasuritë natyrore vendase. Trepça u integrua në Wehrmacht Luftwaffe të Hermann Göringut pas aneksimit të Serbisë në prill të 1944 dhe u zgjerua falë punës së detyruar. Me tërheqjen nga Kosova, në nëntor 1944, gjermanët shkatërruan gjithçka që mundën, nisur nga fonderia deri te makineritë dhe zyrat.

E shtetëzuar nga Jugosllavia më 23 nëntor 1948, Trepça u “shpagua” nga anglezët me një shumë prej 4.5 milionë sterlinash.[30] Por arriti të bëhej një gjigant industrial vetëm pas një politike investimesh intensive duke filluar nga vitet e ‘60-a dhe veçanërisht në gjysmën e dytë të viteve të ‘70-a. Deri atëherë, intensive kishte qenë, mbi të gjitha, puna, sipas politikës represive të modelit stalinist të zhvillimit ekonomik të adaptuar nga Tito menjëherë pas luftës. “Filluam duke i vjedhur minierat dhe pyjet: gërmuam damarë të mineraleve më të pasura, premë pyje të tëra … të gjitha ato produkte të kërkuara nga tregu i huaj dhe për të cilat e kishin siguruar valutën për të blerë lëndën e parë dhe atë të ndërmjetme për nevojat e prodhimit industrial dhe për të furnizuar popullatën." Kështu shkruante në kujtimet e tij, Svetovar Vukmanović-Tempo, drejtuesi komunist partizan, të cilin Tito e emëroi ministër për Minierat dhe Energjinë.[31] Kjo lloj politike ekonomike vazhdoi deri në prishjen me Bashkimin Sovjetik në vitin 1948.

Pas shfrytëzimit të egër në periudhën e parë të pasluftës, jugosllavët u ndodhën përpara problemit të madh, të krijuar nga largimi i anglezëve: mungesa e teknikëve dhe special-istëve. Inxhinierët dhe teknikët e parë erdhën nga republikat tjera, pjesa më e madhe e shkolluar në Universitetin e Lubjanës dhe ishin sllovenë ose serbë: për shembull, Arsen Pensa, një slloven i sjellur në vitin 1948 me dekret të Drejtorisë së Minierave në Beograd, të cilit iu refuzuan të gjitha kërkesat për transferim deri në vitin 1956, ose Branko Glušćević, një serb nga Dalmacia, i cili në vitin 1953 u bë drejtori i parë që nuk ishte funksionar politik.[32] Ndërsa gjeologët vinin nga Gjermania Lindore.

Në vitin 1960, më shumë se 50% e 6,000 punonjësve të angazhuar në prodhim ishin të pakualifikuar ose gjysmë të kualifikuar, pra pa asnjë formim profesional, dhe pak më shumë se 6% kishin kualifikim të lartë. Në gjithë

ndërmarrjen qenë vetëm 86 të diplomuar, pesë nga të cilët ishin shqiptarë. Për sa i përket fuqisë punëtore më pak të kualifikuar, përfaqësimi i serbëve dhe shqiptarëve ishte pothuajse i njëjtë. Por ndërsa 65% e punonjësve të gjysmë-kualifikuar ishin shqiptarë dhe pjesa tjetër serbë e malazezë, ky raport përmbysej tek përqindja e punonjësve të kualifikuar.[33] Në këtë mënyrë, sa më lart në hierarkinë e ndërmarrjes, serbët ishin të mbipërfaqësuar, duke marrë parasysh se përbënin më pak se 30% të fuqisë punëtore të përgjithshme.

Hendeku i dukshëm midis numrit të shqiptarëve në fuqinë e përgjithshme të punës dhe atij të punonjësve të kualifikuar ishte i njohur si problem nga partia, por justifikohej me parimin e meritokracisë: thjesht nuk kishte mjaft kuadro shqiptare. Në fakt, kjo ishte e vërtetë për shkak të mungesës së madhe të shkollimit që kishte rrënjë të thella, qysh prej ndalimit të shkollave që nuk ishin në gjuhën turke gjatë Perandorisë Osmane, apo shkollave që nuk ishin në gjuhën serbe gjatë Mbretërisë së Jugosllavisë; shqiptarët që dëshironin të mësonin të lexonin dhe të shkruanin në gjuhën e tyre përdornin shkollat fetare islame, medresetë. Vetëm gjatë pushtimit fashist, gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur gjermanët dhe italianët krijuan një "Shqipëri të Madhe" duke bashkuar Kosovën dhe Mbretërinë e Shqipërisë, u themeluan shkollat e para në gjuhën shqipe.

Me krijimin e Jugosllavisë socialiste, më në fund u krijua një sistem arsimor në gjuhën shqipe në të gjithë krahinën, por u desh kohë që të zhvillohej dhe pavarësisht kësaj, vazhdoi të mbetej prapa për një periudhë. Kuadri i parë shqiptar në historinë e Trepçës dhe, për një kohë, i vetmi shqiptar në menaxhment ishte Minir Dushi, që nuk është bir i një minatori, por i një tregtari nga Gjakova, i cili hyri në minierë në vitin 1958, pasi përfundoi studimet në Universitetin e Mineralogjisë dhe Gjeologjisë në Beograd me një bursë studimi nga Trepça.

Minir Dushi: "Po, e gjithë fuqia punëtore e krahut ishin shqiptarë. Inxhinierë? Nuk dilnin dikush me mendu që mund të ketë inxhinierë shqiptarë…Por, nuk zinin besë që ka edhe inxhinierë shqiptarë. Dhe unë, në zyre…vinin e çelnin derën me pa si duket inxhinieri shqiptar. Pse? Ishin mësu ata gjith nji inxhinier britanik, gjerman; pastaj vinin slloven, serb, malazez, e gjitha nacionaliteteve tjera, e nuk mund imagjinonin të ketë nji inxhinier i minierave shqiptar." Pas katër vjetësh, "um thirrin nga drejtoria… 'Nja dy shokë kanë ardhë nga Këshilli Ekzekutiv i Kosovës e dojnë me bisedu dishka me ju'…aty kishte ardhë përveç tjerëve Kolë Shiroka. Kolë Shiroka ka qenë sekretari Seksionit i Arsimit, Shkencës dhe i Kulturës. Drejtori thotë…'Dojmë me e hapë nji Shkollë të Lartë Teknike, e me marrë përsipër ti me librin edhe udhëheqje ne shkollës'."

Ishte viti 1961, fillimi i një ndryshimi të madh në politikat e zhvillimit. Investimet u rritën. Në vitin 1964 filloi ndërtimi i fabrikës së plehrave kimike NPK dhe pastaj, menjëherë, një fabrikë e acidit sulfurik. Dështimi i tyre pothuajse i menjëhershëm për shkak të rrezikshmërisë së produkteve kimike të prodhuara nuk i ndikoi investimet e mëtutjeshme: pas një viti, u rindërtua dhe u zgjerua rafineria e plumbit, një nga katër më të mëdhatë në botë, dhe u ndërtua një rafineri e re, më e madhe për zinkun.[34]

Filloi gjithashtu t'i jepej përparësi krijimit të kuadrove të teknikëve vendas. Në Mitrovicë dhe Prishtinë u hapën shkolla profesionale. Më vonë, në vitin 1970, u themelua zyrtarisht universiteti në Prishtinë. Minir Dushi ishte

protagonist i këtij revolucioni arsimor. Pasi u bë prorektor në Prishtinë, në vitin 1974 ai themeloi Fakultetin e Miner-alogjisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë. Shembullin e tij për të dhënë mësim në fakultet e ndoqi edhe kushëriri më i ri, Avni Dushi, i cili gjithashtu kishte përfituar bursë studimi nga Trepça, por në vend të Beogradit, zgjodhi të studionte në Zagreb dhe u bë inxhinier në Stantërg. Dushët vinin nga një familje me nam në Gjakovë, të njohur në qytet si Beg Dushi. Krenar për trashëgiminë e vet familjare dhe të qytetit të tyre: "Gjakova ka qenë qytet shumë i mirë me njerëz shumë të mirë", Avni Dushi e bëri Mitrovicën, qytetin më të madh e më dinamik të Kosovës, të vetin: "Por Mitrovica mandej ka qenë qytet më i madh me më shumë popullatë. Bile, thonë që shumë gjakovarë kanë shkuar të jetojnë në Mitrovicë dhe kam dëgjuar që dikur 60% e popullatës së Mitrovicës kanë qenë gjakovarë." (*Avni Dushi*).

Gjatë viteve të '60-a zhvillimi i Trepçës dhe i punon-jësve të saj, si edhe ai i Kosovës dhe i Jugosllavisë, filluan të lidheshin ngushtë me njëri-tjetrin.

Sefedin Istrefi: "Jam shumë krenar që jam minator, t'thom t'vërtetën, shumë krenar… punën e ka lonë Zoti. Dikush thotë, 'Shih ai, aty ka fshinë asfalltin!' Po, edhe ato duhet me punu dikush. Po, dikush i grah ni makine, dikush i grah ni kolice, dikush… kryesorja osht mos me hjekë. Po minator, t'thom t'vërtetën, o konë privilegj me konë minator. Pse po thom? Rreziku ka qenë n'çdo hap, po t'jesh minator ti i ke pasë dyrt çelë jo veç n'Kosovë, kur ka qenë Jugosllavia marë se marë s'u konë kurr' thuja po… bonat e Trepçës ti ke shku n'Grand, ke hongër bukë me bon t'Trepçës, ti ke shku ke ble n'butikun ma t'shtrejtin n'Prishtinë me bona t'Trepçës, ke ble rrobe, merre me men. … Do të thotë, bonat e Trepçës janë konë n'funkcion n'krejt Kosovën, ku ke shku e kanë pa bonin e Trepçës t'kanë pritë me duar hapun."

*Isuf Pec*i: "Jom konë pasë shku ni kredit me marrë për shpi me maru…e kom marrë ni kredit në 'Beobank' të Beogradit, në bankë dhoke me kredit. Jom shku, jom hi në Beograd, e masi e mora atë kredit për shpi diçka, hina në atë dugoj, 'Beko' u thirrë ajo firma e Beogradit, u konë ma e madhja në Jugosllavi për tesha, tesha ka pasë 300 euro si me i bo tash asi. Edhe i kqyra, i kqyra… po du me lidhë çfarë vle e ka pasë Trepça, krejt ketë bisedë p'e lidhi me Trepçën, edhe hi aty, thomë, më kqyri. Ajo tha, 'Çka po i kqyr këto tesha?', ajo shitësja në Beograd. Thashë, 'Po, po i kqyri tek jonë të mira qeto tesha'. 'Po merri, bre'. Thashë, 'Po, s'kom bre pare me i marrë unë', a din. Tha, 'I kahit je, ku punon?' I tregova. Tha, 'Në Trepçe? Ehhhh, qetash ko me t'i palu me t'i shti në llastik'. … Veç ja kom dhonë lëtërnjoftimin. Tha, 'Gjysën e shitores ta dho për Trepçën. Se ka qenë garantues qy, qy ka qenë garantues, garantuse e Jugosllavisë o vlla. Hej, e jo për ni parë tesha të mia ça kanë kushtue."

Punë dhe rezistencë

Nëse ka ndonjë dyshim për rolin e ikonografisë së Trepçës në Jugosllavinë socialiste, mjafton të shohësh monumentin "Faltorja e Revolucionit", ose Tempullin e Dëshmorëve Partizanë Serbë dhe Shqiptarë, sot i njohur si Përmendorja e Minatorëve të Rënë, një monument gjigant në stilin e Stonehenge, i ndërtuar mbi Kodrën e Partizanit, që gjendet vendosur mbi kodrën e qytetit kur vjen nga Prishtina. Është vepër e arkitektit më të njohur

të brutalizmit jugosllav, Bogdan Bogdanović, autor i monumenteve të Jasenovacit dhe Mostarit në përkujtim të Luftës së Dytë Botërore. Pas luftës, këto monumente dhe të tjera të ngjashme me to bënin pjesë në një plan më të gjerë të transformimit të peizazhit jugosllav nga një vend konfliktesh mes kombeve në një vitrinë të një "identiteti të përbashkët jugosllav."[35]

Në 1959, kur filluan punimet për ndërtimin e "Faltores të Revolucionit", në Kosovë ndihej shumë nevoja e krijimit artificial shoqëror dhe kulturor. Shqiptarët dhe serbët kishin luftuar edhe dhunshëm për zotërimin e Kosovës që nga koha e aneksimit të kësaj province të Perandorisë Osmane nga Mbretëria e Serbisë në prag të Luftës së Parë Botërore. Në vitin 1941, Mitrovica shënonte një kufi të brendshëm me veriun e Kosovës, që gjendej nën qeverinë kuislinge serbe gjatë okupimit gjerman, ndërsa jugu ishte bashkuar me Shqipërinë "e pavarur", por në fakt, ishte nën kontrollin e Perandorisë Fashiste.[36] Kjo ndarje çoi në një homog-jenizim të dhunshëm etnik, i nxitur për arsye taktike nga fuqitë pushtuese, përfshirë italiane fashiste, e cila inkurajoi hakmarrjet ndëretnike për të mbajtur nën kontroll popullsinë lokale.[37] E gjithë kjo rriti mosbesimin dhe armiqësinë midis shqiptarëve dhe serbëve, të cilat arritën pikën kritike pas çlirimit nga gjermanët në vjeshtën e vitit 1944.

Tito urdhëroi një mobilizim të përgjithshëm në Jugos-llavinë e pasçlirimit, duke rekrutuar me forcë të gjithë burrat e aftë, për t'i dërguar në veri në përpjekjen e dështuar për të pushtuar Triesten. Një kryengritje e shqiptarëve, dhe jo vetëm e tyre, kundër vazhdimit të luftës, u shtyp përgjak-shëm.[38] Në dimrin 1944-1945, banda të armatosura shqiptarësh bënë një rezistencë të fundit kundër partizanëve pikërisht në Stantërg. Por në malet përreth Mitrovicës u zhvillua si aksioni partizan, ashtu edhe rezistenca kundër bashkimit të sërishëm me Serbinë. Shqiptarët luftuan në të dy frontet, megjithëse në numër më të madh kundër partizanëve.

Babai i Bahtije Abrashit, minator, ishte anëtar i brigadës "Shala e Bajgorës". "U plagos tri herë. Disa herë janë mundu me e zanë të gjallë, mirëpo nuk kanë mujtë. Ia kanë marrë nanën në burg, ia kanë kallë shtëpinë, ia kanë marrë motrën në burg, në burgun famëkeq pranë Mitrovicës, Shipol. Mirëpo, nuk e di qysh ka mujtë…ka pasë njerëz edhe aty që i kanë ndihmu edhe i kanë liru pas ni kohe, nuk e di sa kohë prej burgut. E kanë… me vajzën. Vajza, e cila ka pasë emrin Vahide, une nuk e mbaj mend se… si ka ardhë prej burgut, 'Kurrë', thoshte nana ime, 'S'ju kanë terë sytë veç t'u qajtë'. Me atë ankth, me atë mërzi edhe ka vdekë. Kështu që, kur s'kanë mujtë ata me zanë armiku, ia ka shkatërru familjen" (*Bahtije Abrashi*).

Ndërsa gjyshi i Shyqyri Sadikut, minator që nga viti 1935, e pastaj i detyruar të punonte me gjermanët gjatë luftës, luftoi krah komandantit të Ballit, Ahmet Selaci, bashkë me gjithë vëllezërit e tij. Sipas tregimeve të gjyshes, kulla e familjes ishte rrethuar disa herë nga policia, e cila kërkonte t'i kapte kryengritësit, të mbrojtur nga informatorët vendas e të fshehur në mal nga kushërinjtë, një lojë kukafshehtas që zgjati deri në fund të viteve të '50-a.

Pasojat e këtyre zgjedhjeve ishin, ashtu siç edhe pritej, të ndryshme për shqiptarët në Jugosllavinë socialiste të pasluftës. "Mas luftës ka qenë shumë aktiv në Mitrovicë, ka qenë njeri i çmuar, i respektuar, ka qenë edhe kryetar i

Mitrovicës ni kohë të shkurtë, derisa kanë gjetë njeri të arsimuar." (*Bahtije Abrashi*). "Babgjyshi ka qenë edhe i burgosur. Ka qenë i burgosur politik, po flas, mas luftës, si ballist, ka qenë i dënum edhe me vite burg. I ka kalu ato vite burg edhe realisht pas përfundimit t'burgut ju ka kthy blegtorisë" (*Shyqyri Sadiku*).

Pavarësisht dallimeve, u mboll bindja se shqiptarët ishin të gjithë "të pabesë", se që të gjithë ishin filofashistë ose jo mjaftueshëm antifashistë. Kur Tito u prish me Stalinin në vitin 1948 dhe udhëheqësi komunist i Shqipërisë, Enver Hoxha, u rreshtua me Stalinin, edhe komandantët partizanë shqiptarë të nomenklaturës jugosllave shiheshin me dyshim si një kolonë e pestë.[39] Ky mobsesim ekziston edhe sot në Serbi dhe referenca tek Lufta e Dytë Botërore është e zakonshme. Në të vërtetë termi "ballist", pra kundër-partizan, pra fashist, vazhdon të përdoret me konotacion negativ në gjuhën e përditshme për shqiptarët, madje edhe në shkolla.[40]

Monumentet kushtuar luftës partizane u ndërtuan si një provë e prekshme e së kundërtës. Përmendorja e minatorëve përbëhet nga dy kolona në formë koni, 19 metra të larta, që mbajnë një bllok në formën e një karroceje minatorësh. Fillimisht e ndërtuar me beton dhe bakër, sot përbëhët vetëm prej betoni. Në bazën e përmendores, një mbishkrim në dy gjuhë përkujton minatorët partizanë të *Rudarska Četa* (Brigadës së Minatorëve), të varrosur në kodër. Simbolika më e theksuar është blloku prej betoni që përfaqëson, siç thuhet, karrocën e minatorëve. Por ndoshta kujton edhe sulmin e partizanëve më 30 korrik 1941, kur shpërthyen teleferikun që transportonte mineralet nga puset e Stantërgut në fonderinë e Zveçanit për të furnizuar industrinë gjermane të armëve. Megjithatë, simbolika politikisht më e rëndësishme paraqitet nga dy kolonat, që përfaqësojnë popullin serb dhe atë shqiptar të bashkuar, si në luftën antifashiste, ashtu edhe në punën në minierë. Bogadnović tha se ajo çka ata donin të simbolizonte ishte një "rrugëkalim apo një portë" e frymëzuar nga hapësira e madhe rreth monumentit: "Në takimet e mia me klientët vendas, serbët dhe shqiptarët, dukej se punonin shumë mirë së bashku... dhe rezultoi që [monumenti] tani ndodhet pikërisht në kufirin mes pjesës serbe dhe asaj shqiptare të qytetit."[41]

[2] Tanjug, "The Strikes at Trepca and Kopaonik", *BBC Summary of World Broadcasts*, 27 February 1989.

[3] Aziz Abrashi dhe Burhan Kavaja, *Epopeja e minatorëve. Marshet e tubimet protestuese dhe grevat e minatorëve të Trepçës në vitet 1988-1990*, Prishtinë, 1996, f. 11.

[4] Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, London: Pluto, 2000.

[5] Anna Di Lellio, "The Missing Revolution in Serbia: 1989-2008," *International Journal of Politics, Culture and Society* 22 (3), 2009: 373-384.

[6] Llogaritja më e besueshme e humbjeve njerëzore u krye nga organizata Humanitarian Law Center. Në vitin 1998 pati 1,018 viktima civile dhe 682 luftëtarë midis shqiptarëve; 129 civilë dhe 151 ushtarë midis serbëve; dhe 44 civilë që u përkisnin grupeve të tjera etnike. http://

www.kosovskaknjigapamcenja.org/?page_id=46&lang=de. Sipas të njëjtit burim, numri total i viktimave të luftës dhe pas luftës (janar 1998 - dhjetor 2000) është shumë më i lartë: 10,317 civilë, nga të cilët 8,676 shqiptarë, 1,196 serbë dhe 445 romë dhe grupe tjera, së bashku me 3,218 anëtarë të formacioneve të armatosura, me 2,131 anëtarë të guerrilasve shqiptarë UÇK dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK), 1,084 anëtarë të forcave serbe të sigurisë, dhe tre anëtarë të misionit të NATO-s, KFOR.

[7] Lufta përfundoi në qershor të vitit 1999 dhe u pasua nga tërheqja e Serbisë nga Kosova dhe një administrim ndërkombëtar nën kujdesin e OKB-së. Kosova shpalli pavarësinë e saj më 17 shkurt 2008, por Republika e Kosovës nuk njihet nga Serbia dhe nga rreth gjysma e shteteve anëtare të OKB-së.

[8] Thomas Sewell, "Historical Events as Transformations of Structures: Inventing Revolution at the Bastille," *Theory and Society* 25 (6), 1996: 841-881, 844; Robin Wagner-Pacifici, *What is an Event?* Chicago University Press, 2017, 5.

[9] Wagner-Pacifici, ibid., p. 8; Alessandro Portelli, *The Death of Luigi Trastulli and Other Stories. Form and Meaning in Oral History,* State University of New York Press, 1991, f. 1.

[10] Goran Musić, *Making and Breaking the Yugoslav Working Class: The Story of Two Self-Managed Factories*, Central European University Press, 2021, f. 3; për ngjarjet të shihen f. 183-184 e f. 185.

[11] Pieter Troch, "Ethnopolitics in a Mining Enterprise in Crisis: Revisiting the Albanian Miners' Protests in Late Socialist Kosovo," *Nationalities Papers,* e publikuar online 2024: 1-19. http://hdl.handle.net/1854/LU-01J5Q9M6BQK3G0F9RQ30S01542

[12] Stefano Bianchini, "Rinnovamento dell'economia e spinte nazionaliste fra il 1965 e il 1972," in *L'autogestione jugoslava*, redaktuar prej Stefano Bianchini Istituto Gramsci. Sezione Emilia-Romagna, Franco Angeli, 1982, f. 40-69.

[13] Sabrina Pedro Ramet, *Thinking about Yugoslavia. Scholarly Debates about the Yugoslav Breakup and the Wars in Bosnia and Kosovo,* Cambridge 2005, f. 66-67.

[14] Alain Ducellier, "Is It True that Albanians Invaded Kosova?" in *The Case for Kosova. A Passage to Independence*, redaktuar nga Anna Di Lellio, London: Anthem, 2006, f. 27-36, f. 35.

[15] Michael Palairet, *Trepča. 1965-2000, Lessons Learned and Analysis Unit of the EU Pillar of UNMIK in Kosovo.* 2003, f. 8.

[16] Michael Palairet, "Metallurgical Kombinat Smederevo 1960-1990: A Case Study in the Economic Decline of Yugoslavia," *Europe-Asia Studies* 49 (1997):1074-1077; "Mismanaging Innovation: the Yugo Car Enterprise (1962-1992)," *Technovation* 13 (1993), 119-123; "Ramiz Sadiku: A Case Study in the Industrialisation of Kosovo," *Soviet Studies* 44 (5) 1992: 897-912.

[17] Pieter Troch, “Social Dynamics and Nationhood in Employment Politics in the Trepça Mining Complex in Socialist Kosovo (1960s),” *Labor History* 60 (3) 2019: 217-234, f. 218.

[18] Hardten Eggert, *An Overview of the Development of Mitrovica Through the Years,* Kosovar Stability Initiative, 2012. p. 15.

[19] Për t’iu referuar “mentalitetit” të shihet Palairet, citim i një analisti serb në vitet e ‘90-a, f. 7.

[20] Davide Rodogno, *Contro il massacro. Gli interventi umanitari nella politica europea 1815-1914,* Laterza, 2012.

[21] Banac, “The Kaçaks,” in *The National Question in Yugoslavia*, Cornell University Press 1984, f. 291-306; Eric Hobsbawn, *I banditi. Il banditismo sociale nell’età moderna*, Einaudi, 2002.

[22] *1912. Aubrey Herbert: A Meeting with Isa Boletini,* http://www.albanianhistory.net/1912_Herbert/index.html

[23] Daut Dauti, *Lufta për Trepçën (sipas dokumenteve britanike),* KIEAI, Pristina, 2002.

[24] Eggert, *An Overview,* f.11; Erëmirë Krasniqi (ed.), *A Site of Political Struggle: Trepça Mine 1989,* Oral History Initiative, 2023, f. 10-12.

[25] Përshkrimet që vijojnë janë marrë nga kapitujt I dhe II të librit: “Kossovska Mitrovitsa."

[26] Eggert, Ibid., f. 10, duke iu referuar regjistrimit të vitit 1931: *Kraljevina Jugoslavija, Opsta Drzavna Statistika Definitivni rezultatit popisa* 1921, Sarajevo, 1932, f. 94-95.

[27] Vladan Jovanović, “The colonization of Kosovo,” *Peščanik,* 8/4/2013. *https://pescanik.net/the-colonization-of-kosovo/https://www.taylorfrancis.com/chapters/edit/10.4324/9780429464799-36/serbia-kosovo-macedonia-revolt-resettlement-repression-vladan-jovanović*

[28] Eggert, *An Overview*, f. 12.

[29] Krasniqi (ed.), *A Site of Political Struggle*, f. 18.

[30] Krasniqi, Ibid., f. 25.

[31] Susan L. Woodward, *Socialist Unemployment: The Political Economy of Yugoslavia 1945-1990*, Princeton University Press, 1995, f. 124.

[32] Troch, "Social Dynamics," f. 230. Nota 3.

[33] Troch, Ibid., f. 220.

[34] Egger, *An Overview*, f. 15.

[35] Sanja Horvatinčić, "Memorial Sculpture and Architecture in Socialist Yugoslavia," in *Toward a Concrete Utopia: Architecture in Yugoslavia. 1948-1980*, redaktuar nga Martino Stierli dhe Vladimir Kulić, The Museum of Modern Art, 2018, f. 105-111, f.105. Kam shkruar për të në "War Memorials in Kosovo: The Ordering Principles of Emotional Maps," in *BorderScape. Research, Representation and Spatiality in the Borders*, redaktuar nga Agata Rogoś dhe Stanisław Ruksza, Sterngberg Press, 2023.

[36] Jozo Tomasevich, "Italian-Albanian Rule in Kosovo and Western Macedonia," in *War and Revolution in Yugoslavia, 1941-1945*. Occupation and Collaboration, Stanford University Press, 2001, f. 148-156.

[37] Burimet italiane shprehimisht i referohen nxitjes së dhunës kundër kolonëve serbë. Për shembull, Luka Pietromarçi, një funksionar i lartë i Ministrisë së Punëve të Jashtme, në ditarin e tij të papublikuar të 8 janarit 1943, i cituar në veprën e Davide Rodogno, *Il nuovo ordine mediterraneo. Le politiche di occupazione dell'Italia Fascista in Europa (1940-1943)*, Bollati Boringhieri, 2003, f. 356 e Francesco Jacomoni, *La politica dell'Italia in Albania nelle testimonianze del Luogotenente del Re Francesco Jacomoni di San Savino*, Cappelli, 1956, f. 316.

[38] Anna Di Lellio dhe Dardan Luta, *Dimri i Gjatë i Vitit 1945. Tivari,* Prishtinë: Oral History Initiative, 2019. Edhe në anglisht: *The Long Winter of 1945. Tivari*, Toronto University Press, 2023.

[39] Ivo Banac, *With Stalin Against Tito*, Cornell University Press, 1988, f. 214-216.

[40] Anna Di Lellio, Orli Fridman, Srđan Hercigonja e Abit Hoxha, *Fostering a Critical Account of History in Kosovo: Engaging with History Teachers' Narratives of the Second World War,* Oral History Kosovo and Center for Comparative Conflict Studies, 2016.

[41] Bogdanović by Bogdanović.Yugoslav Memorials through the Eyes of Their Architect, New York: The Museum of Modern Art, 2018, f. 58-61.

FAMILJA NË MINIERË

Ramadan Gjeloshi: “Po, këtu në Trepçë ka qenë, në kohën e ish-Jugosllavisë… besoj që atëherë kanë pasë qëllim Partia Komuniste, veç për në Stantërg ka qenë traditë baba u dalë, djali osht’ punësu. Kështu që, unë thashë në fund të ‘81-shës jom punësu në vend të babës. M’i ka dorëzu çelësat, ormonin [dollapin] krejt ato, u ngjit naltë ku jonë konë zyret u lajmëru edhe u dalë në pension. Kur u dalë baba në pension ja kanë dhonë tri rrogat e fundit, ni orë dore të shtrejtë bukur mirë. Nji dhuratë të arit kështu {tregon me duar madhësinë}, kogja e madhe. Edhe tri rroga, po, tri rrogat e fundit ia kanë jep plakut tem në atë kohë."

Kur ishte i ri, babai i Ramadan Gjeloshit kishte punuar si polic, pastaj ishte martuar dhe ishte shpërngulur në Mitrovicë. Pasi kuptoi se paga e një minatori ishte sa trefishi i asaj që e merrte si polic dhe e bëri mend se do t’i leverdiste të fitonte më shumë tani që po planifikonte të krijonte familje, ai, bashkë me një mik, vendosi të linte policinë dhe të fillonte punën në minierë. Të të birit, Ramadanit, i cili kishte filluar shumë herët punën si minator në Sokobanjë, në Serbi, ku kishte më shumë mundësi punësimi, me daljen në pension të babait, iu lirua një vend pune në Stantërg.

Edhe punonjësi i ashensorit, Zeqir Fejzullahu, u punësua në Stantërg në vitin 1981, pasi babai i tij kishte qenë minator aty për 26 vjet, ndërsa vëllai i madh punonte te makineritë. Babai i kishte treguar sa e vështirë ishte jeta në kohën e tij dhe sa e rëndësishme ishte puna në minierë. “Puna n’Trepçë ka ndiku shumë, se falë Allahut atij i kofshim falë edhe kena punu. Na kena pasë edhe ni rrogë t'mirë, jo shumë t'mirë, po kena pasë nifarë, nifarë rrnese jo t'keqe, jo t'ligë. Kena rrnu mirë, jo ashtu shumë t'mirë, veç nuk kem pasë nevojë m'i thanë dikujna, ‘Ami do pare sot, se jom ngushtë’, s'ke pasë nevojë e ke marrë rrogën” (*Zeqir Fejzullahu*).

Shumica e minatorëve ishin fshatarë dhe banonin në fshatrat përreth Mitrovicës, në rajonin malor të Shalës së Bajgorës. Avdi Uka, i lindur gjatë Luftës së Dytë Botërore në Tërstene, 18 kilometra nga Mitrovica, kujton: “Edhe shkollën e kena pasë në fshat, ku aty kom nisë filloren në atë kohë. Tash po i çojnë ma të ri, atëherë na kanë çu pak ma të vjetër, shtatë-tetë vjeçar kur i bojshum atëhere shkojshum në fillore. E kom krye filloren, po mirë boll, po kushtet jonë konë shumë, shumë, shumë të dobëta. Shumë të dobëta. Babin e kom pasë, ka rrnu, diku afër niqind vjeçar u konë kur u dekë, në ‘57-tën u dekë. Domethonë, s’ka punu kurrë kurkun, kurkun s’ka punu hiç. Veç u marrë me tokë, me gjo, me jetë të fshatit. Ka majtë, në atë kohë, ka majtë lopë e dhenë e dhi e bullica e bletë... Krejt u bo, krejt jetën e ka pasë në fshat. Tokën e ka pasë, goxha shumë tokë ka pasë me to u bo idare, bukën ja ka qitë toka e vet. Mullinin për me blu millin e ka pasë të vetin, në tokë të vetën atje edhe u përmeçat [i’a ka dalë mbanë] qashtu. Ma vonë u bomë na djeltë e tina, pesë vllazni edhe fillum kur ke puna, nuk kena mujt mu shkollu asnjo, atëhere na u punësum në Trepçe, une jom punësu në Trepçe dikun në ‘67-tën pa kualifikim. Ma vonë dikuri e kom marrë kualifikimin aty për aty në sipërmarrje, atëherë na e jepshin kualifikimin. Kom punu si xehëtar, tek deri në vitin ‘89-tën.... jeta u konë e keqe, pse u konë e keqe thom këto, prej

fshatit tem e me shku në minierë u du ë ni orë e gjysë me shku në komë, verë e dimën. Nuk ka pasë automjet, s'ka pasë autobusë, s'ka pasë rrugë edhe u du me udhëtu në komë. Ni orë e gjysë me shkue, ni orë e gjysë me kthye, në tri ndërrimet, domethonë dimër-verë, shi-borë, gazep i Zotit u konë. Po mirë boll, atëhere me ni rrogë kena jetue, qishtu qysh kena mujt. Kena nejt në familje të madhe, 27 antarë jena konë, ma vonë dikur jena da me vllazni edhe gjithkush e kena bo jetën e vet, me ato mundësitë e veta… Jena konë, kena rrnue bashkë, tek deri diku '75-tën jena da. Jena shku diku afër 30-ve, 27 antarë kem bo" (*Avdi Uka*). Por vazhduan të jetonin në fshat.

Shyqyri Sadiku: "Domethanë, gjithmonë jom kanë i lidhun prapë me fshat… Mixha i babës ka metë n'kullë ktu në Bare, na me mixhallarë …jena shpërngulë vitet '76 në Vushtrri, tokën nuk e kena shitë në Bare. Edhe deri n'vitet '90-ta jena dalë gjithë e kena punu tokën. E kena pasë obligim. Jena dalë i kena thurë pronat tona, livadhet tona, edhe i kena kositë gjithë…." Sadiku ishte rritur në fshat me familjen e tij të madhe prej 33 anëtarësh. Babai i tij filloi të punonte në minierë vonë, në vitin 1974, kur ishte mbi 40 vjeç; nuk kishte mundur më parë. Shyqyriu deshi të studionte për mineralogji në universitet dhe madje kishte arritur të regjistrohej, por nuk kishte mundësi të vazhdonte studimet. Ai përfundoi shkollën teknike në qershor të vitit 1981. Në korrik u hap një vend pune si teknik në Stantërg, ku aplikoi dhe pastaj u punësua, në tetor. "Për herë t'parë qe kom fillu punën këtu, edhe jom kanë n'moshë shumë i ri, n'moshën 18 vjeçare. Edhe prej atëhershit, tash po flas realisht, nashta edhe jom lidhë shumë me Trepçën, edhe gjithçka jom n'gjendje me dhanë për Trepçën, se nashta hapat e parë të rinisë time kom fillu ktu; po flas hapat e parë, që nashta jom kanë n'atë moshën që jom kanë i pavarur realisht" *(Shyqyri Sadiku*).

Jeta në fshat ishte e varfër dhe e margjinalizuar, por ekonomia e fshatit ndihmonte për të plotësuar pagat e për të mbajtur familjet e mëdha dhe minatorët shpesh duhej të zgjidhnin si ta ndanin kohën e tyre. Edhe gjatë viteve të '80-a në Trepçë kishte ankesa për numrin e lartë të mungesave gjatë sezonit të korrjeve.[42] Megjithatë, pavarësisht kësaj, shumica e punëtorëve të Trepçës u transformuan nga fshatarë në klasë punëtore dhe u orientuan drejt një shoqërie urbane. "Miniera e ka pasë atë të vetën, atë fuqinë e vet dhe na krejt fije për fije, krejt Shala se jo veç katuni jem, po Shala krejt i madh e i vogël, ka dy e tre e katër [anëtarë të familjes] i ka pasë në Trepçe. E ajo u konë qysh me thonë, magjja e Shalës e hambari i Kosovës, Trepça" (*Avdi Uka*).

Stantërgu nuk tërhiqte vetëm minatorët. Remzije Dauti ishte mësuese dhe partia e kishte dërguar atje së bashku me bashkëshortin e saj, Rasimin, në fillim të viteve të '60-a, menjëherë pasi kishte përfunduar shkollën. Trepça u ofroi dy mësuesve të rinj një nga banesat që i zotëronte. "Atje o' bjeshkë, edhe dimrit kur binte borë ka qenë pak vështirë përmesh ku deri në shkollë… Terreni s'ka qenë përpara asfalt si tash që o', po je du m'u gjetë simbas terrenit edhe m'i qitë hapat për me ardhë deri në shkollë. E në shkollë kur kemi ardhë, shkolla ka qenë e madhe, e mirë, dy katëshe, e kemi pas nxemjen qendrore. Asnjë shkollë s'ka pas në Mitrovicë nxemje qendrore vetëm Stantërgu. Masanej Stantërgu ka qenë qendër intelektuale se e kemi pas bazenin që e kanë ndërtu anglezët. Unë gjithmonë i kom marrë çikat me burrin jemi shku në bazen jemi la. Masanej e kemi pas sallën e filmit, ka qenë biblioteka, e kemi pas muzeun e xeheve. Kur vijshin njerëzit kanë pas me kqyrë muzeun e xeheve, a din? Edhe sot e atë ditë ekziston" (Remzije Dauti).

Trepça ishte magjike edhe për Mitrovicën. *Burhan Kavaja*: “Faktikisht ka qenë qytet i minatorëve… Si fëmijë e di, kur u mershin rrogat në Trepçe, për arsye se ato dy-tri ditë ishte një rrëmujë e paparë për me u siguru ose me gjana ushqimore, ose me veshmbathje për arsye se shumica prej tyne punojshin në Trepçë…Të gjitha ato gjana nga kolonitë angleze. Ka pasë bazenet, fushat e tenisit, sallat për ballo, ka pasë në të gjitha këto rrethe si në Stantërg në Zveçan." *Bahtije Abrashi*: “Në krahasim me qytetet tjera ka qenë qytet ma i zhvillum, ma i avansum. Janë zhvillu shumë takime, atëherë të Krahinës Autonome, krejt delegacionet që kanë ardhë kanë ardhë në Mitrovicë. Trepça ka qenë gjigandi i tretë në Ballkan, kështu që ka qenë interesant për të gjithë… edhe n’shkollë fillore kena pasë kontaktet e pionerëve me qytetet tjera. Kanë thanë, ‘Oh, po na duket sikur me shku në tjetër shtet. Ktu jeni ma t’avansun, ma!’”

Vlera e punës

Kur flitet për koston njerëzore të punës në minierë, minatorët kanë prirje fillimisht të theksojnë përparimin e industrisë, që supozohej se do t’i lehtësonte vështirësitë që kjo punë bartte në vete.

Ramadan Gjeloshi: “Shpesh [babë] u la, u pastru në shpi, a dinë, shpesh në shpi u pastru. Se s’u konë larg e sene. ‘Puna’ tha, ‘u konë e fshtirë në atë kohë, mjetet jonë konë ma të dobëta, s’ka pasë teknikë’. Tregojke bile vena-vena me kolica qysh kanë bajt xehe, qaq jonë konë korridoret e ulta, nuk jonë konë qysh duhet edhe ka qenë fshtirë, tha, ‘Punë e rond’. Po kadal-dalë tu u avansu e sene, tu pru makineri të reja ka vazhdu."

Ibush Jonuzi: “T’u fillu prej udhëtimit, prej ushqimit, prej veshëmbathjes, mjetet e punës, mjetet siguruse për punë, në atë kohë kanë mungue të gjitha, nën nji. Nën dy, krejt ka qenë punë fizike. I kanë pasë do çekana shpues edhe tjetër çdo gja u dashtë fizikisht me e krye punën e vet, kanë bajtë me vagoneta, me krahë xehen e kanë bajtë. E kanë ngarku me lopatë e kanë thy me çekan, të gjitha ato jonë konë po thom punë shumë të mundimshme. Kurse tani situata është krejt ndryshe, edhe në kohën kur kom fillu unë ka qenë situata ma e mirë sesa në atë kohë kur ka punu baba jem e djali axhës e axha tjetër, e krejt ato.”

Pavarësisht përparimit, nëntoka e minierës nuk ndërronte.

Valdete Idrizi, e bija e një minatori: “E kujtoj se njeri ka qenë shumë si çokollatë, me pluhun e kështu krejt, domethonë njifarë.... Edhe i thojshim ‘O babë, koke bo si çokolladë’. Edhe tani thojke, ‘Hajde pra...’ Gjithë m’thojke, se unë kom pasë qef aerokrem e çokolladë, e thojke, ‘Ani pra, ty ta kona, hajde me m’puth’. E di që qashtu e kom puth. Edhe thashë, ‘Po’” (*Valdete Idrizi*).

Nexhmi Zeqiri: “Ka ndodhë që prindin tem s’e kam njoftë. Kam shku m’i kërku kumeditë çka… m’u ka nevojitë ni diçka kur kam shku, se atje je krejt zi." I biri i një minatori, Nexhmi Zeqiri, që u bë mjek falë një burse studimi nga ndërmarrja në 1984, e thirrën në minierë. Biografia e tij e bëri dëshmitar të privilegjuar të rrezikshmërisë së madhe të punës. “Ka pasë lëndime shumë… Osht’ edhe temperatura shumë e naltë, ka edhe lagështi, ka edhe

ujë, ka edhe erna, ka situatë… si mjek…Ka ndodhë ni vdekje aksidentale, kanë nxanë…ne i themi, xehja gjatë shpuarjes ka nxanë minatorin e ka mytë, sasi e madhe shpuarjet, ato me maqina. Pastaj ato trenat e vogël që e bartin xehen, aty ka mytë njerëz, ka mytë minatorë ose janë lëndue. Shpesh herë kemi shkue poshtë në minierë me disa metra nën tokë, horizonti tetë-nantë diku 800 metra. Kemi konstatu vdekjen ose kemi ndihmue procesin e minatorëve për me i transportu naltë me iu dhanë ndihmën e parë aty, se i ka nxanë xehja e s'kanë mujtë me lëvizë" (*Nexhmi Zeqiri*).

Ramadan Gjeloshi: "Tre vetë me durë të mia i kam nxjerrë të vdekun…Bile njo i Kqiqit, veç sa e patën martu as tre mujë, nifarë Gëzimi, djalë i mirë, i hjeshëm, i ri, i urtë, punëtor. Punishtja qysh osht' {përshkruan me duar} si kjo diku, si dhoma, ky *zidi* [srb.: muri] për shembull, mu rrëzu e ka nxonë Gëzimin prej Kqiqi dhe Qamilin prej Vllahije, dy këta. Edhe e kena minu atë bllokun për me i nxjerrë ata dy... Edhe kena minu jo kështu me të madhe poshtë municion, po ka ni vrimë të vogël u dashtë do munici me shti, me hekë ato pjesë-pjesë që me shku dej te ata, a din, që mos m'i dëmtu edhe ata. A din, kanë vdekë, po mos me dëmtu trupin e tyne edhe i kemi nxjerrë. Të tretin, u konë Veli Bajgora ai ka punu në *filling* [anglisht: mbush] i thojshin, do mbushje të horizontit, të punishteve, ato e kom nxjerrë me durë të mia edhe ato e kom nxjerrë. E ai u konë t'u punu më skiper tu e ngreh dheun, se lëshojshin dhe prej naltshit për me mushë tash punishten, kur mushet qekjo punishte kryhet, shkon deri në ni metër në tavan, tash prej atyhit vazhdohet përpjetë me hjekë xehen, a po kupton?"

Anita Susuri: "A je konë ti najherë në rrezik? Në rrezik të keq a je konë?"

Avdi Uka: "Jom konë në rrezik niqind herë, mu ka shembë *ruda* [srb.: xehet] para hunve, para hunve, ura tonelata. Më ka shkelë vagoni, në grizë aty ku lëshohet ruda, ai shprazet shkohet në për nifarë ure derdhet vagoni, une e kom pasë komën këtu, dy gishtat i kom të thyme. Në gip se kom majtën i mujekusur, po më ka rujt Zoti, e ata dy gishta janë sot e atë ditë jonë të thyem. Qashtu qysh jonë hi në gips qashtu jonë metë, të komës po. Kena pasë lëndime kapak, jo të mëdha, dikush goxha të mëdha, ka dikush që e ka hupe dhe komën, ka dikush që e ka hup edhe dorën, ka dikush që e ka hup synin. Domethonë gjithçka ka ndodh aty, gjithçka ka ndodh. E une qat' lëndim e kom pasë qat'herë, vëllau të njejtin sisteme ka pasë, doren, gishtin e ka thye vëllau i madh."

Gjëja e parë që bënte Avdi Uka kur kthehej nga pushimi me leje, ishte të shkonte në minierë të kontrollonte nëse shokët e tij ishin të gjithë mirë. "Për gjeneratën teme sa une kom punu në minierë, deri '90-ën që kom punue, nontë vetë e kanë hup jetën aty, nontë vetë. Ni Sejdi Muliqin e kena qit në kese të sheqerit, që u ra, në shakt u ra, domethonë, sikur kur e derdh grunin prej thesit, qashtu u bo njeri. Ka ndodh që e kena çu gjithë ditën me hjek bllokat e me heqë *rudën* [serbisht: xehe] për me nxjerrë kufomën e tina që ka nejt nër bllok. Jetë e fshtirë u konë… une jom konë në fshat ku bash i fshatit tem njo e ka hup jetën në minierë aty. Edhe në pra 12:00 të ditës lajmroi, tha, 'Nji fatkeqësi…' në tranzistora, televizora s'ka pasë atëherë, as s' ka pasë rrymë në fshat temin, edhe qishtu thotë, 'E hupi jetën filan fisteku'. Dhimtë gjithë, mërzi gjithë, tutë gjithë, krejt familja"*(Avdi Uka)*.

Tahir Salihu kujton një aksident të të atit, një veteran i minierës i punësuar në vitin 1948. Ai mbeti i ngujuar nën një masë prej gjashtë tonësh e gjysmë

për më shumë se katër orë dhe mezi ia doli të dilte, me gjysmën e eshtrave të thyera.

Arditë Aliu: “Qysh ndikoj ky aksident i babës t’juj te ju përsonalisht?”

Tahir Salihu: “Po sigurisht se gjithë ato ndikojnë te unë si biri i tina, sikur te tjert, te shokt për shembull, kur ndodh ni fatkeqësi n’minierë. Se aty n’minierë, me fat qoftë, po, aty shkrun: ‘E din me hi, po kur del nuk e din.’ Se osht punë e vshtirë, e rrezikshme n’çdo aspekt. Aty kanë ndodhë edhe raste tjera une kur kom punue. Disa shok qi kanë met n’minerë t’vdekun."

Kur vdiste një minator, ishte zakon të punësoheshin fëmijët e tij. Kur ndodhte ndonjë fatkeqësi, niste një proces për të përcaktuar dëmshpërblimin e duhur. Me këtë merrej zyra e Alije Gashi Tmavës, ekonomiste dhe e bija e një tekniku të minierës, e punësuar në vitin 1985. “Osht’ përcjellë vendi i punës i atij punëtori, osht’ marrë ni mesatare e pagës mandena iu ka bo kompensimi i damit sa osht’ lëndu, çfarë dami, sa përqind të damit… Lëndimin ia jep mjeku, komisioni mjekësor e cakton damin, mandena bohet në bazë të dokumentacionit, në bazë të mjekut që e cakton a tash, tash nuk kem” (*Alije Gashi Tmava*).

Por rreziqet për shëndetin e minatorëve ishin të përditshme, siç tregon ai shkrimi në hyrje, për të cilin flasin të gjithë: “Me fat."

Beqir Maliqi: “Me futje aty te sinjalisti na i thojmë edhe në kafaz ndryshon çdo gjo, edhe domethonë edhe frymëmarrja edhe lëvizjet edhe sidomos ata fillestarë që hyjnë për herë të parë. Shtypja e ajrit ndikon për veshë për shembull, shkurdhohen veshët thuhet. Neve na mësojshin këta ma të vjetrit që, ‘Përbiju ndaq me t’u çelë veshët’ ose diçka. Por, njëfarë paniku t’rrokë në vetvete, njëfarë heshtje t’u shku atje e posaqërisht kur hin atje edhe në vendet e punës për shembull që jonë bukur të rrezikshme. Punohet e të djerësitun punëtorët, temperaturat e larta, rrymimi i ajrit ka pusorja osht’ i madh për shembull, sidomos osht’ problem kur shkon ti atje nëpër vende të nxehta edhe djerësitesh e kur të dojsh me dalë osht’ rryma e ajrit e freskët, sepse hyn prej pusit kryesor rryma e freskët… kujdes për shembull që unë kom pasë këshilla prej babait, që veshu mirë edhe ruju se miniera t’han e miniera t’prishë në aspektin shëndetësor."

Mësuesja e Stantërgut, Remzije Dauti, e kuptoi çfarë do të thoshte të punoje në minierë kur ofroi të hynte me një delegacion, meqë ajo ishte edhe drejtore e organizatës së grave të vendit. “Kur kom hi poshtë, t’gjashtin horizont, 610 metra poshtë kom qenë horizont ku nxjerren xehet, kur kom zhdrypë [zbritë] poshtë…e kom pa rruga shumë e ngushtë, e qysh po thehen xehet, e uji po kalon, e ajër jo sa duhet, truni ja nisi pak m’u blloku, qaq e kom ndi veten keq m’u kanë dhimb ata punëtorë që po punojnë aty. Kur jom hyp nalt e ju kom thanë arsimtarëve, ‘Dijeni, puna jonë është lluks. Fëmijët e qatyne prindërve ushqehen me gjak të prindit’. Çfarë mundi kanë pasë minatorët! Në fillim iu kanë dhanë… ka një shujtë, a din, kështu; kur kanë punu ma shumë, iu kanë dhanë plus rrogës. Masanej, iu kanë dhanë nganjëherë edhe qumësht me pi, se qumështi i pastron mushknitë… u sëmurshin njerëzit prej silikozës në mushkni” (*Remzije Dauti*).

Klinika e minierës, që në vitet e ‘80-a u zhvendos afër Stantërgut, punonte

me orar të plotë. *Nexhmi Zeqiri*: “Nalt në Stantërg në ambulantë kem vizitue edhe minatorët edhe familjarët e tyre.…Aty [Zveçan] osht’ shkritorja dhe rafinerija. Aty u shkri xehja. Aty kemi bo edhe kujdestarinë ne stacionalen e kem pasë ku ka pasë edhe helmime shumë me plumb. Ku u shkri xehja temperaturat janë shumë të nalta 500-600, avujt e atyne xeheve kur janë shkri xehet kanë helmue minatorët…Për fat, kom pasë fat dhe me magjistru edhe me doktoru në Tiranë në këtë lami, ‘Helmimet me plumb në Stantërg, ndikimet e tyre në shumë faktorë’…”

Anita Susuri: “Cilat kanë qenë pasojat që i kanë pasë për shembull?”

Nexhmi Zeqiri: “Avujt e plumbit edhe metaleve tjera kanë dëmtu sistemin nervor. Pastaj dhëmbët i kanë pasë shumica të dëmtum, eshtrat qashtu të dëmtum, se plumbi lidhet në eshra ma së shumti edhe në sistemin nervor. Këto dyja që e qujmë ne lokomotori i eshrave, sistemin nervor, këto dyja janë që i atakon ma së shumti. Po foli për pjesën e Zveçanit ku osht’ shkrirtorja, kurse në Stantërg, sëmundja që e marrin minatorët quhet silikoza e dioksidit të silicit. Janë mikro-thërmija që atakojnë sistemin e mushkërive të frymëmarrjes dhe që dëmtojnë mushkëritë. Dhe kjo sëmundje si silikozë osht’ e njoftun, hyn në kuadër të sëmundjeve profesionale. Profesioni ua ka bo këto bashkë me këto helmimet tjera. Por, në Stantërg në minierë është silikoza, kurse në pjesën e Zveçanit ku bëhet shkrirja kemi helmimet me plumb akute që i qujmë ne edhe kronike, por ato akute janë ma kryesoret."

Një punë e veçantë

Për Isuf Beqirin, teknik i minierës, të gjitha ishin të njohura, i kishin treguar i ati dhe gjyshi, të cilët kishin qenë minatorë. Megjithatë, hyri në Trepçë në vitin 1978, siç e donte tradita e familjes, menjëherë pas shkollës teknike. Edhe Xhafer Nuli, inxhinier dhe drejtor i mirëmbajtjes, e dinte mirë si punohej. “Nuk ka pasë familje në fshat tonë që s’e ka pasë dikond të punësum në ‘Trepçë’, kryesisht në Stantërg … E kom ditë, i kom ditë kushtet, s’i kom ditë detajisht, mirëpo e kom ditë qysh i kanë tregue kushtet edhe rrethanat. E kom ditë që jonë konë shumë të vshtira, e kom ditë që jonë kushtet që dojnë një përkushtim të veçantë edhe puna e don një përkushtim të veçantë. Puna në miniera osht’ sikur puna në ushtri. Aty nuk ka me shku me lonë hajt me një indulencë të punës, mirëpo, puna don përkushtim” (*Xhafer Nuli*).

Krahasimi i punës së minatorit me profesione të tjera që kërkojnë përgjegjësi, vendosmëri dhe gatishmëri për të pranuar rreziqet nuk është unik për Xhafer Nulin. Na kujton këngën e vjetër të sindikatës, të cituar nga Portelli në historinë e tij gojore mbi zonën minerare të Harlan County, në Kentucky: "Jeta e një minatori është si ajo e një marinari/çdo ditë jeta e tij është në rrezik/e megjithatë, me guxim ai del në det." Na kujton edhe kombinimin e vetëdijes dhe pranimit të kushteve të vështira të punës edhe nga minatorët amerikanë.[43]

Në familjen e madhe të Trepçës, rreziqet e punës ishin një fakt i pranuar dhe jo një pengesë, sepse përveç pagës, ato kompensoheshin nga shoqëria dhe nga solidariteti mes kolegëve. *Isuf Beqiri*: “Veç puna osht’ e rrezikshme, puna osht’ e vshtirë, po kur o shoqnia e mirë, para luftës u konë tjetër, shoqnia e mirë o konë shumë. Zatën, njo për tonë, tonë për njo.’” *Tahir Salihu*: “Kemi

pasë qysh me than, ni harmoni mes veti shumë t'madhe ne puntortë. Muj me than u knaqshim mes veti…Po shoqnia gjithmonë um ka përkrahë. Edhe familja, kom pasë përkrahje n'maksimum. Edhe shoqnia n'maksimum përkrahje… jena kanë 'nja' gjithmonë." *Zeqir Fejzullahu*: "Vallahi vullneti jem u kanë gjithë, fort i mirë u kanë për Trepçën. Edhe po thom' që çdo njeri atje e man sevdaja, sevdaja. Po gjithkon e man sevdaja, çdokanin e man sevdaja aty, veç u kanë shumë e çuditshme që u kanë sevdaja e fortë me shoqni. Ku hishe tu keshë, tu ba llaf, tu ba, domethanë nuk kish najfarë kijameti, po ish ni gzim i madh kur takohesh aty me shoqni." Në fabrikën e akumulatorëve të Trepçës, në Mitrovicë, "relacionet kanë qenë shumë njerëzore, se njerëzit nuk kanë pas' kohë me u marrë me gjana banale, se edhe punëtorët kanë qenë entuziasta të m'dhej, e kanë desht' prodhimin se kishte rezultate praktikisht" (*Zeki Loxha*).

Në vazhdën e këtyre kujtimeve përfshihen shumë gjëra, të cilat nuk duhet të ngatërrohen. Ndjenja e një uniteti të pandashëm, e përkatësisë në komunitet, e solidaritetit, e miqësisë dhe raporteve shoqërore të ndërtuara mbi vëllazërinë dhe humorin, por edhe krenaria dhe dinjiteti që sjell puna e tyre. Nuk dua të krijoj një imazh stereotip të minatorit ideal, por është e rëndësishme të theksohet se të gjitha këto përvoja dhe ndjenja janë të pranishme kudo, madje edhe në kujtimet e minatorëve uellsianë dhe skocezë nga studimet e shumta të historisë gojore të minierave në Britaninë e Madhe.[44] Për krenarinë me aftësinë që kanë për t'u përballur me vështirësitë dhe rreziqet e punës në minierë, për etikën e tyre të punës dhe për solidaritetin, flasin edhe minatorët amerikanë.[45]

Po atëherë, si mund të shpjegohen përplasjet nacionaliste midis shqiptarëve dhe serbëve për të cilat flitet kaq shumë? Për shumë minatorë ky problem nuk ka ekzistuar kurrë.

Asllan Hasani: "Po, kena pasë hajgare, kena pasë hajgare. Kena pasë hajgare edhe me serb se dej diku veç u bonëm si ni familje. Tash kur punofsh dhet' vjet, pesëmdhet' vjet, tetëmdhet' vjet bohësh si ni familje"…

Ridona Berisha: "A po m'tregon a ka pas barazi mes punëtorëve, a jeni trajtu t'barabartë…"

Asllan Hasani: "T'barabartë jena trajtue. Kush ka dasht' me punue nuk ka pas pengesa pej anës t'sërbve kurgjo … tanajshi ma kanë dhôn maqinën…E tanajshi kur e kanë pa qi jom i aftë edhe jom i kujdesshëm për qat punë, m'kanë shti edhe e kom marrë me komision. U ardhë prej Beogradit komisioni edhe ma kanë dhonë kfalifikimin."

Ndoshta arsyeja e mungesës së përplasjeve të mëdha ndëretnike gjendej në solidaritetin e minatorëve.

Ridona Berisha: "A ka pasë diferencime etnike n'Trepçë? A ka pasë barazi mes punëtorve?"

Zeqir Fejzullahu: "Qysh po thue barazime?"

Ridona Berisha: Barazi mes punëtorve a ka pasë, a ka pasë diferencime me u dallu punëtort?

Zeqir Fejzullahu: “Ja, ja aty veç t'thashë edhe pare ma herët, që aty [Këshilli] veç vendimet i kanë pasë gjithë e cili e ka pasë vendimin e vet… edhe asni punëtorë si thotë, ‘s’o qështu’…”

Ose ndoshta, thjesht, dallimet etnike në minierë nuk ishin të tilla sa të krijonin përplasje.

Gani Osmani: “Jo, s’kena pasë problem, se aty veç u doke që shumica janë shiptarë. Po të tregoj në venat ma të zorshëm që je konë, janë konë minatorët shiptarë edhe jonë konë ni pjesë, ka pasë edhe romë, ka pasë boshnjakë, ka pasë edhe sërbë, ka pasë edhe sërbë, unë punëtorë e kom pasë që u konë xehëtarë. Mirëpo, u konë nji numër ma i vogël. Venat ku jonë konë si elektricistë, makinistë, do vene ma të, ma të lehta jonë konë sërbët, në venat kyç janë konë sërbët. Mirëpo, veç u pa tajshi që shumica jonë shiptarë edhe duhet me ju fol në gjuhën shqipe."

Tensionet shkaktoheshin kryesisht përmes problemit të gjuhës. Një minierë e drejtuar nga një manaxhment serb për shumë vite pati vështirësi të përshtatej me dygjuhësinë e sjellë nga punësimet masive të shqiptarëve, që erdhi për shkak të zgjerimit të ndërmarrjes dhe politikave të balancimit të përbërjes etnike të fuqisë punëtore. Madje, minatorët shqiptarë kishin mësuar një fjalor të kufizuar serbo-kroatisht, siç quhej atëherë, për lehtësi pune në minierë.

Ibush Jonuzi: “Nuk ka ditë me thonë, ‘Quhem Ibush Jonuzi’, po sërbisht e ka thonë. Ose atë numrin e pagesës, u dashtë, rregull u konë me i lonë numrat, për shembull, unë e kom pasë numrin 116, me ditë kur hish në minierë, kur dalsh prej miniere, krejt ato. Edhe ata s’kanë ditë me thonë numri i rrogës po kanë thonë *platni broj*, më fal që e përdora kështu sërbisht, po në origjinalitet. E profesor Miniri vazhdimisht tu ju dhonë vërejtje, ‘Nuk bon ashtu, duhet shqip m’u mësue’… Termet s’i kanë ditë, s’kanë ditë ata. S’kanë pasë shkollë, pos nëse e kanë pasë naj kurs të sërbishtës krejt ato."

Në vitin 1968, Këshilli Qendror i Punëtorëve miratoi një rregullore që u jepte të drejtën punëtorëve të Trepçës të flisnin në gjuhën e tyre dhe përcaktonte që të gjitha dokumentet e ndërmarrjes të hartoheshin në shqip dhe serbo-kroatisht nga një njësi përkthyesish dy-gjuhësh.[46]

[42] Radivoj Kovacevic, “Work Disruption at Trepca Described” *Ilustranova Politika*, 28 July 1981, f. 20-21.

[43] Alessandro Portelli, *They Say in Harlan County: An Oral History,* Oxford University Press, 2010, f. 135-156.

[44] Lee Waddington, “Rethinking Camaraderie as Emotional Practices: Deindustrialization and Deskilling in South Yorkshire Coalfields, 1980s-2000s” *Contemporary British History* 37 (3) 2023: 432-464.

[45] Portelli, *They Say in Harlan County*, f. 142.

[46] Troch, “Social Dynamics,” f. 221.

EPOKA E ARTË

Periudha nga vitet e ‘60-a deri në vitet e ‘80-a konsiderohet si epoka e artë e Trepçës. Gjatë këtyre viteve, “punësimi, si i drejtpërdrejtë, ashtu edhe ai i tërthortë, u rrit masivisht dhe ndërmarrja pagoi paga të mira (për standardet lokale).”[47] Të ardhurat personale për një punëtor ishin mesatarisht mbi 300$ në muaj, që do të thotë mbi mesataren e të ardhurave të atëhershme në Kosovë.[48]

Çka kishte ndodhur ishte rezultat të ashtuquajturës “stuhi e përsosur”. Në vitin 1965, Jugosllavia krijoi Fondin Federal për Përshpejtimin e Zhvillimit të Republikave dhe Krahinave të Pazhvilluara (FADURK) dhe futi disa miliarda në ekonominë e Kosovës, Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Njëkohësisht, pati ndryshime domethënëse në krye të udhëheqësisë komuniste jugosllave, shoqëruar me reforma politike dhe institucionale. “Hapi i madh përpara” që çoi vendin në nivele konsumi të admiruar nga i gjithë blloku socialist i Evropës Lindore nuk ndodhi falë planit pesë-vjeçar të inauguruar pas Luftës së Dytë Botërore, i cili dështoi menjëherë, por falë prezantimit të ngadalshëm të decentralizimit dhe kredisë.

Që në vitin 1966, largimi nga të gjitha funksionet e partisë dhe shtetit i Aleksandar Ranković, hero partizan dhe një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Tito, ministër i brendshëm dhe drejtues i shërbimeve sekrete, ishte një çlirim. Ranković i kishte përndjekur me zell stalinist ata që ishin rreshtuar me Bashkimin Sovjetik, kur Stalini u nda me Titon në vitin 1948, por edhe çdokënd tjetër që mund të konsiderohej si armik i shtetit. Kur provat për krimet e tij u bënë publike, “shtrembërime të rënda, dosje të shërbimeve sekrete (sidomos për kroatët dhe shqiptarët), një pushtet i pakufizuar dhe pa masë... gjithashtu një karakter i fortë panserb i urryer nga kombet e tjera jugosllave”, qeveria e re serbe u përpoq të identifikonte Serbinë me Jugosllavinë dhe të braktiste centralizmin.[49] Në Plenumin e Brionit (1966) partia bëri një lloj “mea culpa” për teprimet centralizuese të dy dekadave pas çlirimit, duke i hapur rrugën prirjeve më vetëqeverisëse.

Gjatë pushtetit të Ranković, shqiptarët e Kosovës e vuajtën më shumë shtypjen sesa të tjerët. Ata ishin cak i një fushate të dhunshme. Duke u thirrur në emër të mbledhjes dhe konfiskimit të armëve, shqiptarët u shantazhuan, keqtrajtuan dhe u mbajtën në paraburgim përtej praktikave të zakonshme të operacioneve policore. Një nga veprimet tjera të tepruara të epokës së Ranković ishte edhe diskriminimi sistematik dhe i tërësishëm. Në Mitrovicë, partia dënoi Departamentin e Kuadrove të Trepçës, kryesisht serbë, për

mospranimin e kërkesave për punësim madje edhe të shqiptarëve të pajisur me diploma të marra falë bursave të ndërmarrjes. Justifikimi ishte se kërkesat ishin shkruar në gjuhën shqipe. Departamenti u kritikua nga punëtorët dhe partia për korrupsion, paaftësi dhe diskriminim.[50]

Ndërsa trysnia e organeve të sigurisë shtetërore po zvogëlohej, me decentralizimin po vendoseshin rregulla të reja, që e bënin të pamundur për qeverinë federale të kontrollonte ndërmarrjet, një proces që kishte nisur qysh në vitin 1965. Kontrolli mbi organizimin ekonomik u kalonte republikave, përfshirë edhe çështjen e personelit të ndërmarrjeve, si edhe bankave dhe shërbimeve sociale. Edhe vetë partia po e ndryshonte organizimin. Kongresi i nëntë i vitit 1969, për herë të parë futi udhëheqjen kolektive përmes një presidence prej 14 anëtarësh që zëvendësoi Komitetin Qendror, duke zgjeruar sipas të njëjtit parim edhe organet e saj si sindikatat, shoqatën e veteranëve dhe rininë komuniste. Partia quhej Lidhja Komuniste që nga viti 1952, por struktura e re e zbehu edhe më shumë karakterin e saj si një trup i bashkuar, që garantohej politikisht nga autoriteti i Titos.[51]

Pasojat e decentralizimit

Në vitin 1974, Kushtetuta e re e Jugosllavisë miratoi auton-ominë e plotë, jo vetëm të republikave kushtetuese të Federatës, por edhe të dy provincave të Serbisë: Kosovës dhe Vojvodinës. Me autonominë dhe decentralizimin ndryshuan raportet e pushtetit ndërmjet kombësive në favor të shqiptarëve, të cilët mbizotëronin në aspektin demografik në Kosovë dhe i dhanë karakter edhe subjektivitetit të krahinës. Në krye të partisë ishte Mahmut Bakalli, tashmë kryetar i komunistëve në Prishtinë që nga viti 1967, i cili më pas u ngjit në pozitën drejtuese krahinore në vitin 1971. Bakalli konsiderohej si një "mbrojtës" i Titos dhe si përfaqësuesi i përsosur i klasës intelektuale shqiptare, që po zgjerohej. Në pozitat drejtuese, ai ishte i lirë të zgjidhte kuadro të rinj politikë dhe menaxherialë shqiptarë, përkrahës të komunizmit të decentralizuar jugosllav.[52] Në mesin e tyre ishte Aziz Abrashi, i diplomuar për ekonomi në Beograd dhe mësues në Shkollën Normale, i cili iu bashkua menjëherë udhëheqësisë krahinore dhe drejtoi politikat ekonomike të saj.

Karriera e Burhan Kavajës na krijon një ide për atë se çfarë mund të nënkuptonin këto ndryshime për Trepçën dhe për Kosovën në përgjithësi në atë periudhë. “Pasi e kreva fakultetin me bursën nga Trepça, fillova me punu me 1964-tën në Kishnicë si inzhinjer i repartit, mandej si udhëheqës teknik i mjeteve sipërfaqësore. Dhe në fund të viteve ‘69-‘70, Azizi pat kalu në organet e administratës kërkoi që edhe une t’i bashkangjitna… E para herë sipas amandamenteve kushtetuse të vitit ‘69, u formun organet e administratës në Prishtinë për Kosovë. Mandej kam qenë Kryesinspektor i Inspektorateve Teknike [1970], mandej Zavendës Sekretar ose Zavendës Ministri [1974] që së bashku me Azizin kena bo përgaditjet e shumë ligjeve ekonomike… ligje të cilat ishin jetike për popullin shqiptar… Aplikimi i këtyre ligjeve do të thoshte pavarësi e plotë të Kosovës prej Sërbisë. Neni 1. I Ligjit për Xehëtari shkrunte se, ‘Pasuria e Kosovës osht’ shoqërore edhe i takon Kosovës’…Na këtë ligj e kena bo si paraprojekt me gjithë ata të punësumit e Sekretariatit për Ekonomi. Ishin nji numër mjaft i madh i tyne të cilët punojshin. Mos harroj t’ju thom ka ndodh shpesh herë që i kena bo kopijimin e ligjeve tjera për arsye se nuk kishim kuadra aq të forta të mëdha, po çdo herë e përgaditshim projektin edhe e çojshim në qeveri, qeveria e

çojke në Kuvend edhe u aprovojke në kuvend, për arsye se ishte nji entuziazëm, ishte një gjo që e para herë formulojshim e bojshim, në bazë të gjitha atyne amandamenteve që i takojke Kosovës" (*Burhan Kavaja*).

Përmes Inspektoratit, Kavaja e vendosi të gjithë doku-mentacionin e Trepçës në një kamion dhe e transferoi nga Beogradi në Kosovë. Në bashkëpunim me një inxhinier serb, ai shënoi një kufi ndërmjet Serbisë dhe Kosovës në thellësi prej 400 metrash në Bellobërd, për të ndarë burimet minerare të njërës palë nga ato të palës tjetër, në mënyrë që inspektorët e rajoneve përkatëse ta dinin se cilin territor kishin nën juridiksion.

Korab Krasniqi: "Çka keni gjet në dokumentacione diçka që ju ka ndihmu juve në punë?"

Burhan Kavaja: "Shumë me randësi ka qenë dokumentacioni gjeollogjik, i cili kish qenë në atë kohë krejt i akumulum në Beograd për rezervat, për resurset, për rezervat e cilësisë, cilësitë e landëve të para minerale në Kosovë. Si të Trepçës ashtu edhe të Obiliqit, ashtu të Leposaviqit, Kishnicës, Novobërdës. Ai dokumentacion na ka mundësu ma vonë që me Azizin me përgaditë nji material të cilin e kena pasë në tubimin shkencor ma vonë në Tiranë, 'Resurset e Kosovës si mundësi e zhvillimit ekonomiko-shoqëror të Kosovës', ku e patëm dhonë vlerën e këtyne resurseve dhe 505 miliardë dollarë me çmime kur nji barrel ka qenë dhetë dollarë."

Përgjatë gjithë viteteve të '70-a mitologjia jugosllave, që fliste për një përparim të vazhdueshëm, mbeti e pakontestuar. Si kulm i reformave institucionale dhe ekon-omike ishte vetëmenaxhimi i ndërmarrjeve, një politikë inovative në kontekstin e teorive socialiste, që kërkonin të zgjidhnin problemin e pjesëmarrjes dhe tjetërsimit të punonjësve. Nëse Edvard Kardelj njihet si babai i idesë për t'u dhënë punonjësve kontroll mbi punën e tyre, përmes vetëmenaxhimit ndoshta u shpreh më së shumti "person-aliteti kolektiv" i grupit udhëheqës komunist jugosllav dhe autonomia e tij nga ndikimet e jashtme pas shkëputjes me Stalinin.[53] Ligji mbi Punën e Bashkuar, i miratuar në vitin 1976, u miratua në kulmin e një sërë reformash, që kishin shtrirë kontrollin e fabrikave tek punonjësit e tyre. Ligji përcaktonte format e vetëmenaxhimit të fabrikave, të quajtura organizata të lidhura me punën, si dhe të të gjitha veprimtarive të tjera ekonomike dhe sociale, duke përfshirë komunitetet lokale. E gjithë struktura politike e vendit përjetoi revolucion.

Në realitet, vetëmenaxhimi nuk ia doli të zhvillonte ekonominë në një shkallë më të gjerë, ndërkohë që ndikoi në ngadalësimin dhe izolimin e tregut të brendshëm, duke kontribuuar në krizën ekonomike. Megjithatë, ky model i socializmit çoi në një shpërndarje të pjesshme të pushtetit dhe ruajti vendet e punës dhe pagat, duke legjitimuar regjimin për aq kohë sa kishte para. Pjesën tjetër e bënë vendimet e marra gjatë krizës energetike të vitit 1970, kur Jugosllavia u bë proteksioniste dhe financoi investime masive në zëvendësimin e importeve me petrodollarët e ricikluar.

Në Trepçë, autonomia e krahinës dhe e ndërmarrjes solli investime të mëdha, shtim të vendeve të punës dhe rritje të pagave. Në vitin 1973, Veli Deva u bë drejtori i parë shqiptar i Trepçës.

Avdi Uka: "Veç kur ja nisën, *vit-vit-vit*, erdh asfallti edhe prej neve, prej

fshatit te matje… Rroga ka qenë shumë e mirë, shumë e mirë ka qenë, jeta e mirë…Merre me men që në kohën e Veli Devës, me dy lista e marshum rrogën, me dy lista. Se nuk guxojke me ni listë me shti rrogën se dalke shumë, e ta dajke në dy pjesë. Ni pjesë ta dha ke këtu, njo këtu, domethonë ke pasë pare sa të dush… Nimojke sindikata me libra të fëmive, mu m'i ka dhonë librat e fëmive ka ni thes libra e fletore, sindikata. Domethonë, erdh puna tu u përmirësu, tu u hujdis e asi. Ja nisën me maru banesa, Veli Deva i ka maru banesat në Tunelin e Parë edhe e ka pasë dhonë fjalën që duhet okolla minierës tek deri në Shalë atje banesa me bo. Ai punëtor i Trepçës që do banesë me ja dhonë çelësat, ai që nuk don banesë po don me marrë kredit, i thojshin me afat të gatë, 30 vjet, 40 vjet kredi, me ja dhonë kreditin, me ja bo të mujshme minatorit."

Në fund të viteve të 70-a, selia qendrore e ndërmarrjes në Mitrovicë përfshinte një repart transporti, një fabrikë të rimorkiove, një bankë, një kompani sigurimesh, një laborator, një institut metalurgjik, një institut shëndetësor, një hotel, një restorant, një fabrikë tekstilesh, etj. Në vitin 1981, popullsia e Mitrovicës ishte dyfishuar krahasuar me vitin 1961, duke arritur në rreth 53,000 banorë. Me këtë rritje, përbërja e saj demografike ishte transformuar plotësisht. Popullsia sllave kishte rënë nga 44.4% në 20%, shqiptarët kishin shkuar nga 50% në 60%, ndërsa boshnjakët dhe romët ishin rritur nga 3% në 15%. Dyndjet nga zonat rurale, nga rajonet e tjera të Kosovës dhe nga republikat e tjera jugosllave, e kishin shndërruar Mitrovicën në një qytet shumë-etnik me shumicë shqiptare.

Në vitin 1978, u bë njëri nga investimet më të mëdha në Trepçë, ndërtimi i një rafinerie plumbi. U themeluan ndërmarrje të reja të grupit në zona të tjera të Kosovës me qëllimin për të përdorur burimet e Kosovës për zhvillimin e Kosovës. Fundi i centralizimit socialist u dha fund politikave grabitqare të rajoneve tjera jugosllave, të cilat blinin energji elektrike dhe burime natyrore nga Kosova me çmime qesharake ose pa paguar fare. "Në vitet e tetëdhjeta, ndërmarrja i përmbushi pothuajse plotësisht aspiratat e menaxhmentit të saj të ri: minierat e saj furnizonin industrinë metalurgjike të Zveçanit dhe Mitrovicës, ndërsa fabrika kimike në Mitrovicë prodhonte nënprodukte për impiantet e përpunimit të mëtejshëm. Plumbi dhe zinku, kadmiumi dhe metalet e çmuara si ari, argjendi dhe bizmuti furnizuan tre fabrikat e baterive në Mitrovicë, Pejë dhe Gjilan, u dërguan në fabrikën e municioneve në Skënderaj, në përpunimin e metaleve në Gjakovë dhe Prizren, në fabrikën e bojërave dhe të galvanizimit në Vushtrri. Pjesa tjetër shitej në treg."[54]

Trepça është e jona

Me rritjen e ndërmarrjes, rritej edhe "familja" e Trepçës. Vehbi Haxhiu, bir, vëlla, nip dhe kushëri i minatorëve, u punësua në minierë gjatë vitit të parë të studimeve universitare, kur ndiqte ligjëratat me korrespondencë në Universitetin e Beogradit. Ai arriti të përfundonte studimet si student i rregullt kur u hap Fakulteti i Metalurgjisë dhe Mineralogjisë në Mitrovicë. Në korrik të vitit 1971, ai filloi karrierën e tij si inxhinier. "Këtu kisha me falenderu edhe fabrikën që m'ka mundësu edhe ngritjen profesionale pa u sh'kputë nga puna tu dhonë kontributin tim n'punë edhe faktikisht detyra masanej ka rrjedh me kohë derisa ka mrri n'fund në pozitën e drejtorit t'prodhimit n'Fabrikën e Akumulatorëve" (*Vehbi Haxhiu*).

Historia e tij nuk është unike. Në gjysmën e dytë të viteve të ‘60-a, ndërmarrja filloi të ofronte bursa studimi, duke u dhënë fillimisht mundësinë fëmijëve të minatorëve, por edhe të tjerëve, që vinin nga fshatrat, për të ndjekur shkolla profesionale dhe universitete.

Burhan Kavaja: “Ne si Kosovë nuk kena qenë të përgaditun për naj avansim ma të lartë të zgjedhjeve kushtetuese. Ne mas ‘45-tës kena ardhë me nji situatë që kena pasë në gishta intelektualë të Kosovës. Me themelimin e universitetit në vitet ‘70-ta, ne fillum nji prodhim, kushtimisht me qujt të kuadrit shqiptar me fakultete. Tek e tuk kishte njerëz si unë edhe tjerë që patën kry nëpër Beograd, Zagreb e Ljubljanë, mirëpo ishte numri shumë i vogël. Me kuadra të cilat dolën nga Universiteti i Prishtinës, ku kom edhe une pjesëmarrje në ato kuadra, ne krijum një kuadro të mirëfilltë që kishte mundësi m’u ballafaqësu me tehnikën dhe teknologjinë, arsimin, kulturën, jurisprud-encën në Kosovë.”

Këshilli Qendror i Punëtorëve u përpoq të përmirësonte situatën e shqiptarëve pa futur kuota, duke përcaktuar që përbërja e forcës punëtore duhej të pasqyronte atë të popullsisë, ndaj gjatë përzgjedhjes për bursat e studimit, përparësi iu dha kombësive që ishin të nënpërfaqësuara në vendin e punës.

Djalë, nip dhe kushëri minatorësh, njëri prej të cilëve kishte humbur jetën në minierë në moshën 26-vjeçare, në vitin 1948, Ibush Jonuzi vijoi shkollën teknike dhe universitetin falë bursave të ndërmarrjes. Në vitin 1973 u punësua. Në vitin 1980, Beqir Maliqi, djali i një minatori, diplomoi në Mitrovicë, nën mentorimin e profesorit Minir Dushi, për Ekonomi të Mineralogjisë. Kur i ati mësoi se djali kishte ndërruar fakultetin, i tha: “Eh more bir, ti nuk mundesh tjetërkund m’u regjistru sepse t’kom maru me *rudë,* me xehe.”

Gani Osmani përfundoi shkollën e mesme në vitin 1981 dhe u punësua në moshën 19-vjeçare si teknik minerar në Trepçë, së bashku me të gjithë maturantët e klasës së tij, të cilët, si ai, ishin fëmijë dhe nipër minatorësh. “Une e kom pasë edhe ni përparësi pak, po tregoj kështu, m’u inkuadru në punë se prindi jem në vitet e ‘60-ta ka qenë i lëndum këtu në minierë edhe për atë shkak ka qenë edhe nji lloj përparësie… Nejse, do jonë konë gjenerata ma të moçme që e kanë kry shkollën…jonë hi në moshën 19 vjeçare. Edhe ata e kanë pasë nji përparësi, atëherë konë përparësi ju ka lëndu prindi ose i ka dekë, edhe jonë inkuadru pa kushte” (Gani Osmani)

Duke kujtuar ato kohë, disa kuadro mohojnë se avancimi i tyre shoqëror ka shkaktuar probleme mes punonjësve të ndërmarrjes. Përkundrazi, solidariteti mes minatorëve thuhet se përfshiu të gjithë punonjësit e Trepçës, duke ndikuar dukshëm në jetën e përditshme. “Me ndërrimin e teknologjisë… si me thonë autoriteti i inzhinjerit u rrit’, me ju thonë të drejtën, edhe un’ si entuziast në at’ kohë menxi pritsha me u bo sabahu e me shku në fabrikë edhe me punu” (*Zeki Loxha*).

Ibush Jonuzi përdor pothuajse të njëjtat fjalë për të përshkruar fillimin e ditës së tij të punës. “Jom zgju në ora 05:00, kom ngronë mëngjes. Nona më ka pregaditë në atë kohë edhe pastaj gruja edhe kunatat, gratë e vëllezërive kur s’ka qenë nona. Kom hongër mëngjes në shpi, kom dalë, kom udhëtu deri

në Smrekonicë, gjashtë kilometra, jena hyp në autobus, kom shku në “Trepçë” në ora 07:00. Edhe vazhd-imisht kom qenë me përkushtim me punue…E kom pasë shprehi shtune - dille kur kom punue, me shumicën kom punue, kurrë nuk jom shku me kerr, as me kerr zyrtar, as me kerr temin privat. Gjithë jom shku me minatorë me autobus, ata u kënaqshin kur më pajshin në autobus me ta, kishin qaq dëshirë. Edhe u shike që njëfarë respekti po ju boj që realisht ka qenë, unë shkojsha për respekt të tyne” (*Ibush Jonuzi*).

Jetohej në epokën e artë të Trepçës, “nji periudhë e romantizmit industrial”, siç e quan Zeki Loxha. Por a ishte kështu për të gjithë? Është e pamundur të përgjithësohet, por shtimi i numrit të shqiptarëve në personelin teknik dhe menaxherial të ndërmarrjes sigurisht që i zvogëloi dallimet mes punonjësve, dy të tretat e të cilëve ishin shqiptarë. Ishte një “metamorfozë e kuadrove,” me fjalët e Burhan Kavajës.[55] Ose të paktën, kështu i kujtojnë të gjithë ato vite.

Në kontrast, një pikë thyerjeje ishte, për shembull, përplasja midis entuziazmit të kuadrove të rinj shqiptarë, të mësuar me vetëmenaxhimin, dhe konservatorizmit burok-ratik të menaxhmentit të vjetër serb, i cili nuk e kishte pasur kurrë prioritet të mirën e punëtorëve. Është sikur vetëmenaxhimi, që ishte i menduar gjithashtu si një mënyrë për të baraspeshuar pabarazitë midis kombeve në strukturën e fabrikës dhe shoqërisë, e që përkundrazi, kontribuoi në thellimin e shumë përçarjeve. Konfliktet brenda menaxh-mentit të ndërmarrjes, si rezultat i konkurrencës midis kuadrove serbë dhe shqiptarë, ishin më të theksuara se ato midis punonjësve dhe menaxhmentit, dhe ishin me pasoja të rënda politike. Me ngritjen e kuadrove shqiptarë, filloi një eksod i kuadrove serbë, një fenomen që u manipulua nga nacionalistët serbë si një “dëbim masiv”, por që në realitet ishte pasojë e një sërë faktorësh të ndryshëm, siç erdhi në përfundim një hetim i vetë ndërmarrjes. Në mesin e këtyre faktorëve, tensionet kombëtare ishin vetëm njëri prej tyre, krahas zgjedhjeve individuale, racionale dhe oportuniste të specialistëve që kërkonin paga dhe kushte pune më të mira në rajonet më të pasura të Jugosllavisë.[56] Këto të dhëna vështirë se konfirmojnë tezën e një dëbimi të detyruar, apo siç u tha më vonë, të një gjenocidi.

Për shqiptarët nuk kishte dyshim se kujt i përkiste Trepça, siç thotë kënga “Trepça jonë”, e kënduar në vitin 1981 nga kori i fëmijëve të Radiotelevizionit të Prishtinës gjatë “Akordeve të Kosovës.”[57]

Trepça jonë, Trepça jonë

Këngën për ty e këndoj

Trepça jonë, Trepça jonë

Gjithmonë kënga le t’jehojë!

Trepça jonë e pasur

Na nxjerrë shumë metale

Tymin nga oxhaqet

Asnjëherë s'e ndale

Gjithmonë ke punuar

Kurrë nuk ke pushuar

Kosovën e dashur

Për ta zbukuruar.

[47] Palairet, *Trepça,* f. 9.

[48] Abrashi e Kavaja, *Epopeja,* f. 8.

[49] Bianchini, "Rinnovamento dell'economia," f. 56-57.

[50] Troch, "Social Dynamics," f. 220-221.

[51] Pedro Ramet, "Limited Sovereignty: The Autonomy of the Federal Units," in *Nationalism and Federalism in Yugoslavia, 1962-1991*, Indiana University Press, 1992, f. 70-78.

[52] Biografia e pabotuar e Mahmut Bakallit, me leje nga familja, f. 90-91.

[53] Marco Dogo, "Alle origini dell'autogestione: la formazione di una nuova legittimità rivoluzionaria", në *L'autogestione jugoslava*, f. 19-31, f. 27.

[54] Eggert, *An Overview,* f. 16.

[55] Intervista me autoren, Prishtinë, 8 shkurt, 2024.

[56] Troch, "Social Dynamics," f. 223.

[57] Krasniqi (ed.), *A Site of Struggle*, f. 52-3.

Në fillim të viteve të '80-a, të paktën një pjesë e Kosovës filloi të ndihej më e pasur. Të shtyrë nga represioni politik, por edhe nga varfëria reale e viteve të '60-a, emigrimi i mijëra shqiptarëve drejt Evropës perëndimore, veçanërisht si *"gastarbeiter"*, apo punonjës sezonalë në Gjermani, e shndërroi markën gjermane në valutën e preferuar. Kjo solli një revolucion në sistemin e kredive, të cilat për herë të parë ishin të disponueshme në marka gjermane, me një afat prej 20 vitesh për shlyerjen e borxhit në dinarë jugosllavë. Këto kredi të favorshme mundësuan blerjen e televizorëve, frigoriferëve dhe Fiqës, versionit jugosllav të Fiat 600.

Në Kosovë, më shumë se kudo tjetër ndoshta në Jugosllavinë socialiste, shoqëria e re e konsumit preku kryesisht elitat politike, të ashtuquajturën "borgjezi e kuqe", dhe një shtresë të mesme urbane të përbërë nga kuadro intelektuale dhe profesionale. Kaqusha Jashari, inxhiniere dhe drejtuese komuniste, i kujton kështu këto vite: "Familja jeme nuk ka qenë e varfun, po nuk ka pasë pasuni si kur do që kanë në kohë, në ditën e sodit. Na e kemi pasë ni standard jetësor mjaft për jetën normale…nuk ka qenë problem për shembull për familjen teme me shku verës në deti pushim edhe dimrit me shku në skijim. Nuk ka qenë problem fare. Me qato pare që jonë marrë prej rrogës ti ke mujt edhe me marrë kredi, se kërkush s'ka mujt me ble edhe pajisje shumë të shtrejta të skijimit, për shembull me pare të gatshme, po kredi" (*Kaqusha Jashari*).

Pushimet dhe të mirat e mundshme materiale nuk ishin aspak të zakonshme për grupet shoqërore të margjinalizuara në botën rurale, por as për punëtorët më pak të kualifikuar, si për shembull minatorët. Ata ishin kryesisht shqiptarë, anëtarë të familjeve të mëdha që funksiononin si njësi ekonomike të vetëmjaftueshme. "Atëherë kur e kena marrë rrogën, në zarf të letrës na e kanë dhonë, në zarf të letrës, bonat edhe rrogën, si jena shku në shpi ja kena dhonë vëllaut madh, të zotit shpisë, i ka nxjerrë bonat, na i ka dhonë, pak pare tima, ditën e mirë, udha e marë. Ai ka udhëheqë me to, na s'jena mërzitë për atë pun" (*Avdi Uka*).

Me pak fjalë, nuk kishte shumë hapësirë për konsum. Problemi i pabarazive në Jugosllavinë socialiste ishte identifikuar qysh në vitet e '50-a nga Milovan Djilas në reflektimet e tij mbi "klasën e re" dhe tradhtinë e vlerave të revolucionit nga burokracitë partiake. 20 vjet më vonë, rishpërndarja e pasurisë nuk ishte përmirësuar shumë, por me shkollimin dhe rritjen sociale të shtresave më të margjinalizuara, ishin rritur pritshmëritë për konsum.

Coca-Cola dhe Republika e Kosovës

Në kujtimet e tij, gazetari dhe muzikanti, Migjen Kelmendi, tregon se si shfaqja e shisheve një-litërshe të Coca-Cola nëpër vitrinat e supermarketëve ishte një ngjarje e jashtëzakonshme. Njerëzit, që shkonin ta shikonin të befasuar këtë artefakt, i kujtuan atij banorët e Macondos të Gabriel Garcia Marquez, të mahnitur nga akulli, të cilin nuk e kishin parë kurrë më parë. Sa

hap e mbyll sytë, Coca-Cola zëvendësoi çajin tradicional të trëndafilit si pije për t'iu shërbyer mysafirëve. Ajo shkaktoi gjithashtu ankth tek të rinjtë shqiptarë, të cilët u çmendën pas atij qytetërimi që ishte në gjendje të prodhonte Coca-Cola, Beatles dhe Hollywood; dëshironin të bëheshin pjesë e tij. Nuk mund të harronin që ishin shqiptarë dhe jo vetëm sepse etërit ua ngulitnin fëmijëve në mendje rëndësinë e të qenit të tillë, por edhe sepse Jugosllavia nuk i linte ta harronin atë. "Nga shqiptimi përçmues i termit 'shqiptar' me *šiftar,* ishte e qartë se të ishe shqiptar nënkuptonte që ishe i prapambetur, i paformë, amorf." Çështja ishte: si të mbeteshe shqiptar dhe njëkohësisht të bëheshe pjesë e qytetërimit të Coca-Colës.[58]

Për shumë të rinj të tjerë, që nuk i përkisnin rrethit urban të Kelmendit, i cili kishte grupin e vet muzikor *punk* dhe ishte në rrjedha me kulturën perëndimore, të qenit shqiptar nuk ishte në kundërshtim me jetën e tyre. Ata që rriteshin në një mjedis rural, me traditën gojore të gjyshërve të tyre, nën tingujt e çiftelisë dhe këngëve popullore që rrëfenin trimëritë e patriotëve shqiptarë ndër shekuj, të ushqyer pra me një nacionalizëm romantik, përballeshin me perceptimin dhe përvojën e subalternitetit në botën jugosllave.[59] Ata gjetën aleancë me të tjerët që po zhvillonin një kundërshti më ideologjike ndaj Jugosllavisë. Ishin të rinj që, të edukuar në një univers socialist të mendimit dhe veprimit, ishin formuar në labirintin e vulgatës marksiste-leniniste dhe kishin përvetësuar qëndrimet kritike të udhëheqësit komunist shqiptar, Enver Hoxha mbi "revizionizmin" socialdemokrat të Titos. Ëndrra e tyre ishte një Kosovë e bashkuar me Shqipërinë, ose të paktën një Republikë e Kosovës.[60]

Të gjitha këto aspirata kundërthënëse, por njëherit edhe urgjente, të grupeve që po përballeshin për herë të parë me shoqërinë e konsumit, u përplasën në vitet e '80-a krahas borxhit të madh publik të vendit dhe krizës ekonomike që pasoi. Duke folur para kryesisë së Komitetit Qendror Kombëtar të Lidhjes Komuniste, më 17 shkurt 1981, udhëheqësi i Kosovës, Mahmut Bakalli, deklaroi se optimizmi dhe shpresat e kultivuara gjatë muajve të mëparshëm, pavarësisht vdekjes së Titos në maj të vitit 1980, po shuheshin me shpejtësi; se situata ekonomike në Kosovë po përkeqësohej, si në mbarë Jugosllavinë, por me aspekte edhe më kritike për shkak të prapambetjes së krahinës; që papunësia dhe inflacioni kishin krijuar një pakënaqësi të përgjithshme popullore; dhe se po përgatitej një klimë krizash politike.[61] Askush në majat drejtuese nuk i kushtoi vëmendje paralajmërimit të tij. Por asnjë, përfshirë Bakallin, nuk e kishte llogaritur ekzistencën e grupeve politike të angazhuara ndaj kauzës kombëtare, të cilët partia komuniste mendonte se i kishte çrrënjosur me shtypjen shkatërruese të "armiqve të popullit jugosllav."

Një protestë studentore doli nga auditorët universitarë dhe shpërtheu në rrugë, në mars të vitit 1981, vetëm një muaj pas mbledhjes së Komitetit Qendror, duke u shndërruar pothuajse menjëherë në një lëvizje popullore që kërkonte një republikë të Kosovës, të barabartë me republikat e tjera jugosllave. Autoritetet e cilësuan si një "kundërrevolucion", një kryengritje të nxitur me gjasë nga shërbimet sekrete shqiptare, një bashkëpunim të fshehur mes elitave krahinore me bashkatdhetarët e tyre irredentistë si dhe një paaftësi të këtyre elitave për të mbajtur rendin. Bakalli guxoi të kundërshtonte, duke pohuar se nuk ekzistonte asnjë komplot nacionalist, por një situatë shpërthyese në universitet, ku 36,000 studentë kishin në

dispozicion vetëm pak më shumë se 3,000 shtretër në konvikte dhe 5,000 vakte në mensë, një situatë lehtësisht e manipulueshme nga subjekte radikale politike.[62] Pas një fushate të ashpër mediatike, Bakalli u detyrua të jepte dorëheqje për shkak të dështimit të tij në përmbushjen e detyrës së qeverisjes dhe garantimit të rendit shoqëror.

Në atë kohë, megjithatë, mbizotëroi ideja se nacionalizmi shqiptar kishte bërë thyerjen e parë publike të rëndë në rendin jugosllav. Në fakt, protestat e pranverës së vitit 1981 përfaqësuan një thyerje në historinë e Kosovës jugosllave, qoftë për shkak të përmasave masive dhe radikalizmit të tyre, ashtu edhe për shkak të shtypjes që pasoi. Kjo shtypje ishte fizikisht e dhunshme, me qindra arrestime, gjyqe për rebelim, dënime të gjata dhe spastrime politike, kryesisht në universitete dhe media, por edhe në shkollat e mesme. Dua t'i veçoj dy shembuj. Enver Dugolli është vetëm njëri nga shumë të rinjtë që, në moshën 18-vjeçare, u dënua me pesë vjet burg për brohoritjen në oborrin e shkollës së tij në Drenas: "Kosova Republikë!"[63] Nait Hasani, atëbotë 17-vjeçar, u dënua me tetë vjet heqje lirie për hedhjen e një fotografie të Titos në sifonin e tualetit të shkollës së tij në Prizren.[64] Aparati i sigurisë jugosllave nuk mund të parashikonte se shtypja do të kishte për pasojë forcimin e lëvizjes për pavarësinë kombëtare shqiptare. Burgjet, të mbushura me të burgosur politikë, u bënë shkolla të rebelimit. Emigrimi politik në Evropën perëndimore, larg një shteti policor, mundësoi një debat dhe një organizim më të lirë. E gjithë kjo nuk bëri tjetër pos të mbushte radhët e lëvizjeve të vjetra të fshehta, të shkatërruara nga shërbimet sekrete gjatë dekadave të mëparshme.

Ndoshta për shkak të këtyre zhvillimeve dhe asaj që ndodhi në vitet që pasuan, vlerësimet për protestat e vitit 1981 morën një kthesë teleologjike, duke mbështetur idenë e nacionalizmit në rritje dhe të pashmangshmërisë së shpërbërjes së Jugosllavisë.[65] Një brez i ri studiuesish, më të vëmendshëm ndaj mikrohistorisë, zbulon kompleksitetin e asaj që ndodhi, duke treguar një kombinim faktorësh në thelb të shpërthimit të kryengritjes: pa dyshim, kushtet ekonomiko-sociale dhe rebelimi i studentëve, por gjithashtu mobilizimi i grupeve të fshehta marksiste-leniniste, të njohura nën emrin e përbashkët "Ilegalja", të bindur se udhëheqësit shqiptarë të Kosovës ishin shumë të kompromet uar me Jugosllavinë për të garantuar vetëvendosjen e kombit.

Një revolucion ndryshe

Greva e tri ditëve në Trepçë, në fund të korrikut të vitit 1981, është një shembull ilustrues se sa i kufizuar është leximi i ngjarjeve të asaj periudhe vetëm nga këndvështrimi nacionalist. Kur minatorët refuzuan të punonin, menjëherë u përhapën me shpejtësi thashethemet për një protestë të re anti-jugosllave. "Pas grevës së Stantërgut qëndrojnë nacionalistët!"[66] Revista "Ilustrovana Politika" dërgoi një gazetar nga Beogradi në Mitrovicë për të shkruar një reportazh mbi kryengritjen e re shqiptare, por ai nuk gjeti asnjë gjurmë të një revolucioni nacionalist. Drejtori i minierës, Shukrija [Shyqyri] Kelmendi, shpjegoi se greva kishte arsye krejtësisht ekonomike: produktiviteti i minierës kishte arritur vetëm 86% të objektivave të vendosura, fondet federale për ndihmat familjare ishin reduktuar drastikisht dhe si pasojë,

minatorët morën një pagë për 16% më të vogël se pagën e zakonshme.

Kryetari i partisë në Stantërg, Pregrad Milisavljević, tha se greva ishte nxitur nga një komunikim i keq mes menaxhmentit dhe punonjësve dhe sugjeroi se po të kishin qenë të njoftuar për uljen e pagave, asgjë nuk do të kishte ndodhur. Ndoshta kishte të drejtë, por për aq sa na intereson, është e rëndësishme të dihet se ai e mohoi kategorikisht praninë e ndasive nacionaliste në minierë: "Prej këtu kanë shkuar në demonstratat nacionaliste [të marsit] vetëm tre veta. Me një punonjës nga katër të regjistruar në Lidhjen Komuniste, këtu jemi një fortesë e tillë uniteti, ku nacionalizmi e ka shumë vështirësi të depërtojë. Minatorët nuk janë të gjithë shqiptarë. Çdo njësi punëtorësh ka serbë, turq dhe rumunë, si edhe kroatë dhe sllovenë, madje edhe punëtorë nga Bosnja."

Në fakt, Xhafer Nuli kujton se tre punëtorë u arrestuan me urdhër të partisë, edhe pse ata nuk kishin kishin marrë pjesë në grevë, kishin qenë me leje gjatë asaj periudhe, por ishin parë duke protestuar në rrugë. Për Trepçën, protestat e vitit 1981 ishin sikur të mos kishin ndodhur kurrë.

Avdi Uka: "Trepça ka nejt, qysh me thonë, si në gjumë, s'po di, qysh me thonë, nashta u duftë m'u çue. Po mirë boll, Trepça nuk u çue edhe ka kalu ajo pun." Përmes ndërmjetësimit të kryetarit të qytetit të Mitrovicës dhe të drejtorit, Shyqyri Kelmendi, forcat e policisë, që u dërguan në Kosovë nga Serbia dhe republikat e tjera për kontrolle speciale me urdhër nga lart në klimën paranojake të shtypjes pas demonstratave, nuk hynë në minierë. *Avdi Uka*: "Udhëheqësia e Trepçës, sindikata, drejtori, udhëheqësia e Trepçës duhet m'u konë shembull pe marrë 200 vetë, 1300 minatorë, 200 duhet m'u konë në mbrojtje. E kanë caktu filani, filani, filani edhe s'ka çu peshë kushko, krejt jonë konë të njejtë, po mirë boll e ka rrok dikon qajo farë. Edhe na kanë vesh neve, une vet jom konë i veshun në '81-tën aty. U çuditsha thojsha pse po na pagujnë, për çka po na pagujnë, çka po bojmë na, kurgjo në dyja s'bojshe, po mirë boll shkojshe qaty."

Edhe dy vjet më vonë, greva e vitit 1983 ishte një grevë ekonomike.

Ibush Jonuzi: "Ka pasë ndalesa të punës në atë kohë edhe pse ndalesa e punës, kërkojshin kushte ma të mira, paga ma të mëdhaja krejt ato edhe u nal puna. Une isha në shpi… Ka qenë atëherë Këshilli Punëdrejtues i Trepçës, ka qenë kryetari i Këshillit punëdrejtues edhe i ka pasë zavendësat e vet. Zavendës për çështje ekonomike ka qenë Enis Presheva, një ekonomist me famë në atë kohë. Veç ai me fakultet ka qenë, veç ai në atë kohë edhe në Ljubljanë ka studiue. Edhe atij i kish dhonë Këshilli Punëdrejtues detyrë që me përcjellë tubimin e minatorëve se ata kërkojshin domethonë rritje të pagave e kjo bike në sektorin ekonomik. Erdh Enisi në të gjitha tubimet, i ndëgjoi kërkesat e minatorëve edhe ju premtoi, tha, "Na kena me bo sistematizimin e vendeve të punës." Do të thotë, unë isha drejtus i minierës. Erdh në zyre te unë u kryen tubimet. 'Ibush' tha, 'duhet me krye'… Edhe u kry ajo punë. Do të thotë, u bo riorganizimi i ri, u favorizun vendet e punës të minatorëve ato që tamon u dashke me i stimulue, i qitëm në tubim puntorët të gjithë e aprovun, pa vërejtje."

Ajo që është e sigurt është se greva e korrikut të vitit 1981 nuk nisi një sezon protestash nacionaliste, as në Trepçë, dhe as në ndërmarrje të tjera, por një sezon të trazirave punëtore. Për më shumë, në vitet e '80-a grevat ishin

bërë normale në Jugosllavi. Nga viti 1980, me 253 greva dhe 13,504 pjesëmarrës, arriti në vitin 1988 me 1,851 greva dhe 386,123 pjesëmarrës.[67] Në maj të vitit 1987, miniera e Labinit në Istria bëri në grevë për një muaj; edhe minatorët maqedonas protestuan më vonë gjatë atij viti. Pas ngrirjes së pagave në vitin 1988, protestat u zgjeruan gjithandej.[68]

Në të njëjtën periudhë, në Trepçë pati ndryshime në kuadrot e menaxhmentit. Aziz Abrashi, ekonomist me profesion dhe kuadër politik me përvojë, u emërua drejtor i të gjithë kompleksit minerar në vitin 1983. Si kusht për ta pranuar këtë pozicion, Abrashi kërkoi që të shoqërohej nga inxhinieri Burhan Kavaja. Udhëheqësi i partisë, Azem Vllasi, duhej të ushtronte trysni mbi Kavajën për ta bindur dhe, në vitin 1985, Kavaja u zgjodh drejtor nga Këshilli i Punëtorëve të Stantërgut. Abrashi dhe Kavaja e njihnin shumë mirë njëri-tjetrin sepse kishin punuar bashkë për rreth 20 vjet në politikat ekonomike të Kosovës. Ata mendonin se së bashku do të mund të rikthenin rendin në strukturat dhe financat e Trepçës, ashtu siç ishin mësuar të bënin. Disa vite më parë, Azizi ishte marrë me fabrikën e mobilieve "Tefik Çanga" në Ferizaj, kur ajo falimentoi. *Bahtije Abrashi*: "Ai sikur sekretar për ekonomi, ministër, ka thanë, 'Unë do t'shkoj atje, nuk lejoj me u mbyllë fabrika', edhe vullnetarisht ka shku…ai po ashtu ka qenë punëtor i madh sikur në Fabrikën Tefik Çanga edhe në Trepçë. Saqë ka mrri me i rritë rrogat deri 1200-300 marka një minatori. Është përkushtu shumë për punëtorë, për Trepçën, për Kosovën."

Ndërsa krahu i djathtë i Abrashit, Burhan Kavaja, ishte dërguar nga Ymer Pula, atëherë kryeministër i Kosovës, për të shpëtuar "Sharrin" në vitin 1980, një fabrikë çimentoje, asbesti dhe tubash. Pula, edhe ai ekonomist si Abrashi, i kishte dhënë Kavajës duart e lira për të rimëkëmbur një ndërmarrje me një humbje prej 4 milionë dollarësh. *Burhan Kavaja*: "'Sharrin' e lash me 4 milion dollarë fitim, prej 4 milion dollarë humbje… 2650 punëtorë edhe fabrikën e re të 'Sillkaporit' që u ndërtu… Ma vonë kom marr vesh se 18 vetë në Han të Elezit edhe në rrethinë aty ju kanë lonë emrin Burhan fëmijëve të vet."

Udhëtimi i përditshëm nga Prishtina në fabrikën e Hanit të Elezit ishte i lodhshëm dhe monoton, ndaj pas katër vitesh, Kavaja dëshironte të kthehej në një pozicion qeveritar në kryeqytet. Por partia kishte marrë vendimin për ta dërguar në Stantërg dhe ai iu bind urdhrit; në fund të fundit, e njihte mirë minierën që nga koha kur kishte qenë inspektor. Sfida ishte se si të menaxhonte një ndërmarrje me mijëra punëtorë pasi kishte administruar një me pak më shumë se 2,000 sosh. Kavaja filloi me kushtet e punës dhe të jetesës në minierë. Ai vlerësoi se dreka, e cila shpërndahej në mensë, nuk ishte e mirë, pasi përgatitej në mënyrë të centralizuar dhe për këtë bisedoi me Abrashin. "'Edhe kom vendos' thashë, 'që restoranin vet me marrë në pronë'. 'Po, qysh po ma shkatërron ti kombinatin?' 'Valla, qet' pjesë po ta shkatërroj po qeto duhet me marrë'. Edhe vendosa, e mora në Stantërg restoranin, komplet e ndava prej ushqimit shoqnor që ka qenë për krejt Trepçën. I pari e kom bo ato edhe ajo m'u gjind ma vonë që me ju zi punëtorëve edhe me ju dhonë drekë a darkë për 1300 vetë në minierë. … Mandej ndodhi që së bashku me gjithë Azizin me shku në restoran edhe me i provu gjellnat të cilat i hajshin ata, u ulëm me ta. Ajo krijoi përsëri nji situatë pak të volitshme" (*Burhan Kavaja*).

Ibush Jonuzi: "U bo restorani i punëtorëve fantazi. Kur kanë ardhë

minatorët e minierës së Borit, Borin e dini, ata jane befasue. Tha, 'Qesi ushqimi edhe qeso kushtesh, na nuk kena pa kërkun'. Minatori atëherë i ka pasë triskat për ushqim të ngrohtë, ushqim të thatë edhe qumësht. S'ka pasë minatorë që ka mujt krejt qat sasi me konzumu vet. E pamundshme u konë. Për çfarë gjellë e ka pasë oreksin ai ka mujt me zgjedh aty. Ka dashtë me marrë ushqim të thatë, ka pasë suxhuk, ka pasë përshutë, ka pasë konzerva, peshq, ve të zime. Po thom, mos me citu, gjithçka ka pasë aty. Edhe çdo njoni e ka pasë edhe nga nji litër qumësht."

Tahir Salihu: "Kur jum hi mas pari nuk u kanë ushqimi i mirë. Nuk u kanë restorani i mirë. Me ardhjen e Burhan Kavajs edhe Aziz Abrashit kanë ndryshue gjanat qind për qind…Mujë me than restorani i Stantërgut u kanë hotel, hotel me katër yje, kshtu lirisht muj j'a jepi."

Bahtije Abrashi: "Aziz çdo herë, bile niherë n'mujtë ka shku në kuzhinën e minatorëve me e kontrollue ushqimin. Ka hy në sallë i palajmërum, e kanë servu ushqimin. Ka shku te ni minator e ka pa ushqimin, ka thanë, 'Kjo është e imja, s'është e jotja.' Ndoshta dikush edhe s'e ka njoftë, ka thanë, 'Kush je ti?' Ai tjetri, 'Ej, drejtori gjeneral.' Ka qenë shumë i lidhur. Këtë po e ilustroj për arsye se ka qenë shumë i lidhur për ta."

Por mensa, e përmendur nga shumë persona të intervistuar, nuk ishte arsyeja e vetme për popullaritetin që menaxherët e rinj e gëzonin te punëtorët. *Burhan Kavaja*: "Ditën e parë që shkova në zyre, e mora detyrën, isha menu prej organit aty, kërkova me gëlqeros zyrën. Kur erdha nesra ish gëlqeros zyrja edhe i kishin pru fotele të mdhaja, të mira, si naj kabinet i sulltanatit… Ata kishin probleme me të ardhuna personale, rrogat s'ishin dhonë, kishte problem shumë, material. Thashë, 'Pritni mramjen, në mramje me m'i heq tona këto me i çu'…Ditën e dytë m'u duft me bo nji zgjedhje që mos me ardh shoferi me më marrë përditë prej Prishtine këtu, prej Mitrovicë në Prishtinë, prej Prishtinë-Mitrovicë, i bike ka dy rellacione të kota edhe e ndrrova Vujadinin, kjo ishte dita e dytë. Vujadini aty kish qenë nji Al Kapone, ma i madh se drejtori, nuk kish pasë ç'a s'kish bo, s'kish pasë çka s'ka bo! Une e ndrrova menjiherë. Ai te qet nji letër katër faqe, me nji ndihmë prej atyhit mrenda, ja çon Komitetit Krahinor e Komitetit të Sërbisë e, 'Qe më ndrroi mu veç që jom sërb.' Une e ndrrova nuk kom ditë që krijon atmosferë aq të mirëfilltë te punëtorët ajo punë. Ata e vlerësu atë gjo jashtëzakonisht shumë. Une e mora për arsye ekonomike, mirëpo ajo dul puna që patedhe njifarë ane tjetër psikollogjike" (*Burhan Kavaja*).

Edhe pse nuk kishte fare buxhet, dy drejtorët kishin nevojë për vetura, ndaj me miratimin e Këshillit i Punëtorëve, ata i blenë dy. Kavaja ende qesh kur kujton ngjyrën e veturës së Azizit, e kuqe dhe e zezë, si flamuri shqiptar; ishte më shumë një shaka sesa një afirmim i identitetit kombëtar.[69]

Në Trepçë, struktura e re drejtuese nuk kishte ardhur thjesht për të menaxhuar, por për të sjellë një revolucion. *Ramadan Gjeloshi*: "Na s'kena ditë përpara…Po kur ka ardhë Aziz Abrashi, ai ka qenë kryetar i Këshillit Ekzekutiv në atë kohë, edhe u ardhë këtu si menaxher edhe e ka pa situatën çfarë pune po bohet këtu. Edhe ka thonë, 'Jo, duhet me ja u qit listën se po folët', që e thatë atë fjalën, 'Trepça punon, Beogradi ndërton'. Thotë, 'Me i kqyrë gjithkush sa fiton, me ditë ku po nalet rroga juve'. Edhe na i qiti do lista qekaq {tregon me duar madhësinë}. Shkrujke aty naltë, 'Për Jugosllavi Trepça që e jep kontributin, për ushtri të Jugosllavisë, kontributin…'...Une e

kisha sikur me thonë dy mijë euro rrogën, këtu tash ma qitke dy mijë, a merr vesh e që thashë kom ardhë në 300, që si kom ditë ato tjerat ka jonë shku. Edhe shkojke vijë për Sërbi, jonë konë ato tjerat për Sërbi, sigurime ça po di une, për urë, për anena, vijë, kur visha në fund rroga jeme 300, sikur me thonë 300 euro a 320, a din, me dinar tash s'po muj me ja qëllu, se kom harru. Edhe kur e pamë që unë çka punoj, ku më shkojnë paret…"

Abrashi informonte punëtorët për një problem, për të cilin drejtuesit gjithmonë kishin qenë të vetëdijshëm. Trepça i shiste ushtrisë jugosllave një pjesë të madhe të produkteve të saj, deri në 5,000 ton metale, me çmime të ulura për 30-40% krahasuar me ato të përcaktuara në tregun ndërkombëtar. Nevojat e sigurisë kombëtare kishin përparësi mbi prodhimin. "[Aziz dhe Burhan] gjithmonë kanë qenë në shënjestër të Serbisë se kanë fillu mos me mujtë me shfrytëzu Trepçën qysh e kanë shfrytëzu ata. Shembull, Trepça ka prodhu edhe akumullatorë në Mitrovicë, ka qenë fabrika e akumullatorëve edhe në Gjilan. Ushtria deri në atë kohë i kishte marrë akumullatorët në nivel jugosllav pa asni dinar. Edhe bashkëshorti im ia ka ndërpre. Vetëm me berzën ndërkombëtare" (*Bahtije Abrashi*).

Nehbi Vehbiu: "Faktikisht politika ka dominu …Jugometali ka qenë në Beograd dhe të gjitha produktet, prodhimet që kanë t'bojnë me metal i ka shitë Jugometali n'nivel të asaj Jugosllavie. Ça ka qenë atëhere e jona, ka qenë me ia dhonë stoqet çfare i kemi, e masanej çmimet i ka caktu Jugometali, i ka shitë Jugometali. Kjo ka ndodhë masanej me transformimet në organizata punuese, ka qenë ai Ligji mbi Punën ë Bashkuar edhe na, faktikisht osht hapë Trepça Komerci në kuadër të Kombinatit Trepça për importin edhe eksportin edhe për eksportin e landëve, importin e landëve, por edhe eksportin e produkteve t'gatshme edhe shitjen në tërësi. Edhe ka pasë ato vështirësitë fillestare, për arsyje se Jugometali ka bojkotu, faktikisht ku ka mbërri te blerësit që i ka pasë. Faktikisht neve vështir që na ka leju aty me depërtu, mirëpo tu ju falenderu drejtorit Enis Presheva edhe drejtorëve të organizatave punuese kemi mbërri faktikisht me rikthy tregun, edhe qajo kohë masanej ka qenë kohë kur paret dhe investimi kapital u bo për arsye se paret kanë mbetë këtu edhe qajo na ka ndihmu ma së tepërmi."

Edhe sot e kësaj dite, Burhan Kavaja është i bindur se, megjithëse ndërmarrja ishte me humbje kur ai dhe Abrashi morën drejtimin, shkak i dështimit nuk ishin gabimet e vetëmenaxhimit apo të menaxhimit të dobët. Edhe Trepça jugosllave mund të ishte bërë produktive po të mos ishte grabitur nga qeveria federale. Kushdo që kishte ngritur çështjen për të shitur prodhimet e Trepçës me çmime të përcaktuara nga tregu ndërkombëtar, pa zbritje për askënd, e kishin larguar menjëherë. Ky ishte fati i Veli Devës, që ishte drejtor i Trepçës për një periudhë shumë të shkurtër, nga viti 1973 deri në 1974. Çështja nuk diskutohej, përveç nëse dikush donte të etikohej si "armik i popullit." Qëllimi kryesor i Abrashit dhe Kavajës ishte të "çlironin Trepçën dhe ekonominë e Kosovës nga tundra komuniste."[70]

Zgjerimi i punësimit në Trepçë solli një rritje të fuqisë punëtore shqiptare në të gjitha nivelet, nga punëtorët e krahut deri te punonjësit administrativë. Nga 3,000 punonjës shqiptarë në vitin 1960, në Trepçë numri u rrit në 9,000 në vitin 1989.[71] Numri i punonjësve shqiptarë dhe serbë ishte mbajtur i qëndrueshëm, secila palë nga rreth 45%, por në vitin 1989 shqiptarët kishin arritur 68%, ndërsa në Stantërg ata përbënin 77.5%.[72] Ky prirje e rritjes filloi të jetë e dukshme në gjysmën e dytë të viteve të '60-a, kur u regjistrua një

rritje e madhe, veçanërisht në mesin e punonjësve administrativë, ku numri i shqiptarëve u pesëfishua. Ndër ta, sidomos numri i të diplomuarve u rrit ndjeshëm, duke shkuar nga 6% në 15% brenda 10 vitesh.

[58] *Prishtinë*, 2002, f. 6-9.

[59] Isabel Ströhle, "Of Social Inequalities in a Socialist Society. The Creation of a Rural Underclass in Yugoslav Kosovo," në *Social Inequalities and Discontent in Yugoslav Socialism,* redaktuar nga Rory Archer, Igor Duda dhe Paul Stubbs, Routledge, 2016, f. 112-131

[60] Mrika Limani Myrtai, "The Ideology and Agency of Kosovar Albanian Marxist Groups in the Demonstrations of 1981" *Contemporary Southeast European Studies* 69 (2–3) 2021: 183-203.

[61] Biografia e pabotuar, f. 149-150.

[62] Biografia e pabotuar, f. 156-57.

[63] Enver Dugolli, *Qark i (pa)mbyllur burgjesh*, Prishtinë: Shoqata e ish të Burgosurve politikë, 2019. Edhe në anglisht: *Unbroken. Surviving Milosevic's Prisons*, The Centre for Albanian Studies, 2023.

[64] Komunikimi personal me autoren nëpërmjet Messenger-it, 21 janar 2023.

[65] Robert Pichler, Hannis Granditis e Ruža Fodiatis, "Kosovo in the 1980s – Yugoslav Perspectives and Interpretations," *Comparative Southeastern European Studies* 69 (2-3), 2021: 171-182, f. 172.

[66] Kovacevic, "Work Disruption at Trepca Described."

[67] Musić, *Making and Breaking,* f. 3

[68] Neboša Vladisavljević, "The Break-up of Yugoslavia. The Role of Popular Politics", in *New Perspective on Yugoslavia. Key Issues and Controversies,* redaktuar prej Dean Djokić and John Ker-Lindsay, Routledge, f. 140-160, f. 149.

[69] Intervistë me autoren, Prishtinë, 8 shkurt 2024.

[70] Intervista me autoren, Prishtinë, 8 shkurt 2024.

[71] Të dhënat e përpunuara në bazën e Tav. 3 në Palairet, marrë nga Tiosav Lazarević, *A Brief History of Trepça* (Dokumenti i brendshëm i Trepçës në disk), f. 16 e Troch, Tabela 1, f. 220 "Samoupravljanje na ispitu" [Një test për Vetëmenaxhim, *Trepča* 21.07.1967, f. 3; "O kadrovima – javno [Publicly About Cadres]," Trepča 24.03.1971, f. 5.

[72] Palairet, *Trepça.* 1965-2000, f. 14.

"REVOLUCIONI I JOGURTIT"

Drejtuesit e rinj të Trepçës kishin plane të mëdha për të rimëkëmbur fatin e ndërmarrjes, por nuk do ta dimë kurrë nëse do t'ia kishin dalë, sepse në kohën kur ata morën në dorë situatën, kriza ekonomike, bashkë me atë politike, po përkeqësohej. Si përgjigje ndaj vendosmërisë së udhëheqësisë lokale dhe klasës së mesme shqiptare që po dilte në pah, popullsia lokale serbe reagoi duke rritur distancën me popullsinë shqiptare. Ishte një largim i mirëfilltë për ata që mund ta bënin një gjë të tillë, si për shembull kuadrot, të cilët u larguan nga Kosova në kërkim të kushteve më të mira të jetesës dhe punës diku tjetër në Jugosllavi, por duhet përmendur gjithashtu edhe diskriminimi dhe trysnia që ushtrohej ndaj tyre nga punonjësit shqiptarë. Kjo dukuri ishte shfaqur edhe më parë, por të dhënat e disponueshme për vitin 1969 tregojnë se nga Kosova nuk ishin larguar vetëm kuadrot serbe dhe malazeze, por edhe disa nga kuadrot shqiptare.[73] Derisa nuk kemi të dhëna të tjera të sakta mbi emigrimin e punonjësve nga ndërmarrja në ato vite, të dhënat e regjistrimeve deri në vitin 1981 tregojnë gjithsesi një rënie të numrit të serbëve dhe malazezëve në qytetin e Mitrovicës, që për 20 vjet humbi 2,000 prej tyre.

Distanca tjetër, ajo sociale dhe politike, u shpreh si në rrugë ashtu edhe në institucionet zyrtare dhe vendet e punës, duke nxitur shoqërinë lokale serbe dhe elitat intelektuale e fetare në Beograd të denonconin "gjenocidin" që po përjetonin serbët në Kosovën e dominuar nga shqiptarët. Që nga mesi i viteve të '80-a, përmes komenteve dhe peticioneve, disa përfaqësues të shquar të klerit ortodoks filluan të paralajmëronin opinionin publik ndër-kombëtar dhe vendas për persekutimet që përjetonin serbët në Kosovë.[74] Shtypi serb nisi një propagandë të vazhdueshme dhe të seksualizuar duke përshkruar burrat shqiptarë si përdhunues të grave serbe, ndërsa gratë shqip-tare si "makineri për shumim."[75] Aktivistët nacionalistë serbë përdorën "asambletë e qytetarëve" (*zbor građana*), një lloj mbledhjeje komunale që zbatonte parimet e vetëmenaxhimit, për të denoncuar gjendjen e mjerueshme të të drejtave të tyre si pakicë në Kosovë.[76] Nga këto asamble u organizuan peticione dhe u zhvilluan marshime protest-uese drejt Beogradit për të kërkuar ndërhyrje për mbrojtjen e serbëve nga "gjenocidi."[77]

Edhe intelektualë serbë ish-disidentë adoptuan një retorikë të të drejtave

për t'u dhënë pamje demokratike kërkesave të tyre nacionaliste, duke publikuar në vitin 1986 një Memorandum të Akademisë së Arteve dhe Shkencave (SANU) mbi nevojën për të riafirmuar të drejtat e Serbisë mbi Kosovën. Por Memorandumi ishte kulmi, jo fillimi i një prirjeje, që kishte nisur dy dekada më parë.[78] Që në Komitetin Qendror të majit 1968, shkrimtari, Dobrica Ćosić e kishte denoncuar si të tepruar decentralizimin e saponisur në Jugosllavi.[79] E gjithë kjo këmbëngulje për autonominë e krahinës së Kosovës nuk ishte gjë tjetër veç një përpjekje për ta vënë krahinën në të njëjtin nivel me Republikën e Serbisë, duke favorizuar një barazi që cenonte të drejtat e serbëve. I konsideruar si një disident, Ćosić u margjinalizua. Por vetëm 10 vjet më vonë, vetë Komiteti Qendror formoi një grup pune rreth një dokumenti jozyrtar i njohur si "Plava knjiga" [Libri i kaltër], një dokument që polemizonte Kushtetutën e vitit 1974 dhe autonominë e Kosovës dhe Vojvodinës brenda Republikës së Serbisë. Reagimi i udhëheqësisë së Kosovës dhe i serbëve jo-nacionalistë në kryesinë e partisë bëri që "Libri i kaltër" të lihej në harresë, por vetëm përkohësisht. Duhej pritur deri pas vdekjes së Titos në vitin 1980, kur qeveria federale do të dobësohej, për ta rinisur sulmin ndaj decentralizimit. Lëvizja shqiptare, që shpërtheu në mars të vitit 1981 për të kërkuar një autonomi më të gjerë të Kosovës, krijoi mund-ësinë për këtë rinisje.

Nacionalizmi në ndërmarrje dhe në rrugë

Pas vitit 1981, Trepça pati problemet e veta, por jo si universitetet apo mediet, të cilat u shkatërruan nga spas-trimet e mëdha politike, nga procesi i quajtur "diferencim", sipas gjuhës orwelliane të komunizmit jugosllav. Përjashtimi i vetëm që bëri jehonë ishte arrestimi i inxhinierit Nazmi Peci në vitin 1983 dhe dënimi i tij me pesë vjet burg, "për nxitje të urrejtjes nacionaliste, fetare dhe racore dhe për mosdurim", si dhe "për mbështetje të ideve proshqiptare."[80]

Beqir Maliqi: "Më kujtohet rasti, e kom pasë një shok të mirë, nji Nazmi Peci... Ai vetëm se punonte e kish asi për minierën edhe për organizimin me punëtorët edhe për dhënien e prodhimit të të gjitha, në njëfarë forme fillun me diferencu edhe me etiketu serbët. Bile e kanë burgosë, e kanë pasë burgosë edhe osht' konë dënue pesë vjet burg për kurgjo, veç pse punonte, pse ishte i aftë, kishte asi, donte të punonte këtu. Iu pengonte serbëve… Dy, tri herë m'kanë thirrë në organin e punëve të brendshme në Mitrovicë lidhur me Nazmi Pecin… M'kujtohet tash kur kom qenë në sekretariat atje të punëve të brendshme një shqiptar ka qenë që m'ka marrë n'pyetje edhe kishte informacione të ndryshme rreth meje edhe për Stantërgun…ka qenë i vjetër, shumë ma i vjetër se unë. Tha, 'Me moshë muj me t'pasë femijë, por ti qysh ja ke fillu me punu nuk bon. Unë e ti mujmë me bo muzikë e zhurëm n'qitë zyre deri sa se pengojmë atë zyrën tjetër. Në momentin që ne e pengojmë zyrën tjetër na duhet të ndalemi.' Në njëfarë forme dojke me thonë që ti me punue, por ku i pengon serbët nuk bon."

Në Trepçë, konflikte në vendin e punës, ose thjesht rivalitet, filluan të paraqiteshin në terma të nacionalizmave kundërshtare, që u përcoll me përshkallëzim tensionesh brenda ndërmarrjes, në hap me klimën konfliktuoze që po zhvillohej jashtë saj, sidomos pas demonstratave të '81-shit. *Ibush Jonuzi*: "Unë e kom pasë ni kusheri temin që edhe sot ka qenë ushtar i mirë në kohë të UÇK-së, ni Ali Jonuzi që osht' plagos…nja 50 metra prej shpijave

tona në kohë te demonstratave edhe në atë kohë ka qenë i punësum në Elektro Kosovë. E çojnë në spital dhe prej spitalit e çojnë në burg, në burg të Smrekonicës. Une shkoj me vizitue në burg ato e u bo qaq e madhe. Tani sërbët thojshin, 'Po i jepni pozitë Ibushit që e ka nacionalizmin në shpi të veten'. U bo shumë e madhe, po megjithatë po thom unë krejt ata i mposhtsha veç me punë, se punojsha ma shumë edhe s'kishin çka."

Ndodhi gjithashtu rasti i një drejtori njësie, serbit Sreten Nikolić, i cili përmendi praninë e vazhdueshme të Jonuzit në minierë dhe faktin që ai nuk merrte kurrë një ditë leje, për ta akuzuar se përfitonte nga shpërblimet ditore. U desh një punë e madhe verifikimesh dhe justifikimesh për të dëshmuar mungesën e çdo baze për këto akuza. Dhe pas kësaj, erdhën akuzat për favorizim ndaj bashkëkombësve shqiptarë. *Ibush Jonuzi:* "Se të gjitha kuadrat që e kanë kry në atë kohë janë punësu në Trepçe. Dul gjenerata e parë e gjeologëve të fakultetit të Mitrovicës edhe bomë kërkesë me i punësue në Trepçe. Unë atëherë kam qenë drejtor teknik në Trepçe edhe po ju thom sinqerisht, na nuk kishim nevojë për shtatë gjeologë. Kishim nji, dy se kishum gjeologë. Po për hir që ish gjenerata e parë shiptare, për hir që unë e pyeta ni profesor shumë të respektushëm, thashë, 'Qysh janë këta studenta?' Tha, 'Ibush, janë shumë të mirë, edhe profesorat e Beogradit që ligjërojnë këtu te na thojnë që ma të mirë janë këta studenta se studentat e Beogradit.' Edhe i pranum të gjithë në punë."

Vjollca Meha u diplomua për gjeologji në vitin 1988 dhe u punësua menjëherë me kolegen Mevlyde Emini, por oferta e punës iu refuzua. "Masi na kanë pranu osht' anulu konkursi për shkak që osht' anku sindikata se nuk bon veç shqiptaret m'i marrë e mos m'i marrë të tjera etnive. Kështu që, osht' përseritë konkursi edhe janë pranu edhe dy serbë janë pranu me neve. Domethonë, jena pranu na dyjat edhe dy serbë i kanë pranu, jemi bo katër. Edhe ma herët kanë qenë edhe katër gjeologë tjerë në Departamentin e Shërbimit Teknik" (*Vjollca Meha*).

Nga fundi i viteve të '80-a, atmosfera në zyrat e kuadrove, ku konkurrenca profesionale ishte më e lartë, tashmë ishte e turbulluar. *Alije Gashi Tmava*: "Nuk i ke folë as s'të ka folë. Edhe atëherë kanë qenë biseda të ftofta, nuk kanë qenë biseda ku ta di une. Une e kom pasë ni shoqe punojke edhe kur u dëgjojshim në telefon ajo kishte n'zyre, ishte n'zyre t'përzimë thuajse baraz, tre me tre. E unë nuk e kisha asnjë n'zyre mandej ishin ato masat e dhunshme… fillun m'i pru njerztë m'i punësu kështu e atëherë gjithçka ndryshoi, a po din. Ato bisedat e ftoha, vetëm zyrtare se kështu nuk ke pasë, nuk ke pasë biseda t'mira."

Burhan Kavaja: "Mas nji viti e gjys që shkova une, në '87, ka qenë nji evoluim i këtyre nacionalistave serbë shumë i madh. Në pjesën sipërfaqësore të minierës i kisha të punësum 240 vetë. Shumica e tyne, invalida të punës, po edhe nji pjesë e madhe e tyne të Sekretariatit për Punë të Brendshme, të nxjerr për minierë edhe të fut rrjetën e shpiunave. Përcillni vetëm qeto se kjo na vyn ma vonë. Asnjigjo nuk mujsha me bo pa u ditë në Sekretariat edhe në Komitet, menjëherë për dy minuta, tre minuta gjanat… Nji ditë vjen nji inspektor i Punëve të Brendshme i Sigurimit Shtetnor edhe po hin në derë pa m'ulajmëru fare…'Drejtor…' jo, tha, 'Burhan', jo drejtor, 'tash e tutje ti këtu nuk munesh me marrë kërkon as me lëshu kërkon prej punës pa e ditë unë'. Edhe ja nisi po ma man ni ders kështu, nga aspekti i

Sigurimit Shtetnor, kuptohet mu s'më mbeti kurgjo tjetër, i shkreti. U çova ia çela derën. I thashë, 'Dil edhe mos me kurrë këtu'… S'pata tjetër shans, kur ai po vjen mu po më cakton se si, çka duhet une me bo ma tutje edhe ato s'e kom lonë kurrë mo me hi. Mirëpo, ai ishte i lidhun me këtë rrjetë këtu. Vendosa të gjithë ata që ishin invalidë të punës, e që u sillshin aty me i çu në shpi, me ju dhonë rrogën, me ju dhonë edhe për ushqim kupona me qëllim që mos të krijojnë tollovi në autobuset kur po vijnë punëtorët, se ata p'i nxojnë vendet aty të parat e këta po dalin prej minierës të lodhshëm po duhet n'komë me nejt. Qaty e kisha arsyetimin kryesor, e në esencë e kom pasë që m'u liru prej asaj rrjete aty."

Në gjysmën e dytë të viteve të '80-a, problemet politike në Kosovë ishin katapultuar në qendër të agjendës së partisë në nivel qendror. Në shkurt të vitit 1986, një grup prej 95 serbëve nga Kosova u paraqitën në Asamblenë Federale, në qendër të Beogradit, të veshur si fshatarë. "Thanë se ishin zgjedhur në mënyrë joformale si përfaqësues të dyzet e dy qyteteve dhe fshatrave të Kosovës dhe kërkuan të flisnin me udhëheqësinë federale. Në prill të po atij viti, rreth 550 serbë nga Kosova mbërritën në Stacionin Hekurudhor të Beogradit dhe marshuan nëpër rrugët e qytetit bashkë me ata që kishin emigruar nga Kosova në qytete ose në pjesë të tjera të Serbisë."[81] Protesta tërhoqi vëmendjen jo vetëm të opinionit publik, por edhe, në veçanti, të udhëheqësve të Lidhjes Komuniste. Presidenti i atëhershëm i Serbisë, Ivan Stambolić, kumbari i madh i Miloševićit, të cilin disa muaj më vonë ai do ta përjashtonte nga skena dhe më vonë do ta vriste, shkroi në kujtimet e tij se kryesia e Jugosllavisë u alarmua nga rreziqet serioze për përshkallëzimin të situatës dhe filloi të kaplohet nga paranoja.[82]

Në mbledhjen e Presidencës, në qershor të vitit 1986, drejtuesit u informuan se trena të tjerë plot me protestues po vinin nga Kosova, se protestat po fillonin edhe në qytetet punëtore të Rakovicës dhe Smederevës, se qytetarët po u bashkoheshin këtyre protestave dhe se "udhëheqësit e Francuska 7" [adresa e Shoqatës së Shkrimtarëve Serbë] po viheshin në krye të varganëve. Policia mohoi vërtetësinë e këtyre informacioneve, por entuziazmi nacionalist kishte dalë në sipërfaqe dhe udhëheqësia e partisë serbe, tashmë tërësisht në duart e Millošević, e kishte bërë të veten. Edhe ndër punonjësit serbë, të cilët tradicionalisht i kishin shpërfillur temat nacionaliste, të paktën publikisht, Kosova u bë burimi i gjithë pakënaqësisë. Këto ishin akuzat: në Kosovë po uleshin pagat për shkak të shpërdorimit të fondeve federale për t'u dhënë privilegje shqiptarëve dhe në Kosovë po ndodhte "gjenocid ndaj serbëve" përmes një plani të zëvendësimit etnik të bazuar në një natalitet të shtuar dhe në emigrim të paligjshëm të shqiptarëve nga Shipëria.[83]

Në vitin pasues, midis 20 dhe 24 prillit të vitit 1987, u mbajtën tubime masive të qytetarëve në Fushë Kosovë, ku anëtarësia e partisë përbëhej nga një shumicë serbe. Këto të ashtuquajtura "tubime të së vërtetës" treguan qartazi se si kishin ndryshuar kohët. Në sallë ishin mbledhur 300 njerëz dhe Bahtije Abrashi, bashkëshortja e Aziz Abrashit, vajza e një minatori partizan komunist, mësuese dhe drejtuese partie, mori pjesë në këtë ngjarje si kryesuese e Krahinës e Konferencës për Aktivitete Sociale të Grave. Në socializmin jugosllav, kjo shoqatë kishte trashëguar rolin e Frontit Antifashist të Grave dhe ishte pjesë e Aleancës Socialiste të Punëtorëve, organizatë masive dhe ombrellë e organizatave të bazës.[84]

Bahtije Abrashi: “Edhe aty e shpalosën programin e tyre çka po mendojnë edhe ma tutje pasojat ndaj shqiptarëve me dëbim, me na qit’ prej pune, me mbyllë shkollat, me mbyllë universitetin, organet ekzekutive, shtypin. Tmerr, tmerr. Ndër të tjera, thojnë se edhe ju gratë e Kosovës nuk doni kurgjo tjetër vetëm me lindë: ‘Jeni bo si makina lavatriqe, veç fëmijë po lindni. Fushë Kosova është djep i Serbisë.’ E shumë e shumë tmerre. Edhe e mora fjalën… Kom thanë, ‘Fushë Kosova është nji atyne djepave që përkunden në Fushë Kosovë. E aty përkunden shqiptarë, serbë, malazezë, rom e të tjerë.’ Atëherë u kall edhe ma shumë salla.. ‘Ju kurgjo s’dini, veç me linde… Krejtve kena me ju dhunu!”

Ky kërcënim ishte përgjigje ndaj një ngjarjeje që kishte shkaktuar një lloj shqetësimi pak kohë më parë. Fadil Hoxha, udhëheqës i vjetër partizan dhe kreu i partisë komuniste pas luftës, kishte komentuar privatisht një batutë të papërshtatshme lidhur me fushatën mediatike që e portretizonte popullin shqiptar si përdhunues të grave serbe. Ai kishte kërkuar falje, duke mohuar se kishte thënë atë për të cilën akuzohej, megjithatë dëmi ishte bërë dhe nëpër rrugët e Serbisë kërkohej koka e tij.[85] Dhe jo vetëm kaq.

Bahtije Abrashi: “Edhe aty u kall salla, ‘Kena me dhunu grunë e Fadil Hoxhës!’”

Anita Susuri: “Qesi deklarata n’mledhje ka pasë a?”

Bahtije Abrashi: “N’mledhje, me shumë se 300 vetë. Horaz folshin as s’u përfillë rendi i ditës as kurgjo. ‘Grunë e tij, vajzën, nusën,’ me emër, ‘krejt shqiptarët, edhe ty’. Në mënyrë horaz m’drejtohen mua. Edhe unë rash n’nivelin e tyne edhe po ju them, ‘Urdhno, eja, afromu. Unë e kom në gjuhë. S’po ju vjen turp me ju ndi fmitë e juaj, me ju ndi gjeneratat e reja? Na e kemi kultivu Vllaznim-Bashkimin e ju shpreheni kështu’?... Edhe veç që s’më rrehën… E them se të gjithë kanë qenë Millosheviqa. Ka pasë aty gra, në Kryesi të Grave të Kosovës që është dashtë me u çu me reagu. Ka pasë anëtarë të Kryesisë të Lidhjes Socialiste asnjëni… asnjëni s’janë çu me iu kundërvu edhe mos me u dhanë të drejta. Për qata kom të drejtë me thanë që krejt kanë qenë Millosheviqa. Aty u shpalos programi i Millosheviqit. Unë e di qysh kom ardhë në shtëpi."

Bahtije Abrashi arriti të largohej pa pasoja nga ajo mbledhje, falë mbrojtjes që ia dha një kameraman i Radiotelevizionit të Prishtinës dhe shoferi i tij.

Askush nuk ishte i përgatitur për rëndimin tutje të krizës. Në asamblenë e 24 prillit 1987, serbët filluan ta gjuanin me gurë policinë, kryesisht shqiptare, që ishte e pranishme për të ruajtur rendin. Policia u përgjigj duke i rrahur me shufra. “Askush nuk duhet të guxojë t'ju rrahë!” deklaroi Slobodan Milošević para të gjitha medieve. Për të ushtruar udhëheqësinë e e tij karizmatike, ylli në ngjitje i komunizmit serb shfrytëzoi protestat e popullit, duke u veshur me mantelin populist të hakmarrësit të Kosovës dhe duke u vënë në krye të asaj që mediet e quajtën “rilindja e tretë” e Serbisë.[86] Siç ka shënuar historiani Ivo Banac, ishte socializmi që homogenizoi Serbinë më mirë se elitat nacionaliste të shekullit XIX.[87] Duke cituar Dobrica Ćosić, Miloševići personifikoi shpirtin e kohës.[88]

Luftë ndaj vetëmenaxhimit

Mobilizimi populist, i nisur nga grupet serbe nacionaliste në fund të viteve të '80-a, i hegjemonizoi të gjitha protestat dhe e legjitimoi pikërisht luftën jashtë institucioneve të Miloševićit kundër udhëheqësisë kom-uniste, e cila kishte dështuar të zgjidhte krizën ekonomike të vendit. Projekti politik i Miloševićit premtonte një ndërhyrje drastike kundër vetëmenaxhimit, i cili kishte bërë shpërdorime dhe ishte dëshmuar joefikas në ndërmarrje, në shpinë të kompetencave menaxheriale dhe të tregut, duke penalizuar kryesisht punonjësit. Për t'u rikthyer punëtorëve kontrollin mbi punën e tyre dhe për rroga më të mira, do të duhej të fillohej përmes një centralizimi të vendimeve të politikave ekonomiko-sociale, pra një reforme të Ligjit mbi Punën e Bashkuar dhe të Kushtetutës. Në këtë mënyrë, Milošević e lidhi ribashkimin e Serbisë, e cila sipas tij dhe turmave, ishte dobësuar nga autonomia e Vojvodinës dhe Kosovës, me forcimin e Jugosllavisë dhe rilindjen e ekonomisë. Me një goditje të vetme, ai neutralizoi dy tabu të nacionalizmit dhe stalinizmit.[89]

Projekti i vjetër për të ndryshuar Kushtetutën e vitit 1974 dhe për t'i kthyer krahinat autonome sërish nën kontrollin serb u rikthye. Por fillimisht duhej larguar udhëheqësia krahinore, e cila kishte besuar dhe vazhdonte të besonte në autonominë e Kosovës. E para që u dorëzua para trysnisë së "revolucionit anti-burokratik" të bazës, pjesa më e madhe e së cilës vinte nga Kosova, ishte udhëheqësia e Vojvodinës, e cila në fillim i rezistoi idesë së reformës kushtetuese. Më 5 tetor 1988, 100,000 serbë u mblodhën në kryeqytetin Novi Sad ndërkohë që po mbahej mbledhja e Komitetit Qendror Krahinor.[90] Pjesa më e madhe e protestuesve kishte ardhur nga Kosova dhe nga pjesë të tjera të Serbisë, duke u bashkuar me mbështetësit lokalë të Milošević. Duke qenë të vetëdijshëm se kishin humbur plotësisht besimin e partisë serbe dhe duke u sulmuar nga protestuesit me tasë jogurti, krerët e partisë provinciale dhanë dorëheqje duke iu hapur rrugë njerëzve besnikë të Miloševićit, që ishin të gatshëm për të ndryshuar Kushtetutën e vitit 1974. Pas kësaj forme proteste dadaiste, revolucioni i quajtur "anti-burokratik" mori emrin "revolucioni i jogurtit."

Në Kosovë, konsultimi mbi ndryshimet e Kushtetutës, të përgatitura në Beograd, u zhvillua në vilën e partisë në parkun e Gërmisë të Prishtinës.

Bahtije Abrashi: "Ajo ka qenë ni mbledhje e randë. Ka ardhë në delegacion Pera Kostić bashkë me shumë t'tjerë edhe e dhanë ekspozenë pse po dojnë me ndrru Kushtetutën e Kosovës. Thojnë, 'Veç një korrigjim i vogël'... E ata pse kanë dashtë me ndrru Kushtetutën e Kosovës ka qenë se në Kushtetutë të Kosovës ka qenë në atë kohë… Krahina Autonome e Kosovës, pjesë konstituive e Jugosllavisë... Kjo atyne iu ka pengu, se s'kanë mujtë me i zhvillu ato aktivitetet e mrapshta që i kanë zhvillu ktu… Kena reagu, ekziston sigurisht stenogrami, dokumentacioni se çdo gja në atë kohë osht' përcjellë. Unë kom reagu shumë ashpër edhe boj pytje, 'Sikur me pasë qenë gjallë Titoja', shoku Tito atëherë, 'Me pasë qenë gjallë Eduard Kardeli', që ka qenë truni i Jugosllavisë, ai ka dhanë shumë kontribut në hartimin e Kushtetutës së Kosovës, 'A kishit me marrë këtë iniciativë që e keni marrë tash? Unë s'po pajtohem me këtë.' Aty u bo ni rrëmujë, kush jom, tek jom, çka po mendoj, pse po e thom këtë?"

Kryetarja e re e partisë krahinore, Kaqusha Jashari, kishte një pedigre të

jashtëzakonshme: “Mu Millosheviqi më thojke, tha, ‘Krejt, krejt muj me thonë për tjerë, po vetëm për ty s’muj me thonë që je nacionaliste, irredentiste shqiptare s’muj me thonë’. ‘Jo’ thashë, ‘ato s’munesh me thonë kurrë, se une nuk jom. Me pasë nevojë me mbrojt të drejtën sërbe kisha mbrojt. Kushdo që osht’ i shkelun’, thashë, ‘i kom mbrojt të drejtat e punëtorëve në sindikatë, kisha mbrojt çdo të drejte” (*Kaqusha Jashari*). Ajo ishte vajzë e dy partizanëve, të cilët ia kishin vënë emrin Katyusha, si arma e tyre e preferuar, por kishin gabuar në shkrimin e emrit. Babai i saj ishte shqiptar, ndërsa nëna malazeze. Babai ishte komisar policie dhe president i Shoqatës së Veteranëve. Kaqusha kishte qenë anëtare e partisë, që kur ishte vajzë e re, drejtuese e rinisë komuniste, studiuese e inxhinierisë civile në Beograd dhe kishte kaluar në drejtimin e sindikatave të ndërtuesve. Ajo u zgjodh nga kreu i partisë në ikje, Azem Vllasi, në mbarim të mandatit.

Kishte muaj që Vllasi ishte bërë një objekt sulmi, si në asambletë e protestës, ashtu edhe nga ultranacionalistët nëpër stadiumet e futbollit, ku serbët kërkonin me forcë arrestimin e tij dhe madje edhe ekzekutimin për "persekutimet" e popullit serb.[91] “I qitëm synin niherë Rrahman Dedajt nji herë e kemi pasë anëtar i kryesisë. Ka qenë pak shëndetligë, por ka qenë i vendosun, i koqit…Ai nuk pranoi se ishte shëndetligë. Shkum me Kaqusha Jasharin e cila nuk kishte përvojë politike, në ‘86-tën e kishim zgjedh si femër anëtare të Kryesisë të Komitetit Krahinor... Në atë situatë edhe ajo i pritonte. Tha, ‘Unë po e pranoj veç me nji kusht…ti me metë në kryesi’...Thashë, ‘S’ka problem, unë jom aty. Qaty jemi na ekip.’ Na e vlersojshim që Kaqusha nuk do të jetë e shënjestrume prej serbëve si unë që isha veç i shënjestrum. Na si ekip funksionojmë” (*Azem Vllasi*).

Ata nuk e kishin marrë parasysh bazën. Serbët e fërshëllyen Jasharin në asamble në shenjë proteste para se ajo të hapte punimet. “[Millosheviqi tha], ‘Organet s’funksionojnë në Kosovë… Ti s’je e aftë, duhesh me dhonë dorëheqje’. ‘Jo’, thashë, ‘une dorëheqje nuk jepi. Munet vetëm struktura e cila më ka zgedhë mu me më hekë’. ‘Jo, na kemi me iniciu, une kom me iniciu’. Tashë, ‘E di, e kom pa atë letrën…. Une nuk jepi dorëheqje’” (*Kaqusha Jashari*). Në mbledhjen e Kryesisë së Komitetit Qendror të Jugosllavisë, ku ishte anëtare si kryetare e Kosovës, Jashari kërkoi ndihmë, por hasi një mur. Presidenti kroat, Štipe Šuvar, e takoi privatisht për t’i treguar për letrën e Miloševićit dhe i kërkoi të jepte dorëheqje. “Këta sllovenët, ky Millan Kuçan, i tha, ‘Une s’po du me u përzi në çashtje te Kosovës, ajo osht’ çashtja e tynve’. Edhe kroatët qashtu, ’Nuk du me u përzi’…Edhe e formun grupin, erdh grupi këtu në Kryesi kërkun une me u largu, kërkun dhe AzemVllasi me u liru prej antarit të Komitetit Qendror, se ka qenë vetëm anëtari Kryesis e mandati i ka kalu” (*Kaqusha Jashari*).

Taktika e ushtrimit të presionit nga lart dhe poshtë ndaj liderëve që nuk ishin rreshtuar krah Miloševićit ishte provuar tashmë në Vojvodinë dhe Mal të Zi. Java nga 10 deri më 17 nëntor 1988 u tregua vendimtare edhe në Kosovë. Një përmbledhje e seancës plenare të Presidiumit të Lidhjes Komuniste, zhvilluar një ditë më herët, e denoncoi udhëheqësinë në Kosovë si të paaftë për të respektuar dhe zbatuar vendimet e partisë. Milošević i çoi gjërat edhe më tutje dhe më 14 nëntor u ankua që ndërhyrja e tij nuk ishte raportuar saktë. Kritika e tij ndaj udhëheqësve kosovarë nuk ishte e përgjithshme, siç ishte thënë; ai kërkonte pikërisht dorëheqjen e Jasharit, pasi nuk kishte qenë në gjendje të ushtronte detyrën dhe kërkoi gjithashtu një administrim të tillë të krahinës ku serbëve t’u lejohej të organizoheshin ndaras.[92] Hapi i ardhshëm do të ishte votimi mbi shkarkimin e Jasharit dhe

Vllasit nga Komiteti Qendror i Kosovës.

Kaqusha Jashari: “Më thirri në telefon drejtori Aziz Abrashi në zyre qat ditë para mledhjes. Tha, ‘Mos gaboni me dhonë dorëheqje se po vijnë minatorët. Kanë vendos me ardhë’. ‘Jo,’ thashë, ‘me dhonë une jo, vetë ma më lirojnë prej detyrës, a më hekin nuk muj me garantu. Çka di une kur hapët diskutimi, po me dhonë jo.’ Jo s’ja u ka ni hiç, ata u nisën para se që ka fillu mledhja e Komitetit. Une tu e majtë mledhjen, tu e hapë diskutimin, do shiptarë na mbrojshin neve, sërbët na akuzojshin, aty mrena anëtarët. Edhe ubo situatë e ndame, kështu shiptarët me ni anë, sërbët në tjetër anë. Sërbët krejt me politikën e Millosheviqit. Edhe kur mrrinën minatorët qysh kanë mrri, s’besoj që krejt në kom prej Mitrovicës, nashta edhe me autobusa. Kur mrrinën këtu, hinën në Pallatin e Rinisë."

73 Troch, “Social Dynamics,” f. 222. U larguan 25% e serbëve dhe 16% e shqiptarëve nga personeli i universitetit; 5% e serbëve dhe 2% e shqiptarëve nga punëtorët e kualifikuar.

74 Anastasije Jevtić, *Dossier Kosovo*, Lausanne: L'Age d'Homme,1991.

75 Noel Malcolm, *Kosovo. A Short History,* MacMillan, 1998, f. 339; Wendy Bracewell, “Rape in Kosovo: Masculinity and Serbian Nationalism” *Nations and Nationalism* 6, 2000: 563–590.

76 Musić, *Making and Breaking,* f. 182.

77 Malcolm, *Kosovo,* f. 338-339.

78 Jana Dragović-Soso, *"Saviours of the Nation," Serbia’s Intellectuals Opposition and the Revival of Nationalism*, Montreal: McGill Queen's, 2003, f. 13-145.

79 Ivo Banac, “Is it True that Tito’s Yugoslav Policies Favored Albanians in Kosova?” in *The Case of Kosovo*, f. 63-66, f. 66.

80 Associated Press, 28 prill 1984.

81 Musić, *Making and Breaking*, f. 182 dhe Nebojša Vladisavljević, *Serbia’s Anti-bureaucratic Revolution: Milošević, the Fall of Communism and Nationalist Mobilization*, New York: Palgrave Macmillan, 2008, f. 91-92.

82 Perifraze nga Musić, *Making and Breaking*, f. 182-183.

83 Musić, *Making and Breaking*, f. 202-203.

[84] *Konferencija za društvenu aktivnost žena* (KDAŽ), *Antifašistički Front Žena* (AFŽ) e *Socijalisticki Savez Radnog Naroda Jugoslavije* (SSRN).

[85] Dubravka Žarkov, *The Body of War: Media, Ethnicity, and Gender in the Break-up of Yugoslavia,* Duke University Press, 2007, f. 21-24.

[86] Branka Magaš, *The Destruction of Yugoslavia: Tracking the Break-Up 1980-1992*, London: Verso, 1993, f. 206.

[87] Anna Di Lellio, "The Missing Democratic Revolution and Serbia's Anti-European Choice: 1989-2008," *International Journal of Politics, Culture and Societies* 22, 2009:373-384, f. 378.

[88] Dobrica Ćosić. *Un homme dans son Epoque. Entretiens avec Slavoliou Djoukitch, Lausanne: L'Age d'Homme.* 1991, f. 247.

[89] Musić, *Making and Breaking,* f. 185-187.

[90] Viktor Meier, *Yugoslavia: A History of Its Demise*, Taylor & Francis Group, 1999, f. 74.

[91] Clark, *Civil Resistance,* f. 47.

[92] Meier, *Yugoslavia,* f. 76.

MARSHI

Arditë Aliu: "Qysh e mbani n'mend grevën e minatorëve t'viteve 1989? Tregom pak a shumë prej fillimit qysh ka nisë greva, pse ka nisë?"

Tahir Salihu: "Jo, une po filloj prej marshit n'Prishtinë, a bon?... Se vetëm minatort me helmetë n'kokë edhe tesha t'puns, me dal n'rrugë edhe mi tregu bots, se minatori osht, si me than, punë e shejtë. Mi tregue se populli, minatort edhe punëtort, edhe t'gjitha shtresat e popllit shqiptar jonë t'rrezikume."

Në 17 nëntor 1988, e gjithë Trepça marshoi drejt Pristinës, rreth 50

kilometra në këmbë. *Shqyqyr Sadiku*: “Jena shku me mbrojt ish strukturën udhëheqëse të Kosovës, atëhere ka qenë Komiteti Qendror i Kosovës, që ka qenë Kaqusha dhe Azem Vllasi që i kanë përfaqësu ma tepër, Remzi Kolgeci ka qenë realisht. Edhe jena shku me dhanë ni shtytje, ni përkrahje ish-udhëheqësisë shqiptare që mos me hupë ata çka e kishim, ato parime themelore shkumë me i mbrojtë realisht."

Marshi ishte një befasi për shumëkënd, por jo për ata që punonin në minierë. *Xhafer Nuli*: “Në atë kohë m’kujtohet fare mirë diku në shtator apo tetor e kanë pru, ka ardhë Burhan Kavaja, Azizi, ka qenë Burhani drejtor i minierës, Azizi ka qenë drejtor gjeneral, e kanë pru këtë Riza Smakën edhe Halit Muharremin, dy jurista me na spjegu çka osht’ puna e kësaj ndryshimit të Kushtetutës. Ata veç që nuk na thanë, ‘Çunu sa nuk ju hangër dreqi.’ Me thonë të drejtën aty e murrëm një mesazh shumë të fortë qe duhet me bo çmos se… Atëherë na kemi fillu m’u pregaditë edhe me bisedu, thjeshtë me diskutue edhe me e kundërshtu me çdo kusht ndrrimin e Kushtetutës” (*Xhafer Nuli*).

Sipas kujtimeve të Sefedin Istrefi, ishte juristi Rizah Musliu ai që sqaroi çdo gjë, duke e shpjeguar me një metaforë nga bujqësia se si, veçanërisht amandamentin 47 mbi rikthimin e kompetencave vendimmarrëse te Serbia, ishte sikur një bujku, që duhej të mbante në shpinë një thes me misër, t’i prisnin dorën e djathtë dhe këmbën e majtë.

Ibush Jonuzi: “Në shqyrtimet e amandamenteve kushtetuese, vishin delegacione prej Sërbisë, të ish-Jugosllavisë e tylifare… Ishum në rend të parë ulun, nifarë Osman Rashica - ni minator, dikun tash i ka të 80-tat, përndryshe, ka punu ni kohë në Split edhe ai e dike gjuhën perfekt e dike gjuhën edhe i lexojke gazetat. U çu, diskutoi për ndryshime amandamentale, këto, kjo, kjo, kjo, kjo, shumë e citoj. Edhe po më thotë, tha, ‘Drejtor çka o ky me profesion?’ Thashë, ‘Minator’. Tha, ‘Osht’ e pamundshme’. Thashë, ‘Edhe ato minator me kualifikim, se as kualifikim të lartë ky s’ka’. Po minatorët, kanë mendu njerëzit që kanë ditë veç me eksploatu xehen, po nuk ka qenë ashtu. Ata i kanë pa senet shumë larg, i kanë pa. Edhe u shikë që për çdo ditë situata politike u rrënojke në Kosovë."

Burhan Kavaja: “Ajo ka qenë mas tubimit që e patëm, kur disa ia fillunë m’u anku për rroga, disa për ushqim, disa për banesa. E krejt bisedën pasi ju tregova se çka janë t’u na bo tubimet e sërbëve se ku do të jemë ne si avangardë, si punëtorë, si minatorë. Fillunë diskutimet edhe e ndrrun kahjen edhe ajo u bo me kërkesë mandej që, ‘Kush jonë ata që neve kështu po na bojnë? Hajde shkojmë në Prishtinë!’ Edhe prej atyhit qishtu ka ndodh, edhe u nisëm. Aty e kishim edhe shqyrtimin e amandamenteve kushtetuese që dojshin m’i ndrru edhe krejt ai tubim që ia filloi për çashtje sociale, u shndërru në tubim publik, politik për çashtje nacionale."

Lëvizja tjetër në zhveshtoret e atij mëngjesi të hershëm të 17 nëntorit ishte vendimtare.

Tahir Salihu: “Atë natë jom kanë n’ndrrimin e tretë, me datë gjashtumdhetë, jom shkue. Sod osht i vetmi gjallë, ni Rexhep Ibrahimi, i Kqiqit, ka qenë kujdestar i miniers’. Jom shkue edhe pesë minuta n’ora dhetë mramje. Unë isha n’tretën atë natë. Thom Rexh, Baba Rexh i thojshim, ‘Me

thirr Azizin edhe Burhanin, mi lajmrue, se na ma nuk munem me bajt kshtu.'…Jom dal, jom shku n'ndrrimin e tretë, kom punue veç dej n'tre ora, edhe jom dal. Kom nejt ku hijn n'banjo minatort, për me ardh me i hjek teshat e puns' iu kom than t'gjithve shkoni n'sallë ku mahen tubimet. Asnjo s'u desh, as se ka hjek teshat, as helmeten jonë shku aty. Kur shkoj aty, ish kanë Burhani edhe Azizi, ishin ardhë… m'tha Aziz... 'Asniherë kërkesa a t'mira, pej Skënderbeut e deri me sot, shqiptart nuk kanë pasë. Na jem me juve, ju me neve'."

Isuf Beqiri: "Na jena konë të lodhtë po kur jena shku na, une jom konë t'u punu në të parin ndrrim e tash kur u dalë e treta ata kanë vendos, kur jena shku ata s'janë deshë. 'E tash, ç'a po doni?'. 'Po shkojmë në Prishtinë'. Dikush kush ka mujt u vesh, kush s'ka mujt me tesha të shpisë edhe jena shku në Prishtinë."

Xhafer Nuli nuk kishte shkuar në punë atë ditë sepse i ishte dashur të dërgonte djalin te mjeku. Një koleg e lajmëroi dhe ai nxitoi për t'u bashkuar me të tjerët. "Kur i kom pa dathun atë këpucën, kama cullak i kish dal, nëntor ka qenë, borë ka qenë, domethonë 17 nëntori. Ma parë patë ra borë, dika, dika borë. Ashtu të dathun e të deshun me ato robe t'punës aty kur i kom pa s'ma ka marr mendja që dojnë me shku në Prishtinë n'kamë. 'Moni bre djem se s'mundeni në Prishtinë n'kamë', Pasha Zotin, thashë, 'Hajde, t'bojmë diçka, t'bojmë se në Prishtinë'. U afru një punëtor, m'tha, 'Ti po na thu', drejt me të thonë te disa kisha njëfarë ndikimi. Tha, 'Po Burhani po thotë shkoni.' 'A po thotë?' 'Po'. Tashë, 'Ecni, ecni!'" (*Xhafer Nuli*).

Isuf Peci: "Po me qato tesha, helmeta, ju ardhke era minierës, qato që kena punu në punishte, dikush me shlema e me qato jena shku, qashtu jena hi, të zhyta qato tesha. Me fol s'kena fol, njo me shoqin nuk folke, hiç, thu ti se jena kon krejt në bele, po ma zi se beleja u konë ajo."

Nexhmi Zeqiri: "Ne si mjek ishim në gjendje gatish-mërie. Në atë kohë kemi marshue në rast nevoje me iu dalë dikush, me iu dhanë ndihmë edhe ambulanca me i përcjellë mos po ndodhë dikush, mos po smuhet dikush, se kanë qenë minatortë njerëz të vjetër s'ka pasë të ri shumë ... për fat të mirë jo [nuk ja pasë incident] … Po ka pasë lëndime të kamve që nuk kanë qenë serioze diçka, po normalisht me ecë me ato çizme dhetë orë në kam, normalisht që ka telashe, probleme, telashe, probleme me siguri. Nuk kanë dashtë shumë me u eksponu ata me thanë, 'Unë jom smutë'. Ata e kanë pasë qëllimin me ecë përpara. Nuk kanë mendu as për shëndetin e tyne."

Gani Osmani: "Edhe jem nisë në komë, ka pasë tentime edhe prej këtuhit, sigurimit, ka pasë njerëz qitu që jonë konë të sigurimit, civilë, janë ardh policë e kanë tentu me i nalë. Mirëpo, kur e kanë pa që nuk po nalen, janë nisë në kamë teposht. Tash t'u shku rrugës teposht, unë e di që jonë bashkangjit prej qitu në tunel të parë e në Stantërg ju kanë bashkangjit popullata. Kanë vazhdu tajshi për Mitrovicë kur janë shku, ju kanë bashkangjitë rend."

Pas fotografisë së Titos

Ramadan Gjeloshi: "Janë dalë drejtori Burhan Kavaja, Aziz Abrashi, drejtor i

Kosovatrans u konë Zeqir Nebihi, i Prekazit edhe tha, 'Hypni në autobus mos të shkojna në kom'. S'kena pranu, autobusat vishin mas neve…Kur jena shku te fabrika e akumullatorav, domethonë kho, na kanë pa punëtorët e fabrikës, domethonë menxi kanë prit me dalë prej *kapije* [srb.: porta], e për tela, për gardhi që jonë aty e për hekra tu kcy, tu u bashkangjitë…U konë shoqni e madhe, nji mijë e kusur punëtorë edhe vendosëm me shku për Prishtinë. U organizum i morëm flamujt në atë kohë, nejse të Trepçës e ish në atë kohë të Jugosllavisë, flamuri i punëtorëve, syretin e Titos, ka ekzistu në atë kohë Tita… s'ke pasë. E sot ça menoj e s'më heket prej menve jonë konë, ka pasë sërbë këtu e u konë njo që s'ka ditë hiç shqip, thojke, 'Çka o puna? Çka po bohet këtu?' I kanë thonë, 'Po bohet, po shkojna për Prishtinë se s'po na i rritin rrogat'. Mustafë Baraliu i Koprivës, ka vdek edhe ai person edhe ai i pari, 'Daj mi…' [srb.: Ma jep] nejse s'po foli sërbisht, thotë, 'Ama fotografinë e Titës përpara'."

Anita Susuri: "Pse e keni marrë fotografinë e Titos, flamurin e Jugosllavisë?"

Shyqyri Sadiku: "Po, ka qenë nashta edhe ai sistemi ish-komunist, dhomethanë që nuk jem na kundër Jugosllavisë shumë, sa jemi n'mbrojtje të drejtave të shqiptarëve realisht, qajo ka qenë nashta poenta, jo qe nashta na ka vy shumë, po ka qenë poenta e tillë, se sistemi ka qenë i tillë që, 'Nuk jem na me shpërbë Jugosllavinë, po na jem për Jugosllavi po me të drejta t'barabarta'."

Kujtimi i fotografisë së Titos në marsh ngjalli jo pak të qeshura te Avdi Uka. "Po mirë boll, e kanë marrë, gjo keq s'kanë bo, le të thotë kush çka dojnë. E kanë marrë, njeri ne dektë merre ço ka të dush, të dektin, mos e merr të gjallin. Edhe 50 vjet kanë rrnu gjinja, në qat' sistem kemi rrnue, vallahi po. E kanë marrë, nuk ka qenë ajo naj farë çka ta di une, vetum për hak të punkteve të policisë, që nëse të sulmojnë, sulmojnë shembull policia, me thonë, 'Kqyre ç'apo bojnë, syretin [fotografinë] e Titos edhe po na sulmojnë këta,' me ja lonë fajin atynve, jo neve që e kena marrë ato" (*Avdi Uka*).

Xhafer Nuli: "Në ato tubime gjithëherë kemi bisedu edhe njëheri në ato tubime e kemi lavdru pak a shumë Titën, jo për diçka tjetër se qashtu u murrëm vesh … Serbët nuk mujn ja bajnë lavdrimin e Titos, kanë me reagu. Gjithëherë e kemi përmend edhe Titon, 'Tito na i ka dhonë qito të drejta, ju po doni me na i marrë edhe ato.'"

Me Titon përpara, marshi i minatorëve dalëngadalë u bë marshi i një populli. "Kemi shku krejt aty, tani kanë fillu lëvizjet, jo veç të minatorëve po edhe të qytetarëve edhe të studentav edhe të minierave tjera, prej Kishnicës, prej Goleshit krejt kanë pasë …Kishte student, minatorët e minierës së Kishnicës e Goleshit…Atëherë ka qenë lëvizja e njerëzve sikur lumë u konë, tana anët. Po ju thom ni detaj, une i kom dajët në Stanovc, Cakajt, që prej shpisë i kanë pa kolonat e qytetarëve. Edhe i ka thonë nona djalit, 'Çka po rri këtu? Dil me shokë shko!' … Do të thotë, ka qenë qashtu nji angazhim i madh i krejt, krejt njerëzve" (*Ibush Jonuzi)*.

Me të mbërritur në Stanovc, kolona e minatorëve dhe e njerëzve kishte bërë tashmë 27 kilometra. Pas 10 kilometrash të tjera, arriti në Mazgit, një

vend i njohur në fushën e mëllenjave, epiqendër e Betejës së Kosovës të vitit 1389. Beteja ishte një nga betejat e fundit të popujve ballkanikë, të udhëhequra nga princi serb, Lazar Hrebeljanović, kundër pushtimit osman të Sulltan Muratit I, por që nuk pati një epilog. Vetëm rreth 50 vjet më vonë, osmanët e shtrinë pushtetin e Perandorisë në të gjithë rajonin, deri në shpërbërjen e Perandorisë pas Luftës së Parë Botërore. Megjithatë, beteja mori menjëherë një dimension mitik, pasi të dy udhëheqësit u vranë aty: Lazari në betejë, ndërsa Sulltani u vra nga një kalorës për të cilin ka pak të dhëna historike, por që është përdorur shumë në disa tradita epike dhe folklorike të Ballkanit, përfshirë eposin shqiptar.[93] Serbët e identifikuan kalorësin si Miloš Obilić, simbol i hakmarrjes dhe i ringjalljes. Dhe miti i tij, krahas atij të martirit të princit të krishterë Lazar, u bë një materie joshëse për ndërtimin e identitetit fetar, politik dhe kulturor të kombit serb nën sundimin osman e mbi të gjitha mori trajtën e një ideje mobilizuese të ndjenjave nacionaliste në formimin e shtetit serb.

Në Mazgit, dy monumente përkujtojnë këtë betejë dhe, deri më sot, mbeten simbole të dy identiteteve kundërshtuese:[94] një tyrbe që ruan organet e Sulltanit (trupi ndodhet në Bursa, Turqi), dhe në anën tjetër të rrugës, një kullë me arkitekturë gjoja mesjetare, që është ndërtuar në vitet e '50-a, që kujton heroizmin e kalorësve serbë në të njëjtin vend, i quajtur "Gazimestan" sipas emrit të bajraktarit osman. Pikërisht në këtë vend, më 17 nëntor 1988, qindra agjentë policie të pajisur me pajisje për shpërndarjen e turmave kishin formuar një kordon për të ndaluar kolonën e protestuesve.

Burhan Kavaja kishte arritur të rekrutonte madje edhe Liljana Gaśić-in, një serbe, një kujtim që sot e bën të qeshë: "Ka qenë sekretare e Komitetit të Minierës të Lidhjes Komuniste, Liljana Gashiqi…ka punu si nënpunëse, si elektriciste, në mbushjen e baterive, e ka qenë majore e Sigurimit Shtetnor… I thashë, 'Këta po dojnë me shku për Prishtinë, ti duhet me ju pri'" (*Burhan Kavaja*).

Ramadan Gjeloshi: "Në atë kohë u konë kryetar i sindikates Smajl Nimani, sekretare u konë Juljana Gashiq, sërbe u konë. Edhe t'u shku knena na ka dalë… jo qysh ke puna me autobusat, s'deshtëm me hypë e u afru njoni kishe si gazetar, ai ish konë i UDB-ës të Sërbisë, të Jugosllavisë në atë kohë. Sigurimit shtetëror prej UDB-ës të Jugosllavisë. Edhe na që ishim të parët po thotë intervju me marrë edhe ai Smajli thotë, 'Kush o ky Dan?' Thashë, 'S'di'. Njo i veshun, librin e kish pasë, kasetofonin e vogël përfundi, ni libër edhe fletën kishe po shkruj, a din. Edhe fol kjo Juljana Gashiqi sërbisht, i thotë, 'Kush je ti?' Ai i thotë, '*Ti si naša* [srb.: Ti je e jona], ti tek je e jona', kur folë kjo sërbisht edhe ja ngjet për dore Juljana Gashiqit për dore, dëshmitar janë shoqnia, janë krejt. 'Çka bre? Te koka sërb!' Si ju kom afru ngat t'i kom mshu boks e kom gju atje poshtë në rrugë. Ka nga Zeqir Prekazi, drejtori i Kosovatransit, ma ka ngjitë edhe Burhani, 'Mo se ja ke hi udbashit'."

Sefedin Istrefi: "Edhe ai po i prekë n'krah, po i thotë asaj, 'Kush osht organizatori kryesor?' Ajo tha, 'Krejt jonë organizator këtu'. 'Jo, dikush duhet me konë, jo krejt', edhe u shpreh shumë vrazhd' kështu e shau, edhe Dani, Ramadan Gjeloshi… s'kom ditë gjo veç kur e ka pritë qitu {zgjat grushtin te fytyra}, i ka ra radio, mikro-radi e gazetarëve që e ka pasë nër gazetë…veç u rrottullu ai."

Ramadan Gjeloshi: "Na ka dalë qaty ai kordoni i policisë edhe thotë, 'Nuk

bon me shku për Prishtinë'. Nja dy milicë kurrë s'i harroj, ata thjesht të veshun sigurisht kanë qenë tonët nashta, kështu na ka bo me kry {lëviz kokën djathtas} që a din, 'Mos e nalni punën, hecni vazhdoni'. Atëherë i kemi shty anash, aty në rend të parë jom konë…Une jom konë knena me flamur, aty në rendin e parë jena konë, e kom pasë ni jakne të kuqe, ni ditë e ka qit nëpër web, e po ja boj djemve, 'Qe ku jom me jakne të kuqe'. Me ni jakne domethonë u dallojsha une, prej asaj, prej atyhit në rendin e parë. Edhe kena vazhdu, kur jena shku te, që po shesin, që jonë sërbë aty, speca tash, autostrada si *pijac* [srb.: treg] …Na ka dalë Remzi Kolgeci në atë kohë, midis udhe me kerr. 'Ku jeni nisë? Ça po lypni në Prishtinë?' Kurrë si sot s'e harroj me nji mantill të bardhë të veshun Remzi Kolgeci. Ai u konë diçka atëherë në atë kohën në Kosovë i zgedhun, 'Jena nisë me rujt shkambin tond e me ju rujt juve. E lëshona rrugën!' I kanë piskat do minatorë, 'Zoti të vra ik, se për juve jena nisë, nuk jena nisë për veti najsen anej. Ec, lëshona udhën!' E ka kapë kryt me dorë edhe kena vazhdu."

Minatorët ishin nisur në orën 7:00, në të ftohtin e një mëngjesi nëntori. Ata që ende kishin të mbathura çizmet e punës vuajtën tmerrësisht gjatë rrugës. Kur arritën në Prishtinë ora ishte 16:00, një turmë prej 3,000 njerëzish nga Trepça.[95] "Kur jena shku në Prishtinë në atë teposhtëzën në anën e majtë që u konë, te ushtria që hijshum atëherë e kena nisë na parollën tonë mo a din që kushtetutën s'e jepum, ai shkau u metë ja ka lëshu atij Ramadanit fotografinë e Titës në dorë edhe u ikë. Dej atje e ka bajtë atë fotografi. Edhe jemi shku drejt teposhtë, u dalë poplli, studentë na kanë pritë, jemi hi në sallë, kur jena rahatu në sallë u ardhë Kaqusha Jashari. Aty e kena majtë ni fjalim tani edhe tonët, punëtorët, nja tre vetë dolën, Avdi Uka e këta kanë folë aty" (*Ramadan Gjeloshi*).

Flasin minatorët

*Anita Susur*i: "E ti aty kur hine.. ta kanë jep ata të drejtën a ke lyp ti vet me folë?"

Avdi Uka: "Une kom kërku me folë…Unë prej minatorëve të Trepçës kom pasë besim të plotë edhe kush timin e duhanit kur kom bisedu une, frymë kush s'ka marrë edhe ma kanë dhonë gjithë, përparësi kom pasë, gjithë. E nuk o puna që kom folë veç në grevë e në Prishtinë, kom folë gjithë, gjithë e gjithë e gjithë e gjithë…eh. Më kanë marrë nëpër stacione të policisë më kanë majtë ka pesë orë, gjashtë orë, niqind herë, niqind herë. Më kanë thirrë, më kanë thonë, 'Kqyre, ça po të mungon ty? Ça po donti? A po don banesë? A po don kredi?' Që thashë, 40 vjeçar, 'Jo, as s'kom nevojë për banesë, as s'kom nevojë për kredit. U thirrë tubimi, une flas për të drejtën teme. Kom drejt me fol. Mos e thirrë tubimin unë nuk flas.'"

Korab Krasniqi: "Ça ke folë, a të kujtohet?"

Avdi Uka: "Une thashë në fillim që qato, qato punë, qato që i bojke Sërbia, që i bojke Sërbia, drejt për së drejtë le të thotë kush ça dojnë, le të shet kush ça don patriotizëm të rrejshum, nuk jena konë na kundër sërbëve , na jena konë kundër politikës së Serbisë. Tre anëtare të Komitetit, 200 minatorë jonë konë në sallë… edhe kom thonë, 'E luti Komitetin Qendror…' Nuk jom konë komunist kurrë, nuk jom hi në parti kurrë. Une jom minator, Avdi Uka jom, penzioner jom, po mirë boll, une kom kërku, kom thonë, 'Me e marrë

Sllobodan Millosheviqin me e çue te mjeku, nëse osht' i smut me i dhonë ndihmë mjekësore. Nëse nuk osht'i smute, po i bon këto gabime ose këto qëllime, ose këto, këto shkelje të popullit shiptarë, duhet me qitë në konop në urë të Ibrit'…Krejt kanë qenë qato kërkesat që pse m'u punësue arsimi shqiptarë, m' u penzionue, pse para kohshëm me shku në penzion? Për çka? Që ti ke pasë mungesë, ai ka kqyrë me t'i çue. Pse me na e zgjidhë neve Sërbia udheheqësinë e Kosovës, tu u kon me e zgedh na vet? Vet na me zgedh filani, filani, filani, ky ministër, ky këtu, ky aty."

Xhafer Peci: "Në Boro Ramiz, nuk kish vend aty. Jonë ardh tash punëtorët prej Kishnice e Badovci e Hajvalie e krejt. Ata jonë ulë n'tokë, s'ka pasë vend këtu nalt. A po din tani, rinia, gjithçka bre aty nalt. Erdh edhe Kaqusha Jashari aty. Ajo na priti mirë, na foli mirë. Na i kërkum, i tham që dorëheqje mos me dhonë kërkush në presion të kërkujt edhe n'dekshim tonë. 'Jo, na s'kemi me dhonë dorëheqje.' 'Na po vijmë,' minatorët i kanë thonë, 'po vijmë edhe në Komitet atje.' 'Jo, s'keni nevojë… fjalët e juve jonë qito, përkrahja juve, knej anej,' që nuk dojshin m'u bo ma e madhe me gjasë."

Kaqusha Jashari: "Kur lajmërun që minatorët kanë mrri në Pallatin aty, atëhere u murrëm vesh aty në Kryesi, që kemi udhëheqë mledhjen me ndërpre edhe atje me se po më kërkojnë. Edhe shkova atje, po më dokët që ka qenë me mu edhe Remzi Kolgeci, s'e di edhe kush edhe ata nisoj ato, mos me dhonë dorëheqje. Ato kërkesa që i kanë bo ma vonë kur ka qenë greva, ato nuk kanë qenë atëhere. Po vetëm kanë qenë në lidhje me dorëheqjet tona, une thashë, 'Nuk jepi dorëheqje'… Nuk e kom ni une aty mbrojtjen personale, po kom ni nifarë mbrojtjen e vendit, mbrojtjen e Kosovës që mu më ka ardhë mirë."

Me rikthimin e saj, rifilloi edhe mbledhja e Komitetit Qendror, ashtu siç filluan edhe trysnitë derisa të jepte dorëheqje. "Këta të Sërbisë kenë tre-katër, edhe këta të gjithë funksionarët tonë që jonë në Beograd në punë kenë aty, Kolë Shiroka, Sinan Hasani, Ali Shukriu. Edhe këta të Sërbisë aty, kërkojshin une me dhonë dorëheqje. Une thashë, 'Jo'. A në atë materialin që është pregaditë prej Kryesisë jonë aprovu disa dorëheqje që kanë dhonë ma herët disa, Ekrem Arifi, Rrahman Dedaj, të gjithë shiptarë po edhe sërbë kanë dhonë. Faktikisht Kryesia ka qenë me shumë njerëz që kanë dhonë dorëheqje" (*Kaqusha Jashari*).

Arifi dhe Dedaj ishin të afërt me Vllasin dhe ishin të parët që u dorëzuan. Por, ashtu siç kërkoi Miloševići, dhanë dorëheqje edhe të gjithë anëtarët serbë të Komitetit, duke e homogjenizuar atë etnikisht dhe, si të tillë, duke e bërë të pamundur funksionimin e tij. Jashari rezistonte. Për të zgjidhur ngërçin, Komiteti vendosi të votonte njëherësh në bllok paketën e të gjitha propozimeve që ishin në rendin e ditës, përfshirë edhe përjashtimin e Jasharit nga Komiteti Qendror. Dhe kështu e nxorën atë jashtë loje. "Mu më ka ardhë shumë, shumë keq që kolegët e mi shiptarë jonë pajtu me ato. Jonë pajtu se zahere kanë pa që nuk ka rrugëdalje edhe jonë pajtu me qat propozim. E tashti u bisedu meniherë këtu para se që filloi Komiteti, nëse aprovohet kush me më zavendësu, kush me vazhdu" *(Kaqusha Jashari)*.

Ndërkohë minatorët kishin filluar kthimin prapa, këtë herë me autobusët që shoqëruan marshin nga Mitrovica, disa edhe me vetura.

Korab Krasniqi: "Kur ke mrri në shpi' qysh je ni qat' ditë?"

Isuf Peci: “Me të thonë të vërtetën, për veten po foli, i ardhke era, i ardhke era shkret natyrës, era nuk i ardhke gjallni diqysh i ardhke shumë keq i ardhke a din. U dike që nuk o në rregull diçka edhe në hava {hap duart dhe shikon lartë} edhe në dushk {shikon përreth} e në mal, e në rrugë e, u dike që nuk osht’ mirë gjendja, shumë keq osht’."

Ramadan Gjeloshi nuk guxoi të shkonte në punë për tri ditë radhazi, sepse e lajmëruan që ishte në shënjestrën e policisë. “Selim Çitaku edhe ai në sigurim shtetnor ka punu me ta, t’u më përcjellë prej Mitrovicës deri në Prishtinë. Edhe i ka thonë atij Sefedin Istrefit prej Kovaçice, se ky shoku, që bojshin do policia i merrshin ka ni muj ditë, dy në atë kohë, i marrshin rezervista…E i thotë, ‘Sefë, merre atë shokun tond, s’ma dike emrin’. ‘Dan Gjeloshin?’ se Dan më kanë thonë. ‘Merre e shtinë në kallabllak se munën me kapë, me skaju’…Që i ka ra udbashit të Jugosllavisë… Azem thotë, ‘Dan, ama jaknën. Ndrroje po ta jap temën.’ I kena ndrru jaknat, i kemi ndrru jaknet a din, e kështu deri sa jena shku në sallë” (*Ramadan Gjeloshi*).

Makineria represive nuk kishte humbur kohë dhe ishte organizuar. “U ardhë shoku i klasës teme Fadil Bajgora që në atë kohë ka punu në shërbim sekret të JNA-së. I ka fikë dritat e kerrit…Ka thonë, ‘Shoku, jem kom obligim me të njo ue se shërbimi ushtarak o tu të përcjellë, une kurgjo s’di’. Edhe u kthy për rrugë. Thashë, ‘Falemnderit shumë Fadil’, do të thotë jonë ditë këto sene…Une i kom thonë grusë teme hala pa shku ën burg që në burg kena me shku. ‘Jo more, po, veç nona mos te dinë,’ qishtu ka qenë” (*Ibush Jonuzi*).

Në krye të kryesisë për të zëvendësuar Jasharin zgjodhën Remzi Kolgecin, por ngaqë Kolgeci nuk guxonte të përballej me Beogradin, partia serbe e kishte zëvendësuar me Rrahman Morinën,[96] drejtori i Policisë së Kosovës, dhe si shef i sigurimit, ishte emëruar Jusuf Karakushi.

Azem Vllasi: “Ishin faktikisht si marioneta në shërbim të tyne e jo, e jo marioneta pasive…me insistimin e Beogradit prej shtabit të Millosheviqit, por edhe me përkrahjen e qitune kollaboracionistëve që e shitën shpirtin, Rrahman Morina, Jusuf Karakoshi e do serbë që ishin aty ja nisën me bo regjistrin e organizatorëve të protestave nëntorit ‘88 për të tregu që ajo ka qenë një lëvizje e *ujdurm* [trq.: e montuar] armiqësore kundër Jugosllavisë edhe kundër sistemit. Kinse diçka e ngjajshme si ‘81-shin, por kjo shumë ma masovike dhe kjo lëvizje kinse armiqësore e ka në krye një udhëheqës shumë ma serioz. E kush jonë ata? Azem Vllasi e do… E kishin pasë bo listën. Thojnë, ‘92 njerëz i kemi, i ka policia të identifikume si organizatorë.’ Dolën mes tyne krejt njerëz shqiptarë që kishin do emra prej jetës politike, ekonomike. Për shembull, nëse jonë nisë punëtorët e një fabrike të Gilanit e e kishin drejtor nji me emër, thojshin, ‘Ai osht’ organizator se i ka leju, punëtorët s’kishin dalë’.”

Me arsyetimin e ruajtjes së sigurisë, Rrahman Morina pushoi nga puna një numër të madh të agjentëve shqiptarë të policisë që konsideroheshin si “besnikë” të Vllasit, tek i cili nuk kishte besim për të ushtruar represionin.[97] “Mas marshit kanë marrë, po i marrshin këta të mëdhejtë i merrshin ma së shumti. Punëtorët si ngucshin se për shkak të prodhimit, m’u bo mungesë anej. Se ktyneherë u konë, në atë sistemin e Jugosllavisë po foli, niherë m’u nalë korpa veç ni orë, ose skipi qeky i xehjes, vike krejt UDB-ja, ‘Pse u nalë, qe ni orë pse s’ka punu?’ E tash nalët niqin herë s’vjen kush me t’kqyrë, jo tybe. Domethonë, ‘Pse s’po del xehja, prodhimi?’ Atyne ju ka interesu”

(*Ramadan Gjeloshi*).

Anita Susuri: “Mendimi i juj, çka keni arritë atë ditë? A ka pasë naj sukses?”

Xhafer Nuli: “Ajo ka pasë shumë sukses se ai marsh mandej e hapi rrugën për marshe tri ditore, tri ditë ka pasë marshe të pandërpreme, tri ditë prej të gjitha anëve të Kosovës, t’gjitha prej Dragashi, prej Gjakove, prej të gjitha anëve të Kosovës kanë ardhë tri ditë e tri netë kurrë pa nda deri sa ma n’fund i shperndajtën me dhunë. Remzi Kolgeci dul tha, ‘Ik se na… ose shpërndanu ose shkum na marun te tonë’. Ma n’fund u shpërnda ajo edhe… minatorët prapë kanë vazhdu, disa kanë shku, gjithëherë në tona tubimet gati që jonë bo në Prishtinë, mirëpo e kemi majt të nesërmen me 18-in e kemi mbajt edhe këtu në Holl të Sporteve në Mitrovicë edhe prapë nji tubim si prej Stantërgut."

Më 19 nëntor, radioja njoftoi se 100,000 persona kishin mbërritur në Prishtinë para selisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve për të mbështetur minatorët. Në mesin e tyre, një numër i madh grash punonjëse nga fabrika e tekstilit “Emin Duraku” e Gjakovës, ku gratë përbënin 80% të 12,000 punonjësve/eve. "Me të lënë makinat e tyre të qepjes në mbrëmjen e 19 [18] nëntorit 1988, veshën vetëm rrobat e holla të punës dhe marshuan 90 kilometra deri në Prishtinë. Punëtorët e Jatex-it, rreth 4 mijë, iu bashkuan atyre. 'Gratë e reja i lanë fëmijët shumë të vegjël në çerdhet e fabrikës apo në shtëpi,' shkroi Sevdije Ahmeti, 'koha ishte shumë e ftohtë, me mjegull. Më vonë filloi të binte shi dhe shiu u bë borë... kamerat i tregonin ato me sandale ose me pantofla duke sfiduar borën, lodhjen dhe urinë'. Arritën në Prishtinë pas orës 20 të mbrëmjes. Ahmeti kujton si i priti e bashkë me aktivistet e tjera për t’iu siguruar rroba të ngrohta dhe medikamente. 'Një numër i konsiderueshëm grash morën pneumoni, ishin në kushte fizike të mjerueshme dhe pasojat ishin serioze, por psikologjikisht ishin shumë të kënaqura'.’”[98]

Në të njëjtën ditë, në Beograd, Milošević organizoi manifestimin më të madh "spontan" që kishte ndodhur ndonjëherë në histori të Jugosllavisë. Kur takoi masën, ai tha se nuk kishte asnjë fuqi që do të mund ta ndalonte procesin e bashkimit të Serbisë, edhe pse popujt e tjerë të Jugosllavisë e kundërshtonin, nuk ishte kohë e pakënaqësisë, por e luftës.[99]

Në Kosovë, në të gjitha asambletë dhe manifestimet e ditëve pas marshimit, minatorët vazhdonin t’i kushtonin kujdes të veçantë adoptimit të një ikonografie dhe sloganeve jugosllave, për të mos u asociuar me lëvizjen e ashtuquajtur anti-burokratike dhe revolucionin e jogurtit të serbëve, që shfaqnin emblema çetnike dhe parrulla të një nacionalizmi të dhunshëm. Parullat ishin, “Rroftë Komiteti Qendror i LK të Jugosllavisë!” “Rroftë Komiteti Krahinor dhe Kryesia e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës!” “Rroftë Kushtetuta e vitit 1974!” “Të ruhen parimet e Kushtetutës së vitit 1974!” “Poshtë politika serbo-madhe!” “Kaqusha-Azem!” “Kosova nuk është Vojvodinë!”[100]

Por në Kosovë ishin krijuar ndërkohë dy universe paralele, siç u zbulua shumë shpejt si në Trepçë, ashtu edhe në gjithë krahinën.[101] Vlerësimi i marshit nga Komiteti i Mbrojtjes dhe i Vetëmbrojtjes së Trepçës, i udhëhequr nga Juliana Gašić, ishte pozitiv, përkundër kritikave të ashpra të një inxhinieri serb që kërkoi arrestimin e Jonuzit, Ukës dhe Salihut. Përshtypja

dominuese në mediet dhe opinionin publik serb, në përputhje me partinë serbe, por edhe me drejtuesit shqiptarë, ishte se protestat ishin një komplot i armiqve të Jugosllavisë dhe një formë trysnie ndaj serbëve për t'i dëbuar nga Kosova. Këshilli Qendror i Punëtorëve të kompleksit të Trepçës miratoi grevat e minatorëve, por përfaqësues serbë, malazezë dhe turq të minierave të Kopaonikut dhe Gornji-Milanovacit e sulmuan drejtorin e Trepçës, Aziz Abrashin. Në Këshillat e Vetëmenaxhimit, të sindikatës dhe të partisë, disa serbë pyetën se pse Abrashi dhe Kavaja ishin në drejtimin e Trepçës kur Mitrovica kishte kuadrin e saj; duke nënkuptuar se të dy shqiptarët ishin të ardhur nga jashtë, sepse Mitrovica ishte "serbe", ndërkohë që të dy drejtuesit ishin lindur dhe rritur në Mitrovicë. Edhe seksioni i Lidhjes Komuniste në Stantërg, i mbledhur më 25 nëntor, doli me përfundimin se marshi ishte spontan dhe protestat ishin mbajtur brenda kufijve të ligjshmërisë.

Dhjetori është gjithmonë një muaj i shkurtër për shkak të festës së Krishtlindjes, ndaj mes gjërave të tjera, miniera u rihap më 30 janar. Më 2 dhe 3 shkurt 1989, minatorët e Stantërgut u futën sërish në grevë. Ndër të tjera, pagat e dhjetorit nuk u ishin paguar ende. Ata kërkonin të takoheshin me udhëheqësinë krahinore për një sqarim mbi situatën e tensionuar në Kosovë. Rrahman Morina, kryetar dhe Sonja Šepanović, anëtare e kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës, i pritën ata. Para një takimi me mijëra minatorë, ata thanë fjalë të buta: partia do të bënte një vlerësim objektiv të protestave dhe nuk do të lejonte fushatë anti-shqiptare, nuk do të kishte asnjë listë të organizatorëve dhe më e rëndësishmja, nuk do të ndrysh-onin parimet themelore të Kushtetutës së vitit 1974.

Një javë më vonë, më 11 shkurt, u bë publik pozicioni zyrtar i partisë mbi protestat.[102] Në këto qëndrime thuhej: "Organizatorët dhe frymëzuesit janë individë nga radhët e strukturave politike dhe ekonomike, të cilët hapur i kanë shprehur qëllimet nacionaliste, separatiste e kundër-revolucionare… Tërë kohën kanë brohoritur dhe kanë mbizotëruar parullat që të mos ndryshohet Kusthetuta e vitit 1974 …Nuk është arritur të sigurohet mbrojtja dhe sigurja e tërësishme, e drejta dhe liria qytetare e kombësisë serbe e malazeze…Shpërngulja po behet me intensitetin e njejtë…"

Manifestimet në sheshe dhe grevat kishin marrë përfundimisht një karakter politik. Ndaj Partia kishte vendosur të bënte ndarjen mes manifestimeve "të drejta" dhe atyre "kundërrevolucionare."

[93] Ivan Čolović, *Smrt na kosovu polju* Beograd: Biblioteka XX vek, 2017; Anna Di Lellio, *The Battle of Kosovo 1389. An Albanian Epic,* I.B. Tauris, 2009.

[94] Anna Di Lellio, "The Field of the Blackbirds and the Battle for Europe," në *Dynamics of Memory in the New Europe,* redaktuar nga Bill Niven, Ruth Wittlinger dhe Eric Langenbacher, f. 149-165, Berghahn Books, 2013.

[95] Abrashi e Kavaja, *Epopeja,* f. 21.

[96] Kryetar i Kryesisë së Lidhjes Komuniste të Kosovës nga shkurti në mars të 1989.

[97] Meier, *Yugoslavia*, f. 77.

[98] Nicole Farnsworth, ed. *History is Herstory too: The History of Women in Civil Society in Kosovo, 1980-2004.* Prishtinë: Kosova Gender Studies Center, f. 32-33.

[99] Meier, *Yugoslavia,* f. 78.

[100] Abrashi e Kavaja, *Epopeja,* f. 25.

[101] Abrashi e Kavaja, Ibid., f. 26-29.

[102] Abrashi e Kavaja, *Epopeja*, f. 30.

GREVA

Beqir Maliqi: "Dita e parë e grevës u konë 20 shkurti, u konë ditë e hane…Në ndrrimin e parë kom qenë n'punë, kom qenë drejtues i prodhimit. I kemi pasë na i thojmë, 'Zyre të qarkullimit', një zyre atje edhe kështu për herë të parë që m'ka informu njëfarë sinjalisti, m'kujtohet njëfarë Murat Latifi ka qenë sinjalist aty. Thashë, 'A dulën ndrrimi?'… 'Jo valla, nuk po dalin'. 'Pse?' 'S'po dojnë'. Nuk e kom zgjatë ma shumë e kom thirrë në horizontin e nontë një mbikqyrës u konë, ka qenë një Shyqyri Sadiku, atëherë ka qenë një djal i ri edhe ka qenë mbikqyrës në horizontin e nontë."

Shyqyri Sadiku: "Edhe [Maliqi] m'ka thirrë. 'Shyqë, çka osht' problemi?' I kom thanë, 'Çka të intereson, hajde poshtë'. Se nuk kom dashtë me bisedu përmes telefonave… Komunikimi përmes telefonave të tjerë induktiv që jonë në minierë me horizonte tjera e kom autorizue ni parapunëtor timin. I kom thanë, 'Komuniko me horizont…' se horizonti i dhetë ka ardhë natën na u ka bashkangjit. Horizontin e tetë veç u murrëm vesh n'fillim që m'u nalë ata. Edhe e kom shti me komuniku me horizontin e shtatë, gjashtin, t'pestin, katërtin edhe t'tretin. Edhe të gjithë jonë kanë dakord, edhe ka fillu greva."

Sadiku vinte nga një familje shumë e varfër minatorësh, e cila kishte qenë shënjestër e vazhdueshme e diskriminimit, si dhe kishte qenë nën mbikqyrjen e policisë për shkak të gjyshit ballist. Ai vetë ishte aktiv në një grup politik të

fshehtë, i përkushtuar për çështjen kombëtare. Rrëfimi i tij mbi grevën fillon me një takim, dy ditë përpara, të shtunën e 18 shkurtit, me disa shokë që kishin dalë nga turni i tretë në minierë. Vendtakimi i grupit ishte kafeneja përballë stacionit të autobusëve. Aty vendosën të dilnin në grevë dhe përpiluan një dokument që përmbante tri kërkesa: 1. Jo ndryshimeve të kushtetutës së vitit 1974 në pikat e saj thelbësore që garantonin autonominë e krahinave serbe; 2. Jo pensionimit të parakohshëm me detyrim të mësuesëve shqiptarë; 3. Dorëheqjen e tre udhëheqësve të krahinës të zgjedhur nga partia serbe: Rahman Morina, Ali Shukriu dhe Hysamedin Azemi.

Sipas kujtimeve të Sadikut, një çerek shekulli pas grevës, ishte grupi i tij që ndezi fitilin. Rrëfimet tjera sot dallojnë nga ky version, por eksizton një konsensus i gjerë mbi faktin se ideja e grevës mbështetej nga shumica dhe kjo gjë ndihej në ajër. Me fjalë të tjera, të gjithë flisnin për të dhe ishin gati të vepronin.

Avdi Uka: “Kena fol, kena bo, hajde knej, hajde anej, ‘Kena m’u marrëvesh, kthenu, mos u asini. Mos e boni të madhe këtë punë. Ka me u rregullu, çdo sen ka me ra në vend të vet, hajde’ *Buuu!* {onomatope}. S’mu ne shti me nejt në sallë, krejt Kosova aty. U çkepëm, erdhëm ko, sen në dynje nuk u marke vesh, veç ma zi, veç ma zi, përditë ardhke ma zi. U çum në protesta, 800 herë jena dalë në protesta në Prishtinë, e në Mitrovicë, e në Vushtrri e gjthkun. Në krejt Kosovën në protestë, shkijet anej protestë, na shiptartë knej në protestë, *vërc* {onomatope} knej, *vërc* {onomatope} anej u mush pusi, u shpërthye pusi. Çka me bo zgjidhje, veç duhet me hi në grevë. Në sipërfaqe s’na lanë, hajde hinë mina-minatorët, mes veti, une kom folë me ty, ti ke folë me këto, kja ka fol me ato, *buuu!* mrena. Ditën e mirë, udha e marë!”

Organizim dhe spontanitet

Xhafer Nuli: “Para se m’u organizu greva, shumë mirë u diskutu për këtë çashtje qysh ka m’u bo ajo. ‘Duhet me hi, me nejt në minierë edhe m’u nguju deri sa t’i realizojmë tonat nuk bon me dalë’. Ajo ka qenë, nuk ka qenë spontane që thotë dikush-dikush, nuk ka qenë spontane."

Anita Susuri: “Kryesia e ka organizu, a qysh u bo?”

Xhafer Nuli: “Me të thonë të drejtën, ato e kanë organizue në bashkëpunim me disa individë, por në bashkëpunim edhe me drejtorat, po le të thotë kush çka të dojë. Drejtorat jonë konë, tonë jemi konë. Na në njëfarë mënyre e murrëm mesazhin ma herët që duhet me bo çmos edhe jom i bindun që po të mos ishin drejtorat… Kqyre punëtorët sado kudo mundet pak me i frikësu e me i desorientue dikush, mirëpo po të mos ishin ata mirë të lidhun me punëtorë nuk kish me qenë ajo grevë edhe s’kish me pasë qatë jehonë."

Korab Krasniqi: “A ekziston ndonjë organizator kryesor? A ka naj person?”

Xhafer Nuli: “Kanë qenë Azizi, Burhani. Për neve kanë qenë ata me punëtorë bashkë, po me punëtorë bashkë. Jo vetun s’kishin mujtë me bo, mirëpo i kanë pasë një grup të punëtorëve."

Kur zbuloi se po qarkullonte një lloj dezinformate mbi grevën, Kavaja ngriti një sistem të thjeshtë inteligjence. Ai dërgoi Isuf Pecin për të mbikëqyrur qendrën telefonike.

Isuf Peci: “Se atje u konë, për shembull, centralla u konë këtu {spjegon me duar}, u dhezke, krejt numrat jonë konë qitu të shënume si e ke çu ti qat {tregon me gisht majtas}, telefon nalt, qishtu si e ke çu t’u ka dhez drita edhe në mënyrë sekrete kom shku në centrallë atje e kom prekë nifarë pulle edhe kom ndëgju krejt çka po folin. Edhe masanej e kom pasë detyrë me i lajmërue…”

Korab Krasniqi: “A u konë naj informatë kështu kyçe, e randësishme që ju ka nimu Burhanit për me e mirëmbajt situatën apo diçka?”

Isuf Peci: “Po, qai rast që ka thirrë ai Bjelletiqi, ai u konë sekretar i Komitetit Qendror të Sërbisë. Ato e kom nxonë une edhe veç e kom lëshu telefonin, jom hi i kom kallxu Burhanit."

Korab Krasniqi: “Çka ka fol ai?”

Isuf Peci: “Tha, ‘*Šta tražite* bre? [srb.: Çfarë po kërkoni] Çka po doni? A jeni në grevë?’ …Thashë, ‘*Izađe proizvodnja* [srb.: po, del prodhimi]’. Tha, ‘*Ma kakvi*!?’ [srb.: Po çfarë!?]. Se përpara ka qenë ni ditë mos me punu Trepça e ka marrë vesh krejt Jugosllavia, thu ti se u bo kumeditë çka, kiameti u bo, e s’u konë e jonja hiç, s’e kishim pa ditë na. E i kom kallxu, thashë, ‘Kqyre Bjelletiqi, filan njerin e lypi,’ …masi ka fol me mu Bjelletiqi e ka lyp Julla Gashiqi. Julla Gashiqi në atë kohë ka qenë kryetare e sindikatës e na shiptarët e çojshum qishtu, se kur ardhke në tubim ajo, para tubimi të punëtorëve e shajke Serbinë, e shajke sistemin, i shajke, a ko e kish lidhjen me ta qishtu {bashkon gishtat tregues}. Prej që e kom zbulu, une thashë, ‘Kqyre ajo…’, bile Burhani u çudit, tha, ‘Kon e lypi?’ ‘Julla Gashiqin e lypi Bjelletiqi’. Tha, ‘S’osht’ e mujtne’. Thashë, ‘E mujtne o, qysh s’osht’ e mujshme’… Veç me na zbulu neve çka po folim edhe me i ditë planet tona… Po e ka hetue Julla, e kish pa mësue dikush, tha, ‘Pece, *zatvori taj telefon*’ [srb.: Peci, mbylle atë telefon] edhe e kom mshelë une telefonin se… s’di qysh s’ëm shtinën në burg, se m’i ngu ajo ronë osht’.”

Por pse atëherë ekziston legjenda se greva ishte spontane? Është krejrësisht e qartë se si represioni hakmarrës pas marshimit në Prishtinë, arrestimet e para dhe rritja e pranisë policore rreth minierës, shtynë drejt krijimit të një organizimi ilegal. Pas grevës, represioni edhe më i ashpër dhe kërcënimet me vdekje ndaj organizatorëve imponuan një qasje edhe më sekrete në përgatitjen dhe zhvillimin e grevës. Sot, kur nuk ka asnjë rrezik për protagonistët, kujtimet mund të dalin përsëri në dritë.

Burhan Kavaja: “Kot osht’ që dikush thotë prej vetvetiu ka ndodh, pa e dhonë dikush iniciativën nuk mundet kurrë asnjigjo me ndodh. Edhe kryekëput qata që ishin në burg ishin organizatorë kryesor. Azem Vllasi ka qenë me neve në burg, ai ka qenë prej Komitetit Krahinor, i burgosun. Aziz Abrashi ka qenë si përgjegjës për kombinat, unë edhe këta tjerët kena qenë të Stantërgut. Me fillimin e grevës çdo herë edhe tash edhe ma herët kom thonë që nuk duhet me pasë bajraktar, s’kom dashtë as une as tjerët me i bo bajraktar. Për arsy se bajraktarizmi neve edhe na ka shkatërru si popull edhe prej atij momentin ka qenë, ‘Të gjithë jena organizatorë’. A në esencë, organizatorët ma të mirë edhe ma funkcional, edhe ma… kanë qenë qata të burgosunit."

Avdi Uka: “Une kom thonë niqind herë edhe po thom edhe sot, s’ka kush që më bind, gjashtë muj ditë kërkesat janë përmend përpara, gjashtë muj para se me hi në grevë. Po nuk i ka marrë kërkush parasysh, apo kupton? Kur kena hi në grevë i kena qit kërkesat në letër, jonë konë të njo me, s’ka minatorë që s’i ka ditë kërkesat."

E hënë, 20 shkurt, Sadiku po priste që minatorët e ndërrimit të parë, që fillonin punën në atë kohë, të dilnin nga zhveshtoret dhe ndërkohë po fliste me Kurtesh Pecin, mbikqyrësin e nivelit të tretë. “I kom thanë, ‘Kurtesh, na kena marrë ni vendim m’u nalë n’grevë. A jeni t’gatshëm me na përkrahë?’ Ai u kanë në horizontin e tetë, unë jom kanë në horizontin e nantë. Horizonti i nantë ka qenë bash kryesor, se aty kanë qenë shumica e punëtorëve, dikun 70-80 punëtorë n’ndrrim t’parë punojshin në horizontin e nantë…Horizonti i nantë m’u nalë në ni grevë të tillë, na besojshum që na përkrahin të gjithë, edhe horizontet e tjera…’Po’, m’ka thanë, ‘jem t’gatshëm’... Kur jena ardhë n’fund t’ndrrimit, e kena kry punën n’ora 01:00, s’jonë dalë” (*Shyqyri Sadiku*).

Ramadan Gjeloshi: “Kemi folë ndrrimet, nejse s’kena shku na kurrë tubë veç çdo ndrrim edhe ju kena kallxu që, ‘Qe na folëm qishtu’. Se na dalshum prej të parës e dyta vijke, u zatetshim në restoran. Ai vike për mu veshë me shku në ndrrimin e dytë, ‘Na qishtu kena fol, folni, ju ça dojna me bo?’ Edhe jonë infromu katër ndrrimet."

Lajmi se minatorët nuk po dilnin nga miniera i shkoi drejtorit teknik, Ibush Jonuzi, i cili ishte në zyrën e mbikqyrësit të ndërrimit të parë. “Atëherë të gjitha ndrrimet ka qenë kujdestari. … as s’ka qenë Azizi aty, as s’ka qenë Burhani veç une jom konë edhe jom zdirgj meniherë une, i kom thirrë të gjithë inxhinjerët. Bile i thojshim zyrja e fundit qashtu ka qenë emërtimi, në zyre të fundit krejt i kom thirrë. Thashë atij kujdestarit, thashë, ‘Thirri krejt inxhinjerët thuj, Ibushi po thërret’. Jonë ardhë aty thashë, ‘Duhet m’u caktu me shku të gjithë nëpër horizonte me bisedu me minatorët çka o në pytje’” (*Ibush Jonuzi*).

Xhafer Nuli: “Me 20 shkurt, në ora nji, Ibush Jonuzi, drejtor teknik ka qenë i minierës në atë kohë, m’ka thirrë … Ato ditë unë si drejtor i mirëmbajtjes ma tepër kom pasë përkujdesje, u dashtë me u organizue që me u përkujdes rryma mos m’u nal, ventilatori mos m’u nal, se mos me pasë ventilim, mos me pasë ajër ata s’kishin mujt me nejt aty as një moment, ashensori mos m’u nal, ashensori me punu kështu pa kurrëfarë domethonë. Kështu paisjet, infrastrukturën e minierës me majt në gjendje të rregullt." Xhafer Nuli u dërgua me Haxhi Jonuzin për të parë situatën. Pastaj thanë që “kishin harruar” pse kishin zbritur në minierë dhe u bashkuan me minatorët.[103]

Zyrat e shërbimeve teknike ishin shumë afër hyrjes së minierës. Vjollca Meha, gjeologia e punësuar menjëherë pas diplomimit në janar të vitit 1989, ishte atje me gjeologët e tjerë, gjeodetët dhe projektuesit, 80% e të cilëve ishin serbë. Kur morën lajmin për grevën, teknikët shqiptarë diskutuan shkurtimisht dhe vendosën të bashkoheshin me minatorët. “Thashë, ‘Po, na jena qitu. Sa rrijna qitu me shkije, me serbë…’ Se na n’zyre kishim serbë. Ata na vëzhgojshin, kqyrshin kush po shkon tani me thanë masanej jeni konë atje s’jeni konë n’punë, edhe shkum…Na si të reja diqysh e ndim atë o ësinë, nifarë pasigurie se Sigurimi Shtetnor u sillke, na i njofshim kështu si figura. Ata çdo herë na përcjellshin neve në lëvizje” (*Vjollca Meha*).

Grupi i vogël i teknikëve të rinj filloi zbritjen në minierë, por u ndal nga shërbimi i rendit të minatorëve, përgjegjës për hyrjet dhe daljet, të cilët dalloheshin për shkak të një shiriti të kuq, të vendosur në krah. Kolegu që i shoqëronte ata duhej t'u jepte të gjitha garancitë e mundshme mbi biografitë e tyre si njerëz nga familje që nuk ishin të lidhura me regjimin, për t'i lejuar të hynin.

Një për të gjithë, të gjithë për një

Në realitet, vetëm me miniatorët, miniera ishte stërmbushur. Për pak kohë, brenda u ngujuan 1,300 vetë. Organizatorët kishin menduar ta kontrollonin numrin e tyre, por si t'i thuhej jo Mujë Idrizit, i cili ishte në pushim mjekësor dhe doli për t'u bashkuar me shokët? Valdete Idrizi, sot aktiviste për të drejtat e njeriut dhe deputete në Parlamentin e Kosovës, ishte vetëm 14 vjeçe në atë kohë: "[Baba im] ka qenë n'bajë në Banjskë…Edhe, si filloi greva... pat' dalë n'pension t'përkohshëm, jo, t'parakohshëm për shkak që ishte veç smut… di që e la bajën edhe ka shku në minierë…E pyta, 'O babë, a ke mujt ti? Se je smut e je lodhë, e s'ke hongër'. Thotë, 'Jo, more, babë, a din sa ka ma shumë se une atje? Une veç njo prej, veç njo prej gjithë ata njerz që jonë konë… Kurrë nuk ndahen minatorët. Dhe nëntoka ka me lëvizë…Se na e dijmë, kjo osht' pasunia…' S'po di, njifarë, megjithate ta hup, njifarë morali ta ngritte. Kurrë nuk e harroj çfarë ndjenje ma ka jep edhe që kanihere s'kishe nevojë mo për sqarim tjetër. Nashta edhe u frigojsha me pyt ma tepër, mos po ndodhë najsen edhe ma, edhe ma keq. .. E di që seciën herë kur bohen, se nuk i du fort datat me, me i kujtu përkujtimet për ate… edhe kur shkoj, se kam qenë edhe vet në minierë disa herë, kom qenë e kom lypë numrin e babës atje. Numrin 618 e ka pasë. Kom shku në horizontin e dhjetë, se thjeshtë dojsha veç me ditë" (*Valdete Idrizi*).

Burhan Kavaja: "Une kisha mundësi që m'i nal 20-30 edhe mos me lëshu tjetër kërkon. Po nuk mujsha dëshirën e tyne të flaktë për patrotizëm me ju nal se bisha si uzurpator, diktator edhe i lëshojsha në minierë, u caktun edhe roja e cila rrin para pusit edhe i lëshon njerëzit. Aty u caktun dy Jahira, të dytë Jahir e kanë emrin, njoni Neziri, tjetri momentalisht s'po më kujtohet. Të cilët kishin për detyrë me bo seleksionimin kon me lëshu në minierë, kon mos me lëshu në minierë se në minierë mujshin me hi, me depërtu edhe tjerët. Në atë moment kur ka fillu greva na i kena pas 2500 kilogram eksploziv në minierëqë ka mujt me qenë tragjedi shumë e madhe."

Zeqir Fejzullahut nuk iu lejua të hynte në minierë për të marrë pjesë në Asamblenë e Përhershme të grevës. Më shumë se 30 vjet më pas, duket se ai ende ndien nevojën të justifikojë mungesën e tij. "Po vallahi qat' ditë që u nalë, qat' ditë që u nisë tan' jon' kanë t'lidhun. Pos u dalë dikush ka thonë, 'Pej sotit n'grevë, deri sa t'përfundon qekjo punë'. Unë si ojsmon, si ashensiorist nuk kom pasë t'drejtë me shku n'minierë hiç, te ata. Hiç s'kom pasë drejtë edhe s'kom pasë drejtë une me nejtë n'ven pune. Ojsmani, qasaj kohe tetë ditsh', nuk kom pasë drejt as me nejt' une n'ven pune, kur e kom kry orarin tem. Burhan Kavaja, Aziz Abrashi edhe njerzt' që kanë udhëheq, kanë thonë, 'Kqyre, krejt juve duhet, ju, tan' na muj' rrimi, tan' na s'kem nevojë me hangër, tan' s'kem nevojë. Ju ashensiorst me shku te shpija me flejtë, me pushu, me ardhë t'pushushum. Se nëse ju vini edhe na mytni ni njeri, vini pa gjumë edhe na mytni ni njeri, neve na shkon krejt greva poshtë', edhe qashtu osht'" (*Zeqir Fejzullahu*).

Isuf Beqiri: “Më kujtohet pakënaqësi, po ma fshtirë u konë na që s’e pishum duhanin, ma fshtirë u konë që s’e pishum duhanin, na u kuqshin sytë.… I teti u konë, na jena konë të nontin, ajri u konë, a po do me të rrejt, ajri u konë ma i mirë pak në të nontin, i teti u konë pak ma, ma, ma zor, ma zor. Se vike tash Azizi, Burhani, vishin në minierë, vishin aty-aty ren, ‘A po lodhni?’ Veç kajshum a, kajshum tonë. … E kishim pak, më fal nifarë nervoze a dinë. Nifarë nervoze po për me dalë a jo, për me dalë prej miniere a jo… Po bisedojshim që asnjo gjallë me dalë jo, për pa dhonë dorëheqje."

Beqir Maliqi: “Unë m’kujtohet që m’ka ra në horizontin e gjashtë m’ka ra, dikush në nontin, dikush në tetin, dikush në shtatin, se t’gjitha horizontet jonë konë nalë fillimisht punëtorët atje edhe shkum atje me i bind kishe që s’bon e kushtet e rrethanat e shëndeti. ‘Vallahi jo badihava na folni, s’keni çka me thonë na e kemi vendos qitu me net, mos me dalë pa u realizu kërkesat tona e sene’.” Sadiku e pa Jonuzin të mbërrinte në nivelin e nëntë me kryesinë, Smajl Limanin e Ljljana Gaši-inć (sic). Të ulur në tokë, minatorët dëgjuan me respekt drejtorin teknik që iu lutej të dilnin nga miniera. Por ishte e pamundur të bëhej gjë." *Ibush Jonuzi*: “Ata kanë thonë, ‘Na kena vendos, na kena vendos me hy në grevë edhe nuk dalim prej greve’.”

Korab Krasniqi: “A ke nejt tanë kohës, për tetë ditë apo ke nejt ni kohë ke dalë?”

Avdi Uka: “Ja, ja, ja hiç kurrë, absollut kurrë! Osht’ poezia në libër osht’, që më kanë thirrë me tradhëti edhe me të ni me çikën ma të voglën, hajde se osht’... ka desë… I kom thonë në telefon… ni farë Preteni, Xhafer Preteni, poezi ka shkru, në libër osht’ dikun, i kom thonë,‘O zotri, vorret e fshati ti dini, hallall çikës teme, une nuk dal." Merre me mend ti ku jena shku na, edhe qysh kena nejtna, me çfarë këmbëngulj e kena nejt, s’jena dalë prej atyhit."

Dhe në fakt kështu thotë poezia:

I thanë: Vajzën i ke sëmure!

Ai ngriti kokë, vështroi tokën

Ktheu kokën, vështroi tokën

Uli kokën, vështroi tokën.

I thanë: Vajza frymon frymën e fundit!

Ai lëvizi buzët e çara nga shtrëngata,

Nxori nga goja një zë të mprehtë si shpata

Tha: Ju i dini varret e katundit

Hallall bijës mbi dhe

Nga babai nën dhe.

Mbështet kokën mbi supet e shokut…

Tha: Nuk e lëshoj, jo Nënë-Tokën

Pa e trazuar Botën! [104]

Nexhmi Zeqiri: “Ka pasë minatorë që i ka vdekë ni anëtar i familjes, nuk ka dashtë me shku me varrosë, nuk ka dashtë m’i lanë shokët. Ka qenë ni fjalë, ni besë ka qenë aty, a kupton? Sot s’ke ashtu. Minatorët me qenë ma të organizum sot se klasat politike e jonë. Sot kjo osht’ çudi e madhe, çudi e madhe! Se s’ka pasë interes personal aty askush, aty ka qenë interesi kombëtar. Dhe kjo e dallon atë periudhë me të sotit.”

Sapo e informuan se po fillonte greva, Ibush Jonuzi e njoftoi menjëherë Aziz Abrashin, i cili ndodhej në një mbledhje në fabrikën e municioneve në Skënderaj, rreth 30 kilometra larg minierës, dhe Burhan Kavajën, i cili ishte në Prishtinë për një angazhim zyrtar. Të dy drejtorët u informuan se 441 minatorë të ndërrimit të parë, 315 të ndërrimit të dytë dhe 140 të ndërrimit të tretë kishin mbetur në galeritë e minierës.[105] Abrashi dhe Kavaja nxituan për në Mitrovicë për t'u takuar me përgjegjësit e organizatave të punëtorëve dhe të komunës, kryesisht për t'i informuar për grevën dhe për t’i vazhduar përpjekjet për t'i bindur minatorët të dilnin nga miniera dhe të vazhdonin protestën jashtë saj.

Beqir Maliqi: “M’kujtohet Aziz Abrashi, atëherë drejtor gjeneral i Trepçës që ka qenë, kur i ka lutë, i ka lutë me dalë në horizontin e tetë, ‘O veç dilni se haku i familjeve, haku i fëmijëve. P’e prej dorën në qoftë se ka nevojë e prej veç ju dilni e shpëtoni mos jetën e juve edhe familjet e juja’. Por në asnjë mënyrë minatorët nuk kanë pranue."

Xhafer Nuli: “Nuk ju kemi thonë, ‘Dilni’ kurrë, por ‘Veç kqyrni rune vetën, runu, mos u dëmtoni’, si me thonë ‘Shëndetin mos e dëmtoni sa t’mundeni’. Ka pasë dikur qaq një vetmohim ka qenë i madh sa që njerëzit fillun u smujshin, se tonë kohën t’u nejt mrenda. Mandej çizmet mathun, unë vet e di çizmet dikur fillun kamët me m’u bo varë se tonë kohën, tetë ditë e tetë netë pa i dathë çizmet, këpucët, u bonë kamët varë."

Avdi Uka: “Edhe na kanë thonë, ‘Pse bre burra, nuk muni, dam e, nalet prodhimi. Osht’ puna shëndeti ma fortë se prodhimi, nuk o në pytje prodhimi osht’ shëndeti. Me dalë jashtë, në sipërfaqe me dalë’. ‘Ja, nuk bon hiç!’ O zotri në dashi përkrahna, mos dashi shkoni kah doni se nuk dalum’. E kanë pa, e kanë pa edhe na kanë njoftë që na pe nuk lëshojmë, atëherë janë bashkangjitë edhe ata." Uka dëgjonte Burhan Kavajën t’u përgjigjej atyre që këmbën-gulnin që t’i bindnin minatorët të dilnin nga greva, “Minatorët e dinë çka duan. Sot, ndoshta janë të vetmit që kanë të drejtë."[106] Ajo mbështetje e forcoi edhe më shumë vendosmërinë e tyre dhe besimin se do fitonin.

Bahtije Abrashi: “Tri netë edhe tri ditë fare Aziz s’ka ardhë në shtëpi. Të tretën natë ka ardhë me u ndrru. Unë veç kur e kam pa ish zbardhë, ish thi. Aty e kam pa se sa e ka vështirë. Rrobat, teshat e tij kanë qenë krejt t’gavrune, thu ti që i ka hangër diçka ose ua kanë gjujtë diçka prej substancave t’cilave kanë qenë shumë t’randa në minierë. Se minatorët i kanë pasë rrobat e punës që kanë qenë ma rezistente, e ky jo. Edhe unë në atë kohë kam

qenë në Kryesi të Lidhjes Socialiste, kryetare, edhe po i tregoj si është gjendja jashtë. Edhe mas tri dite ia dhanë epitetin se ata janë irredentista. Fjala irredentist është shumë e randë. Janë mundu me tregu që nuk janë iredentista, po jo. Ditën e pestë kur ka ardhë në shtëpi ka qenë ankthi i madh sa t'u dhimbte bashkëshorti, t'u dhimke baba i fëmijëve, ni drejtor i ni gjigandi t'madh, ni ekonomist, ni punëtor i madh, i pashoq. Edhe po i them, 'Ti je drejtor gjeneral s'ki nevojë me ndejtë aty me minatorë'… Tha, 'A ke punu ti n'arsim?' Thashë, 'Po', 'A i kishe lanë ti nxansat tu n'mëshirë të dikujt?' Thashë, 'Jo'. Fillova me qajtë. Tha, 'Edhe une s'muj me i lanë puntortë e mi, minatorët e mi.'"

Çfarë kërkonin minatorët?

Kavaja kishte zbritur në nivelin e dhjetë, por as aty nuk bëhej fjalë për të dalë në sipërfaqe, por si të hartohej një platformë e grevës. E gjitha ishte një sakrificë kolektive, por me një plan të llogaritur mirë. "Po, bisedojmë me ta edhe nji pjesë prej tyne ja fillun m'u anku në çashtje sociale…Mes grevistëve kishte edhe sërbë…ata kanë ardhë me kërkesa sociale edhe kur e kanë pa se une ato sociale e shndërrova në keto kërkesa të vërteta që kanë qenë të nevojshme, atëhere ata e lëshun minierën dulën jashtë, këta tjerët metën aty… Se na… edhe protesta edhe këtu fillum për qato çashtjet parimore kushtetuese. Evoluim ka qenë Kombet e Bashkume me i njoftu, ajo ka qenë kërkesa më doke e dhetë, mos gabofsha; ajo ka qenë evoluim i atyre tubimeve" (*Burhan Kavaja*).

Propozimin për t'i njoftuar Kombet e Bashkuara (OKB) e dhanë një grup mintaroësh, të cilët mendonin dhe vepronin konkretisht, emrat e të cilëve dalin nga të gjitha kujtimet e grevës: Tahir Salihu, Veli Osmani e Avdi Uka.

Avdi Uka: "Për Kombet e Bashkuara e kom qit vet, në tetin horizont në letër, jonë ardhë e më kanë thonë shumë, 'Kjo osht' e ronë, e këto s'bon e *dam-ram!'* {onomatope}. Thashë, 'O nuk bon këto me heq, krejt m'i heq, pa u hequ në, kjo m'uheq s'ka! Se p'e qes une, jom shpreh. Në prehën burrave p'e qes këtˈ problem të Kosovës, në prehën të burrave'. Edhe e kom ditë, edhe që jom minator dhe që s'kom shkollë, menë kom. Unë e kom ditë që në Kombet e Bashkuara na nuk jemi antarë. Ajo me shku kërkesa shkon, po rrin qaty në kont ose në fiokë, nuk e merr kërkush parasysh se s'je antarë i saj, apo kupton? Sikur sot që po flitet, badihava shko kur s'je antar i saj, se s'të merr parasysh, eh. Domethonë, e kom ditë, po oshtˈ qëllimin e ka të madhe."

Alessandro Portelli më shpjegoi se shprehja "men kom", bart një botë kuptimesh. Sipas tij, është e familjes "më vonë i rashë në fije" shprehje e thënë nga Ada Pignotti, një grua e zakonshme dhe pa shkollim formal, duke iu referuar aksionit partizan që shërbeu si shkas për masakrën naziste në Fosse Ardeatine në Romë, ku u vra edhe bashëshorti i saj. Pignotti shërben si fija që e bën bashkë rrëfimin në librin e vetë Portellit, "L'ordine è già stato eseguito" [Urdhri është ekzekutuar tashmë], pikërisht për aftësitë e saj të të menduarit. Si Uka, ashtu edhe Pignotti, "tregojnë atë zgjuarsinë që nuk u njihet kurrë të shfrytëzuarve, viktimave, të shtypurve, për të cilët ne mund të dimë vetëm dhimbjen, zemërimin, durimin, guximin, dhe të ngjashme. E kujtoj shembullin e Rosa Parks, e cila shumë mirë e dinte çfarë po bënte kur e

organizoi [protestën në autobus] me shoqatën kombëtare për përparimin e të drejtave të njerëzve me ngjyrë, NAACP, dhe Qendrën Highlander, të cilën na e kanë përshkruar si një plakë të varfër (42 vjeçe!) me këmbë të fryrë. Kjo grua, e zezë, rrobaqepëse, a mund të ishte edhe zgjuar?"[107]

Me propozimin për të përfshirë OKB-në, synohej ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës, një praktikë tradicionalisht e ndjekur nga pakica shqiptare në Serbi ose në Jugosllavi që nga periudha e Lidhjes së Kombeve. Thirrjet bëheshin mbi idetë e presidentit amerikan, Wilson për vetëvendosjen e popujve dhe mbrojtjen e pakicave. Ndër-kombëtarizimi u bë mantra e rezistencës ndaj Miloševićit, si e rezistencës qytetare, ashtu edhe e asaj të armatosur.

Në horizontin e tetë, mbikqyrësi Halit Istrefi i shkr-uante kërkesat në një letër. "'Pika e parë', un e shkruj shembull, shembull e lashë edhe ni punëtor u afru ka thonë, 'Dorëheqjen e ktyne që e kena lypë tonë'. Tjetri u ardhë Jetish Bajrami, 'E dojna edhe qet' kërkesën e dytë', i treti u ardhë, 'E dojna edhe qet' kërkesë'. A din, hijshin që mos me thonë e ka organizu njoni po me marrë me i përfshi të gjithë minatorët, s'di a po më kupton?" (*Ramadan Gjeloshi*).

Burhan Kavaja: "Mirëpo, kërkesat në nijfarë mënyre ashtu qysh i kërkojshin i shkrum e ia dhashë Riza Muslisë që me dalë me i shtyp, po paraprakisht ju lexova une që, 'A jonë qeto kërkesat e juve?' Une i pata mbledhë kërkesat edhe para asaj ngjarje që u nalën ata edhe njifarë mënyre e disha çfare janë kërkesat tona të përbashkëta edhe po ju thom, 'A jonë qeto kërkesat e juve? Mos me ndrru kushtetutën, mos m'i lonë mi…' Ka qenë nji kërkesa, 'E dojmë Kosovën Republikë'. Edhe dikush e tha ato krejt, une nuke e lash ato me dalë si kërkesë, ia spjegova atina, 'Majtja e Kosovës në kësi niveli të pamvarësisë, si njësi federale na mundëson ato në shkallën e dytë. Me këto po i kërkojmë vetes mundësi të burgosjes të përnjihershme'... Asnji kërkesë s'ka mujt, pa kalu nëpër filtra, me u bo. Krejt … por kanë qenë të ndëgjushëm."

Korab Krasniqi: "A ke pasë ndoshta naj kërkesë tjetër që ke dashtë me shti?"

Isuf Peci: "Po nuk ke mujt."

Korab Krasniqi: "S'ke mujt?"

Isuf Peci: Nuk ke mujt se kqyre, une edhe pare e ceka, gjithkush s'ka mujt me fol aty, jonë konë të organizum, organizimi ka qenë në nivel. Edhe nëse ka dashtë dikush me fol nuk e kanë lonë shoqnia se jonë tutë mos po gabon ose mos po sharron. U konë Avdi Uka, unë kom folë edhe shumë tjerë kanë folë, a po kupton, e kena ditë. Për shembull, me qeta {prek buzët} jena marrë vesh edhe me shiqim {shikon anash}, se ka pasë gazetarë e ka pasë tyli agjensie inteligjence. Veç e kena {shikon majtas} kqyr shoqi-shoqin qishtu, kush po folë filani, kanë hesht krejt e kanë ngue. Kur ka dashtë dikush që nuk u konë bash a din, nuk e kanë lonë. Qekjo ka qenë."

Përfundimisht, këto ishin kërkesat e minatorëve:[108]

Të garantoheshin parimet themelore të Kushtet-utës së vitit 1974.

Të shënohej lista e organizatorëve të takimeve të nëntorit — meqenëse të gjithë minatorët ishin organizatorë të marsheve protestuese, pasi mes tyre nuk kishte pasur asnjë udhëheqës si organizator.

Të dilnin para përgjegjësisë të gjithë ata që kishin përgatitur projekt-ligjin mbi pensionimin e parakoh-shëm të punëtorëve të arsimit të krahinës.

Të shkarkohej Rrahman Morina nga pozicioni i Kryet-arit të Komitetit Qendror të Lidhjes Demokratike të Krahinës së Kosovës, pasi nuk i mbajti premtimet ndaj minatorëve. Të jepnin dorëheqje edhe Hysamedin Azemi dhe Ali Shukriu.

Të ndalej politika e gabuar ndaj popullit shqiptar.

Menjëherë të vijnë doktor Stipe Šuvari, Slobodan Miloševići dhe Ali Shukriu.

Nuk ekziston asnjë organizator, jemi të gjithë organizatorë.

Personat e panjohur nga minatorët nuk mund të hyjnë në galeri.

Të informoheshin përfaqësuesit e krahinave dhe repub-likave mbi situatën në Kosovë.

Një kërkesë tjetër ishte shtuar ndërsa mbaheshin protestat:

Të shqyrtohej pozicioni i shqiptarëve të Kosovës në Kombet e Bashkuara.

Përveç këtyre dhjetë pikave, kërkesa të tjera u shtuan ndërkohë: që akademikët Esat Stavilevci dhe Syria Pupovci të vinin për të shpjeguar amandamentet e Kushtetutës; që një delegacion i punëtorëve të Kishnicës, Novo Brdos dhe Elektroekonomikës të vinin t'i vizitonin dhe që asnjë gazetar serb të mos lejohej të hynte në minierë, meqë të gjithë ishin mbështetës të politikës së "Serbisë së Madhe." Një kërkesë tjetër, që doli më vonë, por që meriton të përmendet është fillimi i fushatës për faljen e gjaqeve.

Më 27 shkurt, në të përditshmen "Rilindja" u botuan dy komunikatat e minatorëve që ishin në grevë. E para njoftonte se nëse kërkesat e tyre do të pranoheshin, minatorët do të punonin një muaj pa pagë. E dyta ishte një thirrje, "me gabime të shumta gjuhësore, por e ngrohtë nga zemra dhe nga porositë e thella njerëzore". "Ne minatorët e Stari Tërgut, të cilët jemi të mbyllur nën tok çe tet ditë pa e pa driten e djellit me sy, pa ngran e pa pi, me gzim të madh ndegjuam lajmin per nji gest human të traditës shqiptare. Fjala është për pajtimin e familjeve Haxhi Bytyqi dhe Sejdi Ramshi. Apeli i xehtarëve te "Trepçës" dhe mbarë Kosovës të gjitha familjeve të gjaksuar mes veti është tja shtrijne si burrat dorën njeri tjetrit dhe të pajtohen, si thoinë populli besën e paçës. Kjo është me çenë usqhimi i jon, drita e jon, kishte me çenë përkrahja me e madhe për neve. Të ndërpritet vlla vrasja."[109]

Sefedin Istrefi: "U falë ni gjak sa jena konë na aty, dikun u ndëgju se na

s'mujshim edhe gazetat m'i përcjellë. I kena pasë Mursel Hazirin u konë n'krye atje ku keni hi te…papuqe i thojmë na, pej atyhit taj kur fillon lifti me shku poshtë, ai i ka lexu disa artikuj na i ka tregu. kështu qi ni gjak u falë edhe veç u konë koha e duhur për apel, me apelu. Mirëpo, nuk ka ardhë apeli pej meje, po ka ardhë…apeli pej meje po, po iniciativa u konë e studentave t'Fakultetit t'Xehtarisë…Edhe une e kom kry amanetin e studentave, edhe t'minatorëve…Mu edhe m'mushën sytë lot kur hie n'atë temën anena…Se nesra kur t'e shohin qit' deklaratë temën, ajo nashta bohët gjyshe i ka shtadhet' vjet edhe thotë 'Hallall Zoti ja boft. A pe sheh s'na e ka hupë munimin'. Pse me hupë munimin? Unë nuk ja hupi munimin kërkujt. Ai qi ka kontribu, kanë kontribu krejt: fshatar e, arsim e, qytetar e, punë e papunë e, krejt jonë solidarizu me minator… Pastaj që une veç u largova edhe e rroku Anton Çeta edhe Zyrafete[110]… o konë ni vajzë m'dokët edhe ajo qatje diku kah Peja mos gabofsha, flokë kaqurrele i ka pasë edhe ajo krah për krah ka shku gjithhere me Anton Çetën."

Fushata për faljen e gjaqeve filloi në fakt në shkurt të vitit 1990 dhe udhëheqësi i saj më i njohur ishte etnologu Anton Çetta. Por lëvizjen e filluan studentet nga Peja, Myrvete Dreshaj, Hava Shala dhe disa ish-të burgosur/a politikë/e të tjerë/a, përfshirë dhe Zyrafete Muriqin e përmendur më sipër.[111] Fushata përfshiu një shumëllojshmëri të të përfshirësh, që nga akademikët te aktivistët, nacionalistë dhe klerikët, si katolikë, ashtu edhe myslimanë, dhe arriti të pajtonte mijëra gjakësi, duke bashkuar shoqërinë shqiptare në një lëvizje rezistence paqësore, e cila në atë kohë pati jehonë të madhe edhe mes pacifistëve italianë.[112]

Më përpara vdes

Ditën e dytë të grevës u vendos që, meqenëse kushtet në disa galeri ishin shumë të vështira, dhe nuk ishte aq frytdhënëse të qëndronin të shpërndarë me pak mundësi për të diskutuar dhe komunikuar, të gjithë të sistemoheshin në nivelin e tetë dhe të nëntë. *Beqir Maliqi*: "Fatmirësisht ka punue ventilatori e ajri ka qenë deri diku në nivel, por kushtet kanë qenë shumë të vështira." *Burhan Kavaja*: "Minatorët kanë pasë ushqim tri racione gjatë ditës, pa pasë ndikim në shëndetin e tyne, përveç kur u mbajt greva e urisë. Për grevën e urisë ajo ka qenë tjetër..."

Në nivelin e pestë ende kishte njerëz, të cilët në ditën e tretë u ankuan se nuk kishin vizitorë, andaj Jonuzi, bashkë me Kavajën, shkoi për t'u dërguar lajme dhe ushqime. Dy menaxherë u detyruan t'u kërkonin minatorëve të mos pinin shumë duhan sepse përndryshe do të zhbënin punën e ekipit të shpëtimit, i cili përpiqej t'i neutralizonte sa më shumë gazrat helmuese që vinin në rrezik shëndetin e tyre.[113]

Nexhmi Zeqiri: "Rreth orës 8:00 vjen një informacion, se ambulanca afër minierës osht' aty, thotë, 'Minatorët kanë hy në grevë' … Fillimisht ne vazhdum punën në ambulancë që ishte aty në Stantërg edhe gradualisht u imponu nevoja që të jemi pjesë, se disa minatorë vishin përmes ni kohe, kish edhe të smutë. Njëri prej tyre, ishte ni inxhinier me epilepsi dhe erdh naltë… Fillimisht ishin të lodhun, të rraskapitun. Ni natë, dy, fillojnë, fillon m'u keqësu situata edhe gjendja e tyre shëndetësore. Ne disa i dërguam në

Mitrovicë, po nuk dojshin me shku në Mitrovicë. … Nuk dojke kërkush me shku në Mitrovicë, sepse atje ishin do mjekë shqiptarë, do mjekë serbë të ciltë ishin kundër grevës të minatorëve … edhe i keqtrajtojshin…shpihun, doktora shqiptarë, ka, që sot janë në Beograd jetojnë… që kanë punu edhe kanë veprue në kundërshtim me vlerat tona që i kem pasë… Në mënyrë spontane e formuam një stacionar në menzën, restaurantin e minatorëve. Aty fillojnë m'i hjekë ato karrika edhe me i shtrue pacientë në disa batanije, disa sene me iu dhanë, ndonjë infuzion, ndonjë ingjeksion, ndonjë ndihmë çka të ka nevojë. Kjo u formu stacionari spontanisht, sepse fluksi filloi m'u rritë… e formun stacionarin diku me 20, 30, 40 shtretër… Dikur edhe do shtretër i sigurum prej këtyre bllokut të vetmumve ku kanë banue… ma vonë erdh edhe ndihmë prej Prishtinës, prej Fakultetit të Mjekësisë edhe disa prej Mitrovicës, por barrën kryesore e kemi bajtë ne."

Xhafer Nuli: "Skender Boshnjakun e kanë thirrë, e ka thirrë Skender Boshnjaku të Ministrisë të Serbisë, në të vërtetë ata e kanë thirrë Skenderin, 'Çka osht' atje? A ka nevojë me pru mjek?' Nuk ishte puna me pru mjek, por me pru agjentë me shpërnda grevën. Tha, 'Mjek nuk m'vyjn, çona barna. Mjek kom boll nuk du'. 'Jo po t'bijmë'. 'Hiç as nji mjek mos ma dërgoni, po çomni barna n'qo ë se keni barna'. S'ka çu kërkush. Na ka ardhë një kamion barna prej Kryqit të Kuq slloven edhe ato t'u e pru dikun te Rashka e kanë malltretu. Kur ka ardhë ai, përfaqësuesi i Kryqit të Kuq, desh ish tranue, 'Qysh m'kanë trajtue, sa keq m'kanë trajtue', ai sllloveni. Mirëpo, nuk kanë mujt me ja nalë se ai i Sllovenisë, s'kanë guxu bash qashtu me asi. Barna na kanë pru prej Sllovenie një kamion."

Ekonomistja Alije Gashi Tmava ndodhej në zyrën e saj kur minatorët u futën në grevë dhe menjëherë u solidarizua me ta. "Kaloi ni ditë, kaloi e dyta ditë… Atëherë filloi numri t'rritet, fillon gjendja e minatorëve të keqësohet edhe u hapë me thanë spitali i improvizum. Aty kem pasë ni rol, kem lujtë rolin e motrave medicinale. I kishim mjekët tanë që kanë qenë mjekët e punës. Motrat u angazhunë, po kish nevojë me u angazhu numër ma i madh. Aty prej 20 shkurtit gjerë me 28 shkurt kur jonë dalë kom qenë aty natë e ditë që s'kom shku kurrë niherë n'shpi, derisa atë ditë kur kanë dalë, unë kom shku m'u pastru edhe ata dulën… Ndihmë kanë qenë ekipa mjekësore me motra që kanë qenë me mjekë, por ne e lujshim atë rol me iu dalë ndihmë, 'Jo, iu keqësu gjendja. Thirre tash mjekun'. A po kupton?" (*Alije Gashi Tmava*).

Si ndihmës-infermiere ishte edhe geologia, Vjollca Meha. "E prej lodhjes qaq të madhe që kom pasë, se ni kohë e gjatë pagjumësia e tonat, më lshoi trupi s'mujsha m'u ngritë… Se tash t'u nejt trupi krejt, mu tensioni m'ra… Edhe po ma bon ni anesteziolog u konë, Nuredin Fazliu, po ma bon, tha, "Qitash, ta jap ni koktell, ki m'u çu", e ma jepi ni injeksion." (*Vjollca Meha*). Vjollca shkoi në shtëpi atë natë, por u kthye të nesërmen në orën 6:00 të mëngjesit.

Nexhmi Zeqiri: "Ma vonë u imponu nevoja me zbritë poshtë, me kqyrë ku janë minatort. Ishin nëpër horizonte të ndryshme të vendosun edhe me kqyrë a janë në gjendje të mirë. Fillun mos me marrë ushqim, mos me marrë me pi kurgjo. Ni lloj greve urie, paknaqësie me kërkesa të tyre. … Ne jepshim ndihmë edhe në minierë. Ka ndodhë aty se s'dojke me ardhë naltë në stacionar. Thotë, 'Jo, unë nuk ndahna prej shokëve! Me ardhë naltë me u shtri komod, kurse shokt e mi me nejtë poshtë'…Nji minatori ia dhamë ni

banane me hangër, tha, ‘Une s’jom majmun, as portokall, mos m’jepni këso. Une po shkoj poshtë, s’du me nejtë këtu ma, poshtë.’ I sëmurë shkoj u kthy atje poshtë."

[103] Abrashi e Kavaja, *Epopeja*, f. 148.

[104] Abrashi e Kavaja, *Epopeja,* f. 122.

[105] Abrashi e Kavaja, *Epopeja,* f. 32.

[106] Abrashi e Kavaja, Ibid., f. 38.

[107] Alessandro Portelli, komunikimi personal nëpërmjet email, 16 shkurt 2024. *L’ordine è già stato eseguito,* Donzelli, 1999.

[108] Abrashi e Kavaja, *Epopeja*, f. 35.

[109] “Apeli i fundit nga horizonti i tetë,” *Rilindja*, 28 shkurt, 1989.

[110] Zyrafete Muriqi Lajçi, e burgosur politike, dënuar me pesë vite burg në 1984 me grupin e Pejës, një nga protagonistët e fushatës për pajtimin e gjaqeve: https://oralhistorykosovo.org/sq/zyrafete-muriqi-lajci/

[111] Në faqen e Oral History Kosovo gjenden një numër i madh intervistash me protagonistët e lëvizjes: https://oralhistorykosovo.org/sq/hulumtime/blood-feuds-reconciliations/; Erëmirë Krasniqi (ed.), *Fushata e Pajtimit të Gjaqeve 1990-1991- Reconciliation of Blood Feuds Campaign 1990-1991*, Iniciativa për Histori Gojore, 2023.

[112] Ndër të tjerë, Valentino Savoldi e Lush Gjergji, *Resistenza non-violenta nell’ex-Jugoslavia. Dal Kossovo, la testimonianza dei protagonisti,* Editrice Missionaria Italiana, 1993; *Kossovo. Conflitto e riconciliazione in un crocevia balcanico*, numër i veçantë i Religioni e Società XI (29) settembre-dicembre, 1997.

[113] Abrashi e Kavaja, *Epopeja,* f. 38.

Në pikën 6 të platformës së grevës kërkohej që menjëherë të vinin në minierë Stipe Šuvar, Slobodan Milošević dhe Ali Skukriu. “Minatorët kërkojnë që atyre t’u flasin drejpërdrejt për politikën diskriminuese ndaj shqiptarëve, së cilës ata po i kontribuojnë.”[114]

Miloševići ishte objektivi i qartë i grevistëve. Prej tre udhëheqësve vendorë, të cilëve iu kërkua dorëheqja, ata kërkonin vetëm praninë Ali Shukriut. Aferisa e tij me udhëheqësinë serbe e bënte veçanërisht të urryer nga minat-orët dhe jo vetëm. Ai qortohej se nuk kishte reaguar kundër propagandës serbe që i quante gratë shqiptare "lavatriçe", apo që i çnjerëzonte ato, duke u thënë se "pjellin si macet", pikërisht ai të cilin Tito e kishte ngarkuar të bëhej kumbari i fëmijëve të nënave me mbi nëntë fëmijë. Si partizan i vjetër shqiptar, Shukriu kishte luftuar kundër gjermanëve në malet e Shalës në rrethinë të Mitrovicës dhe njihte shumë familje minatorësh, të cilët e kishin fshehur dhe trajtuar kur ishte plagosur.[115] Sjellja e tij konsiderohej si tradhti.

Kroati Stipe Šuvar ishte kryetar i Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste Jugosllave që nga qershori i vitit 1988 dhe ishte kritik ndaj lejimit të ngritjes së figurës së Miloševićit në partinë serbe. Ashtu si Miloševići, ai ishte i afërt me ushtarakët. Gazetari gjerman, Viktor Meier, i cili ndoqi nga afër ngjarjet në Jugosllavi, e përshkruan si "një personalitet i ndërlikuar, me aftësi intelektuale të konsid-erueshme të përziera me cinizëm, i cili, pavarësisht gjithçkaje, vazhdonte t'i përmbahej një marksizmi dogmatik dhe primitiv." [116] Ai ishte përzgjedhur para kolegut më "liberal", që në detyrën e ministrit të arsimit të Kroacisë kishte thënë se "mjaftonte një skuadër e mirë ushtarake për t'i shpërndarë të gjithë intelektualët kritikë të Jugosllavisë." Ishte ai që, më 11 tetor të vitit 1988, organizoi mbledhjen e përbashkët të Kryesisë së Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë me udhëheqësit krahinorë të Kosovës dhe që kërkoi që me votim të vendoste sanksione ndaj këtyre të fundit si përgjegjës për "emergjencën e kundërrevolucionit." Në plenumin, në javë më vonë, Šuvar i mbështeti të gjitha ndryshimet kushtetuese dhe kërkesën për ndryshimin e udhëheqjes së Kosovës, duke menduar se nëse do t'i plotësonte dëshirat Miloševićit, ai do të qetësohej. Kjo nuk ndodhi. Në fillim të vitit 1989, Šuvar ishte tashmë një "sorrë e plevitosur", i përndjekur nga Miloševići dhe mbështetësit e tij, që kërkonin dorëheqjen përpara skadimit të mandatit të tij në qershor.

Për kontekst, as Milošević e as Shukriu nuk iu përgjigjën ftesës së minatorëve për takim. Rrahman Morina, kryetar i Komitetit Krahinor të partisë, të cilit po ashtu i kërkohej dorëheqja, vizitoi dy herë Trepçën gjatë grevës, por çdo kërkesë për të zbritur në minierë e hodhi poshtë me një përgjigje të ashpër, "Kam punë më të rëndësishme!" ose me një thënie emblematike, "Unë nuk guxoj të jap dorëheqje!"[117] Kjo deklarata e fundit dukej qartazi si nënshtrim ndaj Miloševićit, e diktuar nga frika. Ditët kalonin dhe askush nga udhëheqësia jugosllave nuk paraqitej. Më 22 shkurt, ndryshimet kushtetuese u miratuan nga Komisioni Kushtetues i Parlamentit serb. Dy ditë më pas, Parlamenti i mbledhur në seancë plenare i miratoi ndryshimet njëzëri, ndërsa përfaqësuesit e Kosovës ishin tepër të frikësuar për të kundërshtuar.[118]

Më 24 shkurt, kur u miratuan ndryshimet kushtetuese, greva kishte hyrë në ditën e pestë. Raif Dizdarević, presidenti i Jugosllavisë, arriti në Prishtinë.[119] Mysliman boshnjak, ish-punonjës policie, dogmatik, oportunist dhe frikacak, Dizdarević ishte bashkuar me Miloševićin që nga fillimi.[120] Sabrina Pedro Ramet e krahason këtë vlerësim të personazhit, të shkruar nga Viktor Meier në atë kohë, me përshkrimin që Dizdarević i bënte vetes 10 vjet më vonë, si "një kundërshtar i ndershëm dhe i guximshëm, edhe pse kryesisht i pafuqishëm ndaj Miloševićit", në kujtimet e tij.[121] Sidoqoftë, duket se presidenti i asaj kohe deklaroi se ishte i gatshëm të bisedonte me minatorët, por vetëm në selinë e partisë në Prishtinë. Sigurisht, ftesa u refuzua dhe në takimin, që u mbajt rreth orës 13:00, morën pjesë vetëm drejtuesit e Trepçës. Dizdarević u shfaq i shqetësuar, "se situata është plot me rreziqe për minatorët e 'Trepçës', për popullin e Kosovës dhe për gjithë Jugosllavinë."[122] Duket se ai madje ushtroi trysni mbi Rrahman Morinën dhe Ali Shukriun që të jepnin dorëheqje. Megjithëse në kujtimet e tij ai shkruan se ishte i bindur se bëhej fjalë për një komplot nacionalist, duke u bashkuar me Miloševićin për shtypjen me dhunë të krizës. Por, kur takoi delegacionin e Trepçës ai shfaqi një fytyrë tjetër. "Thashë se isha nisur me dyshimin brenda vetes në do të kisha mundur të bëja gjithsesi diçka më shumë nga ajo për të cilën u fol në atë mbledhje. Pranova se ajo barrë do të më mbetej në ndërgjegje për gjithë jetën, aq më tepër sepse, si kryetar i sindikatave të Bosnje-Hercegovinës, në atë kohë kisha zbritur në puset e Stantërgut dhe po ata minatorë më kishin nderuar me medaljen e artë të minatorëve të Stantërgut."[123]

Gjenerali që e shoqëronte, Steva Mirković, shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave, shkoi edhe më larg duke thënë se “askush nuk ka të drejtë të vihet mbi interesat e klasës punëtore. Andaj, shokët e apostrofuar duhet të japin dorëheqje!" Me t’u informuar mbi këto diskutime, minatorët e padjallëzuar u ndien optimistë.[124]

Por pasdite erdhi edhe Stipe Šuvar. Pavarësisht se e kishin kërkuar praninë e tij, minatorët refuzuan ta takonin. E kritikuan se ishte vonuar. Juliana Gašići e informoi se ai nuk ishte i mirëpritur dhe se minatorët nuk do të ngjiteshin për ta takuar.[125] Šuvar u arsyetua duke thënë se ishte informuar vetëm të martën për ftesën dhe pastaj kishin qenë disa mbledhje në të cilat nuk mund të mungonte, por të premten në mëngjes ishte liruar. Në mensën e Trepçës, u informua për situatën nga drejtoria dhe sindikatat. Aziz Abrashi mendonte se minatorët duhej ta takonin.

Burhan Kavaja: “Këtu pata nji përplasje me Azizin, une nuk dojsha me e lëshu në minierë, Azizi dojke me e lëshu në minierë edhe në njifarë mënyre arriti edhe e lëshum në minierë. Edhe unë kom qenë kundër drejt me thonë, s’e di a ka qenë ma mirë a jo. Unë i ndëgjojsha minatorët se minatorët thojshin, S’dojmë me i pa asnjo këta, veç dojmë Milloshević-in’ edhe unë i ndëgjojsha s’kisha qare pa i ndigju. Edhe Azizi insistoi."

Abrashi e dinte se i vetëm nuk do arrinte dot t’i bindte minatorët dhe se duhej të merrte me vete edhe Ibush Jonuzin, inxhinierin e minierës, drejtorin teknik, një njeri shumë të dashur për minatorët, të cilët i njihte me emër e mbiemër e deri te numri i matrikulimit. Jo më kot e quanin "kompjuter i gjallë."[126] Jonuzi nuk e kishte lënë minierën as për një çast gjatë grevës dhe kishte shkuar kudo për të kontrolluar dhe mbështetur grevistët.

Ibush Jonuzi: “Vendim kryetari edhe hymë na në minierë, shkumë në

horizontin e tetë. Ja nisi Azizi me ju fol edhe besoni më doket ai moment si m'u konë sot thojsha edhe shkëmbi po qet lot, ça bojshin tu qajt ata, minatorët. I luti Azizi hiç s'pranun, thanë, 'Hiç, hiç nuk dojmë [Shuvari] me ardhë këtu'. U tërhiqëm nja 20 metra edhe po ju thom, thashë, 'Kryetar, a të ju thom une?' 'Mule', tha 'bre Ibush, mule thuju!' Jena kthye përmrapa, ju kom thonë, me dy fjalë thanë, 'Le të vjen'. Edhe e kanë pranue."

Ishte ora 17:00 kur, në një atmosferë të tensionuar, Šuvar dhe Radiša Gačić, edhe këta nga kryesia komuniste në nivelin federal, së bashku me udhëheqësit kosovarë, Remzi Kolgeci dhe Jurij Bajec, me liderët komunalë dhe drejtuesit e minierës, u mblodhën për dy orë me minatorët në katin e tetë.
127 Nuk pati asnjë duartrokitje, asnjë përshëndetje, as slogane, vetëm një lodhje të thellë të grevistëve. Šuvar e hapi takimin duke lexuar letrën që kishte përgatitur në rast se nuk do të mund të fliste drejtpërdrejt me minatorët, një letër e mbushur plot me kërkimfalje për mosardhjen e tij më herët, e cila fillonte me një ofertë bashkëpunimi: "edhe unë jam bir minatori." Ai i siguroi se vonesa e tij nuk nënkuptonte mospërfillje, se amandamentimet e Kushtetutës së vitit 1974 nuk do ta preknin autonominë e Kosovës, autonomi që, sipas tij, ishte arritur që në vitin 1963, vit nga i cili shqiptarët në Kosovë kishin bërë përparime të mëdha. Ai shtoi se, ashtu si minatorët, Lidhja e Komunistëve ishte kundër çdo nacionalizmi dhe shovinizmi, por edhe Serbia duhej të ishte në një pozicion barazie me republikat e tjera dhe, për këtë arsye, duhej të mbante disa kompetenca mbi dy krahinat, mbi Kosovën dhe Vojvodinën, dhe se Kushtetuta duhej të thjeshtohej, sepse burokracia po pengonte përparimin demokratik. "Ju jeni zemra e klasës punëtore, keni një traditë revolucionare", përfundoi ai, "por shikoni, a është e drejtë që në udhëheqjen e Kosovës një shqiptar duhet të mendojë ndryshe nga serbët dhe malazezët në lidhje me çështjen kombëtare në Kosovë – kjo është tragjedia jonë!"

Avdi Uka foli i pari, me zemërimin që i rritej. "Une kom bisedu me to shqip, Remzi Kolgeci ja ka përkthy e kom mujtë me ja thonë sërbisht, s'kom deshtë vet me fol, në tetin horizont vet kom folë shyp, m'inati, m'inati kom folë shyp, eh." (*Avdi Uka*) Me pak fjalë, Uka i tha: "Kush vlen më shumë, ne 1300 punëtorë, që punojmë 150 orë nën dhe, apo Rrahman Morina? Çfarë komunisti është ai? Nëse nuk mund të na premtoni asgjë, ikni prej këtu, se jemi të lodhur dhe nuk jemi në gjendje të flasim." Edhe Veli Osmani kishte folur shkurt. Përmbledhtas tha, "Jemi këtu sepse që kur ka ardhur Miloševići, gjithçka ka shkuar keq në Jugosllavi, është ai që ka filluar t'i ndajë kombet, të flasë për 'vëllezërit serbë', por jemi këtu edhe për tre arsye të tjera: varfëria në Kosovë, puna e rëndë, dhe mbi të gjitha sepse, ndërkohë që ne këtu po japim gjakun, Milošević-i na quan irredentistë."

Šuvar u përpoq t'i qetësonte gjakërat, duke diskutuar kërkesat e minatorëve e mbi të gjitha duke shmangur pyetjet e tyre. Sigurisht, ligji që i dërgonte në pension të parakohshëm profesorët shqiptarë mund të ndryshonte, por ishte çështje e Kosovës, jo e Jugosllavisë. Dorëheqjet nga pozicionet e partisë nuk kërkohen, por jepen vullnetarisht. Vetëm largimi nga një pozicion mund të vendoset kolektivisht. Me një serbishte të përsosur dhe me një theks që e habiti Šuvarin, Mursel Haziri e shfrytëzoi rastin. Në vijim është një parafrazim i asaj çka i tha atij, të cilën po e shkruaj në vetën e parë: "Shoku drejtues, nga ajo çka lexoj në gazeta, 7,000 funksionarë janë larguar nga

pozicionet e tyre gjatë lëvizjes anti-buroktatike, përfshirë edhe ata që ishin dora e djathtë e Titos, si Orlandići dhe Žarkovići, dhe për mua ky është burokratizëm. Në situatën në të cilën gjendemi, edhe sikur të isha sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, do të kisha dhënë dorëheqjen. Ne jemi klasa punëtore dhe nëse partia komuniste është në pararojë të klasës punëtore, duhet të na dëgjojë, jo të na kthejë shpinën. Ju lutem, mos e turpëroni pozicionin që mbani! Na shikoni, ne jemi një masë. A nuk jemi ne më të rëndësishëm se tre personat, dorëheqjen e të cilëve e kërkojmë?"

Beqir Maliqi: "M'kujtohet… Shuvari tha, '*Šta si po zanimanju*?' [srb: Çka je me profesion?] Ky tha, '*Kopač*' [srb: gërmues] jom, minator', se ai mendojke mos naj jurist. Me të vërtetë, ai ka qenë një teknik i xehtarisë edhe ka qenë një mbikqyrës i minierës, por aq rrjedhshëm e fliste gjuhën serbo-kroatishte mirë sa që i la përshtypje atij që nuk osht' ky punëtor i minierës hiç."

Në një moment, të pranishmit filluan të flisnin njëkohësisht, askush nuk po e kërkonte më fjalën. Isuf Tahiri i drejtoi fjalën Šuvarit [Edhe kjo është një parafrazë e imja në vetën e parë]: "Shoku drejtues, në Vojvodinë dhe Mal të Zi kush i detyroi udhëheqësit të japin dorëheqjen?" Šuvari u përgjigj, "Populli." Tahiri: "Po ne kush dreqin jemi, nëse nuk jemi populli!"

Beqir Maliqi: "Një Milazim Istrefi ka qenë, një lloderist aty edhe unë ma larg se aty shumë të dendun menxi merrshim frymë. Tha, O ikni', ja nisi njëfar britme, i ra t'fikt atij Milazim Istrefit e kapën e ndërmjet binarëve m'kujtohet në drejtim të horizontit të tetë zyrja aty e një far britme, ja nisën punëtorët me bërtit e ata udhëheqsat që kenë tu fol e tu ikë njëfarë forme se u tutën që mos po ju ndodhë diçka. Menxi kanë pasë kalu nëpër punëtor e kanë pasë dal përjashta, Stipe Shuvari me qatë grupin që ke."

Burhan Kavaja: "Ato e frigun se kanë me të mytë në minierë, ai fare nuk ka pasë kurrfarë rreziku. Ka qenë nji organizim i mirë, i qetë, me trimëri jashtëzakonisht të madhe. Shpesh me nji oratori Avdi Uka ditke me nxitë çashtjet, herë thojke, 'Dhetë fmi i kom, tonë me dekë unë pre këtuhi nuk dal'. Herë thojke, 'Kom m'u gjujt në minierë me mytë veten', edhe e krijojke nji gjendje pak ma të acarume."

Zeqir Fejzullahu, punonjësi i ashensorit, që zbriti Šuvarin poshtë në minierë, e nxorri atë serish në sipërfaqe. "Kur u dalë prej miniere, u dalë me do njerz' te aty t'Trepçës, që kanë pasë, e kish qitë ni kaqket, qetu n'krye [prekë kokën] edhe ecke, qaj gjenerali i tina rrafsh pesdhet' metra mas tinaj. Ai shkojke tu pi duhon, kaqketën n'krye edhe hiç me kërkon, u idhnue zaher, u mërzit a çka po di gja une, rrap... rrap... rrap shkoj ka kapija." (*Zeqir Fejnullahu*).

Azem Vllasi: "Ka qenë edhe gruaja jeme që ishte gazetare e *Vjesnikut* e Zagrebit, raportonte. U kthy, vallahi ishte kah ora nontë në mramje. U kthy e tronditun, e përlotur. 'Çka u bo? Çka ndodhi sot? A përcjelle?' 'Mos vet! Tha, 'Ke Shuvari. Neve nuk na lëshun atje krejt, por vizita e tij asnji rezultat edhe ata kanë vendosë mos me dalë prej greve pa u plotësu kërkesat e tyne. Dikush po thotë jonë në gjendje të vështirë, kanë me vdek'. Ajo m'preki mu si njeri. S'po muj, a beson… Tash qata njerëz janë që më kanë përkrah mu në nëntor [1988]. Qata njerëz jonë, e di çfare jonë, kush jonë. Kurrë një kërkesë, diçka të papranueshme asmiqësore as kundër. Thashë, 'Vetëm të shkoj t'i shoh'. Nuk kisha unë autorizime…Jo, t'i shoh si njerëz…Bahri Oruqi kojshia jem, që

me një kohë kishte qenë Drejtor Gjeneral i Trepçës, kishte qenë kryetar i Qeverisë të Kosovës… E shkumë bashkë… E pamë një atmosferë të tmerrshme, kurrë s'e harroj në jetën teme. Nuk u dike a osht' ai ambienti {përshkruan me duar} shkëmbinjët e minatorëve, e minierës apo fytyrat e njerëzve… Dulëm unë edhe Bahria me ndjenja ma, ndjenja ma të ronda se që kur shkumë."

Ramadan Gjeloshi: "Syreti i Titës ka qenë i madh aty {tregon në drejtim të murit}... E une bile kesh bash te zyrja, zyrja si këtu osht' atje poshtë në tetin, ja lëshova vendin, u ul. Edhe na kqyri, na kqyri s'foli Azemi hiç. E kqyri syretin atje tha, 'Kqyre djem, nuk jom ardhë me ju lutë dilni, nuk jom ardhë, po prej dhimte, qaq dhimbje të madhe kom ndaj juve se edhe gruja po më kallxon, që osht' gazetare këtu. Sa të jeni në rrugën e qati', tha, kishe të Titos, 's'ka kush ça ju bon. A po ju garantoj që keni me hjekë shumë, ju me gjithë mu që jom ardhë unë sonte këtu, se jom nën përcjellje të madhe."

Vllasi e Oruçi nuk kishin arritur t'i bindnin të dilnin jashtë e as nuk ishin në gjendje t'i ndihmonin për të çuar përpara kauzën e tyre, por ajo vizitë, në ditën e gjashtë të grevës, iu dha shpresë.

[114] Abrashi e Kavaja, *Epopeja*, f. 35.

[115] Abrashi e Kavaja, Ibid., f. 41.

[116] Të gjitha citimet në këtë paragraf janë nga Meier, *Yugoslavia*, f. 75.

[117] Abrashi e Kavaja, Ibid., f. 147.

[118] Meier, Ibid., 81.

[119] Rrëfimi i këtij takimi bazohet në kronikën e sjellë në Abrashi dhe Kavaja, *Epopeja*, f. 57-60.

[120] Meier, *Yugoslavia*, f. 64.

[121] Raif Dizdarević, *La morte di Tito, la fine della Jugoslavia,* Longo, 2001 [Od smrti Tita do smrti Jugoslavije, Sarajevo, 1999];Sabrina Pedro Ramet, *Thinking of Yugoslavia,* f. 113.

[122] Abrashi e Kavaja, *Epopeja,* f. 59.

[123] Raif Dizdarević, *La morte di Tito*, f. 424.

[124] Abrashi e Kavaja, Ibid., f. 60.

[125] Abrashi e Kavaja, ibid., f. 61.

[126] Abrashi e Kavaja, Ibid., f.150.

[127] Përveç citimeve të drejtpërdrejta të protagonistëve, historia e kësaj vizite është parafrazuar nga Abrashi e Kavaja, *Epopeja*, f. 65.

SOLIDARITET DHE REAKSION

Ridona Berisha: "Qysh t'kujtohët pamja e minatorëve n'grevë?"

Sefedin Istrefi: "T'thom une si ni kopsht me lule kështu ta quj. Disa lule jonë t'byshkta kështu lodhën bien, disa lule ngadhnjejnë edhe keshin kështu. E dhonë atë hjeshinë e zbukurojnë edhe kopshtin. Qashtu edhe minatorët. I kqyrë ku jonë, shumë qi i ka rrokë kamera shembull i sheh sidomos kur kanë diskutu, minatorët qi kanë diskutu ata jonë qu pej gjumi se jonë konë t'lodhun, jonë konë t'molist kështu. Po sa ka fillu dikush, ata jonë nalë menihere edhe me vëmendje t'ka përcjellë ça po thotë. Do të thotë na ka dhonë fuqi se kena pasë me kon me nejt aty, se po mos t'ishin konë minatorët t'lidht mes veti e me ikë njo, e dy, e tre, e katër, e atëhere kur zbehët ajo punë edhe tana e hupë atë peshën, efekti…veç herë ka ardhë ma shumë tu na u bashkangjitë edhe mjek, qi ka pasë edhe mjek aty u ardhë mjeku ka nejt merre me men'… E mos t'flas inxhinierat, e mos t'flas studentat, e mos t'flas profesorat … Do të thotë jonë konë krejt me neve, edhe kjo osht ajo qi ne na ka bo m'u ni shumë mirë. Se na p'e bojmë ni pune qi po na përkrah krejt populli. Ne s'është me rëndësi populli tjetër, tjetër populli."

Një lëvizje e popullit

Mbulimi mediatik i grevës në gjuhën shqipe, pavarësisht se shoqërohej në mënyrë jo koherente me komunikimet keqadashëse të partisë, i paraqiste përditë publikut të gjerë atë që po ndodhte në minierë dhe jashtë saj dhe përforconte ndikimin e grevës. Që nga ditët e para, pati një përkrahje shumë të madhe solidariteti me grevistët, si nga grupet e ndryshme, ashtu edhe nga individët. *Xhafer Nuli*: "Për ushqim më kujtohet një rast kur do të Lipjanit erdhën, prunë shumë ndihma prunë, por ma së mrami edhe dy kepë tha {tregon me duar}, 'Qito na i ka dhonë një plakë, tha, 'S'kom tjetër çka me ju dhonë, qito dy kepë' po don m'i dhonë, ka dashtë m'i dhonë ajo vet, me ja u pru dy kepë'. Mandej një familje burrë gru e di që i kanë pru dy lira të arit,

‘Po dojmë me i dhonë kontribut për grevista, për këta këtu me qenë’… M’kujtohet një këtu i Mitrovicës, njëfarë Musa Berani e patë pru lopën, lopën dikun 500-600 kilogram e lidhi për gilindera aty tha, ‘Qe këto prene edhe qitjauni xehtarëve le t’kenë ushqim’. Edhe pse greva e qujshin ‘Grevë urie’, por nuk ka qenë grevë urie se ju kemi çu ushqim, ju kemi çu ushqim… qashtu dy-tri ditë nuk kanë hangër, mirëpo ma vonë tani kanë fillu me hangër, ju kemi çue, ju kemi bajt."

Një ndihmë e madhe erdhi nga njerëzit që, në Kosovë, por edhe në Maqedoni, si edhe në qytetet shqiptare të Luginës së Preshevës, kontribuuan në një fond për familjet e minatorëve, familje të mëdha dhe të varfra, të cilat kishin mbetur pa paga për shkak të grevës.[128] Në shtëpitë e minatorëve, pasiguria dhe ankthi rriteshin dita-ditës dhe jo vetëm sepse u mungonin kushtet për të mbijetuar, por se u mungonin gjithashtu informacionet rreth gjendjes shënde-tësore të familjarëve të tyre në minierë. *Xhafer Nuli*: “Nuk ka pasë [komunikimi me familjet] veç çka kanë ardhë, kanë ardh deri aty me pa, me ditë çka jonë, ‘Thuji mirë jom hajt shko te shpia’, ‘Qysh n’shpi?’ ‘Hajt mos na pengoni, s’ka’.”

Në disa raste, nxënësit e shkollave vendase, në mesin e të cilëve edhe fëmijët e grevistëve, zbritën në minierë për të recituar poezi lavdëruese, të shkruara posaçërisht për këtë rast.[129] Shumë grupe dhe individë kërkonin të vizitonin minatorët.

Ramadan Gjeloshi: “Mu më caktun në tetin horizont signalist, në korpë [srb.: shportë], në korpëku lëshohet në tetin që vje’ dikush une me telefon mi thirrë këta që ishin grevistë atje ulun. ‘Erdh’, për shembull, ‘nji televizion, tre vetë tek jonë, a pi pranoni, a s’pi pranoni?’ ose ‘Janë do studenta a pi pranoni?’ ‘Jo’. Ju thojsha, ‘Mos dilni prej dere’. I mshojsha signali, osht’ edhe ‘Dilni përjashtë’. Dilshin përjashtë… I kom kthy nja pesë-gjashtë korpa une se ka pasë edhe udbasha që i kena ngjo, si kena lonë me dalë hiç, e i kthejshum përpjetë…Po vishin me ditë informata, me kqyrë kush, çka po bohet, menxi s’ka pritë. E vetmja gazetare sa kena nejt tetë ditë e tetë netë Nadira e Azem Vllasit, ajo ka nejt aty. Kurrë s’e harroj bile, e pashë inçizoi, inçizoi e ka pasë edhe ni femër tjetër e ishin konë, i kish pasë do kaseta të vogla, ja dhojke asaj tinxa kur i mushke, ajo i qitke që mos me hetu policia që shkepke lajmet anena. A Nadirja non-stop ka nejt, shumë, pesë-gjashtë ditë. Gati ka nejt krejt aty non-stop me neve…dalke shkojke domethonë në sabah vike apet."

Punëtorët e minierave të tjera të Kosovës e shprehën solidaritetin e tyre duke ndaluar prodhimin më 21 dhe 22 shkurt. Disa shkuan në Stantërg si delegacion, për të shfaqur mbështetjen, e edhe për të bërë përpjekje që t'i bindnin kolegët e tyre të dilnin në sipërfaqe, sepse kushtet në galerinë nëntokësore po përkeqësoheshin nga dita në ditë. Nuk ishte befasi që bëhej fjalë vetëm për minatorët shqiptarë. Ndërkohë, te serbët lindi një reagim agresiv kundër grevës. Telegrame të tëra mbërritën në Stantërg nga Kopaoniku, Çërnaci, Gnjezhdaneja dhe Zveçani, ku grupe punëtorësh serbë kërkonin përfundimin e menjëhershëm të grevës dhe arrestimin e përgjegjësve, pra të Kavajës dhe Abrashit, për "manipulimin shqiptar" të minatorëve të Stantërgut.[130] Në minierën e Kopaonikut, gjithashtu pjesë e kompleksit të Trepçës, rreth 800 minatorë serbë dhe malazezë hynë në një kundërgrevë. Kur Abrashi u përpoq t'i vizitonte, u refuzua. Disa nga përfaqësuesit e tyre erdhën ta takonin në Stantërg përpara zyrave të minierës.

Njëri i tha, “Ik prej këtu, shok kryetar, se je shumë në rrezik. Në zgafellë nuk ka minatorë fare. Ata të gjithë janë këtu."[131] Shqetësim të veçantë shkaktuan zërat që tregonin për planin e një elektricisti serb për të shkëputur energjinë elektrike në galeritë e minierës, zëra që ndikuan të forcohej mbikëqyrja e instalimeve elektrike.[132]

Kjo ndarje e bazuar në përkatësinë kombëtare nuk kishte ndodhur vetëm në minierat e veriut të Kosovës. Në Prishtinë, çdo mbrëmje në orën 17:00, vetëm anëtarët shqiptarë të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës mblidheshin në selinë e tyre, në solidaritet me minatorët dhe kërkesat e tyre. Që nga viti paraprak, saktësisht pas një takimi të tensionuar në Beograd me Shoqatën e Shkrim-tarëve të Serbisë, Shoqata e Kosovës ishte shkëputur. Më 26-27 prill të vitit 1988, delegacionet e dy shoqatave u mblodhën në Beograd për të diskutuar mbi temën "Serbët dhe shqiptarët në Jugosllavinë e sotme."[133] Ideja ishte të qartësoheshin arsyet e armiqësisë në rritje midis dy kombeve. Por, në vend të një diskutimi të arsyeshëm, erdhi deri te përplasja se cili nga dy popujt kishte më shumë të drejta historike për ta konsideruar Kosovën si shtëpi të tyre të kahmotshme. Nuk munguan fyerjet, si vërejtja përfundimtare e Aleksandar Petrovit, kryetar i Shoqatës serbe, sipas të cilit, dialogu ishte zhvilluar në mënyrë të barabartë vetëm nga pikëpamja e numrit të pjesëmarrësve, nëntë në çdo delegacion, por jo nga pikëpamja e profesionalizmit, duke qenë se serbët ishin shumë më të kualifikuar.[134] Komenti përfundimtar i Milan Komnenićit mori një konotacion kërcënues dhe fatkeqësisht profetik, "Zotërinj, këtu jemi në luftë!”[135]

Takimi i radhës, i planifikuar për në muajin maj, nuk u mbajt kurrë. Përkundrazi, 28 anëtarët serbë të Shoqatës së Kosovës, e cila numëronte gjithsej 163 anëtarë, dhanë dorëheqjen në bllok.[136] Në shkurt të vitit 1989, mbrëmjet e organizuara nga Shoqata e Shkrimtarëve, e cila tashmë ishte vetëm shqiptare, shprehnin solidaritetin me minatorët në formë letrare, përmes leximeve të poezive ose fragmenteve nga proza. Me ta u mobilizuan gjithashtu profesorë, gazetarë dhe intelektualë të tjerë. Më 15 shkurt, juristi Gazmend Zajmi përpiloi një dokument që themelonte një Këshill të Punëtorëve të Shkencës dhe të Kulturës për mbrojtjen e pozicionit të Kosovës në Kushtetutën në fuqi. Një javë më pas, anëtarët e Këshillit shkruan një thirrje solidariteti me kërkesat e popullit të Kosovës, të shprehura në "protestat masive të nëntorit 1988 dhe në demonstratat e klasës punëtore të atij shkurti."[137] E nënshkruar nga katër miq, përveç Zajmit, edhe nga historiani Zekeria Cana, shkrimtarët Rexhep Qosja dhe Ali Aliu, si dhe gazetari Ramiz Kelmendi, ky apel në pak më shumë se dy ditë mblodhi gjithsej 215 emra intelektualësh, përfshirë edhe rreth 60 mjekë. Thirrja i drejtohej si Kuvendit të Republikës Serbe, ashtu edhe opinionit publik jugosllav.

Përgjigja e autoriteteve ndaj kësaj nisme ishte shumë e ngjashme me atë ndaj formave të tjera të solidaritetit. Shtypi serb u ankua se nacionalizmi separatist kishte depërtuar edhe tek intelektualët. Gazeta vendase “Jedinstvo” paraqiti apelin dhe nënshkruesit e saj nën një titull që ftonte për "gjuetinë e atyre bishave të egra."[138] Nga nënshkruesit, 65 u dënuan me "izolim", ose arrest administrativ pa gjyq, që parashihte shkëputje të plotë të kontakteve me botën e jashtme. Këta intelektualë përfaqësuan një të tretën e të "izoluarve", të cilët ishin gjithsej 237.[139] Nga ana tjetër, siç ka shkruar Mehmet Kraja, “me vetë apelin…inteligjencia shqiptare fitoi një besim të

madh te populli i vet."[140]

Bahtije Abrashi: “N’atë kohë i kanë arrestu 260 intelekt-ualë të fakultetit, të ekonomisë, t’mjeteve të informimit edhe i kanë çu në burgun e Nishit. Ndër të tjera, prej grave kisha qenë une në listë edhe e ndjera Drita Dobroshi. Kush na ka shpëtu, po du me vdekë edhe nuk e di. Vetëm m’ka thirrë Kryetarja e Grave të Bosnjës në telefon edhe m’ka thanë, “Thirrëm ti mu prej ndonji telefoni të kojshive." Se telefoni jonë është përgju. Për përgjim të telefonit ni nxanës i imi, inxhinier në postë ka ardhë edhe m’ka thanë, “Msuse, telefonin po ta përgjojnë." Edhe kom shku prej kojshive e kam thirrë Elmazën, ‘A e din që je n’listë që kanë me ju arrestu edhe ty edhe Drita Dobroshin?’ Unë i thashë, ‘Jam ba njejtë, le t’më arrestojnë’. Edhe nime u bana njejtë… Po qysh shpëtum, a intervenun kto kryetaret të republikave tjera, se i kom pasë raportet shumë t’mira edhe me të Sllovenisë edhe me të Bosnjës edhe me të Kroacisë.”

Ndërkohë, studentët ishin mbledhur në një tubim pafund në sallën “25 Maji”. Brenda ishte ftohtë, por në shenjë solidariteti me minatorët, askush nuk dilte nga salla. Përkundrazi, njerëzit vinin për t'u sjellë ushqim dhe për të shprehur përkrahje ndaj vajzave dhe djemve. Midis tyre ishte edhe Nerimane Kamberi, atëherë 20-vjeçare, familja e së cilës kishte emigruar në Belgjikën frankofone nga Lugina e Preshevës dhe më pas ajo kishte ardhur në Prishtinë për të ndjekur universitetin e vetëm në gjuhën shqipe në Jugosllavi. Nerimanja tashmë kishte emër, sepse në moshën 14-vjeçare botoi një libër për fëmijë në frëngjisht, më pas shkruante poezi dhe ishte përfshirë në qarqet e gazetarëve të rinj të asaj kohe. Njohja e gjuhëve të huaja e bënte një ndërmjetëse të përsosur për korrespondentët e huaj që ndiqnin ngjarjet në Jugosllavi. Por në shkurt të vitit 1989, Nerimanja ndihej para së gjithash si një shqiptare e Jugosllavisë. Në sallën ku ishin mbledhur studentët, ajo u zgjodh për t'i përfaqësuar studentët në minierë.

Nerimane Kamberi: “Tash unë nuk po them që kam qenë organizatore edhe nuk kam qenë në ato qarqet atëherë, po une veç e kom përcjellë këtë valën e madhe …isha afër me Afrim Zhitinë, i cili është vra nga serbët ma vonë. Edhe u zgjodha, une mendoj që… domethonë tash nuk di, nuk kom hulumtu kush e mori vendimin që unë të jem aty. …ishte pse u përzgjodha ma merr mendja ishte që isha prapë ajo figura ndryshe, ai personazhi ndryshe. Isha shkrimtare e re, simbolizojsha, kishte shumë pak femra shkrimtare në atë kohë, sidomos të reja; që kisha ardhë nga jashtë, që bartja vlera iluministe të filozofëve të shekullit XVIII francëze… Jo, kemi qenë një grup studentësh … dhe ne shkum atje, zbritëm në zgafellë edhe … mbaj në mend që ishte shumë emocionuse… Pastaj ishte edhe rreziku në çdo moment që mund të futeshin në sallë. Paramendoni ne ishim në një hapësirë të mbyllur aty që sërbët mund të futeshin edhe te studentët t’i arrestonin në masë, të përdornin dhunë. Kjo ka mund të ndodhë, po ajo euforia prapë, ajo adrenalina, ideali edhe solidarizimi që kishim ne me minatorë na bënte që ne do të shkonim deri në fund edhe vazhdimisht këtë e përcillnim. Edhe te minatorët ja përcolla imazhin, atë mesazhin e studentëve që ne solidarizohemi, që jemi me ta. Edhe e mbaj në mend… aty kom qajt se…i shihnim edhe disa ishin vërtetë në gjendje të randë. Edhe kur u ktheva atë e mbaj në mend shumë mirë, unë e mora fjalën, prapë sigurisht them si femër po mendoj, si shkrimtare e re, si studente e Universitetit të Prishtinës. Edhe e citova, ishte citimi i Ana Frankut që thoshte, ‘Më mirë një fund i tmerrshëm se nje tmerr i pafund’. Edhe ja përcolla mesazhin minatorëve që ishim me ta, që falenderonin. Edhe vërtet ishte një moment, një moment shumë i madh, shumë i fortë… Mbaj në mend

që pastaj u rrezikum, baba jem erdh me më marrë se frigohej se kishte pa në lajme që pytshin. Madje kishin thënë, 'Kush është kjo belgia në mesin e studentëve në minierë?'Ai kishte frikë për mu, po une refuzova të largohem prej Prishtinës. Nuk pata pastaj ndonji problem, ndonjë arrestim."

Anita Susuri: "Është procedura para se me hy në zgafellë, sepse minatorët nuk e kanë pranu gjithkon aty, po kanë qenë vetëm ata që i kanë zgjedh vetë, dhe juve ju kanë pranu. A ju kujtohet kush ka qenë për shembull në hyrje, si ju kanë pranu?"

Nerimane Kamberi: "Ata nuk kanë pranu, nuk kanë pranu sigurisht se jonë frigu që do t'i mashtrojnë, do t'i manipulojnë, që do të merr një kahje tejet politike greva e tyre. Por, studenti për ta, mos të harrojmë që studenti gjithmonë e ka pasë vendin e vet, vlerën e vet, gjithmonë. Ka qenë edhe në Jugosllavi, 'A studenti!' Mos të harrojmë tash kjo bën pjesë te kujtesa kolektive, studenti osht' ai që e ka çu flakadanin te Tito, te Tita atje, studenti, nxanësi, sepse kemi qenë në një kohë proletare. Ka qenë studenti, minatori, punëtori. Ka qenë Jugosllavia socialiste… Ne i kishim domethonë '89-tën sa i kishim as 20 vjet s'i kish UP-ja. Edhe studenti ka pasë një vlerë të madhe sepse me folë me fjalë të atëhershme e ka simbolizu arsimin, përparimin, dritën edhe minatorët edhe e kanë ditë që na po solidarizohemi me ta… e përfaqësonim universitetin që ishte një arritje e madhe e Kosovës në '70-tat, që ishin faktikisht edhe vitet më të qeta, po edhe më përparimtare për Kosovën deri me Kushtetutën e '74-tës."

Në tregimet gojore të grevave të mëdha të minatorëve, si ajo e mesit të viteve të '80-a në Britaninë e Madhe kundër politikave të Margaret Thatcher, rrëfimi i solidaritetit dhe i bashkimit i vë në hije përçarjet e vërteta.[141] Në rastin e Trepçës, dëshmia e një solidariteti popullor shumë të fortë në shoqërinë shqiptare të Kosovës është e padyshimtë dhe nuk bën pjesë vetëm në kujtesën individuale dhe kolektive. Madje edhe diaspora qëndronte me grevistët. Aktori Bekim Fehmiu, i lindur në Prishtinë dhe i ardhur në Hollywood, Uliksi i serisë televizive që magjepsi gratë italiane 20 vjet më parë, dërgoi një mesazh: "solidarizohem me dinjitetin tuaj heroik e mbinjerëzor."[142] Shqiptarët në Shtetet e Bashkuara i dërguan sekretarit të përgjithshëm të OKB-së Javier Perez de Cuellar një memorandum për t'i tërhequr vëmendjen për rreziqet e një ndërhyrjeje ushtarake në Kosovë, ndërsa një grup të rinjsh u vendosën me çadra përpara pallatit prej qelqi dhe filluan një grevë urie.[143]

Sefedin Istrefi: "K'naqësia ma e madhja unë që kom përjetu unë n'atë kohë, kur na ka ardhë ni telegram pej klubit 'Emin Duraku' pej Dyzeldorfi… Edhe po t'thom qi osht k'naqësi kur i ki krejt njerzt' tu mas veti, atëhere edhe me vdekë vdes, po e din për ça ke vdekë. … Bile aty ku t'dish me popull je i pavdekshëm… M'falni se une u emocionova pak."

Jehona e grevës

Jashtë Kosovës, Sllovenia ishte e para që u mobilizua.[144] Në mbrëmjen e 27 shkurtit, një turmë politikanësh dhe intelektualësh sllovenë u mblodhën në Pallatin e Kulturës "Cankarjev Dom" në Lubjanë, për t'u solidarizuar me minatorët e Stantërgut. Thirrjen për tubim e kishin bërë rreth 20 organizata. Jože Smole, kryetar i Aleancës Socialiste të Punëtorëve të Sllovenisë, shprehu

respektin e tij të madh për minatorët dhe tha se ata ishin përfshirë në një betejë të drejtë.[145] Në tubim foli edhe kryetari i partisë, Milan Kučan, duke dërguar një mesazh të qartë: “Kur njerëzit vendosin të rrezikojnë jetën, politika duhet të orientohet drejt idealeve të tyre dhe jo të atyre që duan të mbrojnë vetëm kolltukët e tyre dhe pushtetin … Në minierën e Stantërgut nuk mbrohen vetëm të drejtat e minatorëve, e drejta e një populli për t'i zgjedhur udhëheqësit e vet, dhe jo vetëm e drejta e barazisë midis kombeve. Atje mbrohet Jugosllavia e Këshillit Antifashist të Çlirimit Popullor."[146] Në atë organizim sllovenët vendosën yllin e Davidit mbi pallto me mbishkrimin "Kosova është toka ime", të njëjtët distinktivë u shitën në rrugë për të treguar se shqiptarët ishin të shtypur nga serbët, por gjithashtu që edhe ndaj sllovenëve ushtrohej e njëjta shtypje nga hegjemonizmi serb.[147] Vetëm një vit më parë, në mars të vitit 1988, udhëheqësisë sllovene iu desh t'u kundërvihej prirjeve centralizuese të Federatës Jugosllave, kur një kritikë e padëgjuar më parë për korrupsionin e ushtrisë u shfaq në revistat sllovene, duke shkaktuar një reagim që filloi t’i ngjajë një puçi në Lubjanë, por u kufizua në arrestimin e vetëm disa gazetarëve.[148]

Në Beograd, reagimi ishte i menjëhershëm. Me të marrë lajmin për nismën sllovene, studentët dhe mbështetësit e Miloshevićit u mblodhën para Kuvendit Federativ për ditë me radhë. Turmës iu bashkuan edhe të tjerë, derisa arriti në një milion veta në atë që mbahet mend si demonstrata e parë masive e partisë së Miloševićit për t'u ushtruar trysni organeve federale. Sloganet ishin: "Kosova është tokë serbe"; "Nuk do ta dorëzojmë kurrë Kosovën, jetojmë në harmoni"; "Jugosllavi, Serbia të mbron"; "Sllovenë, turpërohuni." Madje edhe komuniteti hebraik në Serbi reagoi kundër asaj që e konsideronte si përvetësim dhe manipulim të simboleve të veta. Në mars, u mbajt mbledhja e parë publike e Shoqatës së Miqësisë midis Serbëve dhe Hebrenjve, shoqatë e cila deri atëherë ishte ndaluar nga policia për shkak të karakterit të saj të supozuar kundër ideologjisë jugosllave të vëllazërim-bashkimit. Shumica e anëtarëve të kësaj shoqate ishin po ashtu anëtarë të Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Serbisë (SANU), që ishte përgjegjëse për memorandumin e famshëm, që u dha legjitimitet intelektual ankesave të serbëve si viktima të "gjenocidit" në Kosovë.[149]

Në mediet serbe, por edhe në vendet e punës, u përhapën spekulime dhe zëra tendenciozë, derisa lajmi për grevën e urisë u paraqit si lajm i rremë. Emëruesi i përbashkët ishte se minatorët u manipuluan nga një komplot i drejtuesve, të cilët ishin nacionalistë, terroristë dhe armiq të shtetit. Punëtorët, u tha nga Radiotelevizioni i Beogradit, do të duhej të bënin grevë për çështje ekonomike dhe sociale. Punëtorët e Rakovicës, të pranishëm në turmën para Kuvendit Federativ, kërkuan me zë të lartë shtypjen e grevistëve të Trepçës, të cilët, sipas tyre, ishin fajtorë se iu dorëzuan joshjes së nacionalizmit dhe për këtë duhej të përjashtoheshin nga klasa punëtore jugosllave.[150]

Greva e Trepçës u ndoq nga afër nga radio “Zagrebi” dhe të gjitha mediet sllovene, por edhe nga shumë medie ndërkombëtare dhe sigurisht nga agjencitë e lajmeve “Associated Press” dhe “Reuters”, ndër to tërhoqi vëmendjen edhe gazeta amerikane “The New York Times”. Medie të tjera, “The Guardian” dhe “The Independent”, dërguan korrespondentët e tyre, përkatësisht Barney Petrović dhe Marcus Tanner, dhe publikuan raporte të hollësishme për ngjarjet. Publiku italian lexoi për zhvillimet në gazetat kombëtare, nga “La Repubblica” në La Stampa dhe “Il Corriere della Sera”, në raportimet rreth reagimit ndaj grevës, me disa artikuj që vendosnin theksin

më shumë te përplasjet nacionaliste midis shqiptarëve dhe serbëve sesa te konflikti kushtetues dhe te ajo se çfarë nënkuptonin ndryshimet për Kosovën. “Il Corriere della Sera” i përcolli ngjarjet fillimisht nga Vjena, pastaj dërgoi në Beograd Franco Venturinin, korrespondentin që në Moskë mbuloi periudhën e Mikhail Gorbachev. Rreshtat përmbyllës të reportazhit të tij, të datës 3 mars 1989 mbi arrestimet dhe orën policore në Prishtinë, janë të mprehta, por fatkeqësisht të gabuara: "Nëse deri tani Milošević krijonte frikë, nga nesër shumë do të mendojnë se si ta ndalojnë."[151]

Nga krahu i majtë deri tani nuk është gjendur ndonjë qëndrim i CGIL, Konfederata e Përgjithshme Italiane e Punës, mbi grevën e Trepçës, as në arkivat e organizatës e as në revistën “Rassegna Sindacale”. Të mos spekulojmë se përse ndodhi kjo, marrë parasysh që kujtesa e protagonistëve rreth politikës së jashtme të sindikatës është e mjegullt dhe çështja në vetvete meriton hulumtim të mëtejmë. Mbulimi i ngjarjeve në gazetën komuniste “L'Unità” ofron ndonjë interpretim të mundshëm të kësaj heshtjeje të së majtës italiane. Gazeta botoi raporte të shkëlqyeshme të Mauro Montales, të cilat jepnin ndjesinë e thelbit të lojës politike dhe të shtypjes së ashpër në Kosovë. Por “L'Unità” e datës 3 mars 1989 raportoi veçmas deklaratën e përgjegjësit të punëve të jashtme të Partisë Komuniste, Giorgio Napolitano, i çili ishte në vizitë në Beograd ato ditë për të diskutuar krizën me Stipe Šuvarin, por që nuk tha asgjë për shkarkimet dhe arrestimet masive të minatorëve, duke shpresuar për një zgjidhje paqësore për të "zbutur shtytjet nacionaliste dhe lëvizjet centrifugale." Nuk ka nevojë për ta sqaruar gjuhën zyrtare të udhëheqësit komunist, mjafton ky tekst i shkurtër për të kuptuar se Napolitano i besonte tezës së irredentizmit kundërrevolucionar shqiptar. Ai nuk e kishte kuptuar se, duke ndryshuar parullën e Titos, "Një Serbi e dobët për një Jugosllavi të fortë", në "Një Serbi e fortë për një Jugosllavi të fortë", sheshi i Beogradit po ndërtonte një alternativë autoritative nën udhëheqjen e Miloševićit. Fundja, vështirë se dikush e kishte kuptuar. Me siguri, udhëheqësi komunist Napolitano, i njohur si një realist në politikë, por që ndiqte vijën e partisë, e cila ishte e orientuar të mbështeste prirjen reformuese të Gorbachevit në Bashkimin Sovjetik, ishte pak i interesuar të turbullonte ujërat jugosllave.[152]

Dorëheqjet

Nën trysnitë nga dy pole, nga njëra anë nga Miloševići — "Mos guxoni të jepni dorëheqje!" — dhe nga ana tjetër, nga e gjithë shoqëria shqiptare, përfshirë familjet, të cilat i shtynin të jepnin dorëheqjen, në fund Hysamedin Azemi, Ali Shukriu dhe Rrahman Morina nënshkruan dorëheqjet e tyre. Azemi, djalë minatori, i ngritur nga asgjëja në pozitë drejtuese, siç i pëlqente dhe i pëlqen gjithmonë të kujtojë, i tregon ato momente si poshtëruese dhe të dhimbshme.

Hysamedin Azemi: “Une i kom pasë shokë kryesorë, Bahriun kryetarin e Partisë atje, Burhanin edhe këtë… Azizin e kom pasë vendas të mirë edhe shok. Une si u ardhë letra e parë që u ardhe, une s’di ku tona ka hup rastësisht, edhe une jam kanë aty në Komitet. Emri jem nuk ka figuru, u kanë vetëm këta dy janë kanë…të nesrit kur janë shky ky… …”

Anita Susuri: “Kolgeci?”

Hysamedin Azemi: “Kolgeci e Shuvari e krejt këta, qaty bashkë që ishin. Tona u hi emrin tem aty e kanë shti, jo xehetarët … une me konë i sulmum prej xehetarëve edhe prej atyne edhe në realitet ata dojshin me më likuidu si kandidat, si kundërkandidat i tyne për shumë vene ku ata aspirojshin me arritën. Hyni [në listë emri im], kur përnjeherë une jam çuditë kur e kom dëgju, se une s’kisha kohë me nejt me ta, këta rrijshin te tonë bashkë … Nuk du që me gjetë xehetarin një gisht [me damtu aspak], se une isha djal i xehetarit. Baba im xehetar aty 40 vjet, une vetë jom konë xehetar… mjeshtër elektrik në Kishnicë. E kom pa qysh kur e fshijke fytyrën vetë e ata… i hjeke ato xehen e ato prej fytyrës... u konë një ofendim që thom që janë manipulu, jonë mashtru domethanë që thotë shqip, që thojshin. … Une e kom përdorë qat’ fjalë, tu e mendu me i ndihmu këtyne, po une në realitet aty s’i kom ndihmu atyne po as mu, mu jo se jo, po as atyne, as politikës të Kosovës [asaj] shqiptare. Tash prej distance kollaj është tash me folë, ka bo gabim e ka bo anej-knej, se anej-knej, u dashtë ashtu, u dashtë kështu, hajde tash e… e kom… e kom bo qat”. Ai është gabimi jem…krejt ato janë harru veç mbahet mend që Hysamedin Azemi ka thanë, ‘Xehetarët janë manipulu’."

Kujtimet e tij si aparatçik, të cilin e braktisën kolegët me shpërfillje, vazhdojnë të jenë ende të prekshme. Në zërin e tij ndihet hidhërimi kur përshkruan takimin me presidentin Šuvar, me të cilin përpiqet të flasë si i barabartë, por që ai e trajton me përbuzje dhe superioritet. “I thashë, ‘*Druže predsedniče* [srb.: shoku kryetar], kjo lojë ka me u nalë’. Tha, ‘Këta shokët e tu po më thojnë që njeri i mirë, punëtor i mirë, besnik, e shumë je trim…i thu çka të do ne anej-knej, çka mendon e anej-knej, mirëpo une me ty me të kallxu se këta s’po dojnë me të kallxu, veç shumë i papërshtatshëm.’ Serbisht tha, ‘Nezgodan za saradnju, shumë i papërsht-atshëm je për bashkëpunim, po thojnë këta shokë te tu’. Qaty para tyne…S’jom kanë marakli as i kafës, as i duhanit, as i rakisë. Që thojshin këta, ‘Ti s’je për kafe, për këto anej-knej, s’je as për udhëheqës’…Kundërshtarët e mi i kom pasë une kundërshtarët mrena, se këto…e kanë pasë një tutë që me ardhë me CV-në teme, me fjalorin tem, me angazhimin muj me ju marrë qito funksione të larta të Kosovës, Kryesinë a Partinë. Une në disa mbledhje, është edhe në një dokument ku në një mbledhje ku une diskutoj në “Rilindje”, që kërkoj edhe prej Serbisë mos me m’bo mu ‘shqiptarë të mirë’ se une jam si shumica e shqiptarëve, as nuk jam…i mire i keq, qai që jom…dhe une i kom thanë edhe qetyne shokëve, mos t’ju përmendi emnat, ‘Nuk jam i interesum për asnjë post të kryetarit. Jam i interesum si të më kalon qeky mandat këtu, me u kthy në Elektro-ekonomi’…Kryesia e republikës të propozojke këtu kryesia bijshin dakord… ose u tutshin edhe u bojshe edhe që s’dojshin me të ba, u bojshe kryetar, ose çka po di” (*Hysamedin Azemi*).

Por kështu ndodhi që Azemi u gjend përballë djalit të axhës së tij, i cili i kërkonte publikisht të jepte dorëheqjen, dhe shokëve të udhëheqësisë që i kërkonin të mos e bënte. U ndie i shtypur si në një "sendviç." Edhe Rrahman Morina po përjetonte trysni nga drejtime të kundërta, por në tjetër formë. *Hysamedin Azemi*: “Si tash që e ka Putini me Amerikën anej-knej, edhe Jugosllavia e kanë pasë, qeta ma të mëdhejtë, kryetari i Serbisë me të Kosovës, me këto të Jugosllavisë e kanë pasë telefonin...] *xërrr* {onomatope} Ai telefon, ai po e çon, ja bojke ky zemër gruas…Ky tha, ‘Qe Husko erdhi këtu. Do të jep dorëhekje, e ka thirrë Komitetin.’ ‘Çka bre?’ Po thotë ajo aty. U nijke krejt, se ai me qëllim e lijke me ndi une. U nijke telefoni se ishin qeshtu. Tha ajo, ‘Veç sa e kryva telefonin me shefin’, me Milloshević-in, shefi ishte Milloshević-i, ‘ai më ka thanë me bo çmosti mos me dhanë dorëhekje, qe qitu para vetit e kom Kokin’. Se Koka ne ka pasë djali i tij emrin. Për vajzën

s'po më bjen ndërmend, a Jehonë, a s'di. 'Kokin këtu, une çika i kom helmin të përgaditun, qat' moment që jep ti dorëhekje, kem me… hajde me na gjetë edhe me na varros'. Ajo nuk dike që jam une aty. 'Mo bre, le ti', tha, 'Hysamedinin, Hysamedini është shpiun i Shqipërisë…ti mirë e din që ai grunë e ka të Shqipënisë. Ai është t'u punu me Sigurimin, që janë tu ba hulumtime për to që është shpiun. Mos e ngo ti, shpiun është i Shqipërisë! Mos gabo me dhanë dorëhekje! Ai le të..' U kanë njëfarë gruje serbe ajo, u kanë Buba Morina. 'Me të nanës' tha, 'ço në rrotë të samës Huskën, ti mos jep dorëhekje'."

Megjithatë, vendimet u morën në mbrëmjen e 27 shkurtit, në ditën e tetë të grevës, kur erdhi një letër në zyrën e Stantërgut me dorëheqjet e tre kryesuesëve. *Xhafer Nuli:* "Veç nënshkrimin ia kanë dhonë që po jep dorëheqje. I kanë thonë, 'Jo veç nënshkrimin, por shko, e dojmë me myhyrë'. I thojke, 'Me vule, me myhyrë, shkoni jepini në Komitet, s'paku Komiteti le te vërteton që qita njerëz kanë dhonë dorëheqje'. Ja kanë pru, e kanë vulos edhe e kanë pru dorëheqjen, mirëpo ajo ka qenë krejt mashtrim. Kurrëfarë dorëheqje mandej nuk u apliku."

Në fillim, të gjithë e besuan dhe çka ndodhi më pas ishte tronditëse. Veton Surroi shkruan se, "Ndërsa minatorët mbuloheshin me premtime, Bashkim Hisari, anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, më thirri urgjentisht dhe në takimin në këmbë, përballë 'Boro e Ramizit', më tha shkurt që posa është informuar se do të shpallet gjendja e jashtëzakonshme. Më shikoi në sy, duke u ndalur për një çast, dhe më luti që të kisha kujdes për veten…U ktheva në redaksi dhe kur u lidha me Zenun Çelajn, radaktorin tim të parë në 'Rlindje', që gjendej përditë te minatorët e 'Trepçës,' me tha që tashme është arritur marrëveshja dhe se minatorët kishin zënë të dilnin nga zgafellja. Unë i thashë se është mashtrim, se do të vendosen masa të jashtëzakonshme. Nga marrja frymë thëllë e tij kuptova se nuk ka çfarë të bëhet më."[153]

Më vonë thuhet se Milošević i kishte organizuar vetë ato dorëheqje për t'i bindur që të dilnin nga miniera minatorët, greva e të cilëve e vendoste në situatë të palakmueshme si brenda vendit, ashtu edhe në opinionin publik ndërkombëtar. Ky version është kundërthënës, bazuar në historinë e treguar nga Hysamedin Azemi, që duket se është konfirmuar nga mënyra se si rrodhën ngjarjet më pas. Megjithatë, organizmat drejtuese të partisë nuk e pranuan dorëheqjen.[154] *Xhafer Peci*: "Hysamedin Azemi nuk u kthy. 'Kom dhonë dorëheqje,' tha, 'edhe mo kurrë s'kthehna. E ka lyp populli, qe ku osht' dorëheqja'. Ata dy [Ali Shukriu dhe Rahman Morina] jonë kthy edhe jonë kthye edhe qashtu edhe tani u bonë ato burgosje."

[128] Abrashi e Kavaja, *Epopeja,* f. 42.

[129] Abrashi e Kavaja, Ibid., f. 47.

[130] Abrashi e Kavaja, *Epopeja*, f. 119-122.

[131] Abrashi e Kavaja, Ibid., f. 21.

[132] Abrashi e Kavaja, Ibid., f. 149.

[133] Përfundimi i mbledhjes, i bazuar në artikujt e publikuar të asaj kohe gjendet te Zekeria Cana, *Apeli 215 i intelektualëve shqiptarë,* Rilindja 2001, f. 23-77. Shih edhe Arben Mehmetin, "Relations Between the Writers' Associations of Kosovo and Serbia in the Second Half of the 1980s," *Contemporary Southeast European Studies,* 69 (2-3) 2021: 355-373.

[134] Cana, *Apeli* 125, f. 77.

[135] Cana, Ibid., f. 45.

[136] Mehmeti, "Relations Between the Writers' Associations," f. 368.

[137] Cana, Ibid., f. 126-127. Thirrja e plotë me nënshkrimet, f. 125-144.

[138] Cana, Ibid., f. 150.

[139] Clark, Ibid., f. 53.

[140] Kraja, *Vite të humbura*, f.181.

[141] Daryl Leeworthy, "The Secret Life of Us: 1984, the Miners' Strike and the Place of Biography in Writing History 'From Below'," *European Review of History—Revue européenne d'histoire* Vol. 19 (5) October 2012: 825–846.

[142] Abrashi e Kavaja, *Epopeja,* f. 114.

[143] The Albanian Kosovar Youth in the Free World, "Memorandum February 27, 1989" in *Kosovo Path to Freedom. The Role of the Albanian Youth in the Free World in the Liberation of Kosovo*, redaktuar nga Sergio Bitici, Vatra, 2012, f. 376-78.

[144] Mbi lidhjen, pak të studiuar, mes ngjarjeve në Kosovë dhe ngritjes së Sllovenisë kundër Jugosllavisë, të shihet Jure Ramšak, "'Kosovo, My Land?' Slovenians, Albanians, and the Limits of Yugoslav Social Cohesion," *Comparative Southeast European Studies* 69 (2-3) 2021: 205-222, f. 214.

[145] Meier, *Yugoslavia,* f. 83-84.

[146] Abrashi e Kavaja, *Epopeja*, f. 105.

[147] P. B. Gordiejew, "Playing with Jews in the Field of Nations: Symbolic Contents in the Former Yugoslavia," *Social Identities*, 12 (3), 2006: 377-400, f. 386; Dragović Soso, *"Saviours of the Nation,"* f. 224.

[148] Meier, *Yugoslavia*, f. 58-65.

[149] Gordiejew, "Playing with Jews," f. 387-390.

[150] Mbi mediat, Abrashi e Kavaja, *Epopeja*, f. 97-98; Musić, *Making and Breaking,* f. 243.

[151] "Kosovo, il dramma degli albanesi", *Il Corriere della Sera,* 3 marzo 1989, f. 4.

[152] "Serbi e albanesi all'ultima sfida", L'Unità, 2 marzo 1989, f. 12; "Ondata di arresti in Kosovo", L'Unità, 3 marzo 1989, f. 11. "Napolitano incontra Stipe Suvar", f. 11.

[153] Veton Surroi, *Viti i qirinjve. Si e filluam rezistencën paqësore,* Prishtinë: Koha, 2024, f. 26.

[154] Meier, *Yugoslavia*, f. 84.

KUNDËRREVOLUCIONARËT

Përfundimi i grevës ishte një çlirim për të gjithë. *Avdi Uka*: "Na menxi s'pritëm kur e pamë atë letër, drejt po të kallxoj menxi s'pritëm për me dalë në sipërfaqe ajo m'u çkepë."

Burhan Kavaja: "Ata ishin mbledh krejt para pusit aty në koridor edhe njo s'livritke edhe po vijnë po më thojnë, 'Drejtor, po të thirrin ty. Pa dal ti i pari, na nuk dalum asnjo.' Nuk ishte çashtje e frigës, po une pata punu krejt ajo që në njifarë mënyre me qenë e përbashkët, qetash mos dalë une si lider aty. Thashë, 'Une kom punë të madhe me kqyrë të gjitha punishtet mos po mbetet ndonji minator në to'. Ku me ditë, u shku me flejt, e ka marrë gjumi, i

ka ra të fikët edhe nuk pranova me dalë i pari."

Gani Osmani: “Shiqo, une, veç më kujtohet kur kena dalë prej greve… se tash aty kur të hin në atë koshin, kafazin e njerëzve, kur hin i mrami atje, te dera, ko delë i pari. Une e di që jom hi ma i mrami, kur jom dalë aty po të garantoj nja njiqind a dyqind kamera ishin konë te pusorja, janë konë…Ju ka interesu shumë opinionit se u konë, u bo e madhe. Veç e di që, si jom dalë i pari, m’i kanë mshel sytë."

Xhafer Nuli: “Ka pasë ardhë një mjek i Kroacisë, një Sllobodan Llang. Ai ka qenë përkrahës edhe ka ardhë prej Kroacisë…Bile, ai e ka pasë dhonë idenë që me dalë natën në dy ora, me 28 shkurt në dy ora të natës kanë dalë minatorët, u kry dalja. Që mos me dalë prej territ menjëherë në dritë se mundet me ardhë edhe deri te verbimi i syve, por ja u qitshin nga një fashë syve edhe ishte drita nejse jo qaq e madhe, natë ishte ende."

Nexhmi Zeqiri: “Vallai me të thanë të drejtën dikun shtatë, tetë orë, dhetë orë ka zgjatë dalja. Po kemi qenë të organizum mirë… Gjithë kanë dalë me fasha mbrojtëse, për arsye se tetë ditë e tetë netë ka ndodhë që ais’kapa. Mandej ka qenë ni periudhë që gradualisht shumicën i kanë marrë i kanë burgosë edhe i kanë keqtrajtu edhe nëpër spitale.” *Xhafer Nuli*: “Mirëpo, ato ambullantat, ajo provizorja mbetë plot shtretër, plot me njerëz, por menjëherë fillun hynë policia, hynë agjentët edhe i tarashkatën, i kapën, i qitën."

Derisa kujton minatorët që dilnin nga miniera me fasha, Zeqir Fejzullahu, edhe pas shumë vitesh, nuk mund t’i mbajë lotët dhe nuk është i vetmi që e përjeton kështu. Të gjitha kujtimet e atij momenti janë shumë emocionuese.

Ramadan Gjeloshi: “Kur jom dalë une tri ditë s’kom pa hiç, hiç s’kom mujtë me pa. Na qitën do ujë e sene…Kurrë s’e harroj ‘Kosovatransit’ shoferat edhe kondukterat që na kanë ardhë s’kishim duhan, dy paketa duhan na i kanë pru, tonë kena kajtë, s’e kena menu a din?”

Në të njëjtën ditë, në Beograd, Presidenca e Jugosllavisë u mblodh me urgjencë, me kërkesë të Miloševićit. Përfaqësuesit sllovenë nuk shkuan, por megjithatë, në mënyrë të njëanshme, u miratuan "masat speciale" për Kosovën, një eufemizëm për gjendjen jashtëzakonshme, me mbështetje të plotë të Shtabit të Ushtrisë për partinë e Miloševićit. [155] Të nesërmen, Komiteti Qendror i Lidhjes Komuniste Jugosllavisë e miratoi këtë vendim me vetëm një votë më shumë pas një diskutimi të gjatë dhe të tensionuar me sllovenët, ndërkohë që një turmë e mbledhur jashtë parlamentit bëhej gjithnjë e më e paduruar ndaj asaj që supozonin se ishte ngurrim i udhëheqësve. Populli serb kërkonte më shumë shtypje në Kosovë, deri në ekzekutimin e Azem Vllasit si kreu i komplotit për shkatërrimin e Jugosllavisë. Dizdarević doli nga takimi për t'iu drejtuar protestuesve në emër të Presidencës, duke legjitimuar demonstratën si një lëvizje për Jugoslavinë, por ndaj tij pati fërshëllima. Thirrja e tij për vëllazërim u prit me brohoritjet, "Kjo është Serbi!"[156] Vetëm Milošević arriti t’i qetësonte shpërthimet e zemërimit me premtimin për një dënim të ashpër: "Brenda 48 orëve, do të arrestojmë organizatorët e ngjarjeve të nëntorit 1988 dhe të shkurtit 1989."

Në Kosovë, ndërkohë, teknikët dhe menaxherët u kthyen në Trepçë. “Nesrit më erdhën, inspekcioni ma prunën vendimin, e mbyllën minierën. Masnesrit

dul Millosheviqi në Beograd tha,'*Hapsićemo sve*, Azem Vlasija, Aziz Abrašija, Burhan Kavaju. [Do t'i burgosim të gjithë, Azem Vllasin, Aziz Abrashin, Burhan Kavajën] e të tjerë edhe erdhën na murrën… Vendimi për mbylljen e minierës e pruni Millosh Janiqi, Millosh Janiqi kishte punu te une si inspektor edhe atij i vike keq…se ishte punëtor i imi, me mu kish punu… Edhe e mora e nënshkruva vendimin që u mbyll miniera edhe ata menjiherë e qitën policinë e rrethun minierën edhe mo nuk lejun aty me hi kërkend" (*Burhan Kavaja*).

Kryesuesit e "komplotit"

Burhan Kavaja ishte vetëm në shtëpi atë mbrëmje, pasi bashkëshortja e tij kishte shkuar për kurim në Banjën e Pejës. Ai kishte refuzuar ftesën për darkë nga Aziz Abrashi sepse donte të pushonte. Të dy e kishin parë në televizor fjalimin e Miloševićit.

Burhan Kavaja: "U kthym na qat' ditë që e mur vendimin se mbyllet Trepça, me gjithë Azizin në shpi. Edhe Azizi po më thotë, 'Burhan, veshi çerapat e trasha' (qesh).… Qashtu që natën më kanë marrë rreth orës dhetë pa lonë mundësi m'u vesh qysh duhet… E hapa derën. Menjiherë më urdhnun që mos me lëvizë, me marrë veç diçka shumë të vogël për me vesh. 'E kena nji bisedë me ty', edhe qishtu ka qenë ajo burgosja ime. Më kanë dërgu në Sekretariat të Punëve të Brendshme të Prishtinës, pi atyhit për Mitrovicë, gjithë natën më kanë majt çutë. Nesrit gjithë ditën më kanë majt çutë. Kuptohet nuk pytshin veç që s'më lojshin me flejt edhe qaty rrishin…. Në mramje, 'Në emën të popullit je i burgosun'… Po u mbledhshin gjashtë, shtatë policë edhe përnjiherë të gjithë po bërtitshin 'Je i burgosun!' Krejt, edhe po të rrethojnë edhe po t'i vnojnë."

Aziz Abrashi kishte temperaturë dhe dhimbje fyti, ishte shtrirë në shtrat. E shoqja, Bahtija, e hapi derën natën, kur trokiti policia. "Erdhi policia, tre policë në derë, të mdhej, të armatosur. Normal në gjuhën serbe… 'A është drejtori gjeneral ktu? E kena urdhërin me e thirrë në bisedë informative'… Thashë, 'M'falni, ai është smutë, kur t'i kalon vjen vet.' U konsultun me dikë me toki-voka. Ata thanë, 'Jo, merrne'. Hyna n'dhomë e çova prej gjumit, s'ka qenë lehtë, edhe ia dhashë. I ka pasë ni parë bregë t'leshta i veshi, ni pullover të leshtë, si me armatosë. Shkoi në… e morën. Prit që po e kthejnë, se kthehet thanë. Na mashtrun. Prit që po e kthejnë, prit që po e kthejnë" (*Bahtije Abrashi*).

Avdi Uka e mori lajmin e arrestimit në spital, ku ishte shtruar pasi kishte dalë shumë i molisur nga greva. "Mu më kanë marrë qysh thashë me 7 mars, se me 6 mars më ka lëshu spitali me 7-tin mars um kanë marrë. Ni natë kom nejt në shpi prej 16 dite. Tetë në spital, tetë në grevë, 16 ditë, ni natë jom shku në shpi më kanë marrë me 7 mars në sabah…Edhe erdhën në shpi më murrën më çunë në Mitrovicë, në SUP i thojshin atë here prej orës 11:00 ditës tek deri 11:00 natës um kanë majt në zyre t'u më vet…u konë inspektor shiptar …ai um ka marrë në pytje... Tha, 'Ukë, aktakuzën e keni shumë të rondë, ruje veten, ruje shoqninë'. Për mue u konë pasuni e madhe 'Ruje veten, ruje shoqninë' domethonë që na… u ardhë në 11:00 natës i biri i Sherës, komandantit të burgut që u konë, ai ka punu inspektor Nexhmedin Ajeti, a s'di qysh u thirrke. E ka pru ni letër të sarit, tha, 'Ukë, duhet me hi në

burg'. Thashë, 'Në burg jom, s'ka problem'. Jonë ardhë policia më kanë lidhë më kanë çu në dhomë" (*Avdi Uka*).

Sefedin Istrefi i shpëtoi arrestimit duke ikur. Pas qëndrimit disa-ditor në spital, për dallim nga Avdi Uka, i cili ishte kthyer në shtëpi ku edhe e kishin arrestuar, Sefedini u fsheh te kushërinjtët. Ndërsa rrinte i fshehur në disa familje, i thanë se policia kishte shkuar të paktën pesë herë ta kërkonte në banesën e tij. "Edhe e kisha alltinë, kurrë s'e… ton' kohën e kom pasë alltinë. … dhe mo jom shkue pos ni herë, jom shkue diku nimdhet' e diçka mos gabofsha, t'natës kur jom përshëndetë me familje.… Edhe u metë nona… edhe mo nonën s'e kom zatetë mo. Ajo ka vdekë edhe n'luftë kështu, edhe mo kurr' s'm'hjekët pej syve, m'rrin kështu para sysh… Unë pej vitin tedhet e non' n'mars, mas demonstratës gjenerale une kom qenë jashtë" (Sefedin Istrefi).

Azem Vllasi u largua nga Kosova menjëherë pas përfundimit të grevës. Duke ia marrë mendja se çka po përgatitej, i kishte dërguar fëmijët te vjehërrit në Bijeljina të Bosnjës. Në radio, gjatë udhëtimit me veturë, i dëgjoi kërcënimet e Miloševićit. "Të nesërmit deshta m'u kthy në Prishtinë. Ndodh çka të ndodh duhet m'u ballafaqu me situatën, s'ki ka ikë prej vetës edhe prej vendit tonë. As s'kisha arsye me ikë dika, s'kisha bo kurrëfarë vepre penale… Në mramje vonë vijnë trokisin te dera e familjes të Nadirës policia e Bosnës… 'Kanë thonë me ju sjell në Prishtinë'. Thashë, 'Po, unë me kerr temin jom edhe ashtu t'u shku nesër në Prishtinë'. 'Jo, na kanë thonë me neve duhesh me shku'… Unë me kerr te policisë të Bosnës në drejtim të Prishtinës" (*Azem Vllasi*).

Urdhërarresti iu kumtua më 3 mars: "Prokuria Publike e Qarkut të Mitrovicës së Titos ….i paraqiti kësaj Gjykate kërkesën për hapjen e hetimeve kundër Aziz Abrashit, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer vëper penale kundërrevolucionare të cenimit të rregullit shoqëror nga neni 114 i Ligjit Penal të Jugosllavisë, e dënueshme sipas nenit 139., al 1 e LPJ… për të cilën, me ligj, është paraparë dënimi më i lartë – me vdekje, dënim ky për të cilin është i obligueshem paraburgimi."[157] Akuza ishte shumë e rëndë. Në një episod të kaluar që tashmë kishte mbetur në histori, por që e jep më mirë kuptimin e situatës, përfaqësuesi maqedonas në Presidencë, Lazar Mojsov, kishte folur para dy dhomave të Parlamentit, të mbledhura më 2 mars, duke deklaruar se dispononte një dokument që nga 25 shkurti, i cili përfshinte Azem Vllasin me udhëheqës të tjerë shqiptarë dhe madje edhe shërbimet e armikut Shqipëri, në një komplot në tri faza, nga greva deri te kryengritja e armatosur.[158] Më vonë u zbulua se dokumenti ishte, në stilin tipik stalinist, një fabrikim i Mojsovit.

Por akuza u mor seriozisht në konsideratë. Udhëheqësia jugosllave kërkon dëshmi për komplotin e supozuar për të përmbysur Serbinë dhe Jugosllavinë dhe po kërkon emrat e komplotistëve. Kush e organizoi marshimin e nëntorit? Kush e organizoi grevën e shkurtit? Të gjithë e dhanë përgjigjen e njëjtë. Nuk ka pasur asnjë komplot, ne kundër-shtuam ndryshimet në Kushtetutë dhe protestat ishin spontane, nuk kishte asnjë organizator të vetëm. Më vonë, Kavaja shkroi një ese 78-faqesh për mbrojtjen e tij, të cilën më pas e kaloi në aktet e procesit, ku kundërshtonte përkufizimin si "kundërrevolucionarë." Argumentimi ishte: nëse ne jemi kundër, për cilin revolucion po flasim? Për aneksimin e dhunshëm të Kosovës nga Serbia në vitin 1912-1913? Për refuzimin e njohjes së vetëvendosjes së shqiptarëve në Jugosllavinë, që do të

vinte në vitin 1943? Për aneksimin e dhunshëm të Kosovës nga Serbia në vitin 1945? Për përpjekjen për të përmbysur Kushtetutën e vitit 1974? Dhe për cilin dëbim të serbëve po flasim? Shumë prej tyre po e braktisnin Kosovën, madje edhe vetë shqiptarët. Për ta vërtetuar këtë pikë të fundit, Kavaja kujtoi se në aksidentin e rëndë të 17 nëntorit 1989 në minierën e "Aleksinački Rudnik" në Serbi, një aksident i shkaktuar nga neglizhenca, në mesin e 90 viktimave 14 ishin shqiptarë.[159]

Ibush Jonuzi: "Më nxjerri niherë p'i qelisë edhe te gjykatësi hetues ishin ardhë krejt advokatë aty, jo krejt nashta ja teprova, po plotë salla…Edhe gjykatësi hetues ka qenë ni Avdi Dinaj, që i mirë u konë, edhe atëherë i mirë edhe sot osht' i mirë ai, po koha u konë qashtu. Ja nisi me më pyet, 'Ibush knej-anej'. Thashë, 'Une çka e kom pasë e kom thonë, une mo s'kom çka me shtu kurgjo, bash s'kom kurgjo çka me shtue'. U çue i ndjeri Bajram Kelmendi tha, 'Të lumtë Ibush! Çka p'e maltretoni njerin? E ka dhonë deklaratën e vet. Ju hala p'e maltretoni'. Aty të kanë maltretue."

Anita Susuri: "Dhunë fizike ndaj juve s'kanë përdorë a po?"

Ibush Jonuzi: "Në burg, ja-a."

Anita Susuri: "Veç psiqike?"

Ibush Jonuzi: "Veç psiqike."

Akuza e parë dhe urdhri i arrestit ishin nënshkruar nga Spasoje Zamfirović, prokurori i gjykatës së Mitrovicës së Titos, siç quhej atëherë qyteti, dhe nga gjykatësi hetues, Avdi Dinaj. Për grevën, Dinaj dinte vetëm aq sa kishte parë në televizion. Nuk do ta kishte imagjinuar kurrë që do t'i binte të merrej me një çështje kaq të rëndë.

Avdi Dinaj: "E di si sot… Pas përfundimit të orarit të punës kom shku në banesë. Diku në orë të mbramjës ish kryetari i Gjykatës të Qarkut n'atë kohë Kapllan Baruti e kishte dërgu vozitësin e tij me m'marrë me kerr…Kapllani ka qenë një njeri i jashtëzakonshëm, një njeri jashtëzak-onisht i mirë. Më çoi në zyre. Tha, 'T'kom thirrë me marrë rastin e Vllasit…Tu kisha lutë me i marrë hetimet me i kry'. Thashë, 'Kapllan, për çmimin me u shkarku, nuk e marr. Dej sot s'kom pasë raste politike, as sot s'po du me i marrë.' 'Nëse nuk i merr ti, duhet me ja dhonë dikujt që s'munën me pasë qasje mo n'landë.' Bile une e di se i kom thanë, 'Jepja kujt dush e bo çka t'dush me të. Unë, jo'. Për me ma ndryshu menjën e ka thirrë Tadej Rodiqin. Në bisedë me Tadej Rodiqin po më thotë, 'Nuk osht' e rastit pse kem bisedu me t'marrë ty si gjyqtar hetues... O Avdi, në rastin e Marie Shllakut, vllau jem ka qenë i burgosun me Marie Shllakun, kur u lëshu prej burgu krejt tre mujë ka jetu se e kanë shkatërru. Nëse na nuk e koçisim çashtjën qesaj rradhe'… Kom pranu me i zbatu hetimet…Kom fillu hetimet, jonë marrë n'pytje herën e parë Azem Vllasi, Aziz Abrashi edhe Burhan Kavaja. Pastaj ka fillu zgjerimi i hetimeve."

Me një vendim të paprecedent, gjykatësi Kapllan Baruti u zëvendësua menjëherë nga Ismet Emra. Si kryesues të komplotit u identifikuan 14 individë: Azem Vllasi, Aziz Abrashi, Burhan Kavaja, Lazër Krasniqi, Ibush Jonizi, Mensur Fejza, Rizah Musliu, Ismail Nimani, Mursel Haziri, Sinan Kurteshi, Ramiz Kadriu, Veli Osmani, Avdi Uka, Jetish Bajrami dhe Tahir Salihu. Kjo nuk do të thotë se të tjerët që morën pjesë në grevë arritën të

shpëtonin.

155 Ky paragraf bazohet në Meier, Yugoslavia, f. 84-87; Louis Sell, *Slobodan Milosevic and the Destruction of Yugoslavia*, Duke University Press, 2003, f. 85; dhe Sonja Biserko, *Yugoslavia Implosion. The Fatal Attraction of Serbian Nationalism,* The Norwegian Helsinki Committee, 2012, f. 146.

156 Dizdarević, *La morte di Tito,* f. 445.

157 Abrashi e Kavaja, *Epopeja*, f. 129.

158 Meier, *Yugoslavia,* f. 87.

159 Abrashi e Kavaja, Ibid., f. 144.

Të gjithë brenda

Gani Osmani: "Çdonjoni u konë i dënum, 60 ditë i ka pasë të preme edhe i arrestum…Ja u du me shku në kambë se policia u konë në punkt qitu në tunel të parë ose atje te vorret që janë në hymje të qytetit. Do vena janë konë kyç edhe veç ju ka hi autobusit me regjistër. Ta ka pa emrin s'të ka vetë veç të ka kap, se je konë ti i dënum."

Anita Susuri: "Secili grevist i ka pasë 60 ditë?"

Gani Osmani: "Çdo grevist i ka pasë. Unë e di shokët tonë mas katër vjete, pesë vjete e ka la burgun. Edhe une nuk ju kom ra në dorë, une s'jom hi në burg. Po tregoj kur ka ndodhë, jom ardhë me kerr, ose me naj diçka deri në *rekë* [srb: lum], jom zhdryp përmas banesav, jom dalë ko te tunelli jom hyp, që mos, mos me ra në dorë tyne se s'të ka vet. Domethonë, çdo grevist u konë i dënum 60 ditë, të preme i ka pas. Tajshi, ata i kanë marrë në pytje, nashta u shku për 60, ka nejt dy-tri vjet."

*Xhafer Pec*i: "Filloi tani aksioni kundër minatorëve, u burgos ai, u burgosën punëtorët. E tash u konë interesant, u konë nifarë Elheme Kelmendi gjykatëse, u konë edhe knej serbët. Kush u shku te Elhemja i ka pasë nji muj ditë burg, kush u shku te këta dy-tre-katër. Ajo tona ligjet i ka shkel veç me ju ndihmu punëtorëve."

Xhafer Nulin e morën në pyetje, por nuk e arrestuan. "Gjatë asaj periudhe prej që i murrën këta në burg, tonë kohën e bajsha një bund të Trepçës se thojshe me më marrë bile pak a shumë mos me u konë o se çka po din ti në burg e sene. M'kish pasë diktue një drejtor teknik u konë njëfarë Nexhati, m'kish pasë diktue, 'Çka p'e banë qito?' Thashë, 'Vallahi po don me të kallxu drejtë?... Ma merr menja veç po pres kur ma ngjesin mas qafe edhe me shku

bile nxet me konë. Edhe kur të m'rrehin ndoshta s'ma deshin qito m'bijnë pak ma lehtë qato sene'" (*Xhafer Nuli*).

Isuf Beqiri i përfundoi 60 ditë në një kazermë.

Isuf Beqiri: "'Pse, kush e, tek e?" Çdo sabah u dufke m'u bo rresht aty.' … Na jena konë ni farë barake, ata që jonë konë në burgje të rona jonë konë anena, na jena konë në ni farë barake të keqe, ni farë barake, na nuk jena konë anena… Si jom shku në Mitrovicë më kanë zonë... Veç e kqyrke aty në autobus Isuf Beqiri e vetke ato me radiolidhje, 'Bjere!' Drejt e në burg."

Anita Susuri: "E çka menove?"

Isuf Beqiri: "Kurgjo vallai, jo s'u tuta, jo s'u tuta."

Avdi Uka: "Rreh, prej gisht të komës dej knej në butë të kresë ty beakavenqë s'ëm kanë ra. Që bone hesap me vjerr sa të se trave unxhun në zyre kur më ka pritë në butë të kresë, kur ndryshon moti absollut s'i ngoj meterollogët, se unë e di këtu {prekë kokën} çka po bohet me mot, origjinal. Kur u shku me dhonë mbrojtjen absollut ramjet, që më kanë rrehë komve {prekë këmbët} përfundri e kresë e knej-anej, nuk u çu peshë. Më ka ardhë shumë ronë, që thashë në fillim kurma kanë shanonëne dhe grunë, ike bo dhetë irredentista, nacionalista, separatista, ç'ata di unë këto fjalë tyne jonë. Kur u shku me dhonë mbrojtjen… po shkoj në pika të shkurta, e dinë krejt ç'a janë konë aty edhe familja e tyne edhe e jemja, une i kom thonë Ismet Emrës, kryetarit të gjyqit. 'A je i gatshëm me dhonë mbrojtjen?' 'Une jom i gatshëm nëse më jep garancë që nuk ma rreh kryet edhe nuk ma shanë nonën edhe gruen'…."

Anita Susuri: "E këto biseda informative kur ju kanë marrë, çka ju kanë vet, çka… a ke folë ti diçka?"

Avdi Uka: "'Me ko ke nejt? Ku keni nejt? Me ko njeni marrë vesh? Ku i keni majtë tubimet?' Bone hesap që më kanë rreh bajagi, 'Keni majt mledhje me AzemVllasin, e me Aziz Abrashin. Azizi Abrashin e kije baxhanak'. Ai grunë prej Bajgore, i kom thonë, 'Une prej juve po ni që ai e ka grunë e Bajgorës', në Batinë nuk kom ditë. Thashë, 'Ç'a di une ka e ka drejtori gjeneral gruen', 'Jo, kusherina janë me gruen tonde, i keni majtë mledhjet dikun, për me u përgaditë bajagi për grevë'."

Por trajtimi më i keq u rezervua për minatorët. Udhëheqësia jugosllave synon që të dëshmojë se minatorët ishin të manipuluar për të mbështetur drejtuesit nacionalistë, që sipas tyre, kishin organizuar një komplot kundër shtetit jugosllav. *Isuf Peci*: "Burgu ka qenë 30 ditë, zëvendësi i Sherës [Sherafedin Ajeti, drejtor i burgut] ka qenë Paviqeviqi i Zubin Potokut… Më rrehi fortë, qaq fort më rrehi që më shtrejti në pod edhe ma qiti atë kopaçkën, atë far çizmen këtu {anon kokën, prek faqen}. Tha, 'Ku e ki Burhanin edhe Azizin? Kqyre, ata janë bo milionera, po manipulojnë me ju'."

Drejtësia e regjimit

Lëndimet fizike u rezervuan posaçërisht për drejtuesit, për ata që dyshoheshin më shumë për tradhti. “Na në qelia izolimi total… Por asnjo s’e kanë lonë dy veta në një qeli, kinse mos m’u konsultu diqysh qysh me u mbrojtë e asi” (*Azem Vllasi*).

Burhan Kavaja: “S’kanë lonë gjo pa kontrollu edhe neve në burg, në vetmi dy muj e diçka, në vetmi. Për burg muj me ju tregu nja dy gjana që janë pak interesante. Gjëja e parë, po vijnë dy gardianë edhe po më thojnë, ‘Veç ti munesh Burhan me na pshtu, mos m’u korit dej në fund se mas ndrrimit tim vijnë ndërrimi me sërbë edhe Azem Vllasi osht’ tuj qajt qe dymdhetë orë’… Edhe nime qashtu u konë. Më çunë në vetmi të Azem Vllasit, ia fillova me Azem Vllasin me bisedu. Ai kish pasë emocione shumë se e kish pasë datëlindjene djalit edhe ish konë në asi gjendje që s’kish mujt veten me e nalë. Kur i tregova që… edhe me insistimin e gardianëve edhe që krejt populli jashtë i ka sytë në ne e ne me u tregu kaq të ultë si Ibushit {tregon mbrapa} ashtu qysh i thashë, atëhere arrita me e qetësu. U qetësu. Më premtoi se ka me qenë i qetë edhe në njifarë mënyre u kry qajo punë. Njejtën gja e kena pasë me Ukën, Avdi Ukën, kurse me Azizin ka qenë pakëz situata ma ndryshe. Ka qenë me shëndet i ligë, simbas asaj qysh e tha në burg afër nji mijë hapa që i ka pi, për atë kohë krejt."

Bahtije Abrashi: “Edhe [Aziz] kishte ba grevë urie. Katër-pesë ditë s’ka hangër, ma tani s’ka dashtë me jetu. Ka qenë n’qeli vetëm. Kish pasë frikë se mos e kanë marrë Lindën n’burg, se kjo ka punu n’televizion, ka udhëheq emisionet e rinisë. E ka pasë edhe ni emision mja politik t’cilin e kanë transmetu edhe krejt televizionet e republik-ave... Edhe është frigu mos e kanë marrë edhe këtë n’burg. O frigu edhe për mu. Edhe po m’thirrë ky kryetari i gjygjit, Asllan Baruti, po m’thirrë n’telefon se na vendas. Po m’thotë, ‘Të lutem eja se e kam ni bisedë me ty edhe mos i trego dikujt tjetër që t’kom thirrë’… edhe ai e ka pasë shok, po është dashtë."

Pasi mori informata për gjendjen e bashkëshortit të saj, Bahtije Abrashi nxitoi në drejtim të burgut, ku arriti ta shihte. Ata nuk komunikuan me zë sepse e dinin shumë mirë që dhoma e vizitave ishte nën mbikëqyrje, një mikrofon ishte madje i dukshëm nën tavolinë, por duke shkruar mesazhe në një copë letre. Ajo e bindi të hante. “‘Për hir të minatorëve, për hir të popullit, për hir të fmive edhe mu si bashkëshorte. Pse me vdekë me hipotekë? ‘Mos i merr n’qaf edhe minatorët’. Kur i kam thanë, ‘Mos i merr n’qaf edhe minatorët’, po m’duket në atë moment e ka ndrru mendjen. Ka thanë, ‘Po, du me hangër’…Edhe drejtorit tash, ndoshta edhe kjo është interesant. Po i them, ‘Sherafedin’, e Shero e thirrshin se vendas, ‘shko bleja dy byrekë edhe dy jogurta le t’han njeri bukë’” (*Bahtije Abrashi*).

Adem Vokshi ishte avokati mbrojtës, jo vetëm i Jonuzit, por edhe i Vali Osmanit e Ramiz Kadriut, i cili nuk ishte minator, por punonte në administrimin e ndërmarrjes. “M’kujtohet Ibush Jonuzin disa here e kom vizitu në burg edhe ai qante, qante. ‘Kurgjo s’kom bo,’ thojke, ‘Qysh?’ I kishte nantë fmi, sa i kishte? Nihere, nihere, nihere. Dikur i thashë, ‘Ibush bre, me bo nesër me dalë prej burgut ti edhe me shkatërru vetën, çka i vyn asaj familje? A s’ke bo kurgjo?... Cili ka bo diçka? Përveç teje osht’ Burhan Kavaja n’burg, osht’ edhe Aziz Abrashi, osht’ edhe Azem Vllasi qi ka vro e ka kfillë, edhe ai osht’ n’burg. Nesër do t’vërtetohet që s’keni bo kurgjo edhe ti i vyn

qasaj familje. Kta qëllimin e kanë', mendojsha për pushtetin, 'me ju shkatërru juve sepse jeni njerëz intelektualë edhe qata'. … Edhe e kena prezentu autorizimin n'gjykatë edhe kena tentu me argumentu se ata njerëz nuk kanë faj. Sistemi i tillë ka qenë atëhere, sistemi akuzativ. Por jo obligimi i akuzës me vërtetu se ti ki faj, po obligimi i t'akuzumit me vërtetu pafajësinë… Krejt katër-pesë minatorë i kanë marrë, demek po gjykohen minatort e në të vërtetë ishin kta. Çka kishte vllazërit Krasniqi me u akuzu me grupin e Azem Vllasit? Ai ishte drejtor i KEK-ut ktu në Prishtinë, e tjerë, e tjerë. Qikjo ishte ajo. Ka folë me minatorët, çka ka bo tjetër? Ka folë edhe Stipe Šuvari prej Kryesisë të Jugosllavisë ka folë me minator edhe ato s'e shtijnë n'burg e tjerë, e tjerë. Kurgjo s'kishte n'atë landë. Mirëpo, atëherë gjyqtarë hetues ishte Avdi Dinaj, tash është avokat në Mitrovicë, me to në gjeneratë kena qenë edhe n'studime, e ai ia besoi zhvillimin e hetimeve Rexhep Kaçanikut. Rexhep Kaçaniku ka qenë gjykatës hetues në Mitrovicë, atë që e përmenda pare. Po, ndërkohë e lëshoi gjyqin edhe shkoi me punu në Sigurimin Shtetnor. Edhe atij ia besun tash hetimet edhe ai na thirrke, edhe të akuzumit edhe neve avokatëve kur i merrke n'pyetje të akuzumit, kur i merrke n'pytje… po as dëshmitar s'kishte a. S'kishte kurgjo se s'kishe ku me ia ngjitë. Ata ishin organizu në mënyrë spontane. Nuk kishte ndonjë udhëheqës i cili, barëm barëm në gjykim nuk është vërtetu, ndonji udhëheqës që i ka organizu ato. Sepse gjithmonë pretendohej se Burhan Kavaja, Aziz Abrashi, Azem Vllasi kur kanë qenë n'vizitë i kanë organizu për me i bo qato. Po ishte veç ni shprehje spontane e paknaqësisë. Edhe, a din si osht', ai tetë orë po rrin n'zgafellë atje, s'po e sheh dillin, tetë orë flen edhe veç tetë orë n'dite munën me pa dillin edhe i vjen deri ktu {shpjegon me duar} edhe ma n'moment nuk pajtohet me krejt ato. Si thashë, paret që po fitohen aty ku po shkojnë ato?" (*Adem Vokshi*).

Avokatët e mbrojtjes nuk kishin jetë të thjeshtë. "M'kujtohet niherë Avni Gjakova kur pat' ardhë edhe para se me fillu gjykimi kërkon prej kryetarit t'trupit tretman ma ndryshe ndaj avokatëve. 'Nëse nuk do t'kemi tretman', se na kontrollojshin shumë kijamet, kijamet, a din, 'Nëse nuk do t'kemi tretman, atëherë kur do t'vijmë herën tjetër do t'vijmë lakuriq'. S'ka nevojë me na kontrollu qashtu', a din. Qisi kontrolla kanë qenë shumë t'ashpra. Por, gardianët kur kanë qenë shqiptarë ka pasë ma t'butë, a din. Por, ka pasë gardianë serbë aty që janë sillë bajagi ashpër me t'akuzumit, me neve avokatë nuk kanë pasë konflikte t'tilla. Po atmosfera ka qenë që kur shkojshe me i vizitu t'malltretojshin ty, prit gjysë ore, ni orë, ni orë e gjysë, dy. Me ta hupë kohën, a din, për sa ma rrallë na me lakmu me shku me i vizitu klientat me bisedu me ta. Kjo ka qenë. Edhe ka qenë situata bile për mu shumë e randë sepse me 16 shkurt '90-ës, hala vazhdonte gjykimi i Azem Vllasit, mu ma ka vra policia babën në Pejë, në derë t'shpisë atje edhe u ka pasë ndërpre gjykimi për dy-tri ditë. Mandej ka vazhdu gjykimi, po unë nuk kom ardhë, tek mas nja dhetë dite kom ardhë në gjykim. Ka qenë, nuk e di as sot qysh e kom përballu krejt, krejt atë gjendje, me të vërtetë shumë të randë" (*Adem Vokshi*).

Babai i Adem Vokshit e kishte një dyqan pranë urës së Kapeshnicës, në Pejë, ku një grup djemsh mblidheshin shpesh dhe e gjuanin me gurë policinë. Vokshi i moshuar ua kishte tërhequr vërejtjen që ta ndalnin këtë lojë të rrezikshme, por pa sukses. Policia kishte vendosur një pikë vëzhgimi në shtëpinë e një dentisti serb që jetonte në fund të rrugës, një shtëpi nga e cila mund të shihej shtëpia e Vokshit dhe madje edhe kush ndodhej brenda, përmes derës prej xhami. "Në fund të rrugës atje ka qenë ni shtëpi, tash është rrxu ajo shtëpia është rrënu e ni dentistit serb ka qenë ajo...Por fqinjin e parë

e kena pasë ni sërbe shumë të poshtër, nifarë Zarka ka qenë. Edhe normalisht ajo ka tregu kah po ikin edhe kta policët i kanë punu. Edhe kur kanë dalë atje policia nja 200 vet kanë qenë n'aksion. M'ka tregu prokurori Bujar Juniku që ka qenë i ndjeri prokuror i qarkut edhe njëri me pushkë, me siguri me snajper, e ka gjujtë babën edhe e ka mbytë. Kjo është ajo. … Ka qenë e premte edhe ka qenë, po m'duket Veli Osmani ka dhanë deklaratën atë ditë nëse s'gaboj. Ka qenë deklaratë shumë prekëse. Ka qenë saqë u ndërpre gjykimi edhe prej trupit gjykues u pa që nuk ka ma efekt me mbajtë gjykimin, sepse filloi, filloi nifarë vullneti, nifarë lëvizje te njerëzit edhe lëvizje pozitive n'atë kuptimin edhe u ndërpre gjykim. S'ka ma gjykim, e vazhdojmë t'hanën. Edhe une erdha te shpija. Kur po bon telefoni po lajmërona une, nana po m'lajmëron, tha, 'Adem, abejen', babën, "e kanë plagosë në qafë, e kena çu n'spital. A priton me ardhë?' 'Jo'... Kur kom shku në Pejë, e kom çu nusen me bineq atje n'shpi te nana e baba vet atje…Kena shku n'spital edhe atje m'kanë lajmëru që baba ka vdekë" (*Adem Vokshi*).

Vokshi kujton se Azem Vllasi e ngushëlloi publikisht gjatë procesit. "Edhe u ndërpre gjykimi shkum në seancën e radhës, kur filloi seanca une kërkova fjalën prej kryetarit trupit gjykues, Ismet Emra ka qenë atëherë... E çova dorën tha, 'Urno, Ibush', unë drejt në foltore. Se s'dashta prej venit edhe p'i thom, thashë, 'Dola me i shprehë ngushëllime avokatit të nderum Adem Vokshit për vrarjen, për vrasjen mizore të babës tina në prag të shtëpisë edhe faleminderit'. U ktheva në vend…Edhe kjo nuk u konë bash e lehtë me dalë para krejt atyne, domethonë ja kishin vra shkijet une dalsha m'i shpreh ngushëllime në foltore" (*Ibush Jonuzi*).

Nga periudha e burgut, Burhan Kavaja kujton momente komike apo, si thotë ai, "nji tragjikomedi". "Gjatë grevave, ka këtu tetë ditë e tetë netë me fol për të gjitha veprimtaritë që janë bo në atë kohë. Por esenca e gjithë asaj ka qenë që publikisht me dalë edhe m'u pendu për këtë punë, esenca. Ato e kërkojke Millosheviqi prej këtyne, mirëpo kërkush nji gjo të tillë nuk guxojke me bo. Derisa në burg Ibush Januzitit i kom thonë, 'Maje qafën nalt edhe mos m'u mrrol kështu ose mos m'u gërbav.' 'O drejtor', thojke, 's'po ma manë qafa' … Nji ditë na çunë të lidhun në gjykatë… Azemit p'i thom une, 'A i ndigjove lajmet prom?' Tha, 'Po bre, i ndigjova'. Kcej Azizi, po pyt, 'Ku keni ndigju lajme?' Thamë, 'Na e kena ka ni tranzistor, na kanë dhonë'. Azemi tha, 'Po veç diçka s'u nijke bash mirë i jemi, s'e di pse ashtu'. Ky Azizi u kyç meniherë, 'Qysh tranzistor ju? P'i kahit ju tranzistor?' Na hajgare bomë, a ai e kish pasë marrë ato përnime" (*Burhan Kavaja*).

Humori i zi ndihmonte edhe pse, pavarësisht nga përkrahja e jashtëzakonshme dhe solidariteti i popullatës, Kosova ishte nën ligje ushtarake, e shtypur nga policia dhe ushtria. E megjithatë, jo të gjithë gjykatësit ishin të këqij, akuzat ishin shumë të rënda dhe partia kërkonte dënime të ashpra si shembull për të tjerët.

Adem Vokshi: "Gjithmonë klienti pytë qysh ka me kalu edhe nji prej thanjeve t'mija kur bisedon me klientin, nuk i garantoj kurgjo hiç. Edhe aty ku mundesh me qenë i sigurtë njëmijë përqind nuk guxon me i garantu, sepse gjykata është ajo që vendosë. Edhe jo gjykata... E Ibush Jonuzin i kom thanë, 'O Ibush, mos harro se këtë thanjën popullore, dy pa shpirt një pa kokë'. Vijnë dy dëshmitarë edhe thojnë se Adem Vokshi e ka vra njënin, gjindet kufoma. E ka vra krejt dikush tjetër atje. Po s'ka prova tjera edhe Adem Vokshi nuk mundet me argumentu pafajësinë edhe dënohet me vdekje. Për qata dy pa

shpirt janë ata dëshmitartë që dëshmojnë kundër teje rrejshëm edhe ti shkon e ngel pa kokë."

Ibush Jonuzi: "[Vokshi] tha, '122 dëshmitarë kanë dëshmu për ty, edhe dëshmitë janë, muj me t'i pru me i lexue, janë që mos vet'. Që thashë kanë dëshmu që aty kërkush s'ka mujt me hy në minierë pa thonë Ibushi… E më kish pasë dëshmue nifarë nifarë sërbi i famshëm që ka qenë shumë i papunëtorë, që, 'Jo organizimin e grevës, po edhe numrin e këpucëve të minatorëve ja u dinë'."

Me fjalë të tjera, ai serbi e kritikonte për afërsinë e tij me punëtorët dhe faktin që të gjithë e njihnin si "kompjuteri i gjallë."

Akuzat u finalizuan dhe u paraqitën më 25 gusht 1989. Gjyqi filloi më 30 tetor 1989, tetë muaj pas arrestimeve.

LUFTA VAZHDON

Beqir Maliqi: "Ditëve tjera drejt me thonë menihere kanë ardhë këtu milicia, e kanë rrethue, atmosferë e zymtë, a, atmosferë krejtësisht tjetër. Prej nji atmosfere kur mendun minatorët që u bo diçka e u arritën kërkesat e tyre për dorëheqje, i pranuen, u kriju nji orë policore, nji gjendje ku shiheshin njerëz të organeve të sigurimit tu u shëtit. Milicia nuk i lejshin m'u bashku njerëzit, i malltretojshin në forma të ndryshme tu i marr në pytje, 'Pse ti kështu, pse knej?'… Kam ardhë në zyre kam nejt aty, po nuk kom qenë i ngarkum me asnji lloj pune, me asnji lloj pune fare. Mas gjashtë mujve tani më patën, më patën heq prej prodhimit krejt më kanë pa çu me ni njësi investim dhe zhvillim, në nji ven shumë ma të ulët atje edhe ni numër si patën thirr hiç në punë."

Gani Osmani: "Kur erdhëm na mas greve, i murën ata në burg, ja fillun me i thirrë në punë me bo përçamje. E di si sot kur jena ardhë {tregon me kokë majtas}, këtu porta mshel. Shembull, Gani Osmani nuk hin në punë, filan fisteku hin në punë. Edhe na kena thonë atëherë edhe në grevë…'Njo për të gjithë, gjithë për njo.' Edhe kena thonë, 'Ja kena me punu të gjithë ja s'kena me punu asnjo' …Edhe qata që na i kanë thirrë nuk, nuk kanë vazhdu me punu, e kanë bojkotu punën. Se nji numër i vogël i kanë thirrë me punu."

Ramadan Gjeloshi ishte në listën e rreth 80 personave të cilët i thirrën sërish, punonjës të kualifikuar, përgjegjës për mirëmbajtjen dhe makineritë. Ai nuk donte të shkonte sepse kështu ishin marrë vesh në takimet që mbaheshin kudo nëpër komunat e vogla ku jetonin minatorët. Por Xhafer Nuli, i cili kishte krijuar një sindikatë të pavarur me të tjerë, i tha se duhej të vazhdonin përpara dhe ai u kthye në vendin e tij të punës si operator i makinerive të ngarkimit. Gjeloshi filloi të bënte sabotazhe të vogla për të ulur prodhimin dhe përsëri Nuli e qortoi. Por situata mbetej e tensionuar.

Anita Susuri: “Ka qenë edhe ni grevë e dytë që osht’ mbajt për juve që jeni konë të burgosun."

Ibush Jonuzi: “Po, po…”

Ibush Jonuzi: “Greva e dytë, na kemi qenë në burg atëhere, mu më kanë nxjerrë prej qelije edhe më kanë çu në Stantërg, sigurimi shtetëror me polici, me polici civile, jo polici me uniformë për me i bind minatorët që me heqë… Nuk kanë qenë në minierë atëherë, ata kur unë jom shku po ka qenë në restoran të minatorëve. Edhe une ju kom thonë shkurt, po ata që thashë t’i kanë lexu letrat në xhep."

Korab Krasniqi: “Çka të kërkun ata me ju thonë ti minatorëve?”

Ibush Jonuzi: “Ata prej mue, prej meje kërkun që, ‘Ti ki autoritet mi minatorët, e ti duhet me ju folë që ata me hjekë dorë, me hjekë dorë, me hi në prodhim, me hi në punë, me hi në minierë me prodhue e jo m’u marrë me grevë’. … Thashë, ‘Po më vjen keq që jeni këtu’. E mira e së mirës është ju me qenë në punë. Puna osht’ për minatorë, miniera e pret minatorin’. Qishtu, qeto fjal. Unë e disha gjuhën që ata… po, po thom sinqerisht edhe ma kanë thonë shumë prej tyne, ‘Na e kena ditë qëllimin tond qysh e ki’ edhe as s’kanë hekë dorë as kurgjo. Edhe jom kthy përmrapa apet në qeli më kanë çu edhe përfundoi qashtu."

Ibush Jonuzi kishte takuar rreth 30 minatorë, të cilët Qazim Shala, drejtori i ri i Trepçës, i kishte zgjedhur mes 300 grevistëve të urisë në mensë, të gjithë anëtarë të klanit të tij. Por grevistët nuk u dorëzuan as pas lutjeve të kryetarit të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës, Nazmi Mustafa, i cili iu lut që të ktheheshin në punë sepse me grevën do të shkatërronin Lidhjen Komuniste dhe Jugosllavinë e Titos. Në orët e para të mëngjesit të 17 marsit erdhi një forcë prej 46 *pinzgauerësh* [autoblinda ushtarake] dhe më shumë se 900 agjentësh, që i dhanë fund me dhunë grevës. Miniera u mbyll, por kur u rihap më 26 mars, rreth 30 minatorë të thirrur për të punuar refuzuan të dilnin. Më i dalluari prej tyre, por edhe më i moshuari, sepse ishte mbi të pesëdhjetat, Muharrem Misini, u tërhoq zvarrë nga një makinë e policisë, por të gjithë, të ngarkuar në autobusë, përfunduan në gjykatë dhe u dënuan me një muaj burg. Një refuzim tjetër për të vazhduar prodhimin ndodhi më 31 korrik, kur 240 minatorë protestuan sepse nuk ishin paguar. Një grevë, në dukje vetëm ekonomike, ishte organizuar nga të njëjtit pjesëmarrës të protestave të mëparshme për të alarmuar opinionin publik për situatën katastrofike në të cilën ndodhej Trepça. Në qershor, puna ishte bërë e detyrueshme dhe kush refuzonte dënohej me 30 deri në 60 ditë burg. Në burg përfunduan 1,240 minatorë. [160]

Do ta hedhim minierën në erë

Xhafer Nuli: “Prej grevës mo për çdo muaj, për çdo muaj ka pasë greva e ka pasë ndalesa t’punës e ka pasë pengesa… Po vlen me përmend edhe grevën e tetorit që ka qenë prej 27 deri me 30 tetor. Aty 62 minatorë jonë nguju në horizontin e tetë edhe këta kanë qenë pa bukë e pa ujë, kanë nejtë për tonë kohën, në kushte shumë të ronda."

Ishte fillimi i gjyqit kundër Vllasit dhe të tjerëve. Gjeloshi tregon se të premten, më 27 tetor, në ndërrimin e parë, rreth orës 13:00, vendosi të hynte në grevë me një grup shokësh. Parulla ishte: “Ja mi liru, ja gjallë nuk dalim. Gjallë nuk dalim.” Këtë herë, drejtoria nuk ishte në anën e grevistëve. Në vend të Abrashit ishte Qazim Shala, i cili u mundua t’i bindte të dilin, fillimisht duke u premtuar imunitet e pastaj duke i kërcënuar, “Unë e di sa vetë jeni, unë e di” tha, “sa punëtorë jeni poshtë me emra, me mbiemra ja u kom gjetë dokumentacionin, jeni të përjashtum prej pune." Miniera ishte rrethuar nga forcat speciale të policisë, por grupi i të pakompromisëve arriti të hynte në minierë duke kaluar bllokadat dhe po vazhdonte përpjekjen e tij donkishoteske për të rezistuar. Ata qëndruan rreth tre ditë. Me pretekstin se miniera po mbushej me ujë, ata kërkuan që ushqimi t’u sillej nga punonjësit që mbanin pompën, por policia bllokoi çdo përpjekje për furnizim. Kur u mbaruan cigaret dhe buka që kishin marrë me vete, u ushqyen me kripën që gjetën në një arkë. Të shteruar, të lodhur dhe pa udhëheqje, ishin në prag të tragjedisë.

Ramadan Gjeloshi: “Se na i kishum tetë tona municion në horizont, e vendosëm me shku me thy magacinën e me qit’ rreth e rreth municionin, e vendosëm, nja katër vetë, jo krejt meniherë, katër vetë. Edhe me bo me na hi, se osht’ ni shakt, domethonë ni li tjetër gjermani që e ka maru ktyne-herë, te Mazhiqi atje nalt osht’ {tregon me gisht majtas}…Na mendojshim që i moçëm shumë, gjermani kur e ka maru ktyneherë. Edhe e morëm lokomotivën, hypëm e shkum atje te magacini, osht’ larg atje me shku, nashta jeni konë në minierë, shkum te magacini e nalum. Kur e nalëm une, Azem Azemi i Kqiqit, Islam Xhafa, Sabri Smajli a s’di kush, Sabri Smajli, edhe tash p’i shohum dy te llokomotiva. U konë ni punëtor i moçëm Muharrem Misini i Prekazit, i kish hypë llokomotivës, na ka hetu që pështpëritëm diçka tinxa, e ai kish qef me ditë. I moçëm edhe ma i pjekun po s’dojshim me angazhu për shkak të moshës, ‘53-sh u konë në atë kohë ai, e kanë mytë në luftë në Prekaz…Erdh me llampë. ‘O djema ça jeni ardhë këtu a bon me ditë?’ ‘Vallahin Muharrem, qishtu kena vendosë po t’ja kajmë nonën po te miniratim po te anena… ma mirë me dekë’. ‘Ja, gabim e keni. Po kqyrim sonte, po hijmë tretën natë.’ Nesrit në mëngjes e katërta u bojke. Edhe tha, ‘T’ja u qes kaj cigare’. S’kishim as cigare, ai i kish mledhë këta filterat që i kanë gju a din, gjysa cigarës, i kish mledhë, i moçëm. I kish mledhë, i kish mush ni xhep, thotë, ‘Të ja u qes ka ni cigare edhe menojmë ça dojna me bo’. ‘O ku ki duhan?’ E nxjerrë aty mi llokomotivë ajo drrasa, e qiti ni gazetë e kish pasë në xhep, e maroj prej aty tonëve ka ni cigare, ka dy tima. Po valla qishtu u konë, qe shoqnia jonë që tregojnë. Edhe i pinëm dy tima tha, ‘A po më ngoni? Lene mos e the drynin’. ‘U bo’, thashë, ‘Po të ngojmë Muharrem’, u kthym. Treta natë, domethonë nesër mëngjes e katërta. Na maroi Muharrem Misini, na maroi qat’ cigare, e pinëm të pestit ka dy tima, e krytëm."

Misini, shpëtimtari i Trepçës, u akuzua të nesërmen për “aktivitete armiqësore dhe kundërrevolucionare."[161]

Xhafer Nuli: “Edhe mandej ata jonë shku i kanë nxirrë me dhunë t’u i rreh qysh thojnë, i kanë nxerrë me dhunë… Tonë i kanë burgos. Dhjetë prej tyne i kanë çu për vepër penale i kanë dënu menjëherë, i kanë çu ka tre mujë ditë burg, kurse të tjetër i kanë çu në kundërvajtje. Mandej pas qasaj, pas qasaj ka fillu një fushatë e përgjithshme kështu krejt punëtorët, 1,214 punëtorë na kanë akuzu për kundërvajtje, listën prej 1,214 vetëve për kundërvajtje për

shkak të qasaj greve, 778 si me thonë, na kanë qitë prej pune, na kanë qitë prej punë krejt prej një deri në katër mujë ditë, … 778 suspendim kemi pasë… E mandej kemi, kemi fillu prapë, na nuk jemi nal na, vazhdimisht nuk jemi ndal. Mandej në vitin '90-të minatorët prapë aktivitet gjithërë, gjithërë kërkesa e parë ka qenë 'Lirona shokët prej burgu' edhe prapë kërkesat që i kemi pasë gjithë, qato kërkesa ata i grahshin punës vet. Mandej fillun protestat gjithpopullore nëpër Kosovë edhe nëpër kësi. Me 20 shkurt 1990, prapë në përvjetorin e grevës kanë ardhë minatorët prej Trepçës kanë ardhë në kamë deri te ura e Mitrovicës këtu për me shkue, për me ardhë me ju bashkangjitë turmës të studentave, turmës në protesta. Aty nuk i kanë lonë me hy, ja u kanë pru autobusat, ja u kanë qitë do autobusë, kanë dashtë m'i qitë në autobusa e me i çu në stadion. Atëherë një plan shumë mizorë ka qenë i tyne me i çu në stadion edhe aty me i qitë gaz lotësjellës edhe me i ngulfatë thjeshtë njerëzinë. Mirëpo, studentat ju kanë thonë, i kanë alarmu, 'Mos hypni'… Atëherë jonë bashkangjitë me studenta edhe qatë ditë osht' vra Selman Vojvoda te Ura e Gjakut… Unë aty s'kom qenë… Deri me 14 prill nuk kom mujt me shku në punë…I suspendum kom qenë po. Rreth 1,400 punëtorë u dënuan me nga një deri në tre muaj burgim."

Të Lirë

Më 24 prill 1990, Gjykata e Qarkut e Mitrovicës shpalli vendimin.

Burhan Kavaja: "Unë kam qenë i bindun se lirimi nuk ka me ardh shpejtë. Mirëpo, në seancën gjyqësore me 24 prill [1990], Ismet Emra, kryetari i trupit gjykus, po thotë, 'Të paditurit lirohen nga burgu sepse kanë qenë të ngarkum me aktakuzë…' edhe po ia nis po e lexon aktakuzën. Azizi nuk e ndëgjoi këtë pjesën e parë tha, 'Na paskan fikë bre Burhan'. Thashë, 'Jo, jo po lirohem.' 'Jo more', tha, 'ndëgjo ç'a po thotë'. Ai e lexojke, aktakuza ishte shumë e gjatë. Si e dëgjun këtë pjesën e parë të dispozitivit të vendimit, të aktgjykimit, menjiherë dulën gazetarët edhe e publikun atë. Juve s'ju kujtohet jeni të ri, ka qenë festë në tërë Kosovën. Në Mitrovicë janë mledhë përmi 200 mijë vetë, ka
qenë dy ditë para Bajramit. Njerëzit e kanë prish ngjinimin [agjërimin] edhe ka qenë kjo nji datë historike 24 prilli kur osht' prish Ramazani, osht' festu, osht' bo darsëm pop-ullore. Kena pasë me dhjeta mijëra njerëz që kanë ardhë me na uru lirimin. Bile-bile kajherë po më vjen keq edhe me përmend, po prej shtrëngimit të dorës {zgjat dorën} të cilën minatorët edhe tjerët na shtrengojshin kom pasë dhimbje tre-katër muj ma vonë. Seriozisht. Ajo ka qenë nji çashtje që njeriu prej nji dashnie, hareje, dashurie po ta bon edhe s'e kena ni në atë moment dhimbjet, unë tek ma vonë i kom pasë ni ato dhimbjet."

Bahtije Abrashi kishte shkuar në gjykatë me të birin, Gazmendin, ndërsa e bija, Linda, kishte mbetur në qendër dhe ashtu kishin dashur vetë pasi, duke mos e ditur vendimin, kishin frikë se mos shpërthente situata dhe nuk do ta kishin lejuar të hynte. "N'radio e ka dëgju gazetarin Musë Preniqi, gazetar i Radio Prishtinës … e unë e kam pa n'sallë që i ka kcy krejt karrigat edhe tavolinat për me dalë sa ma shpejtë me lajmëru. Edhe kjo ka vrapu qaq shumë, saqë edhe sigurimi është çuditë kur e kanë pa në koridor të sallës të gjykimit. Veç ia kom ni zanin, i kanë thanë serbisht, 'Ku po shkon? Ku po shkon? Qysh ke ardhë deri ktu?' Kjo tha, 'Une kom fluturu edhe kom ardhë deri ktu'. Kur mbërritën në shtëpi në Prishtinë, gjetën qindra njerëz që i

prisnin. Azizi doli n'ballkon i përshëndeti. Pat' edhe shumë fëmi, nxanësa të shkollës. I kisha unë nja dy-tri paketime bonbonjera edhe e çova ni fëmi, ni nip me ble krejt çka ka bonbone… Kështu që, vështirë ka qenë. Ndoshta po i shpjegoj pak ma lehtë, por s'ka qenë lehtë, s'ka qenë lehtë" (*Bahtije Abrashi*).

Në Stantërg regjimi kishte imponuar një drejtor të ri, Beqir Mehmetin.

Ibush Jonuzi: "Ne na kanë lirue me 24 prill, të vitit '90 prej burgu, të nesërmen jemi shkue në punë, jemi shku në punë unë edhe Burhani, jemi marrë vesh me shkue... Mu më ka tregu policia, ka pasë policë tonët, më kanë tregu policia që, 'Nuk bon me i leju me hy në zyre'…Edhe shkumë në zyre, [Beqir] na priti mirë, 'Mirë se keni ardhë, shqyqyr që u lirutë', krejt ato edhe prej këtij momenti tha, 'Une tërhiqna prej kësaj pozite se ju jeni për këtu, juve ju dojnë minatorët, juve ju donë poplli edhe ju me konë këtu'. Na i lëshun vendimet Këshilli i Punëtorëve se përfundojke procedura domethonë e mandatit. Edhe përsëri rizgjedhje për mu po flas për veti drejtor teknik, Këshilli i Punëtorëve e mur vendimin për rizgjedhje në mandatin e dytë. Shkumë disa herë, po s'kishe shancë."

Mehmeti u largua menjëherë. Ai u zëvendësua nga Rexho Dervišević. Qazim Shala ishte i lumtur që mbeti në pozitën e tij, madje e urdhëroi Dervišević-in të dëbonte plotësisht nga miniera të gjithë të pandehurit e procesit, një urdhër që ishte dhënë edhe nga qeveria e Serbisë. Pavar-ësisht se ishin të lirë, të akuzuarit për kundërrevolucion nuk e kishin jetën e lehtë.

Avdi Uka: "Tash, katër muj ditë, mu e më kanë ardhë dy inspektorët ë UDB-ës që ju thojshin atëhere. Të dy shiptarë, emnin shiptarë, emnin shiptarë. Jonë ardhë në shpi edhe kanë thonë, 'Kqyre Uko, ti nuk bon me shku me hi në miniere, që shkon kena me të lidhë menihere' {kryqëzon duart}. 'Ama me shkri mu ne nuk i hupi 20 vjet punë'. Ka thonë, 'Na jena policë, na nuk dhomë me shkrim, na po të thojmë shyp mos shko'. I kom marrë dy pushime, na i ka dhonë Burhani, pushima vjetor. Njo të atij viti që jena hi, njo të atina që jena dalë. I kena kry dy pushima, dy muj ditë, dy muj jena shku te mjeku kom marrë pushim mjekësor. I kom dorëzu ato dokumentat edhe une nuk jom hi mo në oborr të minierës, as në miniere, dej mas lufte."

U shfaq dilema e emigrimit.

Ibush Jonuzi: "Na thirrën mas ni kohe apet në Prishtinë, shkalla e dytë edhe Bajram Kelmendi thotë, 'Osht' rrezik apet me ju burgos'. Tubohem na edhe merremi vesh me shku për Slloveni. Azizi e Burhani e krejt ata vijnë qitu, e kom pasë shpinë e vjetër, këta të Mitrovicës, Mensur Fejza me do. Thojnë, 'Po shkojmë'…Thashë, 'Ishalla, kurrë s'më marrin, po nesër ne të më marrin, kurrë nuk dalë prej shpije. Më lutët hiç, u krye kjo punë, nuk ka forcë që më bind me dalë prej shpije, le të më burgosin'."

Dikush shkoi në Slloveni për pak kohë. Sefedin Istrefi dhe Milazim Istrefi emigruan në Düren, në Gjermani, ku themeluan klubin "Minatori." Tahir Salihu, Mursel Haziri dhe Ferid Feka emigruan në Suedi.

Bahtije Abrashi: "Ofertë për me shku në Gjermani, ofertë me shku në Zvicërr, disa oferta momentalisht. Ishim n'dilemë a me dalë, a jo? Se kena me i pasë pasojat shumë t'mdhaja. Ai mbetë pa punë, unë mbeta pa punë, Linda

punojke në televizion mbet pa punë. Edhe familja e gjanë për me na tregu se çka mundet, çfarë represionesh munden me ju bo, tre vllazën m'i qitën prej pune, dy gra t'vllaznive. Kështu që… edhe ishte dilema n'shpi, a po dalim, a po rrijmë, a çka po bojmë. Nuk flejta tanë natën. Në mëngjes po bisedojmë të katërtit, po thom, 'Nuk vdesim uni. Unë di me qepë, e kam maqinën ulna qepi'. Unë e kam profesionin edukatore, u dashke me pasë ni diplomë për… 'E çeli ni çerdhe, e kom sallonin e madh e boj çerdhe pesë-gjashtë fmijë, qe. Edhe ma në fund do të bohna taksist edhe aty fitoj. Ni gru taksiste'. E kisha kerrin golf. Kështu që, i dhashë ni kurajo familjes t'mos dalim, po rrijmë… Falë Zotit punum, askush profesionin e vet por nuk hjekëm keq."

Pas protestave, largimeve nga puna dhe arrestimeve, në 8 gusht 1990, shumë punëtorë të Trepçës u paraqitën në punë. "Me 8 gusht kur kemi shku e kanë pasë derën e mbyllun. Me të thonë të drejtën mu m'kanë lajmrue prej centrallës prej telefonave m'lajmrun, 'Vallahi e kanë rrethu krejt Trepçën diçka po bohet krejt ushtri jonë çu po m'doket'. Na kemi shku, kur kemi shku s'na kanë lonë me hy, thotë, 'Tash mo nuk bon me hy'. Kemi tentu me hy n'vendin e punës tonë. Kemi shku tre ditë rresht me hy n'vendin e punës tonë. Ma së mrami na ka dalë policia edhe na kanë dalë të armatosun në front. Bile-bile e kanë shpallë aty që na po dojmë m'u çu në kryengritje ashtu që me na inskenu njëfarë … Mirëpo, na thanë, 'Këtu s'dojmë me ju pa, nuk muni me ardhë'. Majtëm tubim një Këshill i Punëtorëve që na bajagi na nuk hekim dorë prej pune, na jemi punëtorë, mirëpo nuk na kanë lonë mo me shku, nuk kemi mujt me shku" (*Xhafer Nuli*).

Nga 2,860 minatorët shqiptarë, të cilët punonin në Stantërg para grevës, mbetën vetëm gjashtë.

160 Abrashi e Kavaja, *Epopeja,* f. 134-135.

161 Abrashi e Kavaja, Ibid., f. 136.

HISTORIA DHE KUJTESA

Xhafer Nuli: "Mas qasaj që na kanë lonë me punue kur kemi shku në ditën e parë me 28-in, atëherë i kom organizue edhe kom organizu me formu Sindikatën e Pavarur edhe atë ditë e kemi majt një mbledhje në restoran edhe e kemi shpallë, e kemi si me thonë konstitute Kryesinë edhe Sindikatën e Pavarur në mënyrë që me u lidh, me qenë ajo si lidhje n'mes grevës edhe Sindikatës. … Na menjëherë mandej, menjëherë kemi fillu, Sindikatën e kemi pasë, kemi fillu me bo aktivitete në mënyrë që me siguru mirëqenjen e punëtorëve me çfarëdo mënyre me ndihma. Edhe pse ish gadishmëria shumë e madhe e popullatës me ndihmu me ndihma të popullit. Edhe nga ana tjetër

mos me ndal aktivitetin, mirëpo ai aktivitet me vazhdue edhe ajo frymë si me thonë e kundërshtimit me qenë gjithë prezente… kur na largunë menjëherë të nesërmen ose të masnesërmen kemi marrë një ndihmë prej Gjakovës, nja 7000 kilogram miell. S'e di cila ndërmarrje, a Agimi a cila ka qenë, tybe nuk e di. Mandej, kanë fillu do ndihma me ardhë kadal-kadale. Ka qenë një, ka qenë një frikë e madhe, një si me thonë psihozë te njerëzit që çka do të bohet, do të vdesim uni. Mirëpo, ka qenë kështu një organizim i jashtëzakonshëm me ju tregu njerëzve që nuk ka, kërkush s'ka me vdek uni, kërkush s'ka me vujt për ushqim. Kemi me pasë vështirësi, mirëpo deri në realizimin e qëllimeve tona na nuk kemi m'u tërhjek prej këtyne synimeve tona."

Nëpërmjet nismës "Familja ndihmon familjen", familje të rajoneve të tjera në Kosovë u binjakëzuan me familjet e minatorëve, mbijetesa e të cilave ishte në rrezik. Por edhe Trepça vetë i vuajti pasojat, jo vetëm të të larguarit nga puna. Prodhimi ra me shpejtësi. Në vitin 1995, vlera e metalit të prodhuar zbriti në 2.6% të asaj që u prodhua në vitin 1988.[162] Me një fuqi punëtore "të pastruar" plotësisht nga shqiptarët, drejtimi i ndërmarrjes u vu nën përgjegjësinë e ministrisë së Energjisë dhe të Minierave, nga 1991 deri në 1993, nën drejtimin e Nikola Šainovićit, i dërguar i Miloševićit në Kosovë gjatë luftës. Në vitin 2009, Šainović u dënua nga Gjykata Ndërkombëtare për krime të luftës në ish-Jugosllavi dhe për krime kundër njerëzimit, përfshirë edhe dhunën seksuale.[163] Por kjo është një histori tjetër.

Që nga viti 2016, Trepça është një shoqëri aksionare, 80% e së cilës është në pronësi të qeverisë së Kosovës dhe 20% në pronësi të punonjësve, dhe përfshin minierat dhe përpunimin e Stantërgut, Kishinicës dhe Artanës, Kopaon-ikut dhe Leposaviqit. Disa nga punonjësit e vjetër nga periudha jugosllave kanë rifilluar punën pas luftës dhe kritikojnë përdorimin ekskluzivisht nxjerrës të minierave, duke folur për to si për një mundësi të humbur, përsëri, për shkak të shkurtpamësisë së klasës drejtuese. Ndërmarrja vazhdon të ketë humbje dhe mbështetet në subvencionet shtetërore, sepse prodhimi nuk arrin të as paguajë pagat. Ndër grevat më të fundit, ishte mbyllja 10-ditore në nëntor 2023, e shpallur nga punonjësit, të cilët kërkuan më shumë siguri — thuhet se 20 vetë kanë humbur jetën gjatë viteve të fundit — sigurime shëndetësore dhe rritje page. [164]

Pasuria më e madhe e Trepçës mbetet historia e luftërave të saj, veçanërisht gjatë viteve të fundit të Jugosllavisë. Interpretimet e grevës së vitit 1989 përkojnë në përcaktimin e asaj ngjarjeje si vendimtare për fatin e Jugosllavisë dhe të Kosovës, si nga pikëpamja e thyerjes, ashtu edhe e vazhdimësisë me të kaluarën. Por, nuk ekziston një konsensus se si të interpretohet e kaluara dhe as si të projektohet e ardhmja, sepse historia, të cilën greva kontribuoi ta ndryshonte nuk fillon e as nuk mbaron me grevën.

Për Serbinë, greva sigurisht që përfaqësoi thyerjen përfundimtare me kryesinë komuniste të Kosovës. Siç u pa, edhe përpara se minatorët të fillonin protestat, marrëdhëniet midis partive të Prishtinës dhe Beogradit ishin të tensionuara. Në vitin 1987, dy fejtone të publikuara në gazetat "Borba" dhe "Politika" ringjallën një proces të vjetër të vitit 1956, në të cilin shërbimet sekrete serbe dhe shqiptare ishin përpjekur t'i implikonin në një histori spiunazhi Fadil Hoxhën, Ymer Pulën dhe Xhevdet Hamzën, ish-komandantë partizanë dhe udhëheqës të Kosovës jugosllave pas luftës. Këta u shfajësuan menjëherë dhe u rehabilituan plotësisht në vitin 1966, por 20 vjet më vonë historia u ringjall për të provokuar dhe diskreditуar partinë e Kosovës. [165] Në

vitet 1988-1989 ishte Azem Vllasi, përfaqësuesi i brezit të ri të udhëheqësve krahinorë, i cili u identifikua si "jo besnik." Ambasadori amerikan, John Scanlan i tha Millosheviçit të mos bënte gabim duke arrestuar Vllasin, i cili ishte një shqiptar me besnikëri të dëshmuar jugosllave e që ishte përmbajtur nga shtytjet nacionaliste të disa grupeve politike.[166] Por Miloševići kishte plane të tjera. Greva, duke nxitur një lëvizje popullore që përfshiu gjithë Kosovën, ishte mundësi për t'i etiketuar të gjithë shqiptarët — nacionalistë dhe pro-jugosllavë — si terroristë, irreden-tistë dhe kundërrevolucionarë.

Presidenti i Jugosllavisë asokohe, boshnjaku Raif Dizdarević, kujtoi ngjarjet e vitit 1989 dhe para së gjithash grevën e Trepçës si epiqendrën e krizës jugosllave. Ne nuk ishim në gjendje t'i mbronim shqiptarët dhe bashkë me ta as serbët demokratë, duke përdorur mjetet e përcaktuara nga Kushtetuta."[167] Një ndjenjë të ngjashme keqardhjeje ai shprehu edhe në kujtimet e tij, ku ndalet më gjatë në rrëfimin e ngjarjeve të shkurtit dhe marsit 1989 për të justifikuar rolin e tij në shtypjen në Kosovë. [168]

Filozofi Shkëlzen Maliqi, anëtar i klasës intelektuale jugosllave dhe një analist i mprehtë politik, duke shkruar në kohën e ngjarjeve, erdhi në përfundim se greva dramatizoi lindjen "e shqiptarëve si subjekt politik në Jugosllavi."[169] Maliqi e përshkroi atë si një "intifadë shqiptare", "një kryengritje kombëtare në formën e grevës."[170] Ndërkohë që raportimet mediatike, si brenda, ashtu edhe jashtë, përqendroheshin konvencionalisht në gatishmërinë e minatorëve për t'u vetëflijuar në minierë, Maliqi vendosi një lidhje mes grevës dhe mobilizimit të nëntorit paraardhës, duke identifikuar elementin kombëtar: minatorët kishin thyer "bllokun psikologjik" që kishte paralizuar shqiptarët pas shtypjes së protestave të vitit 1981, duke penguar çdo demonstrim të identitetit kombëtar. Por Maliqi refuzoi t'i quante protestat "kombëtare" dhe sigurisht nuk i pa si "irredentiste." Tek e fundit, ndërsa demonstruesit serbë sillnin në protesta portrete të heronjve ikonikë të nacionalizmit serb si Vuk Karadžić apo Njegoš, grevistët shqiptarë kishin mbajtur portretin e Titos; kishin valëvitur si flamurin shqiptar, bashkë me të jugosllav; dhe kishin marshuar nëntë orë në borë për të mbërritur në kryeqytet, për të treguar se nuk ishin "transportuar" me autobusë në protestë, pra, me fjalë të tjera, nuk ishin të drejtuar nga lart si pjesëmarrësit serbë në kryengritjen "anti-burokratike."[171] Këto janë disa vështrime që synojnë ta shohin homogj-enizimin kombëtar si rezultat të zhvillimeve politike të momentit dhe jo si aspekt thelbësor të lëvizjes. Edhe Musić sugjeron se ishte "revolucioni anti-burokratik ai që i detyroi shqiptarët të ngriheshin kundër shtytjeve centralizuese."[172]

Për Maliqin, grevistët e Trepçës dallonin shumë nga protestuesit shqiptarë që, në vitin 1981, kishin kërkuar themelimin e një Republike të Kosovës. Minatorët kishin krijuar një "manifestim urban", ndërsa lëvizja e vitit 1981 ishte "një përzierje e demonstruesve urbanë dhe ruralë." Ky dallim bart kuptim politik në kontekstin e Kosovës, ku idetë panshqiptare kanë qenë gjithmonë më popullore në zonat rurale për arsye historike dhe sociale. Në fund të fundit, grevistët e Trepçës kishin treguar lidhjen e tyre me "Jugosllavinë, edhe pse me një Jugosllavi më të mirë nga ajo aktuale."[173]

Kur sistemi politik jugosllav u hap, menjëherë pas këtyre ngjarjeve, ndaj partive të tjera përveç Lidhjes Komuniste, Maliqi fillimisht u bashkua me grupin e ri që mblidhte nacionalitete të ndryshme, Uruženie Jugoslavenska Demokratska Iniciativa (UJDI, Shoqata për një Nismë Demokratike në

Jugosllavi), por që pati pak ose aspak fat në Kosovë. Më pas, me anëtarë të tjerë të Shoqatës së Sociologëve dhe Filozofëve dhe me Kaqusha Jasharin, themeloi Partinë Socialdemokrate, duke zgjedhur opsionin e një Jugosllavie pluraliste. Ndërkohë, të gjithë e kishin kthyer mbrapsht teserën e partisë dhe Jashari kujton me ironi se sa shumë kishte qarë disa vite më parë për të marrë atë kartelë.

Analiza politike e grevës nga Maliqi nuk ndryshon shumë nga ajo e sociologut, Besnik Pula, i cili më vonë shkroi se greva krijoi një ndarje, jo vetëm me Jugosllavinë socialiste, por edhe me traditën shqiptare të kryengritjes së armatosur. Sipas Pulës, përqendrimi tek armët ishte një formë lufte e rrënjosur në një kulturë rurale shumë më pak të sofistikuar se ajo socialiste. Jugosllavia, përkundrazi, i njoftoi shqiptarët me një repertor protestash të përbëra nga greva, marshime dhe negociata, duke formësuar një elitë kombëtare ndryshe nga ajo që dilte nga një mobilizim komplotist dhe i dhunshëm. Është e padiskutueshme se, duke filluar nga agjitacionet socio-politike të viteve 1988 dhe 1989, rezistenca civile dhe paqësore e shqiptarëve ndaj regjimit të Miloševićit filloi të merrte formë. Të gjithë këta studiues të Kosovës bien dakord se greva përgatiti kushtet për këtë. [174]

Edhe për gazetarin dhe shkrimtarin e vlerësuar, Mehmet Kraja, greva e Trepçës kishte dramatizuar homogj-enizimin kombëtar të shqiptarëve. Kraja ishte gjithashtu i bindur se identiteti kombëtar shqiptar kishte bërë një hap të madh përpara, duke çuar në zhdukjen e dallimeve të brendshme, një përfundim i ndryshëm nga ai i Maliqit. Ai mendon se greva krijoi një thyerje të pandreqshme, duke ekspozuar kotësinë e idesë se dikush mund të ishte njëko-hësisht shqiptar dhe jugosllav dhe aq më pak socialist. Kur apeli i 215 intelektualëve dhe profesion-istëve kundër ndryshimeve kushtetuese u përball vetëm me shtypje të ashpër, Kraja dhe kolegët e tij nga seksioni i kulturës së gazetës “Rilindja” vendosën të jepnin dorëheqjen nga Lidhja Komuniste. Brenda gjysmë ore, 20 prej tyre nënshkruan dorëheqjet; të tjerët pasuan menjëherë. [175]

Mehmet Kraja organizoi frontin e shqiptarëve kundërshtues me një grup të vogël shkrimtarësh dhe gazetarësh, duke përfshirë edhe kritikun letrar, Ibrahim Rugova. Në dhjetor të vitit 1989, ata themeluan Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), një parti masive shqiptare, që shpejt u bë parti-shtet, duke mbyllur çdo hapësirë për pluralizëm politik. Në vitin 1990, me largimin nga puna në masë të shqiptarëves, në radhë të parë nga policia dhe ushtria, u realizua *de facto* ndarja e Kosovës shqiptare nga Jugosllavia. LDK organizoi zgjedhje jozyrtare dhe krijoi një Republikë të Kosovës me Rugovën president. [176]

Me Mehmet Krajën u pajtuan anëtarët e lëvizjes ilegale shqiptare, të cilët u bashkuan me protestuesit në mbështetje të grevës, pa pankartat e tyre "Kosova Republikë" për arsye taktike. Greva, sipas tyre, kishte thyer mitin jugosllav të vëllazërisë dhe bashkimit kombëtar, duke zbuluar ekzistencën e një kombi shqiptar të përjetshëm dhe përje-tësisht antagonist ndaj Jugosllavisë socialiste.[177] Me këtë bindje, nacionalistët themeluan një strategji për çlirim që zgjodhi rrugën e armëve, ashtu siç kishin bërë lëvizjet e tjera shqiptare në historinë e kombit, duke gjetur frymëzim dhe motivim te legjendat e së kaluarës. [178]

Këto pikëpamje kundërthënëse rreth grevës tregojnë ndarje të rëndësishme të brendshme në shoqërinë shqiptare, pavarësisht homogjenizimit të saj, të

cilat përkojnë me grupe të ndryshme sociale dhe politike me ide të ndryshme se si ta shprehnin përkatësinë e tyre kombëtare, dhe gara e të cilëve për pushtet përbën një aspekt të vazhdueshëm të historisë së fundit politike të Kosovës. Madje pa u bërë 10 vjet nga greva e Trepçës, shfaqja e UÇK-së dhe shpërthimi i luftës përcaktoi fatin e një udhëheqësie politike ndryshe nga ajo që kishte udhëhequr Kosovën nëpër rezistencën paqësore ndaj agresionit serb gjatë viteve të '90-a.

Në Kosovën e sotme, kujtesa e grevës së minatorëve është e gjallë midis minatorëve që ende janë ndër ne e të cilët mblidhen çdo vit për të nderuar heroizmin e grevistëve. Por greva nuk zë vend qendror në kujtesën publike të pasluftës, e cila mbizotërohet nga historia e luftës çlirimtare. Një përjashtim nga kjo përbën emri i ekipit futbollistik të Mitrovicës: "Trepça 1989." Qeveria nuk e ka përkujtuar zyrtarisht grevën deri në vitin 2009, në 20-vjetorin e saj. Që atëherë e tutje, teoria e promovuar nga autoritetet ka qenë vazhdimisht e tillë që e trajton grevën si një thyerje me Jugosllavinë dhe si një vazhdimësi të lëvizjes kombëtare shqiptare. Në shkurt të vitit 2024, duke përkujtuar grevën, kryeministri Albin Kurti e vendosi atë në të njëjtin nivel ngjarjesh me deklaratën e pavarësisë së Kosovës, lindjen e UÇK-së dhe çlirimin nga Serbia. [179]

Nga shoqëria civile nisi një lloj kujtese paksa më ndryshe. Në 2023, organizata Oral History Initiative organizoi në Prishtinë një ekspozitë fotografish, të pasuruar me dëshmitë e protagonistëve, me titull, “Një vend i luftës politike: Miniera e Trepçës, 1989." Katalogu i ekspozitës bazohet në arkivin e historisë gojore të organizatës. Në të njëjtin vit, përmbledhja e historisë gojore “Kujtesa e Trepçës”, një tjetër arkiv i historisë gojore, u publikua nga organizata 7Arte e Mitrovicës në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës. Materiali i mbledhur nga këto nisma përbën bazën e këtij libri.

Nga historitë, që na i treguan shumë protagonistë, zbulojmë qëllimet, ambiciet dhe brengat individuale dhe kolektive, të cilat e ndërlikojnë interpretimin e grevës. Por, nëse në retrospektivë është e qartë që ky manifestim i madh popullor përshpejtoi tutje forcat shtytëse — që veç ekzistonin — drejt shpërbërjes së Jugosllavisë, është gjithashtu e vërtetë që ai ofroi një alternativë të mundshme ndaj fundit tragjik të vendit të saj.

[162] Palairet, *Trepça,* f. 13.

[163] Šainović et al. (IT-05-87).

[164] Pietro Aleotti, “Kosovo: Miniere di Trepca, tra scioperi e rivendicazioni il futuro passa (anche) da qui,” *Eást Journal,* 6 nëntor 2023.

[165] Petriti Imami, *Serbët dhe Shqiptarët ndër shekuj,* Samizdat B92, 2017, f. 134-135.

[166] Dusko Doder dhe Louise Branson, *Milosevic. Portrait of a Tyrant,* The Free Press, 1999, f. 60.

[167] Francesco Privitera, "Intervista a Raif Dizdarević," *Ricerche di Storia Politica* (1) 2000: 71-81, f. 80.

[168] Dizdarević, *La morte di Tito*, f. 400-428.

[169] Shkelzen Maliqi, "Greva në Trepçë," në *Nya e Kosovës, as Vllasi as Milosheviqi*, Knjiža zbirka KRT, [1989] 1999: 254-264, f. 264.

[170] Maliqi, Ibid., f. 253.

[171] Shkelzen Maliqi, "Po ndodhi edhe kombësitë," *në Nya e Kosovës*, f. 179-185, f. 181.

[172] Musić, *Making and Breaking*, f. 243.

[173] Maliqi, "Greva në Trepçë," f. 185.

[174] Besnik Pula, "The Emergence of the Kosovo 'Parallel State,' 1988-1992," *Nationalities Papers,* 32 (4) 2004: 797-826.

[175] Mehmet Kraja, *Vite të humbura,* Prishtinë: Rozafa, *1995*, f. 175-178.

[176] Malcolm, *Kosovo*, f. 347.

[177] Gëzim Krasniqi, "Revisiting Nationalism in Yugoslavia: An Inside-Out View of the Nationalist Movement in Kosovo," in *Debating the End of Yugoslavia*, Routledge, redaktuar nga Florian Bieber, A. Galijaš dhe Rory Archer, Routledge 2014: 225-240, f. 199-200.

[178] Anna Di Lellio e Stephanie Schwandner-Sievers, *"*The Legendary Commander: The Construction of an Albanian Master-Narrative in Post-War Kosovo," *Nations & Nationalism,* 12 (3) 2006: 513-529.

[179] https://me.rks-gov.net/en/blog/marking-of-the-35th-anniversary-of-the-miners-strike-at-trepca/

Lista e rrëfimtearËVE/eve

Kjo listë tregon për çdo rrëfimtar/e: moshën dhe rolin e mbajtur në momentin e grevës, datën dhe vendin e intervistës, emrin e intervistuesit/es dhe vendin ku gjenden intervistat e plota për konsultim. Në libër, kur emri i të intervistuarit/ës shoqëron tregimet e cituara në thonjëza, është në kursiv.

Bahtije abrashi, 45 vjeçe, kryetare e konferencës për aktivitete sociale të grave të kosovës, 14 shkurt 2022, prishtinë, anita susuri dhe renea begolli; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Hysamedin azemi, 50 vjeç, kryetar i presidencës së komitetit provincal të kosovës të lidhjes së komunistëve të jugosllavisë, 15 mars 2021, prishtinë, anita susuri dhe renea begolli; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Isuf beqiri, 30 vjeç, teknik i minierës në stantërg, 21 maj 2021, bajgorë, anita susuri, korab krasniqi dhe besarta breznica; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Remzije dauti, 49 vjeçe, mësuese, 13 qershor 2013, prishtinë, dafina beqiri dhe donjetë berisha; https://oralhistorykosovo.Org/sq/remzije-dauti/

Avni dinaj, 37 vjeç, gjyqtar hetues në gjykatën e qarkut në mitrovicë, 28 tetor 2021, mitrovicë, anita susuri, korab krasniqi dhe renea begolli; https://oralhistorykosovo.Org/sq/avdi-dinaj/

Minir dushi, 60 vjeç, inxhinier i minierës dhe akademik, 29 tetor 2018 dhe 24 nëntor 2022, prishtinë, anita susuri, korab krasniqi, kaltrina krasniqi dhe renea begolli; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Avni dushi, 49 vjeç, inxhinier i minierave, kuadër i këshillit ekzekutiv të kosovës, sektori i energjisë dhe minierave, 5 shkurt 2023, prishtinë, anita susuri dhe ana morina. Intervista e papublikuar.

Zeqir fejzullahu, 32 vjeç, ashensorist, 26 shtator 2022, mitrovicë, ridona berisha; në “kujtesa e trepçës. Rrëfime të 100 punëtorëve të trepçës." Vëllimi i dhjetë (ed.) Arsim canolli, 7arte, 2023.

Alije gashi tmava, 27 vjeçe, ekonomiste në stantërg, 21 mars 2022, mitrovicë, anita susuri dhe korab krasniqi; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Ramadan gjeloshi, 29 vjeç, teknik i minierës në stantërg, 25 maj 2021, stantërg, anita susuri, korab krasniqi dhe besarta breznica; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Asllan hasani, 40 vjeç, drejtues i lokomotivës në stantërg, 28 dhjetor 2022, mitrovicë, ridona berisha; në “kujtesa e trepçës. Rrëfime të 100 punëtorëve të trepçës." Vëllimi i parë (ed.) Arsim canolli, 7arte, 2023;

Vehbi haxhiu, 39 vjeç, drejtor i prodhimit në fabrikën e akumulatorëve, 14 tetor 2022, mitrovicë, miridonë syla; në “kujtesa e trepçës. Rrëfime të 100 punëtorëve të trepçës." Vëllimi i dhjetë (ed.) Arsim canolli, 7arte, 2023;

Valdete idrizi, 13 vjeçe, bijë minatori, 14 e 28 maj 2017, prishtinë dhe mitrovicë, erëmirë krasniqi dhe donjetë berisha; https://oralhistorykosovo.Org/valdete-idrizi/

Sefedin istrefi, 30 vjeç, mekanik në stantërg, 30 nëntor 2022, mitrovicë, ridona berisha; në “kujtesa e trepçës. Rrëfime të 100 punëtorëve të trepçës." Vëllimi i tetë (ed.) Arsim canolli, 7arte, 2023;

Kaqusha jashari, 43 vjeçe, kryetare në ikje e komitetit krahinor të kosovës së lidhjes komuniste të jugosllavisë, 2 qershor 2021, prishtinë, erëmirë krasniqi, anita susuri dhe besarta breznica; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Ibush jonuzi, 39 vjeç, drejtor teknik në stantërg, 28 korrik 2021, vushtrri, anita susuri, korab krasniqi dhe besarta breznica; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Nerimane kamberi, 22 vjeçe, poete dhe gazetare, 19 korrik 2021, nerodime (ferizaj), anita susuri dhe korab krasniqi; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Burhan kavaja, 46 vjeç, drejtor i minierës me flotacion në stantërg, 30 tetor 2020, prishtinë, anita susuri, korab krasniqi dhe besarta breznica; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Zeki loxha, 48 vjeç, drejtor i fabrikës së akumulatorëve, 29 dhjetor 2022, brezovicë, djellza jëlliqi; në “kujtesa e trepçës. Rrëfime të 100 punëtorëve të trepçës." Vëllimi i dhjetë (ed.) Arsim canolli, 7arte, 2023;

Beqir maliqi, 33 vjeç, drejtor i prodhimit në stantërg, 26 tetor 2020, stantërg, anita susuri, korab krasniqi dhe renea begolli; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Vjollca meha, 26 vjeçe, gjeologe në stantërg, 21 mars 2022, mitrovicë, anita susuri, korab krasniqi dhe renea begolli; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Xhafer nuli, 42 vjeç, drejtori i mirëmbajtjes në stantërg, 21 tetor 2020, mitrovicë, anita susuri, korab krasniqi dhe renea begolli; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Gani osmani, 28 anni, teknik i minierës në stantërg, 26 tetor 2020, stantërg, anita susuri, korab krasniqi dhe renea begolli; https://oralhistorykosovo.Org/research/miners-strike-1989

Isuf peci, 35 veç, teknik i minierës në stantërg, 17 maj 2021, stantërg, anita susuri, korab krasniqi dhe besarta breznica; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Xhafer peci, 31 vjeçe, inxhinier, stantërg, 21 tetor 2020, anita susuri, korab krasniqi dhe renea begolli; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Shyqyri sadiku, 26 vjeç, teknik i minierës në stantërg, 29 tetor 2020, stantërg, anita susuri, korab krasniqi dhe renea begolli; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Tahir salihu, 34 vjeç, minator në stantërg, 23 shtator 2022, mitrovicë, arditë

aliu; në “kujtesa e trepçës. Rrëfime të 100 punëtorëve të trepçës." Vëllimi i nëntë (ed.) Arsim canolli, 7arte, 2023;

Avdi uka, 46 vjeç, minator në stantërg, 23 korrik 2021, vushtrria, anita susuri, korab krasniqi dhe besarta breznica; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Azem vllasi, 51 vjeç, anëtar në ikje i kryesisë së komitetit krahinor të kosovës së lidhjes komuniste të jugosllavisë, 23 korrik 2021, rubofc (kamenicë), anita susuri, korab krasniqi dhe besarta breznica; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Adem vokshi, 37 vjeç, avokat/profesionist i pavarur, 6 tetor 2021, prishtinë, anita susuri, korab krasniqi dhe renea begolli; https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/

Nexhmi zeqiri, 31 vjeç, mjek në stantërg, 29 mars 2022, prishtinë, anita susuri dhe renea begolli. Https://oralhistorykosovo.Org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/